

ABDURRAHIM BALLA

E VËRTETA E QARTË



E VËRTETA E QARTË

Përgatiti

Abdurrahim Balla

Me emrin e Allahut Mëshirëgjërës Mëshirëplotit.

Falenderimi i takon vetëm Allahut, vetëm Atë falenderojmë! I kërkojmë ndihmë, falje dhe mbrojtje nga të këqijat e veteve tona e nga të këqijat e punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu nuk ka kush e humb dhe atë që Ai e humb nuk ka kush e udhëzon! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.

"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun ashtu siç duhet pasur frikë Ai dhe mos vdisni ndryshe veçse duke qenë muslimanë".

"O njerëz! Jini të bindur (dhe përmbushni detyrimet) ndaj Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një vetje (Ademit) dhe nga ajo, krijoi palën (bashkëshorten) e saj. Nga ata të dy, Ai krijoi burra dhe gra të shumtë. Kijeni frikë Allahun, nëpërmjet të Cilit ju kërkon të drejtat e ndërsjella, dhe mos i ndërprisni marrëdhëniet me të afërmit. Allahu është Vëzhgues mbi ju".

"O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun dhe flisni fjalë të drejta. Ai do t'ju drejtojë ju tek veprat e mira dhe do t'ju falë juve gjynahet tuaja. Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, me të vërtetë që ka arritur fitore të madhe".

Fjalët më të vërteta janë fjalët e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit sal-IAllahu alejhi ue selem. Gjërat më të këqia janë gjërat e shpikura! Çdo shpikje është bidat, çdo bidat është humbje dhe çdo humbje të çon në zjarr!

Një prej mirësive më të mëdha që i ka bërë Allahu besimtarëve është se ua ka plotësuar fenë dhe mirësinë e Tij ndaj tyre. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **"Sot e plotësova për ju fenë tuaj. Plotësova mirësinë Time ndaj jush dhe jam i kënaqur që feja juaj të jetë Islami"** [El Maideh 3].

Allahu Madhëruar i zbriti profetit sal-I Allahu alejhi ue selem për 23 vjet rrjesht, pjesë - pjesë këtë libër të madh i cili është mrekullia e përjetshme e muslimanëve që e kanë në duart e tyre.

Në Kur'an gjenden lajmet e atyre që kanë qënë para nesh, lajmet e atyre që do të vijnë pas nesh. Ai është gjykuesi ndërmjet nesh. Ai është i vërtetë, jo tallje. Çdo mendjemadh që largohet prej tij ia thyen Allahu kurrizin. Kush e kërkon udhëzimin tek diçka tjetër veç tij humbet. Ai është litari i fortë i Allahut. Përkujtimi që përmban urtësitë. Ai është rruga e drejtë. Kush e ndjek atë nuk e humbasin dëshirat. Ky është ai libër me të cilin nuk ngopen dijetarët, nuk ngatërrohen në leximin e tij besimtarët. Nuk vjetërohet prej leximit të shumtë. Çuditë e tij nuk mbarojnë. Sa e dëgjuan xhindët thanë : **"Ne kemi dëgjuar Kur'anin mahnitës"**. Kush flet duke u bazuar në të

ka thënë të vërtetën. Kush gjykon me të ka gjykuar drejt. Kush punon me të shpërblehet. Kush fton për tek Ai është udhëzuar në rrugën e drejtë.

Transmeton Imam Taberiu nga Ibn Ab-basi se ka thënë : “I ka premtuar Allahu atij që e lexon Kur’anin dhe e ndjek atë, që të mos e humbasë atë në dynja dhe të mos e ndëshkojë në Ahiret”. Më pas tregoi fjalën e Allahut që thotë : **“Kush ndjek udhëzimin Tim nuk humbet dhe nuk shkatërrohet”** [Taha 123] ¹.

Por Allahu i Madhëruar për ta plotësuar edhe më shumë mirësinë e Tij ndaj besimtarëve u dërgoi atyre profetin e Tij të fundit sal-l Allahu alejhi ue selem dhe ua bëri detyrë atyre ta ndjekin atë dhe të dëgjojnë fjalën e tij nëse dëshirojnë të jenë të udhëzuar në këtë jetë dhe të shpëtuar në jetën tjetër.

Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Kush i bindet të dërguarit i është bindur Allahut”**. [En-nisa 80]. Shikoje si e ka konsideruar Allahu i Madhëruar bindjen ndaj profetit të tij sal-l Allahu alejhi ue selem bindje ndaj Allahut.

Ka thënë Imam Ahmedi : “E kam lexuar Kur’anin dhe e kam gjetur (urdhëra për) bindjen ndaj profetit sal-l Allahu alejhi ue selem në 33 ajete. Më pas këndoi ajetin që thotë : **“Të ruhen ata që kundërshtojnë urdhërin e tij se mos u bjerë ndonjë fitne”** [En-nur 63]. E përsëriti këtë ajet disa herë dhe tha : Ç’është fitneja? U përgjigj : Është shirku. Nëse njeriu nuk e pranon ndonjë fjalë të profetit sal-l Allahu alejhi ue selem mund të hyjë në zemrën e tij devijimi dhe të shkatërrohet. Më pas këndoi ajetin që thotë : **“Pasha Allahun nuk kanë besuar deri sa të të marrin ty gjykues në mosmarrveshjet ndërmejt tyre”**. [En-nisa 65]” ².

Për këtë arsye ka thënë profeti sal-l Allahu alejhi ue selem në hadithin që e transmeton El Mikdam ibn Ma’dij kerib : **“Mua më është dhënë Libri dhe një gjë e ngjashme me të”** ³. D.m.th Kur’ani dhe urtësia ose sun-neti.

Prandaj detyra e besimarit është të ndjekë këto të dyja nëse dëshiron udhëzimin në këtë jetë dhe shpëtim në botën tjetër. Gjithashtu i bashkangjitet Kur’anit dhe Sun-netit ixhmau ose mund ta quajmë rënia dakord e umetit Islam. Por kjo e treta bazën e ka tek Kur’ani dhe Sun-neti, kështu që burimi i pastër i udhëzimit ndodhet tek Kur’ani dhe Sun-neti i profetit sal-l Allahu alejhi ue selem.

Në të kundërt Allahu na ka paralajmëruar që të ruhem i prej ndjekjes së mendimit të pabazuar në Kur’an dhe Sun-net ose që bie në kundërshtim me Kur’anin dhe Sun-netin. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Ata nuk ndjekin gjë tjetër veç mendimit por mendimi nuk e zë vendin e të vërtetës”** [En-nexhm 29].

¹ Tefsiri i Taberit 18/389.

² Es-sarim El Meslul i Ibn Tejmijes 1/59.

³ Transmeton Ebu Daudi nr 4606. Hadithin e saktësoi Albani.

Ka thënë Ibn Tejmije : “I ka qortuar Allahu në librin e Tij ata të cilët i fshehin argumentet dhe udhëzimin që i ka zbritur Allahu i Madhëruar. Këta zgjodhën rrugën e fshehjes së të vërtetës sepse bie në kundërshtim me mendimin e tyre. Për këta ka thënë Umeri radi Allahu anhu : “Ruhuni nga ndjekësit e mendimit sepse ata janë armiq të sun-netit. I lodhi mësimi përmendësh i sun-netit dhe u rrëskiti prej duarsh dhe nuk e kuptuan. U pyetën në fe dhe u përgjigjën me mendimin e tyre” ⁴.

Ka thënë Ibn Tejmije gjithashtu : “Me anë të marrveshjes së Hudejbijes u arrit një fitore të cilën e dinte vetëm Allahu edhe pse shumë prej muslimanëve nuk e pëlqyen këtë sepse nuk e dinin përfundimin e mirë që kishte. Ka thënë Sehl Ibn Hunejf : **“O njerëz akuzojeni mendimin tuaj. Unë sikur të kisha mundësi ta ktheja mbrapsht urdhërin e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem ditën kur erdhi Ebu Xhendel (ditën e Hudejbijes) do ta kisha bërë”** ⁵ ” e ka transmetuar Buhariu edhe të tjerë” ⁶.

Begatia më e madhe dhe përfundimi më i mirë është tek ndjekja e Kur’anit dhe Sun-netit dhe largimi nga Kur’ani dhe Sun-neti duke ecur me mendime është shkaku i humbjes dhe dështimit të muslimanëve ndër kohëra.

Ndjekja e mendimit të pa ndriçuar me dritën e Kur’anit dhe Sun-netit dhe e mendimit që bie ndesh me Kur’anin dhe Sun-netin u shtua edhe më shumë pas tre brezave të mirë të cilët i ka lavdëruar profeti sal-I Allahu alejhi ue selem.

E sa më shumë kalojnë vitet, dekadat e shekujt aq më shumë largohen njerëzit nga ndjekja e Kur’anit dhe Sun-netit të profetit sal-I Allahu alejhi ue selem. Derisa mbërriti çështja në kohën tonë në atë gradë që çdokush mund ti japë të drejtë vetes për ta kundërshtuar Kur’anin dhe Sun-netin e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem për shkak të çdo lloj dobie që i duket atij e tillë me mendjen e tij. E kjo është fatkeqësia dhe realiteti i hidhur që ne jetojmë sot në kohën tonë.

Sot ne jetojmë në një kohë të çuditshme. Çdo kush pretendon se ndjek Kur’anin dhe Sun-netin e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem me gojë edhe pse realiteti e kundërshton qartë atë pretendim. Për këtë arsye u ngatërrua e vërteta me të kotën në shumë çështje. Çdokush pretendon se është në të vërtetë por nuk shohim unitetin

⁴ Der’ Tearudh El Akl ue En-nekl 3/9.

⁵ E tha Sehli radi Allahu anhu këtë gjë sepse ditën e Hudejbijes kur bëri marrveshjen profeti sal-I Allahu alejhi ue selem me mushrikët vendosën si kusht që profeti sal-I Allahu alejhi ue selem të kthejë mbrapsht çdo musliman që vjen nga Meka për në Medine dhe profeti sal-I Allahu alejhi ue selem e pranoi këtë kusht me urdhër prej Allahut. Në të njëjtën kohë që u nënshkrua marrveshja vjen Ebu Xhendel nga Meka. Kishte dalë fshehurazi për të shpëtuar prej mushrikëve. Atëherë i thanë mushrikët profetit sal-I Allahu alejhi ue selem: Ky është rasti i parë që duhet të zbatosh marrveshjen. U detyrua profeti sal-I Allahu alejhi ue selem të qëndronte brenda marrveshjes dhe i tha Ebu Xhendelit kthehu se Allahu do tju bëjë rrugëdalje. Shumë muslimanë nuk e pëlqyen këtë dhe për këtë arsye e tha Sehl Ibn Hunejf fjalën që përmendëm. Por më mbrapa e kuptuan muslimanët që ajo që veproi profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ishte fitorja e vërtetë.

⁶ Mexhmu’ El Fetava 35/60.

që është fryti i ndjekjes së kësaj të vërtete. Gjë që tregon se jo të gjithë janë në të vërtetën edhe pse ky gabim nuk d.m.th që ne ti quajmë ata mëkatarë. Allahu e di çfarë ka çdokush në zemrën e tij dhe po Ai e di se sa i justifikuar është çdokush tek Allahu për gabimin e tij. Çështja këtu nuk është të gjykojmë për njerëzit por të gjejmë ku është e vërteta që na duhet ne muslimanëve për të qënë të udhëzuar në këtë jetë dhe të shpëtuar në jetën tjetër.

Një prej çështjeve që kanë hapur bisedime të gjera tek muslimanët në mbarë botën Islame gjithashtu së fundi edhe në vendin tonë ishte çështja : A u lejohet muslimanëve të hyjnë në politikë, qoftë kjo duke hyrë në kuvend apo në dikastere të tjera të shtetit me qëllim për të rregulluar sadopak gjëra në dobi të muslimanëve? Gjithashtu i bashkangjitet kësaj çështjeje edhe një çështje tjetër që është : A u lejohet muslimanëve të votojnë apo jo?

Ndodhën disa sprova për muslimanët gjatë kësaj mosmarrveshjeje dhe dolën në pah ato gjëra që fshiheshin në zemër. Lus Allahu e Madhëruar ta shfaqë të vërtetën dhe ti bashkojë zemrat e muslimanëve tek e vërteta. Dolën akuza të pa bazuara tek e vërteta dhe as tek realiteti. E gjithë kjo ishte një sprovë prej Allahut për besimtarët që të shohë kush prej tyre do ta kërkojë të vërtetën me sinqeritet! Kush prej tyre do ta ruajë gojën e vet prej gibeit! Kush prej tyre do ta ruajë zemrën prej mendimit të keq! Kush prej tyre do ta ruajë gjuhën prej akuzave! E të tjera urtësi që nuk është këtu momenti për ti treguar edhe pse janë edhe më të mëdha se këto që përmenda. Falenderimi i takon vetëm Allahut për çdo gjë. Ai ka urtësi të madhe në çdo gjë që bën. Ajo që më shqetëson duke shikuar gjendjen e muslimanëve është fakti që këtë sprovë kaq të vogël shumë prej tyre nuk e kaluan dot por u zhytën në të, kush më shumë e kush më pak. Po sikur të ndodhin sprova më të mëdha!! Kam frikë se nëse do ndodhin sprova më të mëdha aty ka për tu ndarë shapi nga sheqeri. Do dalë në pah kush e do Allahun me të vërtetë dhe kush e do Allahun vetëm kur nuk ka sprova. Allahu na ruajtë besimin deri në vdekje.

Duke parë gjithë mosmarrveshjet që kanë ndodhur në lidhje me këtë çështje e pashë të udhës që të shkruaja këtë libër që ndodhet përpara teje me qëllim që të tregoj atë që ka urdhëruar Allahu dhe i dërguari i Tij sal-l Allahu alejhi ue selem në këtë çështje. Kjo është detyra jonë, të ndjekim atë që ka urdhëruar Allahu dhe i dërguari i Tij sal-l Allahu alejhi ue selem.

Mbase dikush mund të thotë : A ka folur Allahu dhe i dërguari i Tij sal-l Allahu alejhi ue selem për këtë çështje? I themi : Patjetër. Allahu na ka treguar në fenë tonë çdo gjë që na nevojitet dhe profeti i Tij sal-l Allahu alejhi ue selem e ka transmetuar fenë në formën më të plotë dhe ai gjithashtu na ka treguar çdo gjë që na nevojitet në fenë dhe jetën tonë. Kemi nevojë vetëm të njohim atë që na ka urdhëruar Allahu i Madhëruar dhe i dërguari i Tij sal-l Allahu alejhi ue selem.

Përpara se të hyjmë në temë duhet të trajtojmë disa çështje që na ndihmojnë për të njohur të vërtetën dhe arsyen pse kanë rënë në kontradiktë njerëzit në këtë çështje e në shumë çështje të tjera si kjo.

Ka thënë Ibn Tejmije kur është pyetur për Mongolët : “Njohja e gjykimit Islam për ta ka lidhje me dy çështje : **1.** Njohja e veprimeve të tyre dhe **2.** Njohjen e gjykimit të Allahut në lidhje me njerëz të tillë si ata” ⁷. Ky është një rregull shumë i rëndësishëm në lidhje me çdo çështje Islame.

Nëse personit – që jep gjykimin – i mungon njëra prej këtyre dy pikave, gjykimi i tij është i predispozuar të jetë gabim. Prandaj ai që nuk e njeh realitetin duke e përjetuar atë vetë ose duke e dëgjuar atë prej një numri njerëzish të besueshëm që e kanë përjetuar atë, nuk ka mundësi të nxjerrë gjykim të drejtë në lidhje me atë realitet. Por kjo nuk mjafton, duhet që njeriu të njohë edhe gjykimin që ka dhënë Allahu dhe i dërguari i Tij sal-l Allahu alejhi ue selem në lidhje me këtë realitet. Kush i plotëson këto të dyja, ai ka për të qënë më afër se të tjerët me të vërtetën por nuk ka njeri të pagabueshëm.

▪ **Çështja e parë : Realiteti i ndjekjes se Kur’anit dhe Sun-netit.**

Shumë herë më janë ankuar vëllezërit kur u tregojmë të vërtetën në ndonjë çështje se dikush thotë të kundërtën e asaj që thua ti dhe ju që të dy pretendoni se ndiqni Kur’anin dhe Sun-netin. Për këtë arsye është e nevojshme të tregojmë disa gjëra në lidhje me realitetin e ndjekjes së Kur’anit dhe Sun-netit.

Ka shumë çështje fetare në të cilat dijetarët kanë disa mendime të ndryshme. Normalisht që në një çështje, dy mendime të ndryshme nuk mund të jenë të sakta të dyja. Njëri është i saktë e tjetri gabim. Këto mendime marrin vlerë edhe më të madhe kur ato janë të bazuara që të dyja në argumente të qarta fetare nga Kur’ani dhe Sune-neti i profetit sal-l Allahu alejhi ue selem. Ndërsa nëse njëri mendim nuk është i bazuar në argument të qartë ose nuk ka argument fare ai e humbet vlerën e tij si mendim në bazë të largësisë që ka nga argumentet fetare edhe pse ai dijetar që e ka thënë atë mendim mund të jetë i justifikuar tek Allahu. Çështja jonë nuk ka të bëjë me ato raste kur të dyja palët kanë argumente të qarta.

Gjatë vëzhgimit të realitetit del në pah se në një numër çështjesh – të cilat në disa raste nuk kanë të bëjnë vetëm me një person por me të gjithë muslimanët – baza fetare e atyre që i mbështesin ato mendime nuk janë argumentet e Kur’anit dhe Sun-netit por disa fetva të një apo më shumë dijetarësh. Problemi qëndron se muslimanët duke pasur mendim të mirë më shumë se ç’duhet, për atë person që e pyesin, nuk e pyesin për argumentet fetare por vetëm për gjykimin që ka çështja. E më pas, kur

⁷ Mexhmu’ El Fetava 28/510.

dikush e kundërshton këtë gjykim thonë por edhe filani me argumente ka ecur. Por po të gërmosh do gesh që mendimi i tij është bazuar në fjalën e dikujt që mund të jetë prej dijetarëve e ky dikush mbase është bazuar në fjalën e dikujt tjetër, po me mendim të mire, deri sa në fund të zinxhirit del një dijetar që thotë ky është thjesht mendim!!

Prandaj është shumë e rëndësishme që njeriu të kërkojë argumente prej atij që i jep fetva. Shih përshebull një rast. Kam lexuar në një faqe interneti që një person e lejonte hyrjen në kuvend sepse kishte lexuar një fetva të disa personave mbase edhe të panjohur për shumicën e muslimanëve. Ai e shprehte vet, që këtë bindje e kishte arritur sepse këta persona e kishin studiuar këtë çështje për gjashtë vjet!! Më pas ky person ua thotë xhematit këtë çështje si të mbaruar... Xhemati nuk pyet se ku janë argumentet për këtë gjë. E në fund kur dikush e kundërshton këtë mendim të thonë : Por edhe filani Kur'anin edhe Sun-netin ndjek. Po, unë e kuptoj që ai ndjek Kur'anin dhe Sun-netin por në këtë çështje nuk është duke ndjekur Kur'anin dhe Sun-netin!!

Apo raste të tjera që dikush mund të justifikohet për ndonjë qëndrim të gabuar që ka mbajtur, duke thënë se ai ka pyetur për këtë çështje!! A kjo është ndjekja e Kur'anit dhe Sun-netit?! Po qe se marrja e mendimit të dikujt kushdo qoftë ai prej bashkëkohorëve konsiderohet ndjekje e Kur'anit dhe Sun-netit atëherë do ishte më mirë për ne që të kishim mbajtur një medhheb prej medhhebeve të njohura të dijetarëve të hershëm. Mendimi i Imam Ebu Hanifes apo Malikut apo Shafiut apo Ahmedit apo dikujt tjetër prej dijetarëve të selefëve është më i dashur për ne se mendimi i çdokujt tjetër që ka ardhur pas tyre. E përderisa ne e lamë mendimin e tyre me justifikimin se duhet të ndjekim Kur'anin edhe Sunetin, nuk mund të bëjmë fe mendimin e çdokujt tjetër që ka ardhur pas tyre. Këtë nuk e lejon as feja dhe as logjika e shëndoshë.

Ibn Tejmija ka thënë : “Janë të qortuar ata që e panë të vërtetën dhe e lanë atë ose neglizhuan në kërkimin e saj ose i kthyen shpinën duke mos e kërkuar atë për shkak të përtacisë ose shkak tjetër” ⁸.

Kështu që këta edhe pse mund të justifikohen se po ndjekin fetvanë e dikujt ata janë brenda këtij qortimi përderisa atyre u ka ardhur argumenti dhe i kanë kthyer shpinën atij.

Kështu që, nuk i takon njeriu të justifikohet se për këtë apo për atë çështje ka marrë fetva sepse fetvatë nuk janë argumente fetare. E megjithatë nëse ti ecën me një fetva nuk të lejohet ti detyrosh njerëzit të ecin me të, kur ti vetë nuk e di se ku bazohet ajo fetva. As ti quash të humbur ata që nuk kanë këtë mendim që bazohet në këtë fetva sepse kjo është humbja e vërtetë.

⁸ Iktidau Es-sirat El Mustekim 2/85.

Të pretendosh se kjo është e vërteta sepse buron prej gojës së një dijetari sa do i mirë qoftë ai, ky është gabim shumë i rëndë. Sa do i madh që të jetë ai dijetar ai ngelet njeri. Sa do qoftë numri i atyre dijetarëve ata janë njerëz dhe mund të bien dakord për diçka që është gabim. Apo jo?! Përderisa nuk ka Ixhma (rënie' dakord të umetit Islam) në këtë çështje.

E vërteta nuk njihet nga kush e thotë atë dhe as nga numri i atyre që e thonë atë. Kurrë nuk mund të ekzistojë kjo në fenë e Allahut. Lexoje këtë ngjarje :

Pas luftës së Bedrit profeti sal-I Allahu alejhi ue selem u mori mendimin sahabëve se çfarë të veprojnë me robërit e luftës, a ti vrasë apo ti lirojnë? Ebu Bekri i dha mendimin që ti lirojnë ndërsa Umeri i dha mendimin që ti vrasë. Të nesërmen kur shkon Umeri tek profeti sal-I Allahu alejhi ue selem e gjeti atë dhe Ebu Bekrin duke qarë dhe i pyeti (pse qanin). Tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : Po qaj për shkak të mendimit që më dhanë shokët e tu, që ti liroj robërit e luftës sepse Allahu më tregoi ndëshkimin ⁹ e tyre më afër se kjo pema ¹⁰.

Ai që kundërshtoi ishte vetëm Umeri radi Allahu anhu. Ndërsa profeti sal-I Allahu alejhi ue selem dhe sahabet ishin me atë mendin të cilin të nesërmen e qortoi Allahu i Madhëruar madje i kërcënoi me ndëshkim në ajetin që thotë : **“Sikur mos e kishte shkruar më parë Allahu ¹¹ do t’ju kishte ndëshkuar me një ndëshkim të madh për shkak të asaj që morët”**. [El Enfal 68].

Meditoje këtë ngjarje se ajo është shumë e dobishme për atë që dëshiron të kuptojë të vërtetën. Gjithë ai numër sahabesh edhe profeti sal-I Allahu alejhi ue selem me ta e përsëri gabuan dhe ai që e qëllloi ishte vetëm Umeri radi Allahu anhu!

Ajo që përfitojmë nga kjo ngjarje është se e vërteta nuk njihet me numrin e atyre që e mbështesin atë por njihet me mbështetjen e Kur’anit dhe Sun-netit të profetit sal-I Allahu alejhi ue selem.

Në të kundërt mos gjyko për një çështje që ajo është gabim sepse ajo del prej gojës së atij që ti e urren ose e konsideron armik, qoftë edhe armik i vërtetë. Sot shohim shumë njerëz që gjykojnë se një çështje është gabim sepse e thotë filani. Kjo është çudi!! Po të ishte kjo e saktë atëherë duhet që ne muslimanët ta heqim ajetin Kursij nga Kur’ani sepse shejtani shkoi tek Ebu Hurejreh radi Allahu anhu dhe i tha : “Lexoje ajetin Kursij çdo natë...” ¹². Po të ecte Ebu Hurejre me mendjen e shumë njerëzve sot

⁹ Dmth ndëshkimin e sahabëve që i dhanë mendimin profetit sal-I Allahu alejhi ue selem që ti lironte. Nuk tregohet në hadith me sa kam parë që ndonjë njeri tjetër veç Umerit të kishte mendimin e tij.

¹⁰ E kam shkurtuar hadithin dhe përmendur me kuptim. Hadithin e transmeton Muslimi nr 4687 edhe të tjerë.

¹¹ Që nuk do ti ndëshkojë ata që morën pjesë në Bedër dhe se Ai do tua lejonte plaçkën e luftës... do t’ju kishte dënuar.

¹² Transmeton Buhariu nr 2187. Hadithin e kam shkurtuar dhe treguar me kuptim.

do thoshte : Përderisa ma tha shejtani i cili është armik i përbetuar i njeriut këtë gjë, kjo d.m.th që ajeti Kursij nuk qenka ajet Kur'ani në të vërtetë!!

Kështu që ka mundësi që njeriu i mirë të thotë fjalën e gabuar dhe njeriu i keq të thotë fjalën e vërtetë. Prandaj e vërteta dhe e kota nuk njihet prej asaj që del prej gojës së njerëzve, kushdo qofshin ata. Mbaje vath në vesh këtë.

Ai person që dëshiron ti bindë njerëzit se kjo apo ajo çështje është e vërtetë sepse e thotë filani dhe kjo është e kotë se e thotë filani, ai ka gabuar rëndë. Madje ai ua ka treguar njerëzve në formë të qartë që nuk po ndjek Kur'anin dhe as Sun-netin por po ndjek mendimet e njerëzve me anë të të cilave po argumentohet për atë që pretendon si të vërtetë.

Këtu kemi edhe një çështje tjetër. Dikush mund të thotë : Këto fetva janë fetvatë e dijetarëve dhe ne i duam dijetarët dhe i respektojmë ata. Kështu që do ecim me mendimin e tyre.

I themi : Të gjithë ne i duam dijetarët dhe i respektojmë ata. Por kjo nuk do të thotë që ne të ecim verbërisht me atë që thonë ata. Sepse dijetarët nuk janë të pagabueshëm. Teorikisht këtë e dinë të gjithë, por në praktikë shumë njerëz të akuzojnë vetëm pse thua që filan dijetar ka gabuar.

▪ Çështja e dytë : Një prej rregullave bazë në temën e argumentimit.

Kalojmë tek një çështje tjetër shumë e rëndësishme. Disa njerëz me të drejtë thonë : O vëlla, siç pretendon ti se ke argumente ashtu pretendon edhe tjetri se ka argumente. E me të vërtetë sjell argumente.

Përgjigje : Në lidhje me këtë çështje dua të flas për fakte konkrete që kanë të bëjnë vetëm me çështjen tonë sepse nuk është e drejtë ta përgjithësoj, për arsye se dikush mund të gabojë në një çështje por kjo nuk d.m.th se ai gabon në çdo çështje.

Unë e di që edhe ata që e lejojnë hyrjen në kuvende kanë argumente edhe pse për mua ato nuk hyjnë në rangun e argumenteve. Këtë gjë do ta vërtetoj tani me lejen e Allahut të Madhëruar pasi të tregoj thelbin e çështjes dhe kushtin bazë që duhet të ketë një argument që të quhet argument.

Të gjithë muslimanët duke futur këtu edhe grupet e humbura nëse do ti pyesësh për mendimet dhe besimet e tyre do të të argumentohen me argumente nga Kur'ani dhe nga Sun-neti. Nuk është e vështirë për askënd që të gjejë për mendimin e tij argumente qofshin ato të vërteta apo jo. Por e vërteta – o ti që e kërkon atë – kërkohet prej argumenteve të qarta. Ka thënë profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : “Ju

kam lënë në një (rrugë) të bardhë, nata e saj është si dita e saj. Nuk humbet prej saj vetëm se ai që është i shkatërruar” ¹³.

Atëherë vëlla i nderuar, nuk është vështirë të gjesht një argument, por çështja është të gjesht e të mbështetesh tek argumentet e qarta si dielli nëse dëshiron të shpëtosh veten.

Shikoje këtë shembull që ka treguar një prej dijetarëve për argumentimin e gabuar ku thotë : “Nuk është kusht që bidati të mos ketë asnjë argument qoftë edhe të përgjithshëm. Përkundrazi argumentet e përgjithshme mund të tregojnë se kjo vepër në përgjithësi është e ligjshme, por jo duke e kufizuar me disa kufij të veçantë. Si psh: Allahu ka thënë në Kur’an : **“O ju që keni besuar përkujtojeni Allahun shumë”**. [El Ahzab 41]. Por kjo nuk d.m.th që lejohet të thërresësh ezan për namazin e Bajramit. Gjithashtu kjo nuk d.m.th që lejohet ta përkujtosh Allahun vetëm me emrin Allah, Allah, Allah ose hu, hu, hu, (që d.m.th Ai, Ai, Ai) siç veprojnë sufistët”.

Nuk lejohet që në fenë Islame sidomos në çështjet e mëdha të mos ketë një rrugë të qartë dhe argumente të qarta. Përndryshe i bie që fjala e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem që thotë : **“Ju kam lënë në një rrugë të bardhë...”** nuk është e saktë!! Allahu na ruajt, përderisa paska të drejtë çdokush të argumentohet me çfarë të dojë, për çfarë të dojë!! Gjë që nuk është fare e saktë në fe.

Atëherë rregulli bazë në këtë temë është që ne të argumentohemi me argumentet e qarta në fe të cilat janë si dielli në mes të ditës sidomos në çështjet e mëdha.

Ka thënë Albani : **“Çështjet e njohura në formë të prerë në fe nuk hidhen poshtë për shkak të disa dyshimeve** që mund të lindin prej një argumenti qoftë ky edhe në sheriatin tonë. Sepse ndjekja e këtyre argumenteve hyn tek ajeti që thotë : **“ata ndjekin ajetet muteshabihe”** ¹⁴ **me qëllim fitneje dhe devijimi”** [Ali Imran 7]. D.m.th gjithmonë njeriu duhet të ecë me parimet e qarta në fe” ¹⁵.

Kështu që njihen dy lloj argumentesh : **1.** Argumentet e qarta të cilat përmbajnë vetëm një kuptim të cilat quhen **“Muhkeme”** **2.** Argumentet jo të qarta që përmbajnë më shumë se një kuptim të cilat quhen **“Muteshabihe”**.

Detyra jonë është që ne ti shpjegojmë argumentet e paqarta me anë të argumenteve të qarta. Nuk lejohet që ne të bazohemi tek argumentet që përmbajnë më shumë se

¹³ Transmeton Ibn Maxheh nr 43. Hadithi është i saktë.

¹⁴ **“Muteshabihe”** janë ato argumente që përmbajnë më shumë se një kuptim. Në pamjen e parë ato mund të duken sikur bien ndesh me një nga parimet e qarta të fesë. Për këtë arsye ato i shpjegojnë vetëm dijetarët e thelluar në dije siç e tregojnë këtë gjë ajeti ndërsa të tjerët duhet të ecin në bazë të argumenteve të qarta në fe. E nëse ata nuk e veprojnë këtë por ecin me këtë lloj argumentesh atëherë duhet pasur kujdes prej tyre sepse këta kërkojnë fitne dhe devijim siç e tregojnë ajeti.

¹⁵ Kaseta nr 668_02. Marrë nga faqja www.alalbany.net

një kuptim të cilave nuk ua dinë kuptimin e vërtetë vetëm se dijetarët dhe ti përplasim me argumentet e të qarta sepse kjo është rruga e humbjes që na ka paralajmëruar Allahu të ruhem.

Shih se çfarë thotë Allahu i Madhëruar për këtë : **“Ai të zbriti ty Librin. Në të ka ajete muhkemeh ¹⁶ ato janë baza e librit dhe ka të tjera që janë muteshabihe. Ata që kanë devijim në zemrat e tyre ndjekin ato që janë muteshabihe për të bërë fitne dhe për ti shpjeguar ato (sipas dëshirave të tyre). Por shjegimin e tyre të vërtet nuk e di kush veç Allahut dhe të patundurve në dije. Ata thonë : I besuam ato. Të gjitha janë prej Zotit tonë. Nuk përkujtohet (prej kësaj këshille) vetëm se ata që janë të zotët e mendjeve”**. [Ali Imran 7].

Transmetohet nga Aishja radi Allahu anha se profeti sal-l Allahu alejhi ue selem këndoi këto ajete, më pas tha : **“Kur ti shikoni ata që ndjekin ajetet muteshabihe dijeni se këta janë ata që ka treguar Allahu prandaj ruhuni prej tyre” ¹⁷**.

Shembulli më i qartë për këtë që po themi është shembulli për të cilin kanë ardhur këto ajete. Këto ajete flasin për të krishterët në origjinë. Përpiku të bësh lidhjen ndërmejt emrit të sures Ali Imran, fillimit të sures që thotë : **“Nuk ka të Adhuruar tjetër veç Allahut Ai është i Gjalli (që ka jetën e plotë) El Kaj-jum (me fuqinë e të cilit qëndon çdo gjë)”** dhe ajeteve që përmendëm më sipër të cilat ndodhen në faqen e parë të kësaj sureje.

Surja Ali Imran e ka marrë këtë emër që d.m.th : Familja e Imranit. Imrani është babai i Merjemes. Merjemja është nëna e Isës alejhi selam. Kjo na tregon qartë që Isa është njeri dhe kjo është prejardhja e tij njerëzore. Allahu e fillon këtë sure me ajetin që thotë : **“Nuk ka të Adhuruar tjetër veç Allahut Ai është i Gjalli (që ka jetën e plotë) El Kaj-jum (me fuqinë e të cilit qëndron çdo gjë)”** për ti treguar besimtarëve një realitet që nuk pranon diskutime, që Allahu është një. Allahu të ka treguar këtë gjë ty o Muhamed në Kur’an, ia ka treguar edhe besimtarëve të mëparshëm në Teurat dhe Inxhil të cilët po Ai i ka zbritur. Kështu që të gjithë librat qiellorë e tregojnë në formë unanime se : **“Nuk ka të Adhuruar tjetër veç Allahut”**.

Atëherë del pyetja : Përse krishterët thanë për Isën alejhi selam se ai është bir i Zotit? Ku e gjetën argumentin? Më pas na tregon Allahu ajetet që përmendëm më sipër : **“Ai të zbriti ty Librin. Në të ka ajete muhkemeh ¹⁸ ato janë baza e librit dhe ka të tjera që janë muteshabihe. Ata që kanë devijim në zemrat e tyre ndjekin ato që janë muteshabihe për të bërë fitne dhe për ti shpjeguar ato (sipas dëshirave të**

¹⁶ **“Muhkeme”** quhen ato ajete që përmbajnë vetëm një kuptim të qartë si dielli. Nuk mund të kuptosh prej tyre asgjë tjetër veç atij kuptimi.

¹⁷ Transmeton Buhariu nr 4273.

¹⁸ **“Muhkeme”** quhen ato ajete që përmbajnë vetëm një kuptim të qartë si dielli. Nuk mund të kuptosh prej tyre asgjë tjetër veç atij kuptimi.

tyre). Por shjegimin e tyre të vërtet nuk e di kush veç Allahut dhe fortëve në dije. Ata thonë : I besuam ato. Të gjitha janë prej Zotit tonë. Nuk përkujtohet (prej kësaj këshille) vetëm se ata që janë të zotët e mendjeve”. [Ali Imran 7] për të treguar se të krishterët në këtë besim të kotë nuk ecin me argumente të qarta por me ato argumente që quhen muteshabihe ose më thjeshtë dyshime.

Prandaj transmetohet se disa të krishterë që shkuan tek profeti sal-l Allahu alejhi ue selem u argumentuan që Allahu është tre me ajetet që thotë Allahu i Madhëruar : “Ne”. Thanë : “Ne” është shumës, kështu që ky është argument që ka tre zotëra. Ky ishte argumentimi i tyre. Prandaj Allahu i Madhëruar na paralajmëron që të ruhem i prej këtyre lloj argumentimesh. Ato e kanë përgjigjen e saktë por shumica e njerëzve mbase nuk e arrijnë ta njohin dot. Për këtë arsye detyra e tyre është të ecin me argumentet e qarta në fe. Kjo ishte arsyeja që Allahu e filloi suren Ali Imran me ajetin e qartë që Ai është një. E më pas na tregoi këtë lloj argumentimi të gabuar që i çon njerëzit në humbje. Allahu na ruajt.

Ndërsa shembujt nga tema jonë janë të shumtë. Madje të gjitha argumentet që kanë përmendur ata që e lejojnë hyrjen në kuvend janë shembuj për këtë çështje. Por ne po tregojmë këtu disa shembuj shkurtimisht sepse ato do tregohen në vendet e veta në mënyrë të detajuar.

Shembulli i parë : Kemi një ajet të Kur’anit i cili është një nga boshtet e mëdha të Islamit i cili flet për një temë që ka lidhje me qindra çështje të Islamit. Ai ajet është nga ajetet më të qarta. Ka thënë Allahu i Madhëruar : “**Ndihmojeni njëri-tjetrin në bamirësi dhe devotshmëri dhe mos e ndihmoni njëri-tjetrin në gjynahe dhe armiqësi**” [El Maideh 2]. Ne kemi treguar në një nga kapitujt e librit shumë shembuj të këtij rregulli që e tregon ky ajet. Shembuj të marrë nga sun-neti i profetit sal-l Allahu alejhi ue selem.

Disa njerëz e anashkalojnë këtë ajet, madje nuk e përmendin fare dhe argumentohen që lejohet të bashkëpunosh me mosbesimtarët duke u bazuar në disa ngjarje si marrveshja që bëri profeti sal-l Allahu alejhi ue selem me fisin El Huza’a ose hadithin që tregon se para ditës së gjykimit muslimanët do bëjnë marrveshje me romakët e të tjera argumente të këtij kalibri.

Ne e kemi shpjeguar këtë çështje më poshtë por po tregojmë këtu shkurtimisht disa gjëra. U themi atyre që argumentohen me këto hadithe : Çfarë keni për qëllim me argumentimin tuaj me këto hadithe? A keni për qëllim që të tregoni se lejohet të bashkëpunosh me mosbesimtarët? Nëse thonë : Po. U themi : Nuk kemi rënë në kontradiktë në këtë. As nuk është kjo çështja jonë. Ne e ndalojmë marrdhënien me ta ose edhe me muslimanët kur kjo marrdhënie çon në bashkëpunim në gjynahe. Prandaj sqaroheni ku e keni qëllimin : A doni të thoni me anë të këtyre argumenteve se lejohet të bashkëpunosh me ta edhe në gjynahe? Nëse e thoni këtë atëherë pyetja

e parë që u drejtohet është : Po ajetin e qartë që e ndalon këtë gjë ku do ta çoni?! Nëse e thonë këtë e kanë akuzuar profetin sal-I Allahu alejhi ue selem se ai i ndihmonte njerëzit për gjynahe ndërkohë që atij i ka zbritur ky ajet që përmendëm më sipër!!

Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem i tha babait të Nu'man Ibn Beshirit (i cili dëshironte që ta bënte profetin sal-I Allahu alejhi ue selem dëshmitar për një dhuratë që donte ti jepte djalit të tij) : **“A ke fëmijë të tjerë veç tij?”** I tha : Po. I tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“A të gjithëve u dhurove siç i dhurove këtij?”** I tha : Jo. I tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“Unë nuk bëhem dëshmitar në padrejtësi”** ¹⁹.

Shikoje si profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk pranoi të dëshmojë për një dhuratë vetëm sepse ajo ishte padrejtësi. E si mundet që ai ti ndihmojë njerëzit për padrejtësi?! Pasha Allahun që kjo është nga çudirat e kohës së fundit. Arritëm deri në atë pikë sa të akuzojmë edhe profetët e Allahut dhe njerëzit e mirë vetëm si e si për të justifikuar veten në këto gjynahe që bëjmë!! Allahu na ruajt. Lus Allahun që të mos e këtë njeri këtë mendim. Ky është përfundimi i ndjekjes së argumenteve jo të qarta dhe lënia e argumenteve të qarta në fe.

Shembull tjetër : Allahu e ka ndaluar në shumë ajete të Kur'anit gjykimin me ligje të tjera veç ligjit Islam e kjo është një çështje që nuk pranon diskutim në fe. Argumentet për këtë janë të shumëta e do ti lexosh ato në kapitujt që vijnë. Ndërsa ata që e lejojnë hyrjen në kuvend argumentohen me historinë e Jusufit alejhi selam që ai u bë ministër i mbretit dhe normalisht sipas tyre ai do gjykonte me ligje të tjera veç ligjit të Allahut. Por po të kërkoesh në ajetet e historisë së Jusufit nuk gjen asnjë gjurmë që tregon as nga afër dhe as nga larg se Jusufi alejhi selam ka gjykuar me ligj tjetër veç ligjit të Allahut. E si mund të gjykonte me ligj tjetër?! Ai kur ishte në burg u tha shokëve të tij : **“Gjykimi i takon vetëm Allahut”** ndërsa kur doli dhe mori pushtetin veçoi të kundërtën?! A është e pranueshme kjo apo e logjishme?!

Këtë gjë sikur ta bënte një njeri i thjeshtë, do ta qortonin njerëzit duke i thënë : Ti thua atë që nuk e bën. Ose siç thotë populli : “Bëni siç them unë por mos bëni siç bëj unë”. A kështu ka qënë Jusufi alejhi selam?! I dërguari i Allahut?! Pasha Allahun, çudi me këta njerëz!! Janë gati të akuzojnë të gjithë profetët e Allahut vetëm për të justifikuar vetet e tyre!!

Më poshtë e kemi sqaruar edhe më gjerë çështjen e argumentimit të tyre me historinë e Jusufit Alejhi selam. Prandaj nuk ka nevojë të zgjatemi më. Qëllimi im këtu është vetëm të tregoj disa shembuj të ndjekjes së dyshimeve ose atyre argumenteve që quhen Muteshabihe.

¹⁹ Transmeton Muslimi nr 4270.

Për të mos e zgjatur më shumë po them që muslimani në fenë e tij duhet të ecë me gjëra të qarta nëse dëshiron të jetë i udhëzuar në këtë jetë dhe i shpëtuar në jetën tjetër. Allahu na udhëzoftë të gjithëve në rrugën drejtë.

▪ **Çështja e tretë : Studimet e mëparshme që janë bërë në këtë temë.**

Kam gjetur një numër studimesh ose librash që janë shkruar posaçërisht për këtë temë. Prej këtyre librave është libri me titull :

1. **“Islamikët dhe iluzioni i demokracisë”** shkruar nga Abdul Ganij Er-rah-hal. Libri është pak sa i vjetër. Besoj se duhet të jetë botuar nga vitet tetëdhjetë sepse nuk ka datë të shënuar. Ky është nga librat më të gjerë që ka folur për këtë çështje. Libri përbëhet nga dy vëllime të trasha. Vëllimi i parë flet për çështjen e hyrjes në kuvend dhe e trajton çështjen në formë akademike shumë të bukur. Ndërsa vëllimi i dytë flet në mënyrë të zgjeruar për përvojën e muslimanëve gjatë disa dekadave në këtë fushë. Ai tregon në të disfatat e njëpasnjëshme dhe të turpshme që kanë pësuar muslimanët në këtë fushë. Libri konsiderohet nga referencat bazë të kësaj teme sepse ai është një studim i mirëfilltë teorik edhe praktik. Shkrimtari ka dalë në rezultatin se hyrja në kuvend nuk lejohet nga ana fetare dhe nuk ka në të asnjë dobi. Madje ai tregon në libër dëme të shumëta që kanë ardhur për shkak të hyrjes së muslimanëve në politikë. Disa prej tyre i kemi përmendur në librin tonë.

Një libër tjetër është libri me titull :

2. **“Ndriçimi i errësirave në tregimin e dëmeve që ka hyrja në kuvend”**. Këtë libër e ka shkruar Muhamed Ibn Abdullah Er-rimi. Një nga dijetarët e Jemenit. Libri konsiderohet mesatar në madhësinë e tij. Shkrimtari siç duket qartë që nga titulli e ndalon hyrjen në kuvend dhe votimet. Ai ka përmendur në librin e tij 45 dëme që ka hyrja në kuvend. I ka mbështetur fjalët e tij në argumentet e Kur'anit dhe Sun-netit. Libri konsiderohet shumë i mirë në mënyrën e trajtimit të çështjes dhe tregimit të dëmeve që ka hyrja në kuvend. Më pas ka folur për argumentet e atyre që e lejojnë hyrjen në kuvend dhe i ka quajtur argumentet e tyre dyshime. Prandaj gjatë përgjigjeve që jep për çdo argument thotë : Dyshimi i parë, dyshimi i dytë e kështu me rradhë. Ajo që vlen për tu përmendur këtu është se Mukbil Ibn Hadi El Uadi'i cili është një nga dijetarët më të njohur të Jemenit e ka lexuar librin dhe ka shkruar një parathënie për të në të cilën ndër të tjera thotë : “Nuk di që të ketë ndonjë libër më të mirë në këtë temë se sa ky”. Gjithashtu këtë libër e ka lexuar edhe një dijetar tjetër nga dijetarët e Jemenit i cili quhet : Muhamed Ibn Abdul Ueh-hab El Abdeli dhe ka thënë për të : “E lexova këtë libër dhe e pashë që është libër me vlerë i cili ka folur në emër të Ehli Sun-netit. Allahu ia shpërbleftë me të mira për përpjekjet që ka dhënë në

këshillën ndaj muslimanëve”. Gjithashtu i ka bashkangjitur librit të tij një vjershë që flet për dëmet e hyrjes në kuvend të cilën e ka shkruar një nga njerëzit e ditur të Jemenit i cili quhet : Muh-hamed Es-sadik Mugal-lis ²⁰. Me pak fjalë mund të thuash që këtë libër e përfaqësojnë këta katër dijetarë të Jemenit.

Një libër tjetër është edhe libri me titull :

3. **“Pjesmarrja në kuvend dhe ministri”** të cilin e ka shkruar Muhamed Ibn Shakir Esh-sherif. Ky është një dijetar i njohur pjesërisht. Ka shkruar një numër librash që ndodhen nëpër libraritë e vendeve Islame. Kush i sheh librat e tij ve re se shumica e tyre janë në fushën politike. Për këtë arsye mund të them se ky dijetar është nga njerëzit që e njohin shumë mirë realitetin e politikës së sotme gjë e cila është e domosdoshme për të nxjerrë një gjykim sa më real dhe më afër të vërtetës. Në këtë libër ka treguar qartë gjykimin që ka Islami në lidhje me hyrjen në kuvende. Ai e ndalon këtë gjë në mënyrë kategorike dhe e konsideron këtë çështje jo të diskutueshme nga ana fetare. Unë kam marrë shume herë paragrafe dhe fjalë të këtij libri. Në bazë të librave që flasin për këtë temë, që kam lexuar para se të shkruaja këtë libër mund të them se ky libër për mua personalisht është nga librat më të mirë që është shkruar në këtë fushë. Ai nuk është shumë i trashë. Por shkrimtari ka sjellë në të esencën e çështjes duke e trajtuar atë në formë shumë të bukur dhe të fortë në argumentim.

Një libër tjetër është edhe libri me titull :

4. **“El Hasim”** edhe pse libri është pa autor të reklamuar konsiderohet libër shumë i mirë në këtë temë. Ajo që e veçon këtë libër është sjellja e fjalëve të shumta të dijetarëve në lidhje me argumentimet që tregon në të. Gjithashtu edhe ky libër e mbështet me forcë idenë se hyrja në kuvende është e ndaluar në formë të prerë. Ai tregon në të edhe shembuj konkret të cilat kanë çuar në anashkalimin e shumë formave dhe mënyrave profetike për kurimin e problemeve për shkak të marrjes së muslimanëve me politikë.

Një libër tjetër është edhe libri me titull :

5. **“Pretendimi i rregullimit”** të cilin e ka shkruar dijetari i njohur dhe zahidi i shekullit Abdul Kerim Ibn Salih El Humejd. Libri është i vogël në përmasa por i

²⁰ Mbase dikush mund të thotë : Mos shpif o vëlla! Ky person që po tregon ti është deputet, si mund të thuash ti që ky e ndalon hyrjen në kuvend!! Përgjigje : Është e vërtetë që ky ka qënë deputet por ai është larguar nga ai vend pasi ia ka hapur Allahu zemër dhe e ka parë që hyrja në vende të tilla nuk ka dobi por dëme për Islamin. Ky person ka edhe një faqe Interneti. Në të ka shkrime të ndryshme të tij ndër to edhe për gjykimin që ka hyrja në kuvend. Kjo është faqja e tij : www.ssadek.com Prandaj vëllai im të lutem mos u ngut ...

madh në idetë e tij dhe mënyrën e argumentimit. Ai edhe pse nuk e ka cekur drejtpërdrejt çështjen e hyrjes në kuvend vetëm se ai që e lexon e kupton qartë që ky dijetar nuk i lejon këto vepra. Gjithashtu ky dijetar ka shkruar edhe libra të tjerë për këtë çështje.

Një prej tyre të cilin e kam pranë dhe e kam lexuar është edhe libri me titull :

6. **“Tes’hih el Efham Li Murad Shejh El Islam”** në të cilin i kthen përgjigje njërit prej librave më të vjetër që janë shkruar në këtë temë i cili e lejonte hyrjen në kuvend. Në të ai tregon gabimet që ka ky libër i cili e ka keqkuptuar fjalën e Ibn Tejmijes dhe e ka përdorur atë jo në vendin e vet. Po aty i kthen përgjigje edhe dikujt tjetër në lidhje me të njëjtën çështje.

Një libër tjetër është edhe libri që ka shkruar Umer El Eshkar me titull : **“Gjykimi i pjesëmarrjes në ministri dhe kuvend”**. Ai ecën me mendimin se hyrja në kuvend dhe ministri lejohet. Argumentet ose dyshimet që ka sjellë, unë i kam treguar në këtë libër bashkë me përgjigjen që i takon atyre. Ajo që të bën përshtypje është se shkrimtari ka shkruar një libër tjetër me titull : **“Sheriati hyjnor jo ligjet njerëzore”** në të cilin tregon qartë që ligjet njerëzore që i vendosin vetë njerëzit janë shirk e megjithatë ai përsëri e lejon hyrjen duke u nisur nga dëmet dhe dobietë që ka ky veprim!! Përgjigjen për këtë e kam dhënë në vendin e duhur. Ajo që duhet theksuar këtu është se po të kishte qënë çështja e dëmeve dhe dobive në dorën dhe mendjen tonë nuk do kishte nevojë fare për të zbritur Kur’ani dhe as për profetin sal-l Allahu alejhi ue selem!!

Një libër tjetër i cili më ka rënë në dorë për këtë temë është dhe libri me titull : **“Votimet dhe rregullat e tyre në fikhun Islam”** të cilin e ka shkruar Fehd el Axhlan. Studjues në universitetin e mbretit Saud në Rijadh. Ai e lejon hyrjen në kuvend e të tjera gjëra. Unë e kam takuar vet shkrimtarin dhe kam diskutuar me të për çështjen në fjalë. Nuk ka në të asgjë më tepër se ato që kemi treguar në libër. Për mendimin tim librit i mungon drejtësia në një numër çështjesh. Duke pasur parasysh që ai është studim akademik i cili duhet patjetër të tregojë mendimet e të dyja palëve dhe argumentet e tyre. Ndërsa realiteti është ndryshe. Në një prej çështjeve tregoi vetëm mendimin e vet dhe e mbylli çështjen me kaq gjë që i jep të kuptojë lexuesit se në këtë çështje nuk ka mendim tjetër por realiteti është ndryshe. Në një prej temave pasi tregoi argumentet e të dyja palëve nuk u dha asnjë përgjigje por devijoi duke u justifikuar me gjëra pa vlerë. Gjë e cila më çuditi.

Në këtë temë ka edhe libra të tjerë por mua nuk mu dha mundësia ti posedoj ato libra si libri i Abdurrahman Ibn Abdul Khalik etj ... që më pas ti përmendja këtu.

Vlen për tu përmendur këtu se një prej dijetarëve që ka folur më gjerë për çështjen e hyrjes në kuvende është Muhamed Nasir Ed-din El Albani Allahu e mëshiroftë. Unë

kam gjetur në Internet shumë fetva të tij për këtë çështje dhe zgjedhja prej tyre 14 fetva. Disa të gjata e disa të shkurtra. Arsyeja pse ka folur kaq shumë Albani për këto çështje është sepse ai ka jetuar në vende ku zhvilloheshin votimet dhe i ka përjetuar vetë gjendjet e muslimanëve në lidhje me to. Për këtë arsye edhe fetvatë e tij janë më precize në këtë temë dhe më afër argumenteve të Kur'anit dhe Sun-netit. Do ti shohësh ato gjatë librit. Ai e ndalon hyrjen në kuvende në mënyrë të prerë dhe ka treguar për këtë shumë argumente të cilat do ti shohësh në vendet e duhura.

Veçoria e përbashkët e atyre librave të cilët e lejojnë hyrjen në kuvend është se ata nuk japin përgjigje të qarta për argumentet e atyre që e ndalojnë hyrjen në kuvende. Madje siç e përmenda edhe më sipër disa i pranojnë edhe vet ato argumente, por për hir të dëmeve dhe dobive e lejojnë... E për këtë arsye shkruajta këtë libër që të dalë në pah e vërteta duke shpresuar prej Allahut të na dhurojë sinqeritet dhe të na udhëzojë në rrugën e drejtë.

Së fundi, lusim Allahun, Zotin e Xhibrilit, Mikailit dhe Israfil, Krijuesin e qiejve dhe të tokës! Të Diturin e të fshehtës dhe të dukshmes, Atë që do gjykojë ndërmjet robërve të Tij në mosmarrveshjet që kanë pasur, që të na udhëzojë ne tek e vërteta në të cilën njerëzit kanë rënë në kontradiktë. Ai udhëzon kë të dëshirojë në rrugën e drejtë. Amin

Kapitulli i parë

▪ Kujt i takon e drejta e vendosjes së ligjeve në sistemin demokratik.

“Kanë rënë dakord fjalët e të gjithë atyre që kanë shkruar rreth demokracisë se ky term e ka origjinën nga greqishtja dhe përbëhet nga dy pjesë : demos që d.m.th popull dhe cratos që d.m.th gjykim ose ligj. Kështu që ky term domethënë : Gjyrimi i takon popullit. Termi demokraci ka një kuptim politik i cili është i njohur në filozofitë e vjetra dhe të reja. Ky term përfaqëson një rrymë politike që ngrihet mbi idenë se populli duhet të ketë pushtetin politik në shtet. Kështu që fjala e fundit dhe referenca e vetme është populli dhe asgjë nuk del mbi të, që d.m.th se populli i vendos vet ligjet për veten e tij”²¹. Ai gjykon vet në veten dhe për veten e tij.

Ky pushtet i popullit përbëhet nga tre aspekte bazë : 1. Vendosja e ligjeve të përgjithshme të cilat janë të detyrueshme të zbatohen nga të gjithë dhe nuk lejohet të kundërshtohen. Këtë pushtet e ka në dorë kuvendi. 2. Kujdesi për rregullin e përgjithshëm dhe detyrimi i njerëzve për zbatimin e tij në bazë të ligjeve që thamë. Këtë pushtet e ka policia. 3. Zgjidhja e mosmarrveshjeve në mënyrë paqësore ndërmjet nënshtetasve dhe shtetit duke u nisur nga këto ligje. Këtë pushtet e ka në dorë gjykata”²².

▪ Kujt i takon e drejta për të vendosur ligje në fenë Islame.

Islami na tregon se të drejtën për të vendosur ligje e ka vetëm Allahu i Madhëruar. Allahu është Krijuesi i Vetëm dhe vetëm Ai e di se çfarë është e dobishme për krijesat dhe çfarë nuk është e dobishme, ndërsa çdokush veç Allahut është rob i Tij .

Allahu i ka dërguar profetët që tu tregojnë njerëzve këtë të vërtetë , t’ua sqarojnë atyre dhe tu tregojnë se çfarë rrjedh prej saj d.m.th : që nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe se Ai nuk duhet të adhurohet vetëm se me atë që ka ligjëruar Vet.

²¹ Ata që vendosin ligjet në të vërtetë, në sistemin e lirë demokratik, janë njerëzit me influencë dhe pasuri. Për shkak se vetëm ata kanë mundësi të hyjnë në kuvende ose të fusin atë që dëshirojnë në to. Më pas edhe ligjet vijnë në bazë të interesave të tyre jo të shumicës dërrmuese të popullit siç pretendohet. Në një takim të zhvilluar me avokatin Ramzi Klark nënshtetas i një prej shteteve më demokratike të botës ka thënë : “Nuk ka dyshim se pasuria është ajo që flet në gjykatat tona. Shih psh dënimin me vdekje, nuk është dënuar me vdekje asnjë pasanik gjatë gjithë historisë të vendit tonë, ndërkohë që vriten katër veta çdo javë prej të varfërve. Është e qartë që gjykatat mbajnë anën e të pasurve sepse shpenzimet e avokatëve janë marramendëse... Gazetat i ka në dorë shtresa e pasur dhe po ata e kanë në dorë edhe shtetin... Kështu që këtu nuk ka demokraci sepse nuk zgjedh populli. Ata që zgjedhin janë pasanikët, në shtet apo media etj”. Marrë nga Revista politike “El Meshahed” nr 66, 15-21 qershor i vitit 1997 f 11-12.

²² El Musharaketu fil barlaman uel uizareh f 16-17.

Ai që pretendon për veten e tij se ka të drejtë të vendosë ligje e ka ngritur veten në gradën e Zotit dhe ai që e pretendon ose e pranon këtë të drejtë për dikë tjetër veç Allahut e ka bërë atë zot.

Allahu i Madhëruar ka thënë : **“Nuk e shoqëron Atë në gjykimin e Tij askush”** [El Kehf 26]. Gjithashtu ka thënë : **“Gjykimi i takon vetëm Allahut”** [Jusuf 40]. Këto dy ajete e tregojnë qartë që gjykimi ndërmjet krijesave është e drejta e Allahut dhe askush nuk e shoqëron Atë në këtë të drejtë.

Allahu i Madhëruar ka thënë : **“A kanë ata zotëra që u kanë vendosur atyre ligje në fe pa lejen e Allahut”** [Esh-shura 21] Kështu që vendosja e ligjeve është e drejtë vetëm e Allahut ²³. Prandaj Allahu i quajti zotra ata që vendosin ligje për njerëzit pa argument nga Allahu.

Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Mos e hani atë (bagëti) që (në therje) nuk i është përmendur emri i Allahut sepse kjo është fisk ²⁴ . Shejtanët u inspirojnë miqve të tyre që të djalogojnë me ju e nëse ju i bindeni atyre atëherë me të vërtetë jeni mushrikë”**. [El En’am 121].

Transmeton Abdullah Ibn Ab-basi radi-Allahu anhu se disa njerëz shkuan tek profeti sal-l Allahu alejhi ue selem dhe i thanë : A të hamë atë që e vrasim vetë dhe të mos hamë atë që e vrau Allahu?! Atëherë zbritën këto ajete ²⁵.

Ka thënë Ibn Kethiri në tefsirin e tij : Fjala e Allahut **“e nëse ju i bindeni atyre atëherë me të vërtetë jeni mushrikë”** dmth nëse largoheni nga urdhëri i Allahut dhe ligji i Tij dhe merrni fjalën e dikujt tjetër dhe i jepni përparësi atëherë keni rënë në shirk ²⁶.

Ajeti tregon se nëse besimtari largohet nga ligji i Allahut që tregon se nuk lejohet ngrënia e bagëtisë së ngordhur dhe ecën me mendimin e mushrikëve që thonë se ajo është njësoj si ajo që është therur prej duarve tona, ai i ka bërë shok Allahut sepse ka pranuar ligjin që kanë vendosur mushrikët në kundërshtim me ligjin e Allahut.

Ai person që pretendon se ka të drejtë të vendosë ligje për njerëzit ai është **tagut**. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“A i ke parë ti ata që pretendojnë se kanë besuar atë që të është zbritur ty, duan të gjykohen tek taguti ndërkohë që janë urdhëruar ta mohojnë atë”** [En-nisa 60]. Kështu Allahu e quajti atë që gjykon me ligje të tjera veç ligjeve të Tij tagut ²⁷.

²³ Neuakidhul Ijman el keulijeh uel amelijeh f 312.

²⁴ Fisk dmth : largim nga bindja e Allahut.

²⁵ Transmeton Tirmidhiu nr 3069 dhe Ebu Daudi 2821. Hadithi e saktësoi Albani.

²⁶ Tefsiri i Ibn Kethirit. Shikoje fjalën e tij tek shpjegimi i ajetit në fjalë.

²⁷ Neuakidhul Ijman el keulijeh uel amelijeh f 297.

Ka thënë Ibnul Kajim : “**Tagut** është çdokush që njerëzit e tejkalojnë kufirin e tij duke e adhuruar apo ndjekur apo duke ju bindur. Taguti i çdo populli është ai tek i cili kthehen njerëzit për gjykim veç Allahut dhe të dërguarit të Tij sal-I Allahu alejhi ue selem ose ai që adhurohet përveç Allahut ... ” ²⁸.

Ka thënë Abdul Aziz Ibn Baz : “Tagut është çdokush që adhurohet veç Allahut ose gjykon me ligje të tjera veç ligjeve të Tij me qëllim dhe me ndjekje dëshire” ²⁹.

Ajo që e sqaron këtë çështje gjithashtu është se dijetarët e kanë ndarë shirkun në katër lloje. Prandaj shirku nuk është vetëm të adhurosh varret duke i bërë sexhde atyre apo tauaf, ai është katër lloje si vijon :

Ka thënë Abdurrahman Ibnul Hasen Ibn Muhamed Ibn Abdul Ueh-hab : “Dije se shirku i madh është katër lloje : 1. Shirku në lutje . 2. Shirku në qëllim dhe synim. 3. **Shirku në bindje**. 4. Shirku në dashuri ³⁰. Ka treguar pas çdo lloji argumentin e posaçëm.

Argumenti për shirkun në bindje është fjala e Allahut të Madhëruar : “**Ata i bënë dijetarët dhe murgjit e tyre zotra veç Allahut, gjithashtu e bënë edhe Isën birin e Merjemes. Ata u urdhëruan që të adhurojnë vetëm një të Adhuruar. Nuk ka të Adhuruar tjetër veç Tij. I pastër është Ai nga ato që i shoqërojnë**”. [Et-teubeh 31]” ³¹.

Ka thënë Ibn Tejmije në shpjegimin e këtij ajeti : “Këta që i bënë dijetarët dhe murgjit zotra – duke ju bindur në lejin e asaj që ka ndaluar Allahu dhe ndalimin e asaj që ka lejuar Allahu – janë dy lloje : **Lloji i parë** : janë këta që e dinë se ata ndryshuan fenë e Allahut dhe me gjithë këtë ju bindën atyre në këtë ndryshim, duke besuar si të lejuar atë që ka ndaluar Allahu dhe të ndaluar atë që ka lejuar Allahu, vetëm për të ndjekur të parët e tyre edhe pse e dinë se kjo bie në kundërshtim me fenë e profetëve. Kjo është kufër dhe Allahu e quajti shirk edhe pse ata nuk u falen atyre dhe as nuk u bëjnë sexhde atyre. Kështu që kush ndjek dikë në atë çështje që bie në kundërshtim me fenë duke e ditur se bie në kundërshtim me fene dhe e beson atë që i thonë, jo atë që thotë Allahu dhe i dërguari i Tij është mushrik. **Lloji i dytë** : Ndërsa nëse njeriu beson hallallin si hallall dhe haram si haram por u bindet atyre në atë që është në kundërshtim me urdhërin e Allahut është gabimtar si çdo musliman që e bën një gjynah duke e besuar se është gjynah. Këta kanë gjykimin si të gjithë muslimanët gabimtarë” ³².

²⁸ I’lamul Muuekiine 1/50.

²⁹ Et-ta’likat el Bazijeh ala kitabi et-teuhid.

³⁰ Mexhmuatu Et-teuhid 208-209

³¹ Mexhmuatu Et-teuhid 208-209

³² Mexhmu’ El Fetaua 7/70.

Siç e sheh, argumenti e tregoi qartë që këta dijetarë dhe murgjër e kanë ngritur veten e tyre në gradën hyjnore për shkak të ligjeve që kanë vendosur mbi njerëzit në kundërshtim me ligjet e Allahut dhe ata që i ndoqën në këto ligje duke i besuar ato u bënë mushrikë.

Ka thënë Jahja El Haxh-xhuri ³³: “Nëse të pyesin ç’është demokracia? Thuaj : Demokracia d.m.th që të gjykojë populli veten e vet jo në bazë të Kur’anit dhe Sunetit. Çfarë gjykimi ka në Islam? Thuaji : Është shirk i madh. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar **“Gjykimi i takon vetëm Allahut”** [Jusuf 40] dhe fjala e Tij : **“Nuk e shoqëron Atë në gjykim askush”** [El Kehf 26] Po të pyetesh , ç’është realiteti i votimeve? Thuaj : Ato janë pjesë e sistemit demokratik që e hedh poshtë fenë e Allahut. Ato janë përngjasim me mosbesimtarët dhe përngjasimi me ta nuk lejohet. Në to ka shumë dëme. Nuk ka në to dobi për muslimanët. Prej dëmeve më kryesore janë : 1. Barazia ndërmjet të vërtetës dhe të kotës në bazë të zgjedhjes së shumicës. 2. Humbja e kufijve të përkrahjes dhe urrejtjes. 3. Përçarja e muslimanëve. 4. Futja e urrejtjes, armiqësisë dhe fanatizmit ndërmjet tyre. 5. Mashtrimi, dredhitë, hilet, falsifikimi, humbja e kohës dhe pasurive etj” ³⁴.

Ka thënë Albani : “Nuk i lejohet muslimanit e jo më një grupi muslimanësh që të hyjnë në kuvendet të cilat janë ngritur në ligje që janë në kundërshtim me ligjin Islam sepse ka shumë ajete në Kur’an që na ndalojnë të përkrahim mosbesimtarët dhe hipokritët. E si mos na ndalojë Allahu që ne ti ndihmojmë mosbesimtarët apo hipokritët – në vepra ose në besim – që pretendojnë se janë muslimanë?! Ne e dimë se kuvendet sot nuk janë Islame, E ky është një realitet që nuk pranon diskutim në formë të prerë. Sepse muslimanët kanë 14 shekuj dhe nuk i kanë njohur kuvendet vetëm se kur u sulmuan nga mosbesimtarët në shtëpitë e tyre, të cilët ua detyruan muslimanëve ligjet e tyre, ideologjinë e tyre dhe mënyrën e tyre të jetesës. **Kuvendet janë të ngritura në parimin se gjykimi i takon popullit. Kurse në Islam gjykimi i takon vetëm Allahut. E kjo është një çështje që nuk ka kontradiktë ndërmjet muslimanëve për të edhe pse ata kanë kontadikta në shumë çështje të tjera e falenderimi për këtë i takon Allahut. Ka thënë Allahu i Madhëruar : “Gjykimi i takon vetëm Allahut. Ka urdhëruar të mos adhuron askënd tjetër veç Tij”**. [Jusuf 40]. **Kjo është një e vërtetë që nuk pranon diskutim. Atëherë si mund të thuhet që gjykimi i takon popullit?!**” ... Më pas tha : “Nuk bëhet ndryshimi duke ecur me njerëzit në humbjen e tyre por duhet të jetë siç ka thënë Sejid Kutub Allahu e Mëshiroftë i cili përdorte këtë shprehje : **“Duhet pa tjerët të bëhet ndarje** (e të vërtetës nga e kota)”. Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem në daven e tij dhe në luftën kundër tagutit nukanoi nga mushrikët. E Allahu i ka thënë : **“E sikur mos të të kishim forcuar do kishe anuar nga ata pak”**. [El Isra 73-75] Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk e bënte

³³ Jahja el Haxhuri është nga dijetarët bashkëkohorë të Jemenit. Ka shkruar një numër librash në hadith akide dhe fikh.

³⁴ El Mebadi el mufideh fi ehem mesail El Fikh uel Akideh f 18 , pyetjet nr 45-47.

këtë gjë, por Allahu ia tha atij që të jetë mësim për ne që të mos anojmë nga mosbesimtarët dhe mushrikët”³⁵.

I është drejtuar Albanit kjo pyetje : Pse nuk lejohen zgjedhjet? Përgjigje : “Kjo është një çështje e gjatë. Por unë po të them shkurtimisht që zgjedhjet janë mënyrë europiane, shirku dhe idhujtarie sepse ato janë ngritur në kundërshtim me metodën Islame në shumë çështje”³⁶.

Ka thënë Salih El Feuzan : “Vendosja e ligjeve me te cilat duhet te ecin njerëzit në adhurimet e tyre , në bashkëpunimet e tyre dhe në çdo çështje tjetër i takon vetëm Allahut të Madhëruar, Zotit të njerëzve dhe Krijuesit të tyre. **“Atij i takon krijimi dhe urdhëri . I Madhëruar është Allahu , Zoti i botëve”**. [El A’raf 54].

Ai e di se çfarë është e dobishme për robërit e Tij dhe në bazë të kësaj i vendos ligjet për ta . Për shkak se Ai është Krijuesi i tyre, Ai vendos për ta . Për shkak se ata janë robërit e Tij, i pranojnë ligjet e Tij. E megjithatë dobia kthehet tek ata. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Nëse bini në kontradiktë në ndonjë çështje atëherë drejtojeni atë (çështje) tek Allahu dhe i dërguari i Tij, nëse besoni tek Allahu dhe Dita e fundit, kjo është më e mira dhe me përfundim më të mirë”** [En-nisa 59].

Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Në çdo gjë që bini në kontradiktë gjykimin e keni tek Allahu. Ky është Allahu Zoti im”**. [Esh-shura 10].

I kundërshtoi Allahu ata që konsiderojnë ligjvënës (me të drejtë) tjetër veç Tij. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“A kanë ata zotëra që u kanë vendosur atyre ligje në fe pa lejen e Allahut”** [Esh-shura 21].

Kush pranon ligjërim veç ligjërimit të Allahut i ka bërë Allahut ortak. Ato ligje që nuk i ka vendosur Allahu dhe as i dërguari i Tij sal-IAllahu alejhi ue selem në adhurime janë bidate. Çdo bidat është humbje. Profeti sal-IAllahu alejh ue selem ka thënë : **“Kush shpik në fenë tonë atë që nuk është pjesë e saj nuk i pranohet”**³⁷ dhe në një transmetim ka thënë : **“Kush punon një punë që nuk e kemi urdhëruar ajo është e refuzuar”**³⁸.

Ato ligje që nuk i ka vendosur Allahu dhe as i dërguari i Tij në çështjet politike dhe në gjykimin ndërmjet njerëzve quhen ligjet e tagutit dhe të injorancës. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“A gjykimin e injorancës kërkojnë !! Ku ka gjykim më të mirë se gjykimi i Allahut për popullin që janë të sigurtë”** [El Maideh 50].

³⁵ Kaseta nr 358_03. Kaseta është marrë nga faqja : www.alalbany.net

³⁶ Kaseta nr 399_13. Kaseta është marrë nga faqja : www.alalbany.net

³⁷ Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

³⁸ Transmeton Muslimi.

Gjithashtu edhe bërja hallall ose haram është e drejtë e Allahut , nuk i lejohet askujt që ta shoqërojë Atë në të. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Mos e hani atë (bagëti) që (në therje) nuk i është përmendur emri i Allahut sepse kjo është fisk. Shejtanët u inspirojnë miqve të tyre që të djalogojnë me ju e nëse ju i bindeni atyre atëherë me të vërtetë jeni mushrikë”**. [El En’am 121].

Kështu Allahu e konsideroi bindjen e shejtanëve dhe miqve të tyre në lejimin e asaj që e ka ndaluar Allahu shirk. Po kështu nëse dikush i bindet dijetarëve dhe prijësve dhe bën haram atë që e ka lejuar Allahu ose bën hallall atë që e ka ndaluar Allahu i ka bërë ata zotra veç Allahut.

Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Ata i bënë dijetarët dhe murgjit e tyre zotra veç Allahut, gjithashtu e bënë edhe Isën birin e Merjemes. Ata u urdhëruan që të adhurojnë vetëm një të Adhurar. Nuk ka të Adhurar tjetër veç Tij. I pastër është Ai nga ato që i shoqërojnë”**. [Et-teubeh 31].

Transmetohet në një hadith se profeti salallahu alejhi ue selem ia këndoi këtë ajet Adij ibn Hatimit radi-Allahu anhu (i cili kishte qenë i krishter) e ky i tha : O i dërguari i Allahut nuk i kemi adhurar ata. I tha : **“A nuk ua bënë haramin hallall dhe ju e konsideroni të tillë dhe jua bënë hallallin haram dhe ju e konsideroni të tillë”** ?! Tha : po. Tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“Ky është adhurimi i tyre”** ³⁹.

Kështu që bindja ndaj tyre në bërjen hallall të asaj që e ka ndaluar Allahu dhe bërjen haram të asaj që e ka lejuar Allahu d.m.th ti adhurosh ata dhe të biesh në shirk. Ky është shirk i madh. Ai bie në kundërshtim me njësimin i cili është kuptimi i fjalës **“La ilahe il-l Allah”** sepse një prej kuptimeve që përmban kjo fjalë është se bërja hallall dhe haram i takon vetëm Allahut.

Kur kjo është gjendja e atyre që u binden dijetarëve dhe murgjve në bërjen hallall ose haram në kundërshtim me ligjin e Allahut kur ata e dinë që ky është në kundërshtim me të , edhe pse ata janë më afër dijes dhe fesë madje mund ta kenë bërë këtë gjë gabimisht dhe mund të kenë edhe shpërblim për këtë, e çfarë mund të thuhet për atë që u bindet ligjeve njerëzore të cilat i kanë vendosur mosbesimtarët dhe njerëzit pa fe?! Këta i sjellin këto ligje në vendet e muslimanëve për të gjykuar ndërmjet tyre me to!! La hauleh ue la kuuete il-la bil-lah. Këta i kanë bërë mosbesimtarët zotra veç Allahut të cilët vendosin ligje, lejojnë haramet dhe gjykojnë mes njerëzve” ⁴⁰. (Këtu mbaroi fjala e Feuzanit).

Ka thënë komisioni i përhershëm : **“Një prej llojeve të shirkut të madh është ti bësh shok Allahut në ligjënie duke konsideruar si ligjëvënës dikë tjetër përveç Allahut dhe**

³⁹ Transmeton Tirmidhiu nr 309, Ibn Xheriri dhe të tjerë. Hadithin e saktësoi Albani. Shih Es-silsiletu es-sahihah nr 3293.

⁴⁰ Marrë nga libri : “Akidetu Et-teuhid” f 149-152 i Salih El Feuzanit.

duke u kënaqur me këtë gjykim, duke e konsideruar si pjesë të fesë dhe adhurim atë që e lejon ose e ndalon (taguti) në çështjet e gjykimit dhe ndarjes së mosmarrveshjeve ndërmjet njerëzve ose e quan të lejuar edhe pse nuk e konsideron pjesë të fesë. Për këtë ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Ata i bënë dijetarët dhe murgjit e tyre zotra veç Allahut, gjithashtu e bënë edhe Isën birin e Merjemes. Ata u urdhëruan që të adhurojnë vetëm një të Adhuruar. Nuk ka të Adhuruar tjetër veç Tij. I pastër është Ai nga ato që i shoqërojnë”**. [Et-teubeh 31]...”⁴¹ [Abdul Aziz Ibn Baz , Abdu Rrazak El Afifi , Abdullah Ibn Gudejan dhe Abdullah Ibn Kuud].

▪ **Krahasim ndërmjet sistemit demokratik dhe sistemit Islam në këtë çështje.**

Një prej veçorive bazë të sistemit demokratik është se ai që vendos është populli. Kjo është një veçori e demokracisë ndër kohëra. Konsiderohet kjo veçori një nga dallimet bazë ndërmjet Islamit dhe demokracisë. Sepse Islami në themelin e tij bazë ka njësimin e Allahut të Madhëruar që d.m.th se muslimani duhet të adhurojë vetëm Zotin duke u kthyer tek ligji i Tij në të gjitha çështjet e adhurimit ose mardhënieve me njerëzit ose mosmarrveshjeve. Gjë të cilën e treguam më sipër në mënyrë të detajuar.

Kështu që e vërteta tek muslimani është ajo që ka urdhëruar Allahu i Madhëruar dhe i dërguari i Tij sal-l Allahu alejhi ue selem edhe pse kjo mund të bjerë në kundërshtim me shumicën e njerëzve. Gjithashtu e kota është ajo që ka ndaluar Allahu dhe i dërguari i Tij sal-l Allahu alejhi ue selem edhe pse mund të bjerë dakord me të shumica e njerëzve. E vërteta nuk njihet nga numri i atyre që e ndjekin por njihet duke ditur atë që ka urdhëruar Allahu dhe i dërguari i Tij sal-l Allahu alejhi ue selem.

Ndërsa e vërteta në sistemin demokratik është ajo që urdhëron populli ndërsa e kota ajo që ndalon populli. Dëshira e popullit është ajo që gjykon për një vepër, a është e saktë apo gabim. Atë që e pranon populli ajo është e saktë dhe atë që nuk e pranon është gabim. Kështu që dëshira e popullit sipas kësaj ideologjie është e pagabueshme. Për këtë arsye sistemi demokratik e ka ngritur popullin në një gradë që i takon vetëm Allahut. Këtë dallim nuk e mohon dot njeri. Madje demokratikët e vërtetë nuk e konsiderojnë këtë gjë të metë ose mangësi. Përkundrazi ata e konsiderojnë këtë një prej veçorive të larta të demokracisë.

E vërteta dhe e drejta në sistemin demokratik është relative dhe jo stabile. Prandaj atë që e quan të vërtetë ose të drejtë një qeveri e hedh poshtë dhe e quan padrejtësi qeveria që vjen pas saj. Shembujt për këtë janë të shumtë. Psh martesë brenda familjes sot është e ndaluar me ligj. Por mos u çudit nëse një ditë ajo të bëhet e lejuar dhe të konsiderohet e drejtë dhe e mirë. Apo martesë e homoseksualëve. Arsyeja është shumë e thjeshtë, sepse në sistemin demokratik e drejta ecën në bazë të

⁴¹ Fetaua El-lexhneti Ed-daimeh 1/747

dëshirave njerëzore. Ndërsa populli është një laborator ku provohen ligjet kohë pas kohe sa herë që vjen në pushtet një qeveri e re.

Një veçori tjetër e sistemit demokratik është se në këtë sistem njerëzit kani fituar shumë të drejta dhe liri të cilat nuk ua kanë siguruar atyre shumë sisteme të tjera njerëzore. Si e drejta e fjalës, e drejta e besimit ⁴², e drejta për të marrë pjesë në pushtet, e drejta e punës, e drejta e pronësisë etj.

Nuk ka dyshim se njeriu ka të drejtë të jetojë i lirë dhe të marrë të gjitha të drejtat e tij sipas Islamit. Nuk është e drejta e asnjë pushteti që tua ndalojë të drejtat njerëzve. E këto të drejta nuk janë dhuratë dhe as meritë nga shteti por e drejtë e njerëzve që u takon atyre. Atë që Allahu e ka lënë të lirë nuk i takon kujt ta ngushtojë. Shteti ndërtohet për të arritur ato interesa të përbashkëta të cilat nuk arrihen pa të. Kështu që nuk duhet të jetë shteti shkak për humbjen e këtyre të drejtave.

Mirëpo, po ta kalojmë pak këtë bukurinë e jashtme që të mashtrojnë në lidhje me të drejtat e njeriut dhe të thellohem do vemë re dukuritë që vijnë :

1. Po të marrim anën fetare do të vemë re se siç ka të drejtë njeriu të besojë, ka të drejtë edhe ta shajë Zotin ose të tallet me të ose me figurat e larta fetare siç janë profetët e Zotit. Këtë e quan sistemi demokratik : e drejta e fjalës. Fakti më i mirë për këtë që po them është realiteti në botën perëndimore. Ngjarjet që ndodhën në Danimarkë nuk janë larg nga kujtesa. Madje ato karikatura që origjinën e kishin në Danimarkë janë ribotuar në 143 gazeta të ndryshme në 56 shtete në emër të të drejtës së fjalës ⁴³. Më pas autoritetet përkatëse, pas gjithë kësaj, shtojnë se është e domosdoshme të respektohen fetë!!

Gjithashtu fakt për këtë që po them është edhe libri **“Të jetosh në Ishull”** i cili konsiderohet një cënim i qartë i fesë Islame në emër të të drejtës së fjalës. Libër që ka përfshirë shumë akuza të pabaza dhe ofendime të rënda për figurën e Islamit. Në të kundërt nëse dikush prej muslimanëve do të shkruante ndonjë libër kundër fesë krishtere ose ndonjë feje apo sistemi tjetër përgjigjja ligjore do ishte shumë e qartë.

⁴² Sistemi demokratik mban qëndrim asnjëherë kundrejt besimit fetar nga ana teorike. Ndërsa nga ana praktike ndryshon shumë çështja. Shih psh Francën si një nga shtetet më demokratike dhe liberale e ndalon hixhabin për gratë muslimane. Së fundi edhe Shqipëria po e bën këtë gjë me femrat muslimane që duan të shkollohen duke i ndaluar që të hyjnë në ambientet shkollore me hixhab edhe pse unë besoj se edukimi i muslimanëve dhe shkollimi i tyre nuk arrihet me hyrjen e tyre në këto ambiente të ndyra në të cilat fëmijët tanë mësojnë më shumë ndyrësitë se sa ato mësimet për të cilat janë hapur këto shkolla. Ndërkohë që në shkollat tona rinia ka praktikuar lloje të shumta poshtërsish si imoraliteti droga etj e megjithatë nuk kemi parë asnjë lloj reagimi nga organet përkatëse. Të dalë femra lakuriq – gjë që ka ndodhur – në mes të shkollës ose të bëhet imoraliteti në klasë dhe të filmohet nga studentët siç ka ndodhur, kjo quhet demokraci, ndërsa të vishet me hixhab kjo domethënë shkelje e demokracisë !!!

⁴³ Marrë nga www.islammemo.cc lajmi mban datën 1 mars 2006.

Gjë e cila ka ndodhur në vitin 1992, vit në të cilin një prej shoqatave Islame ka botuar një libërth në të cilin tregon fakte të qarta nga Bibla se Isa Alejhi selam nuk është Zot por profet i Zotit. Nuk përmban libri asnjë akuzë, asnjë ofendim ose cënim për Isën alejhi selam. Megjithatë përgjigja e shtetit ishte shumë e qartë dhe e prerë. Ky libër u bllokua menjëherë dhe kjo shoqatë u çlegalizua dhe u pengua nga çdo aktivitet fetar në formë ligjore. Kjo është e “drejta” reale e besimit fetar në sistemin demokratik.

2. Aspekti moral : Imoraliteti, homoseksualizmi, pijet alkoolike, bixhozi etj janë të drejta të individit. Martesa me dy gra ndalohet me ligj, ndërsa imoraliteti me 200 gra është i lejuar me ligj. Para ca kohësh në një shtet demokratik dolën një grup të varfërish para disa autoriteteve përkatëse për të kërkuar të drejtat e tyre dhe përgjigjja ishte : ndërhyu policia, përdor forcën për shpërndarjen e turmës. Po në të njëjtin vend pas pak kohësh dalin një grup homoseksualësh për të kërkuar “të drejtat” e tyre : ndërhyu përsëri policia por këtë herë jo për ti shpërndarë por për ti ruajtur që të kërkojnë “të drejtat” e tyre!!

Martesa burrë me burrë dhe grua me grua është ligjëruar në disa shtete dhe besoj se së shpejti do ta shohim gjithandej ⁴⁴. E si të mos jetë e lejuar kur në pushtet janë vetë ata që e frekuentojnë këtë rrugë ⁴⁵ !! Etj ...

⁴⁴ Këtë e kam shkruar një muaj para se të dalë në diskutim vendosja e ligjit të lejimit të martesës së homoseksualëve. E kur ja, realiteti na tregon qartë vërtetësinë e asaj që po themi.

⁴⁵ Gazeta “El Kuds” që mban datën 9 nëntor e vitit 1998 nr 2954 jep këtë lajm : Tre ministra në Britani, të partisë në pushtet e kanë pranuar se janë homoseksualë, duke mos harruar se qeveria ka edhe të tjerë homoseksualë , si ministri i kulturës , ministri i mjedisit, ndërkohë që edhe katër deputetë e kanë pranuar të njëjtën gjë. Mendo pak, çfarë mund të bëjnë me pushtetin këta njerëz ... !!

Kapitulli i dytë

Pasi treguam në kapitullin e parë dallimin ndërmjet sistemit demokratik dhe sistemit Islam do trajtojmë në këtë kapitull çështjen : A i lejohet muslimanëve të marrin pjesë në kuvend duke formuar parti apo duke futur në të deputetë të pavarur?

Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetjeje duhet të sqarojmë edhe një herë shkurtimisht se kush është roli i kuvendit në sistemin demokratik sepse në të varet nxjerra e gjykimit.

Kuvendi është një autoritet i lart i shtetit i cili përfshin një numër jo të madh njerëzish. Ajo që i lidh ata me njëri tjetrin janë kufijtë gjeografikë. Ata kanë hyrë në këtë vend për të përfaqësuar popullin. Detyra kryesore që kryen kuvendi është : vendosja e ligjeve të cilat kujdesen për mbarvajtjen e shoqërisë.

Në bazë të kësaj që treguam themi se muslimanët në këtë çështje kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Ata kanë dy mendime në këtë çështje. Një grup e lejojnë dhe një grupe e ndalojnë. Ne po i tregojmë të dyja mendimet dhe argumentet e çdo pale, a janë këto dy mendime të pranueshme e më pas do tregojmë atë që është e saktë. Lus Allahun të na udhëzojë në rrugën e drejtë.

▪ Tema e parë : Argumentet e atyre që e lejojnë hyrjen në kuvend ⁴⁶

Faktikisht argumentet e atyre që e kanë lejuar hyrjen në kuvend nuk kanë qenë të njëjta:

Umer El Eshkar është argumentuar vetëm me ato që i quan dobi të sigurta të cilat arrihen duke hyrë në kuvend. Me sa duket, ka parë se nuk ka argumente të tjera për këtë çështje nga Kur'ani dhe Sun-neti të cilat e mbështesin këtë mendim.

Ndërsa Abdurrahman Ibn Abdul Khalik është argumentuar me tre gjëra : 1. Dobitë që ka marrja e këtyre posteve. 2. Argumentimi me historinë e Jusufit alejhi selam dhe Nexhashiut Allahu e mëshiroftë. 3. Fjalët e disa dijetarëve të cilët e mbështesin qëndrimin e tij. Por nuk ka përdorur asnjë argument tjetër nga Kur'ani dhe Suneti për këtë çështje. Me sa duket, ka parë se nuk ka argumente të tjera për këtë çështje.

Ndërsa Mushir El Misri krahas atyre që përmendëm ka treguar edhe argumente të tjera të cilat i janë dukur si argumente të përshtatshme për çështjen dhe do ti përmendim në vijim.

▪ Argumentet nga Kur'ani :

⁴⁶ Ato në të vërtetë nuk janë argumente, ato janë dyshime por ne po i shprehim ashtu siç i kanë quajtur ata vetë.

1. Fjala e Allahut të Madhëruar : **“Fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe dialogo me ta në formën më të mirë”** [En-nahl 125]

Forma e argumentimit : Pjesmarrja në kuvend të jep mundësinë të kundërshtosh ato ligje që bien në kundërshtim me Islamin. Të jep mundësinë tu ngresh argumentin anëtarëve të kuvendit sikurse edhe të vendosësh ligjin Islam në shumë çështje. Kështu që kjo hyn në çështjen e daves të cilën e ka bërë detyrë Allahu i Madhëruar.

Përgjigja ndaj këtij argumentimi :

Po të shohësh tefsirin e ajetit ka për tu bërë i qartë gabimi i përdorimit të këtij ajeti në këtë rast : Ka thënë Ibn Xherir Et-taberiu : “Ajeti tregon se ftesa bëhet për në rrugën e shariatit të cilën e ka ligjëruar Allahu për krijesat. Ndërsa urtësia është shpallja që i ka dhënë Allahu profetit të Tij sal-Allahu alejhi ue selem”⁴⁷. Ka thënë El Khazin : “Këshilla e mirë d.m.th duke u treguar atyre shpërblimet dhe dënimet”⁴⁸. Dialogo me ta në formën më të mirë me butësi”⁴⁹.

Ku tregohet në këtë ajet kjo që pretendohet prej atyre që e lejojnë hyrjen në këto kuvende!!

Ky argument na urdhëron që të merremi me dave. Ku thuhet në të që lejohet të bësh lëshime për hir të daves?! **“Urtësia”** për të cilët flet ajeti është : Vendosja e çdo gjëje në vendin e vet. Ai që e përcakton këtë gjë është shariati dhe jo logjika njerëzore. As urtësia, as këshilla e mirë dhe as dialogu në formën më të mirë nuk d.m.th të bësh tolerime në fe. Gjithashtu ne u themi : Me që ju ia hapët njerëzve rrugën që ti përdorin ajetet e Kur’anit sipas qejfit edhe pse nuk tregohet në to ajo që pretendohet atëherë ne u themi : Disa njerëz hyjnë dhe punojnë në klubet e alkoolit me pretendimin se bëjnë dave. E kur i pyet ku e ke argumentin që lejohet të hysh në këto vende kur dihet se profeti sal-l Allahu alejhi ue selem e ka mallkuar alkoolin dhe shumë të tjerë që i shërbejnë alkoolit, të thotë : **“Fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe dialogo me ta në formën më të mirë”**. E të thotë : forma më e mirë është që unë tu shërbej atyre dhe tu flas për fenë.

Atë përgjigje që do ti jepni ju që e lejoni hyrjen në kuvende, atë përgjigje u japim edhe ne juve ose përndryshe na thoni që ju e lejoni të punosh nëpër klubet e alkoolit ...

Të njëjtën gjë e thotë edhe dikush tjetër që punon në disko, në ato vende që grumbullohen të gjitha të këqijat si alkooli imoraliteti droga etj. Kur ti i thua pse punon atje. Të thotë për të bërë dave dhe për të rregulluar diçka. Por ti i thua që kjo

⁴⁷ Tefsiri i Taberiu 17/321.

⁴⁸ Shpërblimet që ka njeriu kur bën çdo vepër të mirë dhe dënimet që ka kur bën çdo vepër të keqe.

⁴⁹ Lubabu Et-te’ul fi meani et-tenzil, në ajetin nr 125 të sures En-nahl.

nuk lejohet se atje ka shumë haramë dhe ti do ti shohësh të gjitha ato dhe nuk do mundesh ti ndryshosh. Madje ti do tu shërbesh atyre sepse po punon atje. Madje ti me veprimin që bën u thua njerëzve që këto vende nuk janë të këqia. Sidomos kur ti merresh edhe me dave dhe pretendon se u mëson njerëzve fenë. Të thotë : Jo. Unë kam hyrë për të bërë dave. Allahu ka thënë në Kur'an : **"Fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe dialogo me ta në formën më të mirë"**. E kjo formë është me e pranueshme për ta. Sepse unë jam mes tyre, gjë që tregon se unë nuk jam i prapambetur dhe as nga ata që s'marrin vesh nga "jeta". Kështu unë i bëj për vete ata në formën më të mirë për ti ftuar në fe!!

Atëherë u themi atyre që e lejojnë hyrjen në kuvende : Çfarë përgjigje do tu jepni këtyre?! Të njëjtën përgjigje do t'ju japim edhe ne juve për lejimin tuaj. E nëse ju nuk keni përgjigje atëherë përgjigjen ua japim ne për të gjitha në këtë libër me lejen e Allahut të Madhëruar.

Ka thënë Albani : "Hyrja e muslimanëve në këto kuvende të cilat janë të ngritura jo në parime Islame është më e keqe se shembulli që thonë njerëzit : **"Filani për të ndërtuar një shtëpi prish një qytet"** sepse këta po prishin edhe shtëpinë edhe qytetin. Ngaqë këta nuk bëjnë asgjë me anë të këtyre veprimeve. E vërteta është për tu thënë : Këtu ka vend ndjekja e dëshirës, sepse njeriu ka dëshirë të duket dhe të ngrihet lart të hipi në karriget e larta që të thonë njerëzit : Filani është ministër apo zëvendës ministër etj. **Shpirti ia zbukuron njeriut këtë veprim duke e justifikuar se duhet tu tregoj atyre fjalën e vërtetë sepse nuk është e mundur tu tregosh të vërtetën parisë vetëm se duke hyrë në këto vende.** Por ky justifikim nuk është i pranuar. Gjithashtu ata që hyjnë në këto kuvende nuk kanë mundësi të ndryshojnë gjë në to. Së fundi dua të tërheq vëmendjen për një çështje për të cilën kam folur shumë. **A kjo është rruga për të ndërtuar një shoqëri Islame, duke hyrë në një vend që nuk gjykon me ligjin e Allahu?! Ai që nuk e ka diçka nuk ka si t'ua japë atë të tjerë!!** Unë besoj se rruga për të ngritur një shoqëri Islame është duke ecur në rrugën e Muhamedit sal-I Allahu alejhi ue selem i cili na ka lënë një metodikë gjithëpërfshirëse të cilën e ka përmbledhur në një fjalë ku thotë : **"Udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit sal- Allahu alejhi ue selem"**. A iu bashkangjiti profeti sal-I Allahu alejhi ue selem mushrikëve të Mekës për ti rregulluar ata, siç veprojnë këta që duan të hyjnë në kuvende?! Apo e shfaqti fjalën e vërtetë sidomos fjalën e teuhidit **"Dije se nuk ka të Adhuruar tjetër veç Allahut"**. Qëndroi profeti sal-I Allahu alejhi ue selem 13 vjet duke i ftuar njerëzit në teuhid. E ndërkohë ai i edukonte shokët e tij që ti jepnin përparësi jetës së Ahiretit para kësaj jete. A po e ndjekim ne këtë rrugë?! Ata që duan të bëjnë rregullime me anë të hyrjes në kuvend e kanë harruar rrugën e vërtetë e cila është : **"Pastrimi dhe Edukimi"**. Këto janë dy fjalë për të cilat unë i ftoj muslimanët të qëndrojnë tek to dhe ti kuptojnë mirë dhe të punojnë për ti zbatuar

ato... Përkundrazi përdorimi i këtyre metodave është në të vërtetë pengues për të ecur në rrugën e drejtë në të cilën duhet të ecim”⁵⁰.

2. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“I thanë : O Shuajb, ne nuk kuptojmë shumë prej asaj që na thua. Ne të shohim të ty dobët edhe sikur mos jetë pala jote (fisi yt që të mbron) ne do të të vrisnim me gurë”** [Hud 91]

Forma e argumentimit : Ka thënë Abdurrahman Es-sa’di – Allahu e mëshiroftë – : Allahu i mbron besimtarët me forma të shumta, disa mund ti dinë e disa jo. Allahu mund ti mbrojë ata duke bërë shkak fiset e tyre. Siç e mbrojti Shuajbin alejhi selam prej vrasjes me anë të fisit të tij. Prandaj krijimi i këtyre lidhjeve të cilat bëhen shkak që të mbrohet Islami dhe muslimanët lanë të lejuara mbase edhe detyrë. Sepse rregullimi është detyrë në bazë të mundësisë. Prandaj nëse përpiqen muslimanët të cilët janë nën pushtet jomusliman dhe punojnë që të arrijnë të drejtat e tyre fetare dhe jetike është më e mirë se sa të dorzohen që shteti të kujdeset për ti fshirë të drejtat e tyre fetare dhe jetike. Nëse kanë mundësi që ta kenë ata pushtetin në dorë kjo është detyrë por nëse nuk munden atëherë të përpiqen të ruajnë e të mbrojnë fenë dhe jetën e tyre”.

Përgjigje ndaj këtij argumentimi :

U themi : Nuk është e ndaluar të përfitosh prej lidhjeve shoqërore, farefisnore qofshin apo jo për të mbrojtur dhe ndihmuar Islamin dhe muslimanët. Askush nuk e kundërshton këtë. **E gjithë biseda është e përqendruar tek çmimi që duhet të paguajnë muslimanët kundrejt kësaj dobie.** Nëse është çmim i kësaj jete nuk ka problem. Por nëse është çmim fetar që d.m.th të përfitosh prej tyre kundrejt tolerimeve fetare, këtu qëndron problemi. Ajeti nuk flet fare se çfarë çmimi lejohet të japësh për të fituar këto lidhje. Kështu që ne i kërkojmë këto të dhëna nga argumentet e tjera të Kur’anit dhe Sun-netit. Imam Es-sa’di nuk ka folur në fjalën që treguat për çështjen e ligjeve dhe të drejtës së tyre. As nuk ka folur për çështjen e tolerimeve fetare. Kështu që nuk ka se si të merret fjala e tij si argument për diçka që ai nuk ka folur për të. Por edhe sikur të kishte folur, fjala e tij nuk është argument në fe. Fjala e tij sikur të ishte e qartë për këtë temë do kishte nevojë të mbështetej me argumentet fetare.

Po të vëresh argumentet e atyre që e lejojnë hyrjen në kuvend, do shohësh se argumentet e tyre kanë disa cilësi të përbashkëta. Ato janë të përgjithshme si ajeti në fjalë të cilin mund ta përdorë çdokush për të kotën e vet. Gjithashtu përmbajnë më shumë se një kuptim ose mundësi për tu kuptuar që d.m.th nuk e shprehin qartë idenë që pretendohet prej tyre. Ku thuhet në të se Shuajbi alejhi selam pranoi të bëjë harame për hir të daves?! A të bazohemi në këtë ajet dhe të lemë të gjitha ajetet e

⁵⁰ Kaseta nr 381_02. Marrë nga faqja : www.alalbany.net

qarta që kanë zbritur në lidhje me detyrat dhe ndalesat që ka muslimani?! A ti zbatojmë disa ajete e disa jo?!

■ Argumentimi me historinë e Jusufit alejhi salam ⁵¹.

Jusufi alejhi salam kërkoi të bëhej ministër në një shtet jobesimtar për të arritur që të kryejë disa gjëra të dobishme për mbarë popullin. Kjo dobi ishte shpëtimi i popullit prej urisë që pritej të vinte në Egjipt në bazë të ëndrrës që kishte parë mbreti dhe shpjegimit që i dha Jusufi asaj ëndrre edhe pse ai nuk kishte mundësi të mbante drejtësi të plotë ndërmjet tyre dhe as të gjykonte me ligjin e Allahut. E patjetër që do gjykonte me ligjet e mbretit. Kështu që lejohet marrja e një posti të lartë (psh si ministër) në vendet ku nuk gjykohet me ligjet e Allahut nëse ka në të dobi të mëdha ose largimi i disa dëmeve të mëdha.

Përgjigje ndaj këtij argumentimi :

Fillimish duhet pasur parasysh se argumentimi me historinë e Jusufit, që lejohet të hysh në kuvend është argumentim i gabuar për vet faktin se ndërmjet postit të ministrit në të cilin ishte Jusufi alejhi salam dhe deputetit ka dallim jo të vogël. Megjithatë përgjigja do jepet në bazë të argumentimit që kanë dhënë ata që e kanë lejuar.

“Disa njerëzve u pëlqen të argumentohen me historinë e Jusufit alejhi salam kur i tha mbretit që nuk gjykonte me ligjin e Allahut **“Më bëj mua drejtues të pasurisë. Unë jam besnik i ditur”**[Jusuf 55]. Por krahasimi me rastin e Jusufit është krahasim i kotë. Sepse Jusufi alejhi salam nuk e kërkoi pushtetin deri sa i tha vet mbreti : **“Ti sot tek ne ke pushtet dhe je besnik”** [Jusuf 54] D.m.th ke të drejtë të urdhërosh dhe njerëzit të të binden e të mos urdhërohesh prej ndokujt. Po qe se një shtet jobesimtar që nuk gjykon me ligjet e Allahut i thotë një muslimani : Eja merre ministrinë nën drejtim. Ke të drejtë që të vendosësh vet dhe ne nuk ndërhyjmë në punën tënde por do zbatojmë urdhërat e tua, në këtë rast nuk ka problem për këtë musliman nëse e pranon këtë kërkesë. Përndryshe çdo përfitim që mund të përfitojë davja prej këtij njeriu është i përkohshëm (sepse pas tij do vijnë të tjerë) dhe nuk barazohet me dëmin e madh që ka hyrja e tij në këtë post d.m.th me dëmin e zbutjes së gjynaheve në sytë e njerëzve të cilët e shohin këtë njeri duke i kryer këto gjynahe (në emër të fesë)” ⁵².

“Kështu që ka dallim të madh ndërmjet atij të cilit i thuhet : **“Ti sot tek ne ke pushtet dhe je besnik”** dhe atij që i kërkohet të betohet në Allahun që do jetë besnik ndaj ligjit që e vendos popullin në gradën e Allahut të Madhëruar dhe të betohet se do

⁵¹ Shih : “El Musharakeh fil barlaman uel uizareh” dhe “Tenuir Edh-dhulumat bi mefasid el intihabat”.

⁵² El Musharakeh fil barlaman uel uizareh f 195.

zbatojë politikën e shtetit (e jo politikën personale)”⁵³. Prandaj ky krahasim është i gabuar.

Por edhe sikur të jetë e saktë që Jusufi e kërkoi pushtetin vet, ai ishte profet dhe kishte sheriatin e tij që e kishte urdhëruar Allahu ta zbatonte. Ndërsa ne nuk e kemi për detyrë të zbatojmë sheriatin e tij sidomos kur bie në kundërshtim me sheriatin tonë. Është transmetuar në disa hadithe që e tregojnë qartë që kërkesa e pushtetit nuk është gjë e mirë dhe përfundimin nuk e ka të mirë.

- Nga Abdurrahman Ibn Es-semurah transmetohet se profeti sal-l Allahu alejhi ue selem i ka thënë : **“O Abdurrahman Ibn Es-semurah mos kërko të bëhesh i parë sepse nëse ti e merr drejtimin me kërkesën tënde ka për të mbështetur Allahu tek ai (pushteti yt) ndërsa nëse të vjen pa kërkesën tënde ka për të ndihmuar Allahu”**⁵⁴.
- Nga Ebu Hurejreh radi Allahu anhu transmetohet se profeti sal-l Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Ju do jeni lakmitarë për tu bërë prijësa por ai (post) do jetë pendim ditën e Gjykimit. Sa i mirë është kur e merr dhe sa i keq kur e le”**⁵⁵.
- Nga Ebu Musa transmetohet se ka thënë : Hyra tek profeti sal-l Allahu alejhi ue selem dhe me mua ishin dhe dy djem të xhaxhait tim. I tha njëri prej tyre profetit sal-l Allahu alejhi ue selem : O i dërguari i Allahut na bëj prijësa, në një prej vendeve që të ka dhënë Allahu. Të njëjtën gjë i tha edhe tjetri. Tha profeti sal-l Allahu alejhi ue selem : **“Pasha Allahun, ne nuk ia japim këtë detyrë atyre që e kërkojnë dhe as atyre që e lakmojnë”**⁵⁶.

Sç e shoh këto janë hadithe të qarta që tregojnë se kërkimi i këtyre posteve nuk është i mirë, madje përfundimin e ka të keq, vetëm nëse ky njeri ka frikë Allahun dhe zbaton urdhërat e Tij. Por kjo është pothuajse e pamundur në ditët e sotme ku ai që ka poste të tilla është i detyruar të ecë në bazë të një rruge të përcaktuar nga lart.

Gjithashtu nëse disa njerëz thonë se Jusufi alejhi selam mori përsipër vetëm pasurinë e mbretërisë, i themi : Kjo është në sheriatin e tij, ndërsa në Islam marrja e këtij posti kur prijësi është njeri mizor që u bën padrejtësi njerëzve nuk lejohet. Kështu që ne kemi për detyrë të zbatojmë sheriatin tonë dhe jo atë të Jusufit alejhi selam, sidomos

⁵³ El Musharakeh fil barlaman uel uizareh f 199.

⁵⁴ Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Hadithi e tregon qartë se kush i kerkon këto poste nuk e ndihmon Allahu ndërsa kujt i vjen ky post pa kërkesë e ndihmon Allahu i Madhëruar në të.

⁵⁵ Transmeton Buhariu nr 6729. Fjala e profetit sal-l Allahu alejhi ue selem : “Sa i mirë është kur e merr” dmth se ky post të jep pasuri famë dhe kënaqësitë e kësaj jete. Ndërsa fjala e tij : “Sa i keq është kur e le” dmth : ditën e Gjykimit kur të merret njeriu në llogari për çdo të vogël e të madhe do jetë ky post shkak për dënimin e tij.

⁵⁶ Transmeton Buhariu nr 2142 dhe Muslimi nr 4821 e të tjerë .

kur ai bie në kundërshtim me Sheriatin tonë. Allahu i ka dhënë profetëve sheriata të ndryshme dhe i fundit është Sheriati Islam i cili ka shfuqizuar të gjitha Sheriatet e mëparshme. Kanë ardhur hadithe të qarta nga profeti sal-l Allahu alejhi ue selem që e ndalojnë marrjen e këtij posti në rast kur prijësi është mizor dhe u bën padrejtësi njerëzve.

- Transmeton Ebu Seid dhe Ebu Hurejreh radiallahu anhumas se profeti sal-l Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Do vijë një kohë për njerëzit, që paria e tyre do jenë disa njerëz mendjelehtë të cilët afrojnë njerëzit e këqinj, largojnë njerëzit e mirë dhe vonojnë namazin. Kush i arrin ata të mos bëhet përgjegjës ⁵⁷, as polic, as taksa mbledhës dhe as arkëtar” ⁵⁸.** Ky hadith e hedh poshtë argumentimin me historinë e Jusufit alejhi selam sepse Jusufi mori përsipër një post që lejohej për të, ndërsa për ne jo sepse profeti sal-l Allahu alejhi ue selem e ka ndaluar këtë punë.

Ka thënë Albani : “Në një prej ditëve të kaluara kemi folur për çështjen e zgjedhjeve dhe se ato nuk janë të ligjëruara (në Islam) dhe folëm për disa grupe që janë futur në këto kuvende të cilat janë ngritur jo mbi gjykimin me ligjin e Allahut. Një person që ishte prezent nxorri si argument, historinë e Jusufit alejhi selam i cili i tha (mbretit) : **“Më bëj mua drejtues të pasurisë. Unë jam besnik i ditur”**. [Jusuf 55]. Kështu që Jusufi ishte drejtues në pushtetin e një prijësi mosbesimtar. Atëherë pse nuk lejohet që të hyjnë muslimanët në kuvend?!

Përgjigja është në dy aspekte ose më shumë : Jusufi alejhi selam nuk arriti atje me rrugën e votimeve të palejuara. Por Allahu i Madhëruar e sprovoi atë me anë të gruas së mbretit dhe për atë shkak ai u fut në burg. E vazhdon historia e tij në burg me dy shokët e burgut. Më pas njëri prej tyre del dhe bëhet shërbëtor i mbretit ndërsa tjetri vritet. Pas disa vitesh sheh mbreti një ëndërr dhe pyet se kush mund ta shpjegojë. Atëherë kujtohet ai që shpëtoi dhe shkon pyet Jusufin alejhi selam për ëndërrën dhe ia çon përgjigjen mbretit. Atëherë mbreti tha: Ma sillni këtu se dua ta veçoj atë për veten time. **Atëherë** i tha Jusufi alejhi selam : **“Më bëj mua drejtues të pasurisë. Unë jam besnik i ditur”**. Kështu që Jusufi alejhi selam nuk ndoqi asnjë rrugë për tu bërë i parë, madje as nuk i kishte shkuar ndërmend diçka e tillë. Por Allahu i Madhëruar i caktoi atij këto ndodhi të ndryshme deri sa e zgjodhi mbreti për veten e tij dhe e bëri ministër në shtetin e tij. E ai filloi të gjykojë me sheriatin e tij dhe me shpalljen që i dha Allahu i Madhëruar e jo me ligjet e mosbesimtarëve. Ndërsa ne sot trokasim portat e shirkut, porta idhujtarie dhe kufri. Është i pastër Jusufi alejhi selam nga këto e nuk ka mundësi që atij ti shkojnë ndërmend e jo më ti trokasë me të vërtetë. Zgjedhjet përshtaten me sistemet e mosbesimtarëve të cilët nuk bëjnë dallim

⁵⁷ Ka për qëllim të mos marrësh përsipër drejtimin e njerëzve sado pak qofshin ata, në të gjitha format.

⁵⁸ Transmeton Ebu Ja'la në Musnedin e tij nr 1115, 2/362. Hadithin e ka saktësuar Albani në es-silsiletu es-sahihah nr 360.

ndërmjet njerëzve, në bazë të besimit dhe as në bazë të gjinisë. E kur hapen portat e zgjedhjeve hyn në to çdokush i mirë qoftë apo i keq pa asnjë lloj dallimi. Në përfundim zakonisht ata që fitojnë janë njerëzit më të këqinj të shoqërisë. A përshtatet për ne që të ecim në këtë rrugë të mosbesimtarëve dhe të argumentohemi për të me historinë e Jusufit alejhi selam?! Dallimi është si nata me ditën ndërmjet historisë së Jusufit dhe realitetit të zgjedhjeve sot. Pastaj kjo që ka bërë Jusufi alejhi selam është sheriat që ka qënë para nesh dhe profeti sal-l Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Dërgohej profeti tek populli i vet ndërsa unë jam dërguar tek të gjithë njerëzit”**. Kështu që nuk është e saktë që argumentohet nxënësi i dijes me një ajet që ka të bëjë me një sheriat që ka qënë para nesh”

Më pas foli shejhu për një çështje tjetër dhe në fund tregoi një rregull shumë të rëndësishëm ku tha : “Çështjet e njohura në formë të prerë në fe nuk hidhen poshtë për shkak të disa dyshimeve që mund të lindin prej një argumenti qoftë ky edhe në sheriatin tonë. Sepse ndjekja e këtyre argumenteve hyn tek ajeti që thotë : “ata ndjekin ajetet muteshabihe ⁵⁹ me qëllim fitneje dhe devijimi” [Ali Imran 7]. D.m.th gjithmonë njeriu duhet të ecë me parimet e qarta në fe” ⁶⁰.

Pyetje : A ka gjykuar Jusufi alejhi selam me ligj tjetër veç ligjit të Allahut? Pasha Allahun që është për të ardhur turp që të bëhet një pyetje e tillë për një prej profetëve të Allahut. Njerëzit i kanë bërë shumë padrejtësi Jusufit alejhi selam. Dikur e akuzuan për imoralitet ndërsa sot e akuzojnë se ka gjykuar me ligje të tjera veç ligjit të Allahut. Argumentet që tregojnë se Jusufi nuk ka gjykuar me ligj tjetër veç ligjit të Allahut janë si vijon :

Allahu ka thënë në Kur’an për të : **“Kështu Ne i dhamë pushtet Jusufit në tokë. Ai vepron në të si të dëshirojë”** [Jusuf 56]. Marrja përsipër e pushtetit nga ana e Jusufit alejhi selam në këtë shtet mosbesimtar nuk d.m.th që ai nuk ishte i lirë të vepronte çfarë të dëshironte. Kur’ani nuk ka treguar që mbreti i vuri kushte Jusufit në këtë pushtet. Shiko se çfarë kanë thënë dijetarët e tefsirit :

Ka thënë Ibnul Arabi : “Nëse dikush thotë : Si ia lejoi vetes Jusufi alejhi selam të bëhet i parë në pushtetin e një mosbesimtari kur ai vet ishte besimtar dhe profet ? Ne i themi : Nuk ishte kërkesa e Jusufit që të merrte në dorë ndonjë post por ishte kërkesë që vet mbreti t’ia linte pushtetin Jusufit alejhi selam të gjithë që ta merrte

⁵⁹ Janë ato argumente që përmbajnë më shumë se një kuptim. Në pamjen e parë ato mund të duken sikur bien ndesh me një nga parimet e qarta të fesë. Për këtë arsye ato i shpjegojnë vetëm dijetarët e thelluar në dije siç e tregon këtë gjë ajeti ndërsa të tjerët duhet të ecin në bazë të argumenteve të qarta në fe. E nëse ata nuk e veprojnë këtë por ecin me këtë lloj argumentesh atëherë duhet pasur kujdes prej tyre sepse këta kërkojnë fitne dhe devijim siç e tregon ajeti.

⁶⁰ Kaseta nr 668_02. Kaseta është marrë nga faqja : www.alalbany.net

Jusufi alejhi selam pushtetin e tij. Allahu po të dëshironte ia jepte pushtetin Jusufit me luftë dhe forcë ⁶¹.

Ka thënë Muhamed Shakir Esh-sherif : “Fjala që thonë ata që e lejojnë hyrjen në këto poste duke u argumentuar me historinë e Jusufit alejhi selam se ai nuk kishte të drejtë të vepronte çfarë të dëshironte bie në kundërshtim me fjalët e dijetarëve të tefsirit si : Abdurrahman Ibn Zejd Ibn Eslem, Ibn Ueheb, Es-sud-dij, Et-taberi, El Kurtubi, Ibn Kethiri, Ebu Su’ud, En-nejsaburi, En-neseфи, El Hazin, El Begau, Er-razi, Ez-zemeksheri, Ebu Haj-jan El Endelusi, Esh-sheujani, Muhamed Tahir Ibn Ashur. Shiko disa prej fjalëve të tyre në shpejgimin e ajetit :

Ka thënë Ibn Xherir Et-taberi në shpejgimin e fjalës së Allahut **“Ti sot tek ne ke pushtet dhe je besnik”** [Jusuf 54] : “D.m.th ke pushtet për çfarë të dëshirosh”.

Ka treguar Et-taberiu nga Ibn Zejd se ka thënë në shpejgimin e fjalës së Allahut **“Më bëj mua drejtues të pasurisë”** : “Faraoni ka pasur shumë magazina jo vetëm me ushqime. Ia dorzoi të gjitha Jusufit alejhi selam. Gjykimin ia la atij në dorë. Ai që zbatohet ishte urdhëri dhe gjykimi i tij”.

Ka transmetuar Et-taberiu nga Es-sud-dij se ka thënë në shpejgimin e fjalës së Allahut **“Kështu Ne i dhamë pushtet Jusufit në tokë. Ai vepron në të si të dëshirojë”** [Jusuf 56] : “E vendosi mbreti prijës të Egjiptit. Kishte në dorë tregëtinë dhe çdo gjë tjetër. Ky është kuptimi i ajetit : **“Kështu Ne i dhamë pushtet Jusufit në tokë. Ai vepron në të si të dëshirojë”**.

Gjithashtu ka treguar Et-taberiu fjalën e Ibn Uehebit i cili ka thënë : “Ka thënë Ibn Zejd : fjala e Allahut : **“Ai vepron në të si të dëshirojë”** : I dhamë atij pushtetin që ishte në atë vend që të veprojë çfarë të dëshirojë. E sikur të dëshironte ta vendoste faraonin poshtë duarve të tij ose sipër, kishte mundësi ta bënte” ⁶².

Ka thënë El Begau : **“Kështu Ne i dhamë pushtet Jusufit në tokë”** d.m.th e bëmë prijës në Egjipt. **“Ai vepron në të si të dëshirojë”** d.m.th vepron në të çfarë të dëshirojë ⁶³.

Ka thënë Kurtubiu : **“Kështu Ne i dhamë pushtet”** për çfarë të dëshirojë ⁶⁴.

Ka thënë En-neseфи : **“Ai vepron në të si të dëshirojë”** d.m.th në çdo vend që dëshiron të qëndrojë nuk e ndalon kush sepse ato janë në pushtetin e tij ⁶⁵.

⁶¹ Ahkam El Kur’an li Ibn El Arabi. Shih shpejgimin e ajetit në fjalë tek ky libër.

⁶² Shikojë këto fjalë të dijetarëve që u përmendën tek tefsiri i Ibn Xherir Et-taberit 16/148-152.

⁶³ Mealim Et-tenzil, El Begau 4/252.

⁶⁴ Tefsir El Kurtubi 9/185.

⁶⁵ Tefsir En-neseфи. Shih fjalën e tij tek ajeti nr 56 i sures Jusuf.

Ka thënë El Hazin : Kuptimi i fjalës pushtet d.m.th : që askush nuk ka mundësi ta kundërshtojë në atë që dëshiron dhe e zgjedh dhe shpjegimi i këtij pushteti është tek fjala e Allahut : **“Ai vepron në të si të dëshirojë”** ⁶⁶.

Të njëjtën ide e kanë treguar edhe dijetarët e tjerë që përmendëm më sipër dikush më shkurt e dikush më gjatë.

“Qëllimi i tregimit të këtyre fjalëve të dijetarëve të tefsirit është për të sqaruar se ata kanë rënë dakord se Jusufi alejhi selam kishte të drejtë të plotë veprimi dhe nuk ishte nën pushtetin e mbretit” ⁶⁷.

Kështu që fjala e atyre që thonë se Jusufi alejhi selam gjykonte me ligje të tjera veç ligjit të Allahut ose ishte i detyruar të heshte dhe të nënshtrohej para ligjit të mbretit është fjalë e gabuar dhe e pa bazë. Kështu që edhe argumentimi i tyre bie poshtë.

Jusufi alejhi selam kur ishte në burg u tha shokëve të tij : **“Gjykimi i takon vetëm Allahut”** [Jusuf 40]. Në momentin që ai po vuante dënimin e padrejtë ua thotë shokëve të tij këtë gjë pa u frikësuar prej askujt. E si mund të logjikohet që Jusufi alejhi selam pasi të dilte prej burgu e të merrte pushtetin të vepronte të kundërtën e asaj që tha në burg!! Kjo nuk panohet tek njerëzit e thjeshtë e jo më tek profeti i Allahut alejhi selam.

Jusufi alejhi selam nuk bëri asnjë tolerim gjatë jetës së tij që të arrinte në pushtet. Përkundrazi jeta e tij tregon durimin e madh që bëri ai në të gjitha etapat deri sa Allahu i dha pushtetin. Kështu që pushteti i erdhi Jusufit alejhi selam pasi kaloi një numër sprovash në të cilat bëri durim dhe u tregua i devotshëm dhe i pastër nga gjynahet. Shiko se çfarë thotë Allahu i Madhëruar për të : **“A ti je Jusufi ? Tha : Unë jam Jusufi dhe ky është vëllai im. Allahu na bëri mirësi. Ai që tregohet i devotshëm dhe bën durim Allahu nuk ia humb shpërblimin bamirësve”**. D.m.th Allahu më ngriti në këtë vend sepse u tregova i devotshëm dhe bëra durim. Ndërsa shumë muslimanë sot duan të arrijnë pushtet pa kaluar sprovat, pa bërë durim dhe duke bërë tolerime në fe. As devotshmëri e as durim e më pas duan përfundim të mirë!! Ky është mendimi që kanë për Allahun këta!! Nëse e kundërshtojnë dhe nuk bëjnë durim kujtojnë se Allahu do ti ndihmojnë ndërsa nëse ecin drejt duke bërë durim dhe duke u larguar nga haramet kujtojnë se Allahu ka për ti lënë në baltë. Allahu na ruajt.

▪ **Argumentet e sun-netit të profetit salallahu alejhi ue selem :**

1. Fjala e profetit salallahu alejhi ue selem : **“Kush shikon një të keqe ta ndryshojë atë me dorën e tij, nëse nuk mundet ta ndryshojë atë me gojën e**

⁶⁶ Tefsir El Hazin. Shih fjalën e tij tek ajeti nr 56 i sures Jusuf.

⁶⁷ El Musharakeh fil barlaman uel uizareh f 207.

tij dhe nëse nuk mundet ta ndryshojë atë me zemrën tij dhe ky është besimi më i dobët”⁶⁸.

Forma e argumentimit : Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem urdhëroi të ndryshohet e keqja e për këtë tregoi disa etapa. Pjesmarrja në kuvend konsiderohet një nga format më të fuqishme për ndryshimin e të keqes.

Përgjigja ndaj këtij argumentimi :

Ndryshimi i të keqes është detyrë sipas mundësisë. Realiteti e ka treguar se muslimanët me anë të këtyre mënyrave kanë bërë një vrimë në ujë. Të mjafton si fakt xhemati i lhumanëve të cilët kanë 70 vjet që bëjnë lëshime në fe për hir të ndryshimit të të keqes dhe pas kaq kohësh, as të keqen nuk e ndryshuan dhe as vetet e tyre nuk i ruajtën nga haramet.

U themi gjithashtu : Ku thuhet në hadith që për hir të ndryshimit të të keqes lejohet të bësh vet disa të këqia. Madje hadithi tregon të kundërtën, thotë : Ta ndryshojë me atë që ka mundësi. Problemi i argumentimit me këto lloj argumentesh për çështje të tilla i hap portën çdo kujt që ti përdorë argumentet fetare për çdo lloj të kote që dëshiron ai. Pasha Allahun, të thuash : Dua të ndryshoj të keqen, është fjalë e bukur por realiteti është ai që e vlerëson sa e vërtetë është kjo fjalë. Prandaj më sipër treguam për disa njerëz që hyjnë në vendet që janë të mbushura me mëkate dhe argumentohen me argumente të tilla. Gjë që e sqaruam atje prandaj nuk e shoh të nevojshme ta përsëris edhe një herë.

Kjo është një pyetje me telefon që i drejtohet Albanit : Disa vëllezër kërkojnë prej nesh të kandidojmë për deputetë⁶⁹, por me kush që të hyjmë për të rregulluar. A lejohet kjo gjë ?

Përgjigja e Albanit : “Nuk lejohet të hysh në kuvendet që gjenden sot në shtetet arabe dhe nuk them në shtetet Islame sepse ato nuk janë ngritur sipas parimeve Islame. Gjithashtu qëllimi i mirë nuk e justifikon mënyrën e keqe për ta arritur atë qëllim. Fjala që thonë ata : **“Hyjmë për të rregulluar”** është imagjinatë. Realiteti tregon se shumë prej atyre muslimanëve që hyjnë në këto vende për të rregulluar, vet ata rripen (për së gjalli) d.m.th prishen vetë sepse atje është një turli deputetësh që shumica e tyre nuk janë muslimanë. Ata janë pa mjekra. Prandaj kur hyn ndër ta ai që pretendon se do rregullojë, rregullimi i parë që bën është rregullimi i mjekrës së tij. E kështu vazhdon e merr prej saj e merr prej saj deri sa të bëhet mjekër sipas

⁶⁸ Transmeton Muslimi nr 49.

⁶⁹ Kur themi të hyjmë në kuvend ose të kandidojmë për deputet kemi për qëllim të njëjtën gjë.

medhhebit disa të njerëzve pa dije atje në Siri që thonë : **“Mjekra më e mirë është ajo që sapo ka mbirë”**”⁷⁰.

2. Ka thënë profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“Do vijnë disa prijësa, do shihni prej tyre të mira e të këqija. Kush i kundërshton ata ka shpëtuar. Kush largohet prej tyre ka shpëtuar ndërsa kush përzihet me ta është shkatërruar”**⁷¹.
3. Gjithashtu ka thënë profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“Do tju vijnë disa prijësa. Do shihni prej tyre të mira dhe të këqija. Kush e urren (të keqen) ka shpëtuar, kush e kundërshton atë ka shpëtuar ndërsa ai që kënaqet dhe e ndjek atë (është shkatërruar)”**⁷².

Forma e argumentimit : Këto hadithe dhe të tjera hadithe të tilla të shumëta tregojnë se lejohet të marrësh pjesë në kuvend, mbase edhe mund të jetë detyrë ndonjëherë. Sepse profeti sal-I Allahu alejhi ue selem tregon qëndrimin që duhet të mbajë muslimani kundrejt prijësve të devijuar. Nëse ai largohet prej tyre ka shpëtuar. Nëse bashkohet me ta dhe hesht kundrejt të këqijave të tyre është shkatërruar dhe nëse i kundërshton ka shpëtuar. Ky kundërshtim mund të jetë në ambjentet e hapura të shoqërisë dhe mund të jetë në kuvend. Kjo e dyta pa dyshim që është më e fuqishme dhe me influencë më të madhe. Ajo mund të çojë – edhe pse në raste të rralla – në ndryshimin e të keqes. E meqenëse kjo mundësi ekziston atëherë ajo është më e mira, sepse fjala e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem **“kush i kundërshton”** nuk është qëllimi thjesht ti kundërshtosh me gojë por hyn këtu edhe ndryshimi i të keqes për atë që ka mundësi. Këtë gjë e mbështet edhe hadithi i mësipërm : **“Kush shikon një të keqe ta ndryshojë atë me dorën e tij, nëse nuk mundet ta ndryshojë atë me gojën e tij dhe nëse nuk mundet ta ndryshojë atë me zemrën tij dhe ky është besimi më i dobët”**.

Përgjigja kundrejt këtyre argumenteve :

U themi : Këto argumente janë në të vërtetë argumente kundër jush e jo për ju. Sepse ju edhe ju pse kundërshtoni disa të këqia, shumicën e tyre nuk i kundërshtoni, madje të keqen më të madhe – të drejtën e vendosjes së ligjeve – nuk e kundërshtoni sepse po ta kundërshtoni do fluturoni, nga ai vend. Ju do tu flisni deputetëve për haramet dhe do lini pa u treguar teuhidin. A besoni ju se davja duhet filluar gradualisht?! E gjëja më e rëndësishme është teuhidi. Sidomos ato çështje në teuhid në të cilat njerëzit bien në kundërshtim me to përditë. Çfarë dobie ka ti flasësh atyre

⁷⁰ Kaseta nr 339_11. Marrë nga faqja : www.alalbany.net

⁷¹ Transmeton Ibnu Ebi Shejbeh 7/530 nr 37743 dhe Taberani 11/39 nr 10973. Saktësoi Albani , shih sahih el xhami es-sagir nr 5974.

⁷² Transmeton Muslimi nr 1854.

për haramet apo për të kërkuar një të drejtë kur ti hesht ndaj teuhidit, çështjes thelbësore të Islamit?! A ky është ndryshimi i të keqes që bëni ju?!

Shembulli juaj në këto vende është si shembulli i një personi që hyn tek tyrbet për të shërbyer në to. Në to ka njerëz që i luten dhe i bëjnë tavaf varreve dhe pasi hyn nuk u flet njerëzve për çështjen bazë, por u flet për pijet alkoolike apo për kamatën apo për diçka tjetër duke mos harruar edhe shërbimin që u bën atyre. La pa kundërshtuar gjënë më të madhe e më pas çfarë dobie ka të flasësh për të tjerat?! Profeti sal-IAllahu alejhi ue selem kur e dërgoi Muadhin në Jemen i tha : **“Gjëja e parë në të cilën do ti ftosh është të adhurojnë vetëm Allahun e nëse e pranojnë atëherë urdhëroi të falin pesë vaktet e namazit...”**⁷³.

Atëherë ju keni rënë tek grupi që ka thënë profeti sal-IAllahu alejhi ue selem : **“ndërsa kush përzihet me ta është shkatërruar”**. Arsyeja është sepse ju – siç e thamë – do heshtni **“për hir të daves”** nga disa çështje, madje nga çështjet më kryesore të fesë veç lëshimeve dhe tolerimeve dhe harameve që ju bëni vet atje. Mos thotë njeri se këto nuk janë të vërteta?! Realiteti 70 vjeçar i ka treguar këto gjëra. Prandaj ju nuk jeni as me ata që kanë shpëtuar se u larguan dhe as me ata që e kundërshtuan. Kështu që nuk ngelet vetëm se grupi i tretë të cilit ju i përkisni në të vërtetë. Madje e përfaqësoni atë. Atëherë këto hadithe janë argumente kundër jush e jo për ju.

Ka thënë Albani : “Hyrja në kuvend nuk është rruga e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem. Davja e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem dhe e te gjithë profetëve ka qenë e përqendruar tek fjala : **“Adhuroni Allahun dhe largohuni nga taguti”**. Shiko jetën e Nuhut alejhi selam 950 vjet me popullin e tij. Për çfarë i ka ftuar njerëzit? I ka ftuar për teuhid. Sot shumë grupe na qortojnë ne dhe na thonë deri kur do merreni ju me teuhid e me Kur’an e Sun-net ndërkohë që çifutët kanë pushtuar vendin etj etj? Ata në të vërtetë nuk na kundërshtojnë ne por profetët e sidomos atë që ka jetuar më gjatë se të tjerët Nuhun alejhi selam. Këta njerëz nuk e njohin vlerën e teuhidit. Ata e kanë harruar fjalën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem që ka thënë : Kush thotë : **“Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut me singëritet në zemër ia bën Allahu haram trupin e tij zjarrit”**. Nuk e njohën madhësinë e teuhidit prandaj u larguan. Ku shkuan? Shkuan tek ato gjëra që nuk i kanë në dorë dhe as nuk kanë mundësi ti arrijnë kurrë. **Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk i shoqëroi mushrikët në rrugën e tyre dhe nuk eci me ta në humbjen e tyre me qëllim që tu tregonte atyre argumentet me mënyra diplomatike siç duan të bëjnë këta**. Unë jam i sigurt se këta muslimanë “selefi” – me kupimin alegorik jo real sepse ata kanë devijuar nga kjo rrugë pjesërisht – do ndikohen prej të tjerëve e nuk kanë për të ndikuar tek të tjerët. Ne i kemi parë ata në Siri. Ndonjëri prej tyre mund të hyjë atje me mjekër të madhe mirëpo sa hyn fillon e shkurton dhe e shkurton deri sa të bëhet mjekër Siriane për të cilën ata thonë : **“Mjekra më e mirë është ajo që sapo ka mbirë”** d.m.th e shkurton

⁷³ Transmeton Buhariu nr 1458 dhe Muslimi nr 132.

me makinë nr 1 apo nr 2. Ne po flasim në bazë të realitetit, pastaj ne e dimë ndikimin që ka rryma që merr çdo gjë përpara, ndikimin që ka posti dhe karrigia. **Këta hyjnë në kuvend duke përdorur një hile të shejtanit shumë të rrezikshme, hyjnë me justifikimin se duan të rregullojnë.** O vëlla ec në rrugën e daves që ke qënë siç ka thënë profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“Nëse udhëzon Allahu në duart e tua një person është më e dashur për mua se devetë e kuqe”**. Allahu ka udhëzuar me anë të daves selefije mijëra njerëz për mos thënë miliona. Por nëse këta do hyjnë në politikë atëherë davja do dobësohet. E kjo është ajo që u ka ndodhur ihuanëve dhe partisë liberale të cilët nuk kanë përfitur asgjë prej daves së tyre, asgjë me gjithë lakminë e madhe që kanë pasur për thirrjen në çështjen e që e quajnë : “Gjykimi i takon vetëm Allahut”. Them i : Gjykimi i takon Allahut, vetëm për prijësat ndërsa për ne jo?! Kam dëgjuar disa hatiba atje në Siri që flisnin në hytbe kundër parisë që gjykojnë jo me ligjet e Allahut mirëpo ai e kundërshton ligjin e Allahut në veten e tij në namazin e tij dhe adhurimet e tij. Kur e këshillon për këto të thotë : Ky është medhhebi i Ebu Hanifes. Gjykimi me ligjet e Allahut a ka të bëjë vetëm me mosbesimtarët?! Gjithashtu edhe muslimanët e kanë detyrë që ta njësojnë Allahun në gjykim. I këshillojmë vëllezërit tanë kudo që ndodhen, nëse dëshirojnë kënaqësinë e Allahut të mos hyjnë në këto kuvende sepse ata kundërshtojnë Islamin. Allahu i është drejtuar profetit të Tij sal-I Allahu alejhi ue selem duke i thënë : **“E sikur mos të të kishim forcuar do kishe anuar nga ata pak”**. [El Isra 73-75]. Ndërsa këta kanë anuar shumë sepse këta i përkrahin këto ligje. Së fundi më shkruajti një vëlla nga Jemeni i cili më tregonte se në to ata pohojnë kamatën, imoralitetin, alkoolin etj. E si mund të bëhet rregullimi në këtë formë?!⁷⁴.

4. Marrveshja e fudulit : Marrveshje e cila është bërë në kohën e e injorancës dhe u quajt : Marrveshja e fudulit. I dhanë besën njerëzit njëri tjetrit në të që do ndihmojnë atë që i bëhet padrejtësi prej cilit do fis qoftë. Në këtë marrveshje kishte marrë pjesë edhe profeti sal-I Allahu alejhi ue selem dhe ka thënë për të : **“Kam marrë pjesë në një marrveshje në shtëpinë e Abdullah Ibn Xhed’anit nuk do ta shkëmbeja atë pjesmarrje edhe me devetë e kuqe”**. Shkaku i kësaj marrveshjeje ishte se kurejshët i bënë padrejtësi njerëzve në vendin e shenjtë. Prandaj u ngrit Abdullah ibn Xhed’an dhe Zubejr Ibn Abdul Mut-talib dhe i thirrën njerëzit në këtë marrveshje për të ndihmuar atë që i është bërë padrejtësi.

Forma e argumentimit : Kjo ishte një marrveshje ndërmjet disa njerëzve për të ndaluar padrejtësinë dhe për të mos e lejuar atë. Kjo është e ngjashme me atë që bën deputeti në kuvend, sepse qëllimi është arritja e dobive dhe largimi i dëmeve edhe pse çdo njëri prej tyre ka një këndvështrim të ndryshëm për dëmet dhe dobitë. Megjithëse kjo marrveshje ndodhi në kohën e injorancës ajo mori legjitimitetin e vet

⁷⁴ Kaseta nr 700_01. Marrë nga faqja www.alalbany.net

nga fjala e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem : **“Nëse më ftojnë për një gjë të tillë në Islam do marr pjesë”**. Por siç dihet padrejtësia nuk është e njëjtë në konceptin e të gjithë njerëzve. Besimet mund të ndryshojnë në këtë. Islami e ka hedhur poshtë një numër çështjesh që janë padrejtësi të cilat i vepronin mushrikët dhe mendonin se ato janë drejtësi ose nuk janë padrejtësi. Kemi për qëllim këtu të themi se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nga që e pa që dobia ishte më e madhe se dëmi edhe pse e dinte që ata kishin gjëra që mendonin se ato ishin drejtësi por në të vërtetë ato ishin padrejtësi pranoi të marrë pjesë në atë marrveshje.

Përgjigja kundrejt këtij argumentimi :

Pranimi i kësaj marrveshjeje në atë formë që kishte marrë pjesë vet profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk është i ndaluar. Po të shohësh shkakun pse u bë kjo marrveshje ke për ta kuptuar se ky argument nuk ka lidhje fare me këtë që thonë këta. Shkaku ishte padrejtësia që i bënin njerëzit njëri tjetrit duke i marrë pasurinë ose duke i cënuar nderin. Nuk ka vend këtu për të diskutuar se kush ishte koncepti i padrejtësisë për njërin apo tjetrin se aty flitej për gjëra të qarta si ato që treguam. Marrja e pasurisë pa të drejtë dhe prekja e nderit.

Megjithatë ne u themi këtyre : Meqenëse se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem kishte dëshirë të merrte pjesë në marrveshje të tilla edhe pse njerëzit nuk bien të gjithë dakord në konceptin e padrejtësisë e si rezultat disa mund të quajnë padrejtësi atë që nuk e quajnë të tjetër padrejtësi, a mund të thoni psh : Nëse shkon te këta një person që i ka dhënë para me kamatë një tjetri dhe ky i fundit i ka kthyer vetëm paratë që ka marrë, ndërsa kamatën nuk ia ka dhënë. A mund të thoni se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem do merrte pjesë me ta që t’ia merrnin me forcë kamatën atij njeriu dhe t’ia jepnin kamatën atij që e kërkonte?! Duke qenë se disa prej pjesmarrësve në këtë marrveshje e quajnë këtë gjë drejtësi...?! Shembuj të tillë ka shumë. Përgjigja është e qartë. Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem edhe pse e ka thënë : **“Po të më thërrasin do marr pjesë në këtë marrveshje”** por nuk është e mundur që ai ti ndihomjë njerëzit për atë që ata e quajnë “drejtësi” edhe pse profeti sal-I Allahu alejhi ue selem e konsideron atë padrejtësi.

Marrim një shembull tjetër. Nëse shkon një prostitutë tek paria e kësaj marrveshjeje dhe u thotë : Filani nuk më ka dhënë pasurinë që më takon kundrejt imoralitetit që bëri me mua. Prandaj ju lutem më ndihmonë të marr të drejtën time. A mendoni ju se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem do shkonte ti ndihmonte këta njerëz për ti dhënë të drejtën prostitutës sepse një pjesë e atyre që marrin pjesë në këtë marrveshje e quajnë këtë kërkesë të drejtë!! Po ta mendojnë ata që argumentohen me këtë argument se ku i çon ky argumentim do turpëroheshin prej veteve të tyre, sepse ata e bëjnë profetin sal-I Allahu alejhi ue selem si këta muslimanët e sotëm që u thonë njerëzve atë që nuk e veprojnë dhe veprojnë atë që nuk u është urdhëruar. Nuk mund ta mendojë një musliman i mirë se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem i

ndihmon njerëzit për atë që Allahu e ka quajtur padrejtësi. Pasha Allahun kjo nuk mund të ekzistojë kurrë.

Ka thënë Imam Neueuiu : “Vllazëri dhe marrveshja për t’ju bindur Allahut të Madhëruar për tu ndihmuar në fe për të mira dhe devotshmëri dhe ngritjen e të vërtetës është në fuqi dhe nuk është shfuqizuar. Ky është kuptimi i hadithit të profetit sal-IAllahu alejhi ue selem : “Çdo marrveshje që ishte para Islamit, Islami vetëm se e ka përforcuar”, ndërsa fjala e profetit sal-IAllahu alejhi ue selem : “Nuk ka marrveshje në Islam” d.m.th marrveshje për të trashëguar⁷⁵ dhe marrveshjet për gjëra që i ka ndaluar Islami. Allahu e di më mire”⁷⁶. Siç e sheh Imam Neueuiu tregon se marrveshjet që bien ndesh me Islamin nuk lejohen dhe bazohet në hadithin që tregoi më sipër i cili thotë : “Nuk ka marrveshje në Islam”.

E njëjta përgjigje është për çdo marrveshje që mund të tregojnë ata që e lejojnë hyrjen në kuvend. Si marrveshja me Fisin Huza’a ose marrveshja që do bëjnë muslimanët me romakët në kohën e fundit. Të gjitha këto marrveshje nuk dalin nga kufijtë e Islamit prandaj nuk ka të drejtë njeri ti përdorë ato si argumente që lejohet për muslimanët të bashkëpunojnë me mosbesimtarët dhe ti ndihmojnë ata në gjynahe. Këtë çështje do ta sqarojmë edhe më gjerë në kapitullin e mëposhtëm ku do të flasim për gjykimin e votimit in shallah.

5. Zakoni i mbrojtjes : Kjo është një përpjekje për të përfituar prej ligjeve të përgjithshme që ishin nën pushtetin e injorancës.

Në kohën e injorancës ka ekzistuar zakoni i mbrojtjes që d.m.th se njerëzit mbronin njëri-tjetrin. Kështu që kush hynte në mbrojtjen e ndonjë fisi ata e ruanin atë sikur të ishte njëri prej tyre dhe nuk e dorzonin. E për këtë ata ishin gati që të merrnin përsipër të gjitha llojet e vështirësive. Muslimanët përfituan prej këtij zakoni. Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem hyri në mbrojtjen e xhaxhait të tij Ebu Talib i cili e mbronte prej mushrikëve që të mos i bënin keq. Gjithashtu edhe disa sahabë kanë përfituar prej këtij zakoni si psh Ebu Bekri ose Uthman Ibn Medh’un radi Allahu anhum. Gjithashtu përfituan muslimanët prej këtij zakoni kur bënë hixhret në Habeshe duke u strehuar tek një mbret i krishter për tu mbrojtur prej kurejshëve.

Forma e argumentimit : Muslimani mund të përfitojë prej disa marrveshjeve të shoqërisë edhe pse ajo shoqëri është jo Islame në lidhje me mbrojtjen e fesë së tij. Kjo gjë nuk është e ndaluar edhe pse ata janë mosbesimtarë dhe në humbje.

Përgjigja kundrejt këtij argumentimi :

⁷⁵ Sepse trashëgimia nuk fitohet me marrveshje. Ajo është pjesë e pasardhësve të atij që vdes.

⁷⁶ Sherh En-neueuij ala Muslim 16/82.

Ka dallim shumë të madh ndërmjet dy rasteve. Askush nuk e ka ndaluar të përfitojnë muslimanët prej zakoneve të mira që ekzistojnë në shoqërinë ose sistemin shoqëror në të cilin jetojnë muslimanët, por me kusht që të mos bjerë në kundërshtim me fenë. Dallimi ndërmjet kuvendit dhe zakonit të mbrojtjes është si nata me ditën :

Përfitimi prej zakonit të mbrojtjes është i qartë, i përcaktuar dhe i arritshëm ndërsa përfitimi i hyrjes në kuvende apo i votimeve nuk është as i qartë e as i arritshëm, as shpejt e as vonë.

Ata që përfituan prej këtij zakoni nuk pranuan të bëjnë asnjë lëshim në fe kundërt këtij përfitimi. Përkundrazi realiteti ka treguar se ata e kanë lënë këtë përfitim që në momentet e para kur kanë kuptuar që mund të bëhet shkak për të kundërshtuar fenë edhe pse kjo gjë i çoi në mundime dhe tortura. Shih psh rastin kur Ebu Talib e mbronte profetin sal-I Allahu alejhi ue selem. Erdhën kurejshët dhe iu ankuan. I tha Ebu Talib profetit sal-IAllahu alejhi ue selem : Djemtë e xhaxhait tënd (kurejshët) pretendojnë se ti i mundon ata në kuvendet e tyre dhe në xhaminë e tyre pranda mos i mundo më. Atëherë i ngriti profeti sal-I Allahu alejhi ue selem sytë nga qielli dhe tha : A e shihni diellin ? I thanë : Po. Aq sa keni ju mundësi të merrni prej këtij dielli një pjesë të tij aq kam edhe unë mundësi të ndalohem prej asaj që veproj ⁷⁷. Në një transmetim thuhet se Ebu Talibi i tha : O djali i vëllait tim, populli më erdhi dhe më thanë kështu e kështu, prandaj ruaj veten tënde dhe më ruaj edhe mua dhe mos më detyro të mbart atë që se mbart dot as unë edhe as ti. Prandaj leri ato fjalë që i urren populli yt. Profeti sal-IAllahu alejhi ue selem mendoi se xhaxhai i tij nuk do ta ndihmonte më dhe u dobësua në qëndrimin krah tij. I tha profeti sal-IAllahu alejhi ue selem : O xhaxha : sikur të ma vendosin diellin në krah të djathë dhe hënë në krah të majtë nuk kam për ta lënë këtë çështje deri sa ta ngrejë Allahu atë lart ose të vdes duke punuar për të. E këtu qau profeti sal-IAllahu alejhi ue selem.

Kështu që profeti sal-IAllahu alejhi ue selem nuk pranoi të shkëmbejë sigurinë me lënien e tregimit të të vërtetës duke ditur se xhaxhai i tij nuk i kërkoi që të thotë atë që thonë dhe besojnë ata, por vetëm të heshtë dhe mos dëgjojnë ata prej tij atë që e urrejnë.

Pasi vdiq Hadixhja radiallahu anha dhe xhaxhai i tij Ebu Talib e kapi sedra farefisnore Ebu Lehebin dhe donte të vepronte siç veproji Ebu Talib. Me gjithë nevojën e madhe që kishte profeti sal-IAllahu alejhi ue selem në këto momente të vështira ai e tha të vërtetën dhe nuk bëri lëshime në fenë e Allahut për të ruajtur këtë përfitim që kishte prej xhaxhait të tij.

⁷⁷ Transmeton Buhariu në librin Et-tarih el Kebir 7/51. Hadithin e ka saktësuar Albani në es-silsiletu es-sahihah nr 92.

Këtë gjë e tregon ky transmetim të cilin e ka treguar Ibn Kethiri në librin e sirës ku thotë : Kur vdiq Ebu Talib dhe Hadixhja radiallahu anha brenda pese ditëve iu grumbulluan profetit sal-IAllahu ajhi ue selem dy fatkeqësi. Për këtë arsye qëndroi në shtëpi dhe dilte shumë pak. Atëherë kurejshët filluan të vepronin ato gjëra që nuk i kishin vepruar më parë. Kur e mori vesh Ebu Lehebi shkoi tek profeti sal-IAllahu alejhi ue selem dhe i tha : O Muhamed vepro atë që dëshiron të veprosh dhe atë që veproje kur ishte Ebu Talibi gjallë. Pasha Latin nuk të prek njeri deri sa të vdes. Atëherë ndodhi që Ibn Gajtalh e shau profetin sal-IAllahu alejhi ue selem dhe Ebu Lehebi e goditi. Atëherë bërtiti dhe tha : O Kurejsh ! Ebu Utbeh (Ebu Lehebi) e la fenë (e baballarëve). Erdhën kurejshët dhe qëndruan para Ebu Lehebit. U tha : Nuk e kam lënë fenë e Abdul Mut-talibit por dua të mbroj djalin e vëllait tim që të mos i bëjë njeri padrejtësi, që të kryejë atë që dëshiron. I thanë : Shumë mirë ke vepruar, kjo është mbajtje e lidhjes farefisnore. Qëndroi profeti sal-IAllahu alejhi ue selem kështu disa ditë. Askush prej kurejshëve nuk e cënonte sepse kishin frikë prej Ebu Lehebit. Shkon Ukbeh Ibn Ebi Muajt dhe Ebu Xhehl tek Ebu Lehebi dhe i thonë : A të ka treguar djali i vëllait tënd se ku e ka vendin babai yt? I tha : Ebu Lehebi : O Muhamed ku e ka vendin babai im? I tha : Me popullin e vet. Doli tek ata të dy dhe u tha : e pyeta dhe më tha : me popullin e vet. I thanë : Ai pretendon se babai yt është në zjarr. I tha Ebu Lehebi : O Muhamed , a ka hyrë Abdul Mut-talibi në zjarr ? I tha : Kush vdes siç ka vdekur ai do hyjë në zjarr. Tha Ebu Lehebi : Unë do jem gjithmonë armiku yt sepse ti pretendon se Abdul Mut-talibi është në zjarr e që atëherë u treguan edhe më të ashpër kurejshët dhe Ebu Lehebi ndaj profetit sal-IAllahu alejhi ue selem ⁷⁸.

Fjala e profetit sal-IAllahu alejhi ue selem : “me popullin e tij” ishte përgjigje e saktë dhe e vërtetë por pa e treguar qartë se ku është populli i tij sepse kjo nuk ishte çështje thelbësore për momentin. E kjo është një lloj politike Islame. Por kur Ebu Lehebi donte përgjigje të caktuar ia dha atë pa bërë lëshime edhe pse e dinte rezultatin e përgjigjes.

Ngjarje të tilla nga sahabet janë të shumta. E ku janë këta që flasin fjalë apo bëjnë veprime që bien në kundërshtim të qartë me Islamin për të arritur dobi të pa arritshme në krahasim me ta. Qëllimi këtu është të tregojmë se ky argument që kanë sjellë ata nuk vlen si argument që lejohet të heshtim ndaj të kotës kur të hyjmë në këto kuvende për të arritur disa dobi e jo më që të ta themi ne të kotën. Profeti sal-IAllahu alejhi ue selem nuk e pranoi këtë dobi e cila vinte nga kjo rrugë që bie në kundërshtim me ligjet e Islamit.

Gjithashtu edhe sahabet kështu kanë vepruar në kohën kur ishin të dobët. E sikur këto gjëra të lejoheshin, do lejoheshin për ata në mënyrë parësore. E përderisa ata nuk i pranuan këto mënyra kjo tregon që ato janë të ndaluara. Sahabet nuk e kundërshtuan zakonet e mbrojtjes edhe pse ai vinte prej mushrikëve sepse ai ishte

⁷⁸ Es-sirah i Ibn Kethirit 2/147.

pjesë e moralit të lartë dhe nuk binte në kundërshtim me fenë Islame, por kur ai që merrte përsipër mbrojtjen vendoste kushte të cilat binin ndesh me fenë Islame ata e kundërshtonin këtë mbrojtje dhe largoheshin prej saj.

Ebu Bekri radiAllahu anhu u nis për emigrim për në Habeshë kur u sprovuan Muslimanët deri sa kur arriti në Berk El Gimad e takoi atë Ibn Ed-degineh i cili ishte i pari i atij vendi. I tha : Ku po shkon o Ebu Bekr ? Ia ktheu : Më nxorri populli im dhe unë dua të iki të adhuroj Allahun. I tha Ibnu Ed-degineh : O Ebu Bekr, një njeri si ti nuk nxirret dhe as nuk duhet të dalë. Ti ndihmon të varfërit, ruan lidhjet farefisnore, ndihmon në vështirësi dhe nderon mikun. Unë do të të mbroj prandaj ktheu dhe adhuro Zotin tënd në vendin tënd. U kthye Ebu Bekri me Ibn Ed-degineh dhe shkoi tek paria e Kurejshëve e u tha : Ebu Bekri është njeri që nuk nxirret dhe as nuk duhet të dalë. A po nxirrni një njeri që ndihmon të varfërit, ruan lidhjet farefisnore, ndihmon në vështirësi dhe nderon mikun! E pranuan kurejshët mbrojtjen e Ibn Ed-degines dhe i thanë : Urdhëroje Ebu Bekrin ta adhurojë Zotin e tij në shtëpinë e tij dhe të falet e të lexojë çfarë të dëshirojë por të mos na mendojë në kuvendet tona dhe as mos dalë haptazi se ne kemi frikë se do i bëjë fitne grave dhe fëmijëve tanë. Ia tha këtë gjë Ibn Ed-degineh Ebu Bekrit. Shkoi Ebu Bekri. Falej në shtëpinë e tij dhe nuk e shfaqte namazin dhe as këndimin e Kur'anit në vend tjetër veç shtëpisë së tij. Më pas Ebu Bekri e pa të arsyeshme të ndërtonte një vend falje në oborrin e shtëpisë së tij. E kështu falej dhe lexonte Kur'an në të. I vinin gratë dhe fëmijët dhe çuditëshin prej tij sepse Ebu Bekri ishte njeri që qante shumë. Nuk e mbante dot veten kur lexonte Kur'an. Kjo gjë i trembi të parët e kurejshëve. Prandaj dërguan lajm që të vinte Ibn Ed-degineh dhe kur erdhi i thanë : Ebu Bekri falej në shtëpinë e tij por më pas e tejkaloi dhe ndërtoi një vend falje në oborrin e shtëpisë dhe po falet dhe po këndon haptazi. Ne kemi frikë se do i bëjë fitne grave dhe fëmijëve tanë. Prandaj shko tek ai dhe thuaj të falet në shtëpinë e tij. Nëse ai kundërshton atëherë tërhiqe besën që ke dhënë se ne nuk duam ta thyejmë besën tënde por nuk mund ta lejojmë Ebu Bekrin të dalë haptazi. Tregon Aishja se Ibn Ed-degineh erdhi dhe i tha : Ti e di për çfarë kemi rënë dakord. Prandaj ose bëj ashtu ose ma kthe besën që të kam dhënë se unë nuk dua të dëgjoj në arabët që dikush më ka thyer në besën që i kam dhënë dikujt. I tha Ebu Bekri : Ta ktheva besën tënde dhe jam i kënaqur me mbrojtjen e Allahut ⁷⁹.

Gjithashtu edhe sahabet të cilët emigruan në Habeshë dhe hynë në mbrojtjen e Nexhashit i cili ishte i krishter atëkohë, me gjithë nevojën e madhe që kishin për këtë mbrojtje, kur erdhi koha e shfaqjes së të vërtetës që ata mbartnin nuk bënë lëshime dhe as nuk thanë diçka të kotë edhe pse mund të rridhte prej atyre fjalëve që thanë përfundime të njohura.

⁷⁹ Transmeton Buhariu nr 2297.

U përpoq Amr Ibn El As në kohën kur ishte mushrik që të fuste të keqen ndërmjet mbretit dhe sahabeve. Për këtë arsye i tha : O mbret , ata thonë për Isën birin e Merjemes fjalë të rënda. Prandaj thuaju të vijnë dhe pyeti se çfarë thonë. Thotë Umu Selemeh e cila e transmeton këtë hadith : Dërgoi dikë që ti lajmëronte të vinin e ti pyeste për të. Nuk u ra muslimanëve ndonjë gjë më e rëndë se kjo. Atëherë u bashkuan sahabet dhe thanë : Çfarë do themi për Isën kur të na pyesin ? Thanë : **Do themi atë që ka thënë Allahu dhe atë që na ka treguar profeti jonë sal-IAllahu alejhi ue selem dhe le të ndodhë çfarë të ndodhë.** E kur hynë tek mbreti i pyeti : çfarë thoni për Isën birin e Merjemes. Tha Xha’fer Ibn Ebi Talib : Them i atë që na ka treguar profeti jonë sal-IAllahu alejhi ue selem : Isa është rob i Allahut dhe i dërguar i Tij. Ai është shpirti i Tij ⁸⁰ dhe fjala e Tij që e ka hedhur tek Merjemja e ndershme adhuresë. I tha Nexhashi : Nuk ka asnjë dallim ndërmjet të vërtetës dhe asaj që the ti. Atëherë shfrynë murgjit kur e tha këtë fjalë . U tha : edhe po shfrytë ju (nuk shqetësohem) pasha Allahun. Ikni se jeni të sigurtë në tokën time. Ai që ju ofendon do të gjobitet – e tha dy herë këtë – . Nuk dua të mundoj asnjërin prej jush edhe sikur të më japin një mal me ar ⁸¹.

■ **Argumentimi me historinë e Nexhashit Allahu e mëshiroftë ⁸²**

Nexhashi u bë musliman në kohën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem por nuk emigroi për tek ai. Ai ishte mburojë për muslimanët dhe i dobishëm për ta. Historia e tij është e njohur në librat e sirës. Nexhashi u bë musliman. Për këtë nuk ka dyshim sepse profeti sal-I Allahu alejhi ue selem me sahabet i falën xhenazën ditën që vdiq. Tha profeti sal-IAllahu alejhi ue selem për të : **“Vëllai jonë dhe njeri i mirë”**.

Forma e argumentimit me historinë e Nexhashit : Ai u bë musliman në fillimet e Islamit kur emigruan muslimanët për tek ai, në vitin e pestë të shpalljes përafërsisht. E megjithatë ai ngeli mbret në një shtet që nuk ishin besimtarë. Ai qëndroi në këtë post edhe pas hixhretit të profetit sal-I Allahu alejhi ue selem për në Medinë. Ai nuk ka gjykuar me ligjin e Allahut. Po sikur të ishte një prej kushteve të Islamit që njeriu të largohet nga mosbesimtarët nuk do të kishte heshtur profeti sal-I Allahu alejhi ue selem dhe nuk do ta kishte quajtur njeri të mirë e më pas ti urdhëronte sahabet që ti falnin xhenazën.

Përgjigje ndaj këtij argumentimi : Ato gjëra që u treguan në lidhje me historinë e Nexhashit nuk janë argument për atë që pretendon pala tjetër. Asnjëri prej tyre nuk ka treguar diçka konkrete që vërteton se Nexhashi ka gjykuar në kundërshtim me ligjin Islam. Thotë njëri prej tyre : **“Gjykimi me ligj tjetër veç ligjit të Allahut është i**

⁸⁰ Dmth shpirt që ka ardhur prej Allahut. Ky dedikim përdoret në formë vleresimi. Siç thuhet shtëpia e Allahut ose deveja e Allahut.

⁸¹ Transmeton Ahmedi në musned. Shih kapitullin e Ali Ibn Ebi Talib 1/202. E saktësoi Shuajb El Arnauti.

⁸² Marrë nga libri “El Musharekeh fil barlaman uel uizareh” f 224-250 me disa shkurtime.

qartë në historinë e Nexhashit duke parë vet gjendjen që mbizotëronte në atë vend dhe veshtirësitë që haste në të”. Mirëpo ky nuk është argument, ky është vetëm një përfytyrim personal i cili nuk ngrihet deri në gradën e argumentit.

Nexhashi – Allahu e mëshiroftë – ishte njeri i mirë të cilit ia fali xhenazen profeti sal-l Allahu alejhi ue selem dhe dëshmoi se ai e mbylli këtë jetë me përfundim të mirë. Prandaj nuk i takon njeriu që ti atribuojë atij diçka që ia ul vlerën duke u nisur nga hamendja që tia bëjë të justifikueshëm vetes së tij qëndrimin që ka, në lidhje me këtë çështje.

Ngjarjet që janë trasnmetuar nga Nexhashi janë shumë të kufizuara. E nuk tregohet në to që Nexhashi ka gjykuar me ligj tjetër veç ligjit të Allahut. Për të këtë arsye, ta mbështesësh këtë ide në mënyrë të prerë pa pasur fakte të qarta është një lloj ngutjeje jo e mirë në gjykim.

Dijetarët kanë rënë në kontradiktë për kohën kur është bërë musliman Nexhashi. Disa prej tyre janë të mendimit se ai u bë musliman para hixhretit të muslimanëve për në Medine d.m.th në kohën kur emigruan muslimanët për në Habeshe. E disa të tjerë janë të mendimit se ai u bë musliman në vitin e gjashtë të Hixhretit. Nuk dua që të mbështes ndonjërin nga këto mendime por ajo që na intereson është se transmetimet tregojnë se ai ishte i fortë në besimin tij dhe e shfaqti atë haptazi. Gjithashtu i strehoi sahabet dhe nuk lejoi që ti cënonte njeri. Këto qëndrime të qarta të tij të bëjnë që të matesh para se të thuash për të që ka gjykuar me ligje të tjera veç ligjit të Allahut.

Siç dihet, në periudhën e Mekës nuk kanë zbritur ligje, madje edhe shumë prej haramëve kanë ardhur në Medine si kamata apo alkooli etj. Disa adhurime u bënë detyrë në Medine si agjërimi ose drejtimi nga Kibla e disa u vonuan shumë si haxhi. Shumica e ligjeve kanë zbritur në Medine dhe madje në periudhën e vonët. Dihet që Nexhashi vdiq para se të plotësohet feja.

Ka thënë Ibn Haxher El Askalani : “Vdekja e tij ka qënë në vitin e nëntë të hixhrit në mendimin e shumicës së dijetarëve, ndërsa disa të tjerë thanë : Në vitin e tetë të hixhrit. Duket pak si e çuditshme që Buhariu nuk ka shkruar për kohën se kur ka hyrë në Islam Nexhashi por vetëm për kohën se kur ka vdekur edhe pse ky është momenti që duhet ta përmendte këtë gjë. Shkaku është se Buhariu nuk ka gjetur hadith të saktë që tregon se kur është bërë musliman Nexhashi. Por ka gjetur hadith të saktë hadithin që tregon se ai ishte bërë musliman në të cilin tregohet vdekja e tij...”⁸³.

Ka thënë Ibn Kethiri : Me sa duket vdekja e Nexhashit ka qënë para çlirimit të Mekës me një kohë jo të shkrutër, sepse në librin e saktë të Muslimit tregohet se profeti sal-l

⁸³ Fet’hu El Bari 7/191.

Allahu alejhi ue selem u shkruajti mbretërve letra dhe i shkruajti dhe Nexhashit jo atij që kishte qënë musliman ⁸⁴.

Duke u bazuar në këtë mund të themi : Cilat janë ato ligje që zbritën kur ishte Nexhashi gjallë që më pas të themi që ai nuk kishte mundësi t'i zbatonte. Kush mund të flasë me siguri për këtë?!

Jo vetëm kaq, po kush ka mundësi të na e vërtetojë se Nexhashit i shkuan të gjitha këto ligje i mësoi dhe nuk pati mundësi ti zbatonte. Ndërkohë që ka argumente të sakta se muslimanët që ishin në Habeshe kalonin shumë kohë para se të merrnin vesh ligjet e reja që kishin zbritur në fenë Islame. Madje kishte ligje që i kanë marrë vesh vetëm kur u kthyen në Medine.

Transmetohet nga Abdullah Ibn Mes'udi radiallahu anhu se ka thënë : “I jepnim selam profetit sal-I Allahu alejhi ue selem kur ishim në Mekë (në namaz) para se të vinim nga Habesheja. E kur u kthyem nga Habesheja shkuam tek ai i dhamë selam por nuk na e ktheu. Kur mbaroi namazin e pyeta e më tha : **“Allahu vendos çfarë ligjesh të reja dëshiron dhe një prej tyre është që të mos flasim në namaz”** ⁸⁵.

Ka thënë Ibn Tejmija : “Është transmetuar nga Ata’ dhe Katade se Nexhashi falej nga Kudsi deri sa vdiq. Ai ka vdekur disa vite pasi ndryshoi kibra. Kur i fali xhenazen profeti sal-I Allahu alejhi ue selem njerëzit ishin disi të shqetësuar sepse ai ishte falur jo në drejtim të Qabes. Prandaj zbriti ky ajet ⁸⁶. Me sa duket atij i kishte shkuar lajmi që profeti sal-I Allahu alejhi ue selem falej nga Kudsi më pas nuk i kishte shkuar lajmi i shfuqizimit sepse vendet ishin larg. Pranda u justifikua siç u justifikuan ata që ishin në Kuba” ⁸⁷.

Kështu që ai që thotë se Nexhashi nuk ka gjykuar me ligjet e Allahut duhet të tregojë cilat janë ato ligje që ishin bërë detyrë në atë kohë dhe cilat prej atyre ligjeve që ishin bërë detyrë i kishin mbërritur Nexhashit e ai nuk i kishte zbatuar për arsye të ndryshme. Nuk lejohet që ne ti atribuojmë një njeriu si ai se ai nuk ka kryer atë që e ka bërë detyrë Allahu pa argument dhe vetëm me logjikë.

Ka treguar Ibnul Kajim një ngjarje të Nexhashit që tregon se ai nuk ka bërë lëshime përkundrazi është tregua i fortë në fenë e tij edhe para mbretërve të tjerë : “Dërgoi profeti sal-I Allahu alejhi ue selem Amr Ibn El As tek mbreti i Omanit me një letër. Ndër të tjera e pyet mbreti Amrin se ku ishte bërë musliman e ai ia ktheu : tek Nexhashi. I tregova gjithashtu se Nexhashi u bë musliman. Më tha : Çfarë bëri populli

⁸⁴ El Bidajetu ue En-nihajetu 4/316.

⁸⁵ Transmeton Muslimi nr 1229 edhe Buhariu nr 1199.

⁸⁶ Ajeti që thotë : “Allahu nuk ua humb besimin tuaj” dmth namazin tuaj që keni falur jo në drejtim të Qabes.

⁸⁷ Sherh El Umdeh 4/548.

i tij me të? I Thashë : E pranuan dhe e ndoqën. Po murgjit ? Tha : edhe murgjit . I tha (mbreti) : Shiko o Amr çfarë po thua, se nuk ka ndonjë cilësi më të ulët tek burri se gënjeshtër. I thashë : Nuk po të gënjej dhe as nuk e lejojmë atë në fenë tonë. Më pas tha : Mendoj se Herakliu nuk e ka marrë vesh që ai është bërë musliman. I thashë : Posi jo. Më tha : Nga e more vesh këtë gjë ? I thashë : Nexhashi i jepte atij taksa. Kur Nexhashi u bë musliman dhe besoi Muhamedin sal-I Allahu alejhi ue selem tha : Pasha Allahun sikur të më kërkojë vetëm një dirhem nuk ia jap. E mori vesh këtë fjalë Herakliu. I tha vëllai i tij Jenaku : A do ta lesh robin tënd pa të dhënë taksat dhe të besojë një fe të re? Tha Herakliu : Ai e pëlqeu atë fe dhe e zgjodhi për veten e tij. Çfarë ti bëj ? Pasha Allahun sikur mos kisha frikë për pushtetin do veproja edhe unë siç veproi ai. Më tha : Çfarë thua kështu o Amr ? I thashë: Pasha Allahun që po të them të vërtetën” ⁸⁸.

Mund ta krahasosh qëndrimin e Nexhashit siç e tregon Ibnul Kajim në këtë ngjarje me atë që pretendojnë ata që thonë se ai nuk kishte mundësi të bënte gjë prandaj ai gjykonte me ligje të tjera veç ligjit të Allahut.

▪ Argumenti i dobive :

Ata që e lejojnë hyrjen në kuvend thonë : se dobia në këtë veprim është e sigurt dhe është më e madhe se dëmi. Ka thënë Umer El Eshkar : “Një prej argumenteve që kanë ata që e lejojnë hyrjen në kuvend është se ky veprim ka dobi për daven dhe për muslimanët në përgjithësi, dobi e cila është më e madhe se dëmi që ka kjo pjesmarrje edhe pse ka luhatje mundësia e arritjes së këtyre dobive nga një vend në një tjetër”.

Përgjigja kundrejt këtij argumentimi :

A është dobia e hyrjes në këto kuvende e sigurt? Nëse dëshiron ta shohësh realitetin e kësaj fjalë mund të kërkosësh pak në arshivin e historisë së ihuanëve të cilët kanë 70 vjet që kërkojnë pushtet duke menduar se me anë të këtij pushteti do arrijnë të përhapin Islamin. Pas kaq kohësh nuk shohim tek ihuanët vetëm se tolerime pa fund në fenë e tyre. Asgjë më tepër. Historia e tyre është e mbushur me dështime. Nuk të vjen keq pse dështuan por të vjen keq kur të kujtohen të gjitha ato tolerime të pa fundme që kanë bërë ata në fe për të arritur tek asgjëja. Aq sa njeriu i thjeshtë nuk bën dallim ndërmjet fjalëve që dëgjon prej tyre dhe fjalëve të laikëve apo komunistëve apo grupeve të tjera që s’kanë lidhje me fenë. Fjalë të cilat ata i konsiderojnë të domosdoshme për t’i treguar botës se ne jemi si gjithë të tjerët. Madje në disa raste ata bëhen më patriotë se vet patriotët dhe më atdhetarë se të gjithë.

⁸⁸ Zad El Mead 3/605.

Atëherë ku qenkan këto dobitë e mëdha dhe të sigurta?! Nëse keni për qëllim me fjalën dobi ndonjë post që mund të arrini atëherë sqaroheni që ta kuptojnë njerëzit që ju flisni për dobi personale dhe jo dobi të fesë.

Shikoni një prej dobive që arritën Ihuanët në Egjipt ⁸⁹. Në vitin 1953 ata u bashkangjitën me Xhemal Abdun-nasir për të marrë pushtetin dhe e mbështetën atë me të gjitha fuqitë e tyre. Deshi Allahu i Madhëruar që ta marrë pushtetin Xhemali dhe pasi e mori u dha ihuanëve një mësim të mirë që nuk kanë për ta harruar kurrë. I futi të gjithë nëpër burgje. I mbushi burgjet plot me Ihuanë. Mos pyet për torturat e vuajtjet e tyre, por nuk morën mësim.

Abdul Ganij Er-rah-hal ka shkruar një libër me titull **“Islamikët dhe iluzioni i demokracisë”** i cili përbëhet prej dy vëllimesh. Flet për çështjen tonë. Ai ka folur shumë gjatë për të. Madje vëllimin e dytë e ka vendosur vetëm për të treguar disfatat që kanë pësuar vllaznia në Egjipt dhe Siri gjatë shekullit të kaluar që të ketë mundësi çdo person me logjikë ta kuptojë se sa të “sigurta” janë ato dobitë që pretendojnë ata. Këto disfata janë mëse normale sepse këta njerëz nuk kanë ndjekur rrugën profetike në përhapjen e Islamit. Rezultati ishte i qartë, as dobitë që pretenduan nuk i arritën dhe as fenë e tyre nuk e ruajtën. Sot në shumë vende Islame ka një numër jo të vogël deputetësh. Ka pasur gjithashtu edhe para shumë vitesh por nuk po shohim gjë reale.

Shikoni një rast tjetër. Në një nga shtetet e mëdha arabe, me përqindje shumë të madhe muslimane, ekziston edhe një minoritet me përqindje të vogël orthodoksësh. Ka prej tyre që hyjnë në Islam. Një rast i tillë ka ndodhur në vitin 2004 kur një grua orthodokse e cila quhej Uefa Kostandin u bë muslimane. Ajo e fshehu Islamin e saj për dy vjet rresht nga frika se mos e merrnin vesh njerëzit e saj dhe mund të ndërmerrnin kundër saj masa shumë të rënda. Pas dy vjetësh vendosi të largohej nga shtëpia e saj dhe të shfaqte besimin e saj. E kështu veproi. Kur e morën vesh orthodoksët u ndezën nga mllefi pse kjo grua e la fenë e tyre dhe kërkuan prej shtetit ti kthehej kjo grua kishës që të merrte masat e duhura kundër saj. Normalisht që shteti nuk ngurroi ta gjente këtë grua atje ku ishte fshehur dhe ta dorzonte atë tek të krishtetët që më pas ata ta vrisnin ⁹⁰.

Në këtë shtet që përmenda më sipër ka edhe motra të tjera muslimane që kanë lënë fenë krishtere dhe janë bërë muslimane të cilat ndodhen në burgjet e krishterëve. Deri në momentin që unë po shkruaj këto rreshta askush nuk ka bërë gjë për to. Madje as nëpër lajme nuk flitet për to. Këto të dhëna janë marrë nga faqet Islame të Internetin. Pyetja që del këtu është : Këta vëllezërit tanë deputetë me numër jo të vogël në kuvend nuk mundën dot ta ndalojnë padrejtësinë që u bëhet këtyre femrave

⁸⁹ Inxhazat xhema’atu Ihuan El Muslimin fi 80 seneh f nr2.

⁹⁰ Marrë nga faqja e internetit : http://ar.wikipedia.org/wiki/وفاء_قُسطنطين

të cilat zgjedhën rrugën e Islamit në një shtet që pretendohet se është demokratik dhe çdokush ka të drejtë të zgjedhë besimin që dëshiron ... etj etj mashtrime si këto.

Pasha Allahun është çudi me këta njerëz që marrin si argument ndodhinë e Ebu Bekrit me Ibn Ed-deginen kur ata nuk kanë as gjysmën e burrërisë që kishte Ibn Ed-degineh edhe pse ishte mushrik. E as nuk kanë mundësi të bëjnë atë që e bëri ai. Atëherë për çfarë është argument ajo ngjarje?! A është argument që muslimanët duhet të ndihmojnë vëllain deputet që të marrë një karrige?!

▪ **Thonë ata që e lejojnë hyrjen në këto kuvende : Dobitë që mund të rrjedhin prej pjesmarrjes janë si vijon :**

1. Pjesmarrja të jep mundësinë të kundërshtosh disa ligje të cilat bien në kundërshtim me Islamin dhe tu ngresh argumentin anëtarëve të kuvendit, madje edhe të shfaqësh edhe gjykimin Islam në një numër çështjesh. Kjo është pjesë e daves të cilën e ka bërë detyrë Allahu i Madhëruar. Kështu që grupet Islame nëse kanë mundësi ta shfaqin Islamin në këto forma duke e përçarë edhe me anë të mediave si brenda ashtu edhe jashtë vendit atëherë kjo është detyrë dhe nëse nuk bëhet marrin gjynah.

Përgjigje ndaj këtij argumentimi :

“Kjo dobi bie ndesh me dëmet që janë shumë herë më të mëdha se ajo, sepse ju nuk mundeni të arrini këto dobi deri sa të kryeni disa dëme që janë më të mëdha siç është pranimi i të drejtës së popullit për të vendosur ligje. Shembulli i këtij njeriu është si ai që për të ndërtuar një shtëpi shemb një qytet. Sot gjenden shumë mjete me anë të së cilave njeriu mund të transmetojë fenë Islame pa pasur nevojë që të hyjë në këto vende. Madje mos hyrja në këto vende në vetvete është një lloj daveje që tregon qartë kufijtë e Islamit të cilat duhet ti dijnë muslimanët. Sidomos kur flitet për çështje akideje. Ndërsa mendimi që hyrja në këto vende është vaxhib për muslimanët dhe ata marrin gjynah nëse nuk e veprojnë është mendim ekstrem”⁹¹ dhe ka nevojë për argumente.

Albanit i është drejtuar kjo pyetje : Ata (që e lejojnë hyrjen në kuvend) thonë : **“Ai veprim pa të cilin nuk arrihet kryerja e vaxhibit është vaxhib”**. Duke u nisur nga ky rregull a mund të themi ne se hyrja në kuvend është vaxhib sepse me anë të tij ne arrijmë qëllimet e larta të muslimanëve si arritja e të drejtave të tyre etj?

Përgjigje e Albanit : “Ky rregull nuk e ka këtu vendin. Rregulli që thotë : **“Ai veprim pa të cilin nuk arrihet kryerja e vaxhibit është vaxhib”** d.m.th që çdo shkak që është i lejuar në vetvete nëse të çon në kryerjen e detyrës atëherë kryerja e tij është detyrë. Ndërsa nëse ky shkak është haram nuk mund ta thotë ndonjë dijetar këtë rregull në

⁹¹ El Musharakeh fil barlaman uel uizarah f 108.

lidhje me të. Kjo fjalë në të vërtetë është ose injorancë ose dëshirë për të pasur injorancë e njëra prej tyre është më e hidhur se tjetra”⁹².

2. Propozimi i disa projekteve të cilat garantojnë ndryshimin e ligjeve të cilat bien në kundërshtim me ligjet Islame. Gjithashtu kjo është pjesë e urdhërit për të mira dhe ndalimit nga të këqiat, gjë të cilin na e ka urdhëruar profeti sal-I Allahu alejhi ue selem. Përderisa është në dorën tonë atëherë ajo është detyrë. E përderisa kjo nuk bëhet pa hyrë në kuvend atëherë hyrja në të është detyrë.

Përgjigje : Fjalë të bukura. Projekte, plane, ide, por në realitet asgjë. Këto fjalë janë të ndërtuara mbi një kapital të madh iluzionesh që nuk kanë bazë në realitet. Ose përndryshe na thoni : Kush janë ligjet kryesore që janë ndryshuar deri më sot në shtetet Islame në të cilat ka deputetë muslimanë?!

3. Anëtarët e kuvendit kanë imunitet si debutetë që janë. Nuk ka pushtet mbi ta asnjë autoritet qeveritar. Duke u nisur nga këtu themi se muslimanët kanë mundësi të përfitojnë prej këtij imuniteti për të bërë dave në Islam. Askush nuk mund ti pengojë dhe ti ngushtojë – siç ndodh me të tjerët – me justifikimin e luftës kundër ekstremizmit. Gjithashtu ata nuk i qorton njeri për ato mendime që japin në kuvend. Kështu ata kanë mundësi ta shfaqin besimin Islam nëpërmjet kuvendit dhe të zbulojnë gjithashtu kurthet kundër Islamit.
4. Gjithashtu çdo anëtar i kuvendit ka të drejtë ti kërkojë llogari ministrave madje të kërkoje edhe shkarkimin e tyre nga detyra sepse çdo ministër është përgjegjës para kuvendit për çdo neglizhencë që ndodh në ministrinë e tij. E nëse vendos kuvendi shkarkimin e tyre nga detyra atëherë ai konsiderohet i shkarkuar nga data e daljes së vendimit. Nuk ka argumente të prera që e ndalojnë hyrjen në kuvend dhe nuk ka në këtë veprim ndonjë kundërshtim me rrugën e Allahut kështu që çështja ngelet në origjinën e vet d.m.th që është e lejuar.

Përgjigje : Thotë Abdul Kerim El Humejd : “Këtë lloj njeriu (për të cilin flasim këta) e quajnë njerëzit sot “**imagjinari**”. Kanë për qëllim atë flet diçka që e imagjinon në mendjen e tij por që ajo nuk ekziston në realitet. E më mirë se kjo është fjala që ka thënë Muxhahid në shpjegimin e fjalës së Allahut : “**Fjalë të zbukuruara për mashtrim**” d.m.th : zbukurimi i të kotës me gojë. I themi këtij që ka rënë në fitne : Kush zbret nga qielli i imagjinatës tënde në tokën e realitetit e gjen vendin tas. Sa fjalë të ëmbëla?! Si farat në çark, e mashtrojnë atë që i sheh, e mjerë për atë që mashtrohet”.

⁹² Kaseta nr 660_02. Marrë nga faqja : www.alalbany.net

Thotë pak më poshtë si përgjigje për atë që thotë se deputeti mund të flasë çfarë të dëshirojë : “Pasha Allahun që këto janë iluzione në mendjet e tyre, nuk ekzistojnë në realitet. E ka dallim ndërmjet iluzioneve dhe realitetit”⁹³.

Albanit i është drejtuar kjo pyetje : A u lejohet muslimanëve apo disa grupeve Islame të hyjë në kuvend (të kandidojnë) dhe kush është argumenti?

Ka thënë Albani : “Këto kuvende nuk janë ngritur mbi baza Islame. **Përvoja e ka vërtetuar se hyrja e muslimanëve në këto kuvende është një prej rrëshkitjeve që pësojnë muslimanët. Shiko këtu (ku jetojmë) psh : U bënë votime, demokraci mashallah, shumica që fituan në të ishin muslimanë por nuk mundën të bëjnë asgjë. Argumenti që tregon se nuk lejohet të hysh në këto kuvende është më i qartë se dielli në mesditë. Nuk lejohet të mbështetet ai pushtet që gjykon jo me ligjin e Allahut. Na mjafton si fatkeqësi që ne të gjykohe mi me ligje që bien në kundërshtim me ligjet e Zotit tonë. Ndërsa të hyjmë ne në një kuvend të tillë kjo është një fatkeqësi më e madhe se e para. Argument tjetër është se ky veprim është një lloj opiumi për muslimanët për ti larguar ata nga rruga që duhet të ndjekin në dy aspekte : 1. Mësimi i pastër i Islamit sipas rrugës së selefëve në rrugën e Kur’anit dhe Sunetit 2. Zbatimi i tij në vetet tona. Disa parti vazhdojnë akoma të marrin pjesë. Kanë më shumë se gjysëm shekulli dhe nuk kanë mundur të bëjnë gjë, qoftë edhe të rregullojnë disa ide (të gabuara) që i kemi trashëguar nga baballarët dhe gjyshërit tanë. Ndërsa ata që kanë ecur në rrugën shembullore nuk janë si këta, ata kanë ecur me fjalën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem kur ka treguar se kush është grupi i shpëtuar : “Ky grup është ai që ecën në rrugën në të cilën jam unë sot dhe shokët e mi”. Këta – mashallah – rregulluan vetet e tyre, edukuan fëmijët e tyre, rregulluan familjet e tyre dhe u përhapën deri sa mbërritën deri tek vendet e mosbesimtarëve, kurse grupet politike nuk kanë rregulluar asgjë, as edhe vetet e tyre. Prandaj nuk lejohet hyrja në këto kuvende. Sidomos kur dihet që themeli mbi të cilat janë ndërtuar është gabim. Nuk ekziston në Islam diçka që quhet zgjedhje. Zgjedhjet në të gjitha vendet pa përjashtim blihen me para, me poste etj për këtë arsye në to fiton ai që është njeri i prishur, ai që është njeri i shturur, pijaneci, gruaja e shturur etj. A këta do ta rregullojnë popullin?! Sidomos umetin Islam?! “Ah, sa larg, sa larg është ajo që u premtohet”. Pyet dikush : Kur ne u themi njerëzve këto fjalë të mira, na thonë që kjo çështje është çështje ixhtihadi. A është e pranuar kjo fjalë e tyre? Përgjigjet Shejhu : “Kjo fjalë është e refuzuar plotësisht. Ne u themi këtyre që thonë se kjo është çështje ixhtihadi, kush është ai që ka bërë ixhtihad në të? Ku janë këta dijetarë që bëjnë ixhtihad, kur ata e kanë mbyllur këtë portë?! Ka prej tyre që nuk dinë të falen siç është falur profeti sal-I Allahu alejhi ue selem gjë që përsëritet pesë herë në ditë. Ku është ky dijetar që bën ixhtihad?! Allahu na ndihmoftë”. Pyet dikush dhe thotë : Disa mund të sjellin si argument që : A t’ia lemë**

⁹³ Tes’hih el eham limurad Shejh El Islam f 6-7.

këto vende krishterëve, komunistëve apo marksistëve? E pyet shejhu : Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem çfarë bëri? Përgjigjet dikush tjetër : E la Mekën. E përsërit shejhu pyetjen : Çfarë bëri ? Përgjigjet dikush : E la Mekën mosbesimtarëve. Flet Shejhu : Ata mendojnë se fjala që thonë ata është argument shumë i fortë. Ata po ta njihnin të vërtetën dhe të kishin ndjekur rrugën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem nuk do të kishte mundësi asnjë komunist apo ateist që ta pengonte daven. Është e vërtetë që Islami nuk i detyron të gjithë këta që të bëhen muslimanë sepse Allahu ka thënë : **“Nuk ka detyrim në fe”** por ata nuk do kenë mundësi ta pengojnë Islamin”⁹⁴.

Këta të cilët e lejojnë hyrjen në kuvend thonë që kjo çështje është çështje fikhu e nuk ka lidhje me akiden. Kështu kanë thënë ... por ne këtë gjë e sqaruam më sipër në kapitullin e parë që kjo nuk është çështje fikhu sepse ajo ka lidhje të drejtpërdrejt me akiden e muslimanit. Gjithashtu do vijë sqarimi për të më poshtë me lejen e Allahut.

Meqenëse sipas tyre qenka çështje fikhu përse kërkojnë argumente të prera kur dihet që shumica e çështjeve të fikhut nuk kanë argumente të prera?! Besimi i ehli Sun-netit dhe xhematit është se nuk është kusht që në çështjet e fikhut të ketë argumente të prera. Këtë lloj kushti e vendosin grupet e humbura. Kështu që fjala e tyre që thonë : **“Nuk ka argumente të prera që e ndalojnë hyrjen në kuvend prandaj lejohet”** është fjalë pa vlerë. Po të ecim me të atëherë duhet të hedhim poshtë shumë gjykime fetare sepse nuk paska për to argumente të prera!! E megjithatë argumentet janë të prera e do vijnë më poshtë me lejen e Allahut.

⁹⁴ Kaseta me nr 328_04. Kaseta është marrë nga faqja : www.alalbany.net

- **Tema e dytë : Argumentet e atyre që e ndalojnë hyrjen në kuvend.**

Kuvendi ka një rol të rëndësishëm në drejtimin e çështjeve të shtetit. Pa hyrë në detaje ne vemë re se roli kryesor që ka kuvendi është si vijon :

“Vendosja e ligjeve, në bazë të të cilave ecën shteti. Ligje te cilat mund të jenë të reja ose të modifikuara. Kjo e drejtë e vendosjes së ligjeve nisët nga rregulli i njohur që thotë : “Drejtimi i takon popullit dhe gjykimi më i lartë në çështjet e shtetit dhe shoqërisë është mendimi i shumicës pa vënë re referencë tjetër”. Në përkufizimin e këtij “drejtimi” të popullit është thënë : **“Ky është një pushtet i lartë absolut që nuk ka shok dhe as rival i vetëm në vendosjen e ligjeve në lidhje me çështjet e shtetit ose shoqërisë dhe nuk ka mbi të dhe as nuk i afrohet asnjë lloj pushteti”**. Kështu që kuvendet janë të ngritura mbi bazën e vendosjes së dëshirës njerëzore në vend të dëshirës hyjnore”⁹⁵.

- **Çështje : Kështu që pyetja që del këtu është : Çështja e hyrjes në kuvend, a është çështje që ka të bëjë me akiden apo me fikhun apo me të dyja ose a është çështja e hyrjes në kuvende çështje ixhtihadi⁹⁶ ?**

“I pyesim ata të cilët besojnë se kjo çështje është çështje ixhtihadi : Çfarë keni për qëllim me fjalën ixhtihad? A keni për qëllim që kjo është çështje e re që nuk ka ekzistuar në kohën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem? Nëse thoni po, këtë kemi për qëllim atëherë përgjigja e kësaj është në dy pika :

1. Kjo bie në kundërshtim me atë që është e njohur prej jush në lidhje me kuvendin dhe zgjedhjet. Ju thoni që ato kanë qënë të njohura që në kohën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem⁹⁷. Prandaj kujtojeni atë që thoni dhe shkruani e mos ju shtyjë bindja që keni në një çështje që të thoni çfarë do lloj

⁹⁵ El Musharakeh fil barlaman uel uizarah f 49.

⁹⁶ Këtë çështje e kemi nxjerrë nga libri “Tenuir edh-dhulumat bi keshf mefasid el intihabat” f 174-176 me disa shkurtime dhe shtesa të nevojshme dhe nga libri El Musharakeh fil barlaman uel uizarah.

⁹⁷ Nga të fundit libra që e mbështesin këtë ide të çuditshme është libri me titull “El Intihabat ue Ahkamuha fil fikh El Islami” f 23-28 në të cilin ka treguar si argument që votimet kanë ekzistuar që në kohën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem, besën që u ka marrë profeti sal-I Allahu alejhi ue selem sahabëve në atë që quhet “Bej’atul Akabeh” dhe ka kërkuar prej tyre të zgjedhin 12 veta që të jenë të parët e tyre. Argumentimi është tepër i largët. Ku krahasohet zgjedhja e 12 vetave prej njerëzve të mirë, besimtarë, që njiheshin nga të gjithë, me zgjedhjen e njerëzve që më e pakta që mund të thuhet për ta është se janë të pa njohur për popullin. Por nuk duhet harruar se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk i kërkoj ata të zgjidhen për të vendosur ligje siç ndodh sot. Kështu që dallimi është shumë i madh. Siç dihet që sistemi i zgjedhjes së qeverisë me anë të votimeve nuk ka lidhje me Islamin dhe as nuk ka qënë i njohur ndonjëherë në historinë Islame e as nuk është praktikuar ndonjëherë. Kështu që njeriu çuditet me këta njerëz të cilët janë kaq të mahnitur me çdo gjë që vjen nga perëndimi deri në atë pikë sa duan që çdo gjë që vjen që andej ti veshin petkun Islam që të bëhet e pranueshme tek muslimanët qoftë edhe duke i përdredhur argumentet deri sa të hyjnë në vendin që kërkojnë këta njerëz. Pasha Allahun ne jetojmë në kohë fitnesh.

fjale që ju bën dobi në vende të ndryshme e më pas ta hidhni poshtë po ju atë fjalë.

2. Po, është e vërtetë që këto fatkeqësi nuk kanë ekzistuar në kohën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem. Por kjo nuk domethënë që çështja ngelet në dorë të ixhtihadit dhe nuk lejohet të kudështohet ai që gabon në të. Dijetarët i krahasojnë ngjarjet e reja me parimet dhe argumentet Islame duke shikuar se kujt i përket e më pas e bashkangjisin me atë parim të cilit i përket ngjarja. E ne i kemi treguar më sipër disa dëme të kësaj çështjeje dhe se cilit parim Islam i përket kjo çështje.

Nëse thoni që kemi për qëllim me fjalën ixhtihad që nuk ka argument në të. U themi që përgjigja e mësipërme mjafton. Por u themi gjithashtu se fjala juaj që në këtë çështje nuk ka argumente nuk është e vërtetë. Mund ti shohësh argumentet e shumta në këtë libër që ta kuptosh se sa vlen kjo fjalë që thonë ata ⁹⁸.

Nëse thoni që ne kemi për qëllim me fjalën ixhtihad që kjo është çështje që duhet shikuar nga ana e dëmeve dhe dobive që ka e më pas të nxirret një gjykim për të. U themi : Kjo gjë duhej bërë para 70 vjetësh kur ishte fillimi i këtyre çështjeve ndërsa tani që muslimanët kanë 70 vjet që pësojnë disfata pas disfatash në këtë fushë, a ka ngelur më të thuhet duhet të shohim dëmet dhe dobite ?! A nuk mësojmë ne muslimanët prej asaj që pësojmë për vite me rradhë ?! Transmeton Ebu Hurejreh radi Allahu anhu nga Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem se ka thënë : **“Nuk pickohet besimtari nga një vend dy here”** ⁹⁹.

Nëse thoni që ne kemi për qëllim me fjalën ixhtihad që në këtë çështje nuk kanë rënë dakord dijetarët, për këtë arsye nuk ka të drejtë njeri të na qortojë pse zgjedhim një mendim. Ju themi : Siç dihet, çdokush që kundërshton ixhmaun e dijetarëve qortohet dhe kundërshtohet por këtu ka dhe edhe një çështje tjetër : Ka prej atyre çështjeve që vërtet ka në to dy mendime, vetëm se njëra palë i ka argumentet e qarta kurse pala tjetër jo. Në këtë rast nuk mund ta lëshojmë litarin për çdokënd të thotë çfarë të dojë ¹⁰⁰.

⁹⁸ Megjithatë mund të shtojmë këtu diçka tjetër. Sot ka edhe gjëra të tjera të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem si droga. A mund ta quani edhe këtë çështje ixhtihadi gjithashtu?! Domethënë që nuk ka argument dhe çdo kush mund të zgjedhë mendimin e tij?! Si thoni?!

⁹⁹ Transmeton Buhariu nr 5782 dhe Muslimi nr 7690.

¹⁰⁰ Shih psh çështjen e muzikës. Ka ekzistuar një kontradiktë e pa konsiderueshme në gjykimin që ka muzika në Islam. Mendimi i njohur dhe që e mbështesin argumentet e qarta nga Kur’ani dhe Sun-neti është se ajo është haram. E megjithatë ka njerëz që e bëjnë hallall. Atëherë, të heshtim nëse shohim ndonjë musliman duke dëgjuar muzikë ?! Apo çështja e kamatës apo bixhozit për të cilat gjen sot fetva që i lejojnë etj...

Fjala që kanë thënë dijetarët se nuk është detyrë të qortohet njeriu në çështjet që kanë më shumë se një mendim, a e kanë thënë këtë për çështje të tilla si çështja jonë e cila ka kaq shumë dëme apo kanë për qëllim çështje më të thjeshta se kjo ?!

Një pyetje u drejtoj atyre që thonë : “Nuk duhet të qortohet njeriu në çështjet që ka më shumë se një mendim”. Ju vetë a e keni zbatuar këtë gjë me ata që ju kundërshtojnë apo i keni akuazuar ata me lloje të ndryshme akuzash të cilat i kanë shkruar Melaiket dhe do pyetet çdokush për çfarë i ka nxjerrë goja!! I ankohemi vetëm Allahut të Madhëruar i cili do gjykojë ndërmjet njerëzve ditën e Pendimit”.

Ka thënë Muhamed Shakir Esh-sherif : “Po ta shohim çështjen në aspektin se nga e ka pikënisjen kuvendi dhe në çfarë bazohet – gjë që e treguam më sipër – vemë re se çështja ka lidhje me akiden, sepse ka të bëjë me çështje bazë të akides Islame si psh : Kush ka të drejtë të vendosë ligje? Kush është roli i njeriut në këtë mes? **Sikurse pranimi i hyrjes në këto kuvende në gjendjen në të cilën ato janë përbën një cënim për akiden.** Ndërsa nëse këto kuvende gjykojnë me ligjet e Kur’anit dhe Sunetit atëherë ngelet çështja e mënyrës së formimit të tyre, kushtet e anëtarëve të tyre, të drejtat e tyre dhe ana teknike që ka të bëjë me të. Në këtë rast mund të themi që çështja është çështje fikhu mund të ndryshojnë mendimet ndërmjet njerëzve, disa e lejojnë e disa e ndalojnë, disa e kanë të saktë e disa gabim. Duke u nisur nga realiteti i kuvendeve, gjykimi Islam për hyrjen në to është se kjo vepër është haram” ¹⁰¹.

“Përdorimi i kësaj rruge është veprim i kotë nuk çon në rezultate para se të kenë formuar muslimanët shoqërinë muslimane. Ky është një lloj mendimi i cekët edhe pse tregohen për të shumë arsye për ta bërë të pranueshëm. Por mbi të gjitha në të ka disa gabime të rrezikshme të cilat e godasin davetin në zemër dhe e pengojnë atë edhe pse në pamjen e parë duket sikur ato e ndihmojnë ose i shpejtojnë hapat e daves” ¹⁰².

“Gabim i parë : Gabim në akide. Si mund ti lejohet muslimanit të marrë pjesë në këto vende të cilat vendosin ligje, kur ai beson se ai që vendos ligje është vetëm Allahu. Me gojë thotë ligjet i vendos vetëm Allahu ndërsa me vepra thotë të kundërtën. Si mund ti lejohet atij që të marrë pjesë në të e jo më të betohet për ta respektuar dhe ruajtur atë ndërkohë që Allahu ka thënë : **“(Allahu) ju ka zbritur juve në libër (urdhër) nëse dëgjoni që njerëzit mohojnë dhe tallen me ajetet e Allahut mos qëndroni me ta deri sa të ndryshojnë bisedë sepse përndryshe ju jeni si ata”** [En-nisa 140]. Ndërkohë që ato vende për këto gjëra janë ndërtuar. Atëherë si mund të rrijë njeriu me ta?! Të gjitha ato justifikimet që tregohen nuk e bëjnë të pranueshme kundërshtimin e qartë të akides si psh : ne i tregojmë atyre zërin e

¹⁰¹ El Musharakeh fil barlaman uel uizarah f 54-55

¹⁰² El Musharakeh fil barlaman uel uizarah f 55

Islamit, ne e tregojmë gjithmonë që nuk jemi dakord me ato ligje, ne flasim në një mimber legal etj ...

Ata thonë : A nuk ka shkuar profeti sal-I Allahu alejhi ue selem tek kurejshët në kuvendet e tyre për tu transmetuar fjalën e Allahut?! Patjetër që shkonte dhe i këshillonte por nuk merrte pjesë si anëtar në kuvendet e tyre. Po sikur një musliman që fton në Islam, të ketë mundësi të shkojë në kuvendet bashkëkohore dhe t'i lejohej të flasë, atëherë e ka detyrë që të shkojë dhe të transmetojë të vërtetën, vetëm se në këtë rast ai nuk është anëtar në të, por është ftues që ka ardhur nga jashtë. Ka ardhur për të ftuar në atë që ka zbritur Allahu, as ai kuvend nuk e konsideron pjesëtar dhe as ai nuk e konsideron veten pjesëtar në të por është vetëm transmetues ka ardhur për të thënë një fjalë dhe do largohet.

Gabimi i dytë : Zbutja e çështjes para njerëzve. Ne i themi njerëzve që gjykimi me ligje të tjera veç ligjeve të Allahut është i kotë. Më pas na shohin njerëzit duke marrë pjesë në atë që ne i themi se nuk duhet të marrim pjesë në të! Si do jetë rezultati?! Kështu njerëzit nuk do kenë një përfytyrim të qartë në lidhje qëndrimin Islam kundrejt këtyre çështjeve.

Gabimi i tretë : Loja diplomatike. E kanë vërtetuar përvojat e gjata se në këtë lojë i forti e ha të dobëtin. Nuk i jepet mundësi të dobëtit qoftë edhe pa dashje ti marrë diçka të fortit. Forca dhe dobësia në lojën diplomatike nuk ka të bëjë me të vërtetën ose të kotën dhe as me shumicën ose pakicën. Mundet një pakicë në popull të ketë mbështetje nga brenda gjithashtu edhe nga jashtë dhe kështu kjo pakicë është e fortë. Ndërsa shumica dërrmuese është e dobët, është e shtypur edhe pse është shumicë” ¹⁰³.

▪ **Argumentet për këtë çështje janë të shumta :**

“Ekzistojnë shumë argumente që tregojnë se vendoja e ligjeve i takon vetëm Allahut i cili na ia ka transmetuar ato me anë të librit të Tij ose me anë të profetit të Tij sal-I Allahu alejhi ue selem. Kjo çështje është çështje akideje dhe jo çështje fikhu e ixhtihadi. Kundërshtimi në të nuk pranohet në rrethin e Islamit. E kjo ide është nga argumentet më të forta që tregojnë se nuk lejohet hyrja në vende ku i jepet njerëzve e drejta e vendosjes së ligjeve. Sikurse nuk ka asnjë lloj dobie që i afrohet këtij dëmi real. Kanë ardhur shumë argumente të Sheriatit të cilat tregojnë se Allahu është Gjykuesi dhe vetëm atij i takon gjykimi. Kështu që kjo është një çështje që ka lidhje me Allahun e Madhëruar prandaj dhe duhet ta besojë çdo besimtar dhe duhet të punojë për ta realizuar atë në veten e tij dhe në realitetin shoqëror” ¹⁰⁴.

▪ **Argumentet e Kur'anit :**

¹⁰³ El Musharakeh fil Barlaman uel uizarah f 56-58.

¹⁰⁴ El Musharakeh fil barlaman uel uizarah f 60.

Prej argumenteve që tregojnë se i gjithë gjykimi i takon vetëm Allahut dhe nuk ka shok në atë gjykim qoftë ky gjykimi i universit apo i sheriatit janë këto që vijojnë: Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“...askush nuk e shoqëron Atë në gjykimin e Tij”** [El Kehf 26]. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Vetëm Allahut i takon gjykimi ka urdhëruar të mos adhuron tjetër kënd veç Tij”** [Jusuf 40]. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“...vetëm Allahut i takon gjykimi. Ai tregon të vërtetën dhe Ai është Ndarësi më i mirë”** [El En’am 57]. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“...vetëm Allahut i takon gjykimi. Atij i jam mbështetur dhe Atij le ti mbështeten ata që duan të mbështeten”** [Jusuf 67]. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Në çdo gjë që bini në kontradiktë gjykimin e keni tek Allahu. Ky është Allahu Zoti im”**. [Esh-shura 10]. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“... Kjo gjë erdhi sepse kur ftohej për tek Allahu i Vetëm ju mohonit dhe nëse i bëhej shok atëherë besonit. Prandaj gjykimi i takon Allahut Të Lartit të Madhit”** [Gafir 12]. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Mos lut me Allahun të adhurar tjetër. Nuk ka të adhurar tjetër veç Tij. Çdo gjë do zhduket veç Fytyrës së Tij. Atij i takon gjykimi dhe tek Ai do ktheheni”**. [El Kasas 88]. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“A gjykimin e injorancës kërkojnë. E ku ka gjykim më të mirë se gjykimi i Allahut për popullin që është i sigurt”**. [El Maideh 50]. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Më pas u kthyen tek Allahu Zoti i tyre I Vërtetë. Atij i takon gjykimi dhe Ai është më i shpejti Llogaritës”** [El En’am 62]. Këto ajete me idenë që përmbajnë përbëjnë një pjesë të akides së muslimanëve të cilën e kanë detyrë ta besojnë në lidhje me Allahun Zotin e tyre. Siç kanë për detyrë të besojnë se Allahu është Krijues, Furnizues, Ai që jep dhe merr jetë. Gjithashtu kanë për detyrë të besojnë se urdhëri dhe gjykimi i takon vetëm Allahut. Ka treguar Allahu se nuk ka shok në gjykimin e Tij : **“Nuk e shoqëron Atë në gjykimin e Tij askush”** [El Kehf 26]. Në një këndim tjetër thotë : **“Mos i shoqëro Atij në gjykim askënd”** [El Kehf 26]. Ka thënë Allahu i Madhëruar në formë pyetjeje retorike : **“A kanë ata zotëra që u kanë vendosur atyre ligje në fe pa lejen e Allahut”** [Esh-shura 21]. Ka thënë Esh-shenkiti : Allahu i quajti zotra ata që vendosin ligje në fe pa lejen e Tij ¹⁰⁵.

Është betuar Allahun në Vetën e Tij të Lartë se nuk ka besuar ai i cili pretendon se është musliman nëse nuk kthehet për të gjykuar tek profeti sal-I Allahu alejhi ue selem dhe nëse kthehet por ndihet i ngushtuar prej atij gjykimi dhe nuk dorëzohet para tij. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Pasha Zotit tënd nuk kanë besuar deri sa të të marrin ty si gjykues (ndërmjet tyre) më pas të mos gjejnë ngushtim prej atij gjykimi në vetet e tyre dhe të dorëzohen”** [En-nisa 65]. Gjithashtu i ka ndaluar ata ti japin përparësi fjalëve të tyre para fjalës së Allahut dhe të dërguarit të Tij. Ata duhet të ecin pas shpalljes hyjnore. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“O ju që keni besuar mos dilni para Allahut dhe të dërguarit të Tij”** [El Huxhurat 1].

¹⁰⁵ Edhuau El Bejan 7/156.

Ka treguar Allahu i Madhëruar se ata që pranojnë ligjërim tjetër veç atij të Allahut të Madhëruar të cilin e ka transmetuar me anë të Kur'anit dhe Sunetit të profetit sal-I Allahu alejhi ue selem i kanë bërë ata (që i kanë vendosur këto ligje) zotra veç Allahut të Madhëruar. Kur'ani na ka treguar që të ruhem prej ndjekjes së rrugës së ithtarëve të librave të mëparshëm duke thënë : **“Ata i bënë dijetarët dhe murgjit e tyre zotra veç Allahut, gjithashtu e bënë edhe Isën birin e Merjemes. Ata u urdhëruan që të adhurojnë vetëm një të Adhuruar. Nuk ka të Adhuruar tjetër veç Tij. I pastër është Ai nga ato që i shoqërojnë”**. [Et-teubeh 31]. I thanë Hudhejfes radi Allahu anhu : Ç'mendim ke për këtë ajet ? Tha : Ata nuk agjëronin dhe as nuk u faleshin dijetarëve të tyre por kur këta e bënë haramin hallall ata e konsideronin të tillë dhe kur ata ua bënë haram diçka që e kishte lejuar Allahu ata e konsideronin të tillë e ky ishte adhurimi që u bënë atyre ¹⁰⁶.

E kanë pyetur Ebul Alijen : Si ishte adhurimi që u bënë beni Israilët dijetarëve? Tha : Thanë : Nuk dalim para dijetarëve tanë në asgjë. Po na urdhëruan do ta zbatojmë. Po na ndaluan do largohemi megjithëse ata i kishin urdhërat dhe ndalesat në librin e Allahut. Por ata morën mendimet e njerëzve dhe e lanë librin e Allahut pas shpine ¹⁰⁷.

Diçka e ngjashme është transmetuar edhe nga Ibn Ab-basi dhe Hasen el Basriu. Shih librin Tefsir Et-taberi 14/211-212.

“Muslimanët që ia lejojnë veteve të tyre të hyjnë në këto kuvende me justifikimin e mbrojtës së Islamit nuk u mjafton që ta pranojnë se e drejta e vendosjes së ligjeve i takon Allahut, vetëm me zemrat e tyre, sepse ky pohim teorik duhet ndjekur me punë që d.m.th të mos hysh në ato vende të cilat bien në kundërshtim të plotë me këtë. Besimi nuk është vetëm me fjalë përkundrazi ai është me fjalë edhe me vepra. Për këtë gjë kanë rënë dakord të gjithë dijetarët e ehli sunetit dhe xhemitit” ¹⁰⁸.

■ Argumentet nga sun-neti i profetit sal-IAllahu Alejhi ue selem :

Transmeton Shurejh Ibn Hani' nga babai i tij Hani' se kur shkoi tek profeti sal-I Allahu alejhi ue selem i dëgjoi profeti njerëzit duke e thirrur o Ebu El Hakem. E thirri profeti sal-i Allahu alejhi ue selem dhe i tha : **“Allahu është “El Hakem” (Gjykuesi) dhe Atij i takon gjykimi”**. Po ty pse të thërrasin Ebu El Hakem (babai i gjykuesit). I tregoi Hani' arsyen pse. Pastaj profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ia ndryshoi këtë emër dhe i vendosi emrin me emrin e fëmijës më të madh që kishte Shurejhut. I tha : ti je Ebu Shurejh ¹⁰⁹. Kështu që profeti sal-I Allahu alejhi ue selem e hodhi poshtë këtë lloj emërtimi dhe e tregoi arsyen pse kur tha : **“Allahu është “El Hakem” (Gjykuesi) dhe Atij i takon gjykimi”**.

¹⁰⁶ Tefsir Et-taberi 14/211.

¹⁰⁷ Tefsir Et-taberi 14/212.

¹⁰⁸ El Musharakeh fil barlaman uel uizarah f 65.

¹⁰⁹ Transmeton En-nesai dhe Ebu Daudi. Hadithi është i saktë.

Ka thënë Ibnul Ethiri në shpjegimin e këtij hadithi : “Nuk e pëlqeu këtë emër profeti sal-l Allahu alejhi ue selem (për njerëzit) që të mos e shoqërojë Allahun askush në këtë cilësi” ¹¹⁰.

Në lutjen e hapjes së namazit në natës profeti sal-l Alluha alejhi ue selem thoshte ndër të tjera : **“Tek Ti gjykohe”** ¹¹¹. Ka thënë Ibnul Ethiri : D.m.th tek Ti drejtohem për gjykim sepse vetëm Ty të takon” ¹¹².

Këto argumente të qarta nga Kur’ani dhe sun-neti i profetit sal-l Allahu alejhi ue selem tregojnë në formë të prerë se Allahu i Madhëruar është Gjykuesi. Vetëm Atij i takon gjykimi dhe askush nuk e shoqëron atë në këtë cilësi. Kjo është akideja e muslimanëve në lidhje me Allahun.

Kështu që arsyet pse hyrja në kuvend është e ndaluar janë të shumta prej këtyre arsyeve është : 1. Pretendimi se të drejtën për të vendosur ligje e ka dikush tjetër veç Allahut qoftë edhe kur ai me zemër nuk e pranon atë që e shpreh me gojë. Këtë arsye e shpjeguar më sipër dhe treguar argumente të shumta për të. 2. Betimi për respektimin e këtij shirku para se të hyjë në kuvend. Këtë çështje do ta shpjegojmë pak më poshtë. 3. Muslimani është i urdhëruar të mos e besojë tagutin dhe të mos e mbështesë atë. Këtë gjë e kemi shpjeguar më sipër dhe do ta sqarojmë edhe më gjerë në kapitullin e ardhshëm inshallah. E të tjera arsye që do tregohen në vijim.

- **Çështje : Janë transmetuar disa hadithe të cilat i ndalojnë muslimanët që të punojnë nën pushtetin e atyre që kundërshtojnë Islamin dhe ndalojnë marrjen përsipër të përgjegjësiave edhe pse ata prijësa janë muslimanë. Nga kjo kuptohet se nëse ata janë mosbesimtarë kjo ndalesë është më e rëndë :**

Transmeton Ebu Seid dhe Ebu Hurejreh radiallahu anhumu se profeti sal-l Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Do vijë një kohë për njerëzit që paria e tyre do jenë disa njerëz mendjelehtë të cilët afrojnë njerëzit e këqinj, largojnë njerëzit e mirë dhe vonojnë namazin. Kush i arrin ata të mos bëhet përgjegjës”** ¹¹³, as polic, as taksa mbledhës dhe as arkëtar” ¹¹⁴.

Kur profeti sal-l Allahu alejhi ue selem e thotë këtë gjë për disa prijësa muslimanë çfarë mund të thotë për ata që nuk janë muslimanë fare?!

Nga Ebu Hurejreh radi Allahu anhu transmetohet se profeti sal-l Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Mjerë për prijësat dhe për përgjegjësat. Disa njerëz do ëndërrojnë ditën**

¹¹⁰ En-nihajetu fi garib el ether. Shih rrënjën hakeme.

¹¹¹ Transmeton Buhariu nr 1120.

¹¹² En-nihajetu fi garib el ether. Shih rrënjën hakeme.

¹¹³ Ka për qëllim të mos marrësh përsipër drejtmin e njerëzve sado pak qofshin ata, në të gjitha format.

¹¹⁴ Transmeton Ebu Ja’la në Musnedin e tij nr 1115, 2/362. Hadithin e ka saktësuar Albani në es-silsiletu es-sahihah nr 360.

e Gjykimit sikur të ishin të varur për flokësh mes qiellit dhe tokës dhe të mos kishin punuar këtë punë” ¹¹⁵.

Ka transmetuar Abdu Er-Raz-zaku me zinxhirin e tij të tranmsetimit nga Mehdi se i ka thënë Ibn Mesudi radi Allahu anhu : “Çfarë do bësh ti o Mehdi kur të lihen pas shpine njerëzit e mirë e ta marrin drejtimin në dorë njerëzit e pa pjekur dhe të vonojnë namazin nga koha e vet ? I tha : Nuk e di. I tha : Mos u bëj taksambledhës, as përgjegjës, as polic dhe as postjer” ¹¹⁶.

Duket qartë në hadith që këto ndalesa nuk janë në çdo kohë por në atë kohë kur paria janë njerëz të këqij. Arsyeja pse profeti sal-IAllahu alejhi ue selem ka ndaluar nga këto punë në këto kushte është sepse njeriu që do marrë përsipër këto punë patjetër që do ti ndihmojë ata në gjynahe. E realiteti e ka treguar vërtetësinë e kësaj gjëje edhe pse ne e besojmë atë që ka thënë profeti sal-IAllahu alejhi ue selem pa pasur nevojë ta shohim atë në realitet.

Ka ndaluar profeti sal-IAllahu alejhi ue selem ndihmesën e prijësave dhe drejtuesve të cilët kundërshtojnë ligjet e Sheriatit dhe ka paralajmëruar që të ruhemi në formë të prerë prej kësaj gjëje sepse ai që i ndihmon ata është ortak me ta në ato gjynahe.

I ka thënë profeti sal-IAllahu alejhi ue selem Ka’b Ibn Uxhres : **“Allahu të ruajt o Ka’b Ibn Uxhreh prej drejtimit të mendjelehtëve”**. Tha : Ç’është drejtimi i mendjelehtëve ? Tha : **“Prijësa që do jenë pas meje, nuk ecin në rrugën time dhe nuk e marrin sunnetin tim. Kush i beson ata në gënjeshtat që thonë dhe i ndihmon në padrejtësitë që bëjnë nuk ka lidhje me mua edhe unë nuk kam lidhje me të dhe as nuk kanë për ardhur tek haudi im” ¹¹⁷, Ndërsa kush nuk i beson ata në gënjeshtat e tyre dhe nuk i ndihmon ata në padrejtësitë e tyre ai është njeriu im dhe unë jam i tiji dhe ka për të ardhur tek haudi im” ¹¹⁸**. Një hadith të tillë e ka transmetuar edhe Khab-babi radiallahu anhu nga profeti sal-IAllahu alejhi ue selem me zinxhir transmetimi të saktë gjithashtu ka transmetuar një hadith të tillë edhe Hudhejfe radi Allahu anhu me zinxhir transmetimi të saktë.

Allahu i Madhëruar e ka ndaluar ndihmesën në gjynahe dhe armiqësi ku thotë : **“Ndhimoheni njëri-tjetrin në bamirësi dhe devotshmëri dhe mos e ndihmoni njëri-tjetrin në gjynahe dhe armiqësi”** [El Maideh 2]. Shembujt në fikhun Islam për këtë

¹¹⁵ Transmeton Ahmedi në Musned 2/352. Hadithi është i saktë. E saktësoi Albani në Sahih et-tergib ue et-terhib nr 788 dhe Shuajb El Arnauti në musnedin e Ahmedit nr 8627.

¹¹⁶ Transmeton Taberaniu në Mu`xhem el Kebir 9/299 nr 9498 , Abdu Er-Raz-zaku në Musanef 2/383 nr 3789.

¹¹⁷ Pellgu që i ka premtuar Allahu profetit të Tij sal-IAllahu alejhi ue selem, uji it ë cilit është më i bardhë se qumështi dhe shija e të cilit është më e ëmbël se mjalti kush pi prej tij nuk etet më kurrë. E kush e humbet atë ai me të vërtetë është fatkeq.

¹¹⁸ Transmeton Tirmidhiu nr 617 dhe nr 2425 , En-nesai nr 4207 dhe nr 4208. Saktësoi Albani. Shih sahih et-tirmidhi dhe sahih en-nesai me të njëjtët numra.

ajet janë të shumta dhe do vijnë më poshtë me lejen e Allahut të Madhëruar. Normalisht që ai njeri që hyn në këto vende do ti ndihmojë kolegët e tij në gjëra që janë të ndaluara, sepse vet natyra e vendit dhe punës e kërkon këtë gjë. Kështu që zbatimi i këtij ajeti dhe i këtyre haditheve është i pamundur për të.

Allahu i Madhëruar e ka ndaluar animin nga mizorët. Hyrja në këto vende është nga llojet më të qarta të animit nga ata. Ka treguar Allahu i Madhëruar se ata që e bëjnë këtë gjë dënohen me zjarr. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Mos anoni nga ata që kanë bërë mizori sepse (po e bëtë) do t’ju prekë zjarri”** [Hud 113] Ka thënë Ibn Ab-basi : Mos anoni d.m.th mos u afroni tek ata. Të njëjtën gjë e ka thënë edhe Sufjan Eth-theuri.

Ajo që e sqaron edhe më shumë kuptimin e ajetit është ajeti para tij në të cilin ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Ec drejt siç je urdhëruar edhe ata që janë penduar me ty dhe mos e teproni. Ai është Shikues i asaj që veproni”**. Më pas tha : **“Mos anoni nga ata që kanë bërë mizori sepse (po e vepruat këtë) do t’ju prekë zjarri”**. D.m.th ecja drejt është e kundërta e animit dhe teprimit. Ka thënë Sufjan Eth-theuri për ata që ndihmojnë prijësat mizorë : “Kush u jep atyre bojën ose u mpreh lapsat (me të cilin shkruajnë) ai është ortak me ta në çdo gjak që kanë derdhur në lindje apo perëndim” ¹¹⁹.

Gjithashtu ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Ata ishin gati të të largonin ty prej asaj që të shpallëm Ne që të shpifje diçka tjetër e atëherë do të bënin mik. E sikur mos të të kishim forcuar do kishe anuar nga ata pak. Atëherë Ne do të jepnim ndëshkimin e dyfishtë në këtë jetë dhe të dyfishtë në jetën tjetër. Më pas nuk do gjeje kush të të ndihmonte prej Nesh”**. [El Isra 73-75]

Ka thënë Ibnu Xherir Et-taberi në shpjegimin e këtyre ajeteve : “Mendimi më i saktë në kuptimin e këtyre ajeteve është të themi se Allahu na ka treguar për profetin e Tij sal-IAllahu alejhi ue selem se mushrikët **gati sa nuk e larguan nga e vërteta që i shpalli Allahu për të vepruar diçka tjetër. E kjo është shpifja ndaj Allahut**. Më pas se çfarë ishte ajo gjë konkretisht kjo nuk është sqaruar në Kur’an dhe as në hadithet e sakta. Kjo mund të jetë kërkesa që i bënë mushrikët profetit sal-IAllahu alejhi ue selem që të prekte idhujt e tyre ose mund të jetë kërkesa që i bëri fisi Thekif profetit sal-IAllahu alejhi ue selem që tu jepte leje të përfitonin prej të ardhurave të idhujve një vit e më pas ti thyenin ato ose mund të jetë diçka tjetër” ¹²⁰.

Komisionit të përhershër i është drejtuar kjo pyetje : A ka gjynah ai musliman që merr pjesë në vendosjen e ligjeve (në një shtet që nuk gjykon me ligjin Islam)?

¹¹⁹ El Uera’ Ahmed Ibn Hanbel f 93.

¹²⁰ Tefsiri i Taberiut 17/507-508.

Përgjigje : “Nëse këto ligje bien në kundërshtim me Islamin nuk lejohet pjesëmarrja në vendosjen e këtyre ligjeve. Ndërsa nëse nuk bie në kundërshtim me Islamin nuk ka problem” ¹²¹. [Abdul Aziz Ibn Baz, Abdu Er-Raz-zak El Afifi, Abdullah Ibn Gudejan, Abdullah Ibn Ku’ud]

Ka thënë Albani : “Hyrja në kuvende të cilat janë të ngritura në ligje që bien në kundërshtim me Islamin nuk lejohet. Unë çuditë si mund të thotë një musliman që kjo është rruga e drejtë?! Them se mund ta thotë këtë gjë një musliman që nuk e njeh rrugën e profetit sal-l Allahu alejhi ue selem. Të gjitha grupet Islame janë dakord në qëllimin që kanë, por bien në kontradiktë në mënyrën e arritjes së këtij qëllimi. Një prej këtyre mënyrave është hyrja e muslimanëve në kuvend me qëllim që ti modifikojnë ligjet, ti kufizojnë dëmet e tyre dhe të arrijnë ndryshimin e atyre ligjeve të dëmshme që është e mundshme të ndryshohen deri sa me kalimin e kohës të bëhet ligji i kuvendit ligj Islam!! Unë besoj se këtë lloj mënyre nuk e thotë ose e beson asnjë prej dijetarëve të medhhebeve Islame por ky është medhhebi i një njeriu që ka qenë musliman por ka qenë i prishur të cilin e quanin Ebu Neu-uas ¹²². Ngritja e ligjit Islam me anë të kuvendeve lejohet sipas medhhebit të Ebu Neu-uasit. Ka thënë Ebu Neu-uasi (në vjershë) : **“Më kuro me atë që ishte shkaku i sëmundjes”**. Kjo është një nga gjërat më të çuditshme që dëgjojmë prej disa ftuesve muslimanë sot. Ky qëllim (që kanë grupet Islame) nuk mund të arrihet vetëm se me një mënyrë të vetme e kjo është rruga e profetit sal-l Allahu alejhi ue selem e cila mund të përmblihet me dy fjalë : **“Pastrimi dhe Edukimi”**. Shumë njerëz e kanë provuar këtë rrugë (rrugën e politikës). Çfarë përfituan prej saj? Asgjë. Ne kemi parë disa muslimanë të cilët janë shumë optimistë dhe hyjnë në kuvend, më pas dalin prej tij dhe u është dobësuar besimi i tyre tek këto kuvende (sepse e kanë parë që nuk fitohet gjë prej tyre). Ne këtë shpresojmë, vetëm se ata po e çojnë mundin e tyre dëm për të arritur një qëllim shumë të lartë me anë të një rruge që është në kundërshtim me Islamin. Nuk besoj se ka njeri qoftë edhe i paditur të mos e ketë dëgjuar fjalën e profetit sal-l Allahu alejhi ue selem të cilën e thoshte në hytбет e tij : **“Udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit sal-l Allahu alejhi ue selem”**. Nuk ka dyshim se udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit sal-l Allahu alejhi ue selem. Mirë, a mori pjesë Muhamedi sal-l Allahu alejhi ue selem me mushrikët dhe a eci me ta në sistemin e tyre? Përkundrazi, Allahu i Madhëruar i ka thënë: **“E sikur mos të të kishim forcuar do kishe anuar nga ata pak. Atëherë ne do të jepnim ndëshkimin e dyfishtë në këtë jetë dhe të dyfishtë në jetën tjetër. Më pas nuk do gjeje kush të të ndihmonte prej Nesh”**. [El Isra 73-75]. Allahu ekber. Allahu i

¹²¹ Fetaua El-lexhneti ed-daimeh el emxhuatu el ula 1/789, nr i fetvasë 7796 pyetja nr 2.

¹²² Emri i tij i vërtetë është : El Hasen Ibn Hani El Hakemi. Ka qenë poet shumë i njohur, shumë bujar por ka qenë njeri i prishur, pinte alkool dhe thurte vargje për të. E ndër vjershat e tij që ka bërë për alkoolin është ky varg që tregon Albani në të cilin thotë nga dashuria e madhe që kishte për të : “Më kuro me alkoolin i cili ishte shkaku që u sëmura”. Kështu edhe këta duan të kurohen me atë që është shkaku për sëmundjet.

Madhëruar po e kërcënon profetin e Tij sal-l Allahu alejhi ue selem. Ky ajet është argumenti më i madh që tregon se nuk i takon asnjë grupi muslimanësh që të anojnë tek ky gjykim në emër të rregullimit të tij. Allahu ka thënë në ajetin tjetër : **“Mos anoni nga ata që kanë bërë mizori sepse (po e bëtë) do t’ju prekë zjarri”** [Hud 113]¹²³.

Shih se çfare thotë profeti sal-l Allahu alejhi ue selem për ata që rrijnë me prijesat mizorë : **“Do vijnë disa prijësa, do shihni prej tyre të mira e të këqija. Kush i kundërshton ata ka shpëtuar. Kush largohet prej tyre ka shpëtuar ndërsa kush përzihet me ta është shkatërruar”**¹²⁴.

Paralajmërimet që kanë dhënë dijetarët për ata që u afrohen prijësve të cilët bëjnë padrejtësi dhe nuk kryejnë detyrat edhe pse ata gjykojnë me ligjin Islam, sepse afrimi tek ata është i rrezikshëm për besimin e atij që afrohet. Rrallë se mund të shpëtojë ai që u afrohet atyre nga gjynahet. E çfarë mund të thuhet për ata që afrohen tek ata prijësa që nuk gjykojnë fare me ligjin Islam.

Transmetohet nga Hudhejfe radi Allahu anhu se ka thënë : “Ruhuni nga vendet e fitneve. I thanë : Kush janë vendet e fitneve? Tha : Portat e prijësve. Mundet që ndonjëri prej jush të hyjë tek ata dhe ti besojë në gënjeshttrat e tyre dhe të thotë për ta atë që nuk e kanë (në formë lavdërimi). Transmeton Katadeh nga Ibn Mes’udi se ka thënë : Portat e tyre kanë shumë fitne. Pasha Atë në dorë të të cilit është shpirti im, aq pjesë sa u merrni ju atyre prej pasurisë aq pjesë u marrin edhe ata juve prej besimit tuaj¹²⁵.

Transmeton Ebu Bekr El Merrudhi se Imam Ahmedin e ka pyetur një person që kujdesej për burgjet dhe i ka thënë : O Imam, hadithi që flet për mizorët (prijësat që u bëjnë padrejtësi njerëzve) dhe ndihmuesit e mizorëve a është i saktë? I tha: Po. Atëherë ia ktheu : O Imam, a jam unë prej ndihmuesve mizorëve (për shkak se punoj në këtë punë)? I tha : Jo, ti nuk je prej ndihmuesve të tyre, ti je vet prej tyre. Ndihmuesit e mizorëve janë ata që të lajnë ty rrobat dhe të gatuajnë¹²⁶.

Ka thënë Sufjan Eth-theuri : “Po e pe lexuesin e Kur’anit që shkon tek prijësi dije se ai është hajdut. Po e pe se shkon tek pasanikët dije se ai bën syfaqësi. Ruhu se mos mashtrohesh duke të thënë se ke për të larguar ndonjë padrejtësi dhe për të mbrojtur ndonjë person që i është bërë padrejt, sepse kjo është hilja e Iblisit të cilën e përdorin kënduesit e Kur’anit si shkallë (për të arritur qëllimet e tyre)”. Ka thënë

¹²³ Kaseta nr 706_05. Marrë nga faqja www.alalbany.net

¹²⁴ Transmeton Ibnu Ebi Shejbeh 7/530 nr 37743 dhe Taberani 11/39 nr 10973. Saktësoi Albani , shih sahih el xhami es-sagir nr 5974.

¹²⁵ Musanef Abdu Er-Raz-zak 11/317.

¹²⁶ Shih librin : “Menahixh el ulemah fil emir bil ma’ruf uen-nehji anil munkar”

Fudejl Ibn Ijadh : “Na e mësonin largimin nga prijësat siç na mësonin suret e Kur’anit”¹²⁷.

Dijetarët ia mbathnin nga frika prej këtyre posteve. Transmetohet nga Lejth Ibn Sa’d¹²⁸ se ka thënë : Më tha Ebu Xha’fer (Prijësi) : A e merr në dorë drejtimin e Egjiptit? I thashë : O prijësi i besimtarëve unë jam i dobët dhe origjina ime kthehet tek skllëvërit. I tha : Nuk ke dobësi se je me mua. Megjithatë nëse ti nuk dëshiron më trego një person që ti jap në dorë drejtimin e Egjiptit. I thashë : Uthman Ibn Hakem El Xhudhami është njeri i mirë dhe ka fis (të gjerë). Kur e mori vesh Uthmani këtë gjë i dha besën Allahut që nuk do ti flasë Lejthit më me gojë¹²⁹.

Dijetarët i bënë hexhr dhe largoheshin prej atij që hynte në këto poste në të cilat kishte padrejtësi. Transmetohet nga Ahmed Ibn Seid Er-ribati se ka thënë : Shkova tek Imam Ahmedi por ai nuk e ngrinte kokën të më shikonte me sy. I thashë : O Ebu Abdilal! Njerëzit shkruajnë prej meje hadithin në Hurasan. Po qe se ti do sillesh me mua kështu do të ma hedhin hadithin tim. Më tha : Ku do shkosh ti kur të thuhet ditën e Gjykimit : Ku është Abdullah Ibn Tahir (prijësi) dhe ata që rrinin me të ? Shiko se çfarë lidhje ke ti me të. I thashë : Më dha të drejtoj Ribatin (një vend) prandaj hyra tek ai. E Ahmedi e përsëriste fjalën që tha : Ku do shkosh ti kur të thuhet ditën e Gjykimit : Ku është Abdullah Ibn Tahir (prijësi) dhe ata që rrinin me të ? Shiko se çfarë lidhje ke ti me të¹³⁰.

Transmetohet nga Husejn Ibn Mensur se ka thënë : Hyra tek Jahja Ibn Jahja¹³¹ dhe i dhashë selam por ai nuk më dha përgjigje. U ula në një cep derisa u larguan njerëzit dhe u afrova i putha kokën. I thashë : O mësuesi im a kam bërë ndonjë krim? Tha : po, ke bërë një krim dhe një gjynah të madh. I thashë : Kush është ky ? Tha : Kur të thërritet ditën e Gjykimit ku janë shokët e Abdullah Ibn Tahir a nuk do pyetesh ti para drejtësisë!! I thashë : Allahu më faltë. Pendothem tek Allahu. Atëherë u afrua tek unë, më përqafoi dhe më tha : Tani je vëllai im¹³².

Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem kur ishte në Mekë me gjithë shokët e tij, kanë hasur shumë vështirësi prej kurejshëve. Ai kishte mundësi që të gjente një rrugë të mesme ku të binte në ujdin me mushrikët për disa gjëra të përbashkëta. Gjë e cila u jepte atyre një farë lirie veprimi dhe ua lehtësonte presionin që kishin. Mushrikët nuk

¹²⁷ Këto dy fjalë ndodhen tek : Shuab El Ijman i Bejhakiut 12/36 nr 8972.

¹²⁸ Një nga dijetarët më të mëdhenj të Egjiptit. Ka jetuar në kohën e Imam Malikut dmth në shekullin e dytë të hixhrit dhe ka vdekur në vitin 175 të hixhrit, katër vjet para Malikut. Thuhet se ka qënë më i ditur se Maliku por nxënësit e tij nuk e shpërndanë dijen e tij.

¹²⁹ Es-Sunen El Kubra i Bejhakiut 10/98 nr 20732.

¹³⁰ Es-Sunen El Kubra i Bejhakiut 10/99 nr 20740.

¹³¹ Një nga dijetarët e mëdhenj në fikh dhe hadith. Ka vdekur në vitin 226 të hixhrit sipas mendimit më të saktë të dijetarëve. Ka thënë Imam Ahmedi për të : Nuk ka nxjerrë Hurasani pas Ibn Mubarekut njeri më të mirë se ky.

¹³² Es-Sunen El Kubra i Bejhakiut 10/99 nr 20738.

kërkonin prej tij që të linte daven dhe as që të thoshte që feja e tyre është e saktë por dëshironin prej tij vetëm **të mos fliste keq për idhujt e tyre haptazi dhe as për akiden e tyre të pishur**. Nëse do ta bënte këtë gjë do ta linin të bënte dave.

Gjithashtu profeti sal-l Allahu alejhi ue selem nuk ka ecur me konceptin e dobive që ecin sot shumë njerëz, d.m.th: të hesht ca kohë deri sa të forcohem dhe të shtohen njerëzit rreth meje. Ai e kundërshtoi këtë gjë dhe zgjodhi rrugën tjetër që ishte: Shfaqja e të vërtetës dhe mos pranimi i lëshimeve sepse rruga e themelimit të daves nuk mbështetet mbi lehtësimet dhe lëshimet në çështjet bazë. Përkundrazi mbështetet tek shfaqja e të vërtetës të pastër pa e ndotur ose e ndyrë atë me asgjë edhe pse mund të ikin për shkak të kësaj disa dobi ose vijnë disa mundime. Prandaj Allahu i Madhëruar i tha : **“Thuaj: O ju mosbesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju adhuron, as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj, as unë nuk do të jem adhurues i atyre që ju po i adhuron, as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj. Ju keni fenë tuaj dhe unë kam Fenë time (Islamin)”**. [El Kafirun 1-6]. D.m.th e tregoi qartë që feja ime nuk ka lidhje me fenë tuaj, ndërsa sot po përpiqen shumë njerëz të gjejnë lidhje ndërmjet Islamit dhe sistemeve njerëzore për tu treguar mosbesimtarëve që ne jemi njësoj dhe nuk ka dallim ndërmjet nesh jush. Allahu na ruajt besimin.

Gjithashtu Allahu i Madhëruar iu drejtua profetit të Tij sal-l Allahu alejhi ue selem duke e paralajmëruar të ruhet prej zgjidhjeve të mesme : **“Ata dëshiruan sikur ti të bësh disa lëshime që edhe ata të bëjnë lëshime”** [El Kalem 9].

Madje e ka konsideruar Kur’ani ndjekjen e zgjidhjeve “të mesme” që bashkojnë të vërtetën me të kotën, një prej rrugëve të munafikëve. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Kur u thuhet atyre : ejani tek ajo që ka zbritur Allahu dhe tek i dërguari, do ti shohësh munafikët duke kthyer shpinën. E si do jetë gjendja e tyre kur tu bjerë atyre ndonjë fatkeqësi për shkak të asaj që kanë punuar me duart e tyre. Më pas do vijnë tek ti e do betohen në Allahun se ne deshëm vetëm mirësi dhe bashkim (ndërmjet të kotës dhe të vërtetës)”** [En-nisa 61-62]

Kjo nuk domethënë që ne mos kërkojmë ato gjëra që janë të dobishme me të vërtetë për daven dhe as nuk domethënë që ne duhet të përballohem pa i vlerësuar rezultatet, sepse sheriati nuk na e bën detyrë të përballohem kur është e mundur që të arrihet qëllimi me anë të një rruge tjetër me më pak harxhime. Për këtë ka thënë profeti sal-l Allahu alejhi ue selem : **“Mos e ëndërroni takimin e armikut dhe lutjuni Allahu t’ju ruajë, por nëse e takoni bëni durim”** ¹³³. Por kush është rregulli në këtë çështje (çfarë rruge duhet të ndjekim)? Këtë gjë e sqaron profeti sal-l Allahu alejhi ue selem në marrveshjen e Hudejbies kur e penguan mushrikët për të hyrë në Mekë. Tha : **“Pasha Atë në dorë të të cilit është shpirti im çfarë do lloj zgjidhjeje që të më**

¹³³ Transmeton Buhariu nr 2966 dhe Muslimi nr 1742.

kërkojnë në të cilën ka respekt për shenjat e Allahut do t'ua pranoj". Ka thënë El Hatabi : Kuptimi i respektit të shenjave të Allahut këtu d.m.th lënia e luftës në vendin e shenjtë ¹³⁴, përdorimi i zgjidhjeve paqësore dhe mos derdhja e gjakut. Ky rregull na sqaron se kur mund të biem dakord me mosbesimtarët dhe kur jo.

Prandaj nuk është e ndaluar të marrësh pjesë në asnjë lloj organizate ose shoqate edhe pse nuk është muslimane duke pasur parasysh këtë kusht, **d.m.th ruajtja e kufijve të Allahut.**

Ka thënë Ibnul Kajim : “Ndër dobitë që përfitohen nga historia Hudejbies është se mushrikët , bidatçinjtë , njerëzit e prishur ose mizorët nëse kërkojnë një gjë me anë të së cilës ata duan të respektojnë kufijtë e Allahut duhet tu përgjigjemi dhe ti ndihmojmë edhe pse nuk i ndihmojmë në gjëra të tjera. **Duhet ndihmuar në ato gjëra në të cilat ata duan të respektojnë kufijtë e Allahut por nuk duhet ndihmuar në kufirin e tyre apo padrejtësitë e tyre. Kështu që çdo kush që kërkon ndihmë për atë gjë që është e dashur për Allahun duhet ndihmuar kush do qoftë ai përderisa sa nuk rrjedh prej kësaj ndihmese një gjë e urryer më e madhe.** Kjo është një nga gjërat më delikate dhe më të vështira për veten” ¹³⁵.

▪ **Argumenti i rrugës së sahabeve radi Allahu anhum.**

Janë transmetuar nga sahabet shumë ngjarje të cilat tregojnë se ata nuk e praninin përzierjen e Islamit me diçka tjetër nga cila do anë qoftë. Abdullah Ibn Ab-basi radi-Allahu anhum kur pa disa njerëz në kohën e tij që kapeshin pas fjalës së Ebu Bekrit dhe Umerit radi Allahu anhum në kundërshtim të sun-netit të profetit sal-IAllahu alejhi ue selem i kundërshtoi dhe u tha : “Kam frikë se do shkatërroheni”. Transmetohet nga Ibn Ab-basi radiallahu Anhum se ka thënë : “Profeti sal-IAllahu alejhi ue selem ka urdhëruar për të bërë haxh temetu’. I tha Urueh Ibn Zubejr : E ka ndaluar këtë gjë Ebu Bekri dhe Umeri . I tha Ibn Ab-basi : Çfarë thotë Urueh ? I thanë thotë : E ka ndaluar këtë gjë Ebu Bekri dhe Umeri . Tha Ibn Ab-basi : Kam frikë se do shkatërroheni. Unë u them : Ka thënë profeti sal-IAllahu alejhi ue selem ndërsa ai më thotë ka thënë Ebu Bekri dhe Umeri ¹³⁶?! ”

Shiko një rast tjetër që tregon se sahabet nuk praninin përzierjen e diçkaje tjetër si referencë me sheriatit. Transmeton Ebu Katade : Ishim tek Umran Ibn Husejn disa veta, ndër ne ishte dhe Bushejr Ibn Ka’b. Na tregoi Umrani hadithin se profeti sal-IAllahu alejhi ue selem ka thënë : **“Turpi është i gjithi i mirë”**. Tha Bushejr Ibn Ka’b : Ne e kemi lexuar në librat e mëparshëm se turpi është hijeshi por edhe dobësi. Atëherë u nxe Umrani deri sa iu skuqën sytë. I tha : Unë të tregoj prej profetit sal-I

¹³⁴ Sepse lufta në atë vend është me e ndaluar se kudo. Për këtë arsye profeti sal-I allahu alejhi ue selem ishte gati të bënte me mushrikët çdo lloj marrveshjeje në të cilën ruheshin kufijtë që ka vendosur Allahu.

¹³⁵ Zad El Mead 3/303.

¹³⁶ Transmeton Ahmedi në musnedin e tij 1/337.

Allahu alejhi ue selem ndërsa ti e kundërshton?! Më pas e përsëriti Umrani hadithin por edhe Bushejri e përsëriti atë që tha dhe Umrani u zemërua. E ne filluam ti themi : O Umran ai nuk është njeri i keq ai është prej nesh ¹³⁷.

Transmetohet nga Ubadeh Ibn Es-samit El Ensari radi Allahu anhu se shkoi në luftë me Muaujen radi Allahu anhu kundër romakëve. Ai (Ubadeh) vuri re se njerëzit në tregëtinë e tyre blinin copat e arit me dinar (prej ari) dhe copat e argjendit me dirhem (prej argjendi) dhe u tha : O njerëz ! ju jeni duke ngrënë kamatën. Unë e kam dëgjuar profetin sal-IAllahu alejhi ue selem se ka thënë : **“Mos e blini arin me ar vetëm se në formë të barabartë pa shtesë dhe pa vonesë”**. I tha Muaujeh : O Ebu Uelid (Ubadeh), nuk më duket se është kamatë kjo, vetëm se në rastin e vonesës. I tha Ubadeh : Unë të tregoj diçka nga profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ndërsa ti më tregon mendimin tënd?! Nëse Allahu më nxjerr (që këtu) nuk jetoj në një tokë që ti ke pushtet mbi mua. E kur u kthyen (nga lufta) shkoi në Medine. I tha Umeri radi Allahu anhu : Pse u ktheve o Ebu Uelid? Ai ia tregoi arsyen dhe se çfarë i tha Muaujes. I tha (Umeri) : Kthehu o Ebu Uelid në vendin ku ishe. E shëmtoftë Allahu atë vend në të cilin nuk je ti dhe njerëzit si ti. Më pas i shkroi Muauijes : Nuk ke pushtet mbi të dhe urdhëroi njerëzit të bëjnë atë që të tha Ubadeh sepse ajo është e vërteta” ¹³⁸.

Gjithashtu transmetohet nga Seid Ibn Xhubejr se i ka thënë Ibn Ab-basit : Neuf El Bekali pretendon se Musa (që ishte me Hidrin) nuk është Musa i Beni Israilëve por është një Musa tjetër. Ia ktheu (Ibn Ab-basi) : Gënjeu armiku i Allahut. Na ka treguar Ubej Ibn Ka’b nga profeti sal-IAllahu alejhi ue selem se : “Musa u ngrit për të folur një herë para Beni Israilëve ...”. Tregoi historinë deri në fund.

E quajti armik i Allahut sepse kundërshtoi hadithin e profetit sal-I Alahu aljehi ue selem. E ç’mund të thuhet për atë vend që është ngritur mbi bazën se e drejta e ligjeve i takon popullit. Patjetër që njeriu nuk duhet të rrijë në këtë vend dhe duhet të tregojë të metat mbi të cilat është ngritur. E jo të marrë pjesë në të me pretendimin se do arrijë disa dobi...

Për herë të parë në historinë Islame është gjykuar në vendet Islame me ligje të vendosura nga njerëzit në kohën kur Tetarët pushtuan vendet muslimane pas gjithë atyre shekujve që muslimanët gjykonin me ligjin e Allahut. Vendosi mbreti i Tetarëve Xhinkiz Khan ligjin e tij që e quajti El Jasik ose El Jasa. Ky libër ishte i përbërë nga një numër ligjesh të marra nga fe të ndryshme, feja çifute, krishtere dhe Islame. Në të kishte edhe shumë ligje të cilat i kishte vendosur me mendjen dhe dëshirën e tij. Ky u bë ligj tek pasardhësit e tij. I jepnin përparësi ndaj Kur’anit dhe Sun-neti të profetit sal-IAllahu alejhi ue selem. Ka thënë Ibn Kethiri për këtë : “Kush e bën këtë ai është

¹³⁷ Transmeton Muslimi nr 166.

¹³⁸ Transmeton Ibn Maxheh nr 18. Hadithi është i saktë.

mosbesimtar...”¹³⁹. Ka treguar Ibn Kethiri disa shembuj prej këtij ligji më pas ka thënë : “Këto janë kundështim i qartë i të gjitha ligjeve hyjnore të zbritura tek profetët alejhim selam. Ai që e le sheriatin që i ka zbritur Muhamedit sal-IAllahu alejhi ue selem dhe shkon për tu gjykuar tek ligjet e tjera të shfuqizuara (si Teurati ose Inxhili) ka mohuar e jo më ai që shkon për tu gjykuar tek El Jasa dhe i jep këtij përparësi!! Kush e bën këtë ka mohuar e për këtë ka rënë dakord i gjithë umeti Islam. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“A gjykimin e injorancës kërkojnë !! Ku ka gjykim më të mirë se gjykimi i Allahut për popullin që janë të sigurtë”** [El Maideh 50]. Gjithashtu ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Pasha Zotit tënd nuk kanë besuar deri sa të të marrin ty si gjykues (ndërmjet tyre) më pas të mos gjejnë ngushtim prej atij gjykimi në vetet e tyre dhe të dorzohen”** [En-nisa 65]¹⁴⁰.

Nga ato që treguam del në pah se çdo kush që pretendon se atij i takon gjykimin ka pretenduar se është ortak me Allahun e Madhëruar dhe ka bërë shirk. E njëjta gjë mund të thuhet për atë që e pranon këtë pretendim për dikë tjetër. Allahu na ruajt. Për këtë arsye nuk duhet që muslimani të marrë pjesë në këto vende të cilat e kanë marrë të drejtën e Allahut për vetet e tyre. E kur do kenë mundësi ta heqin këtë ligj ata që hyjnë në këto vende kur vet pjesmarrja e tyre është arritur në bazë të këtij ligji?!!

Nëse dikush thotë : Unë e kundërshtoj këtë gjë. Përgjigje : Kundërshtimi yt është formal nuk ka asnjë lloj ndikimi në pamjen e jashtme. Kjo është një fjalë që nuk e mbështet puna. Hyrja në këto vende është ndërtuar mbi përfytyrimin se njeriu mundet me anë të zërave dhe mendimeve të vendosë një ligj të ri në të cilin ka dobi ose të shfuqizojë një ligj që është i dëmshëm. Kështu që ai kur hedh mendimin kërkon mendimin e pjesëtarëve të tjerë dhe mendimi i tyre është ai që gjykon për këtë propozim!!

Kjo nuk domethënë që njeriu mos shkojë në vende të tilla për të thënë të vërtetën. Thënia e të vërtetës në këto vende është dëshmi që e ka lavdëruar Allahu për këtë umet : **“Kështu ju kemi bërë një Umet të mesëm që të jeni dëshimtarë për njerëzit”** [El Bekareh 143]. Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem shkonte tek kuvendet e kurejshëve dhe i ftonte ata në rrugën e Allahut të Madhëruar. U tregonte atyre të vërtetën me argumentin e vet dhe e kundërshtonte të kotën. Kështu kanë qënë edhe profetët alejhim selam para tij. Kjo punë është pjesë e daves që duhet të kujdesemi për të. Po sikur të ishte çështja e hyrjes në ato kuvende vetëm për të thënë të vërtetën dhe kundërshtimin e të kotës nuk do ishte e lejuar të mos shkoje. Por çështja është ndryshe. Kjo si çështje kërkohet të bëhet rrugë e umetit në të cilën duhet të eci. Sepse askush nuk hyn dot në atë vend dhe të flasë deri sa të pranojë

¹³⁹ Tefsiri i Ibn Kethirit 3/131.

¹⁴⁰ El Bidajetu En-nihajetu 13/139.

bazën mbi të cilën është ngritur ky kuvend. Por nuk është e saktë në Islam dhe as në logjikë që të pranojmë të kotën me qëllim që ta kundërshtojmë atë.

▪ **Betimi para ligjit.**

Mbi çka u tha është edhe një çështje tjetër të cilën shumë njerëz e mendojnë formale por ajo nuk është e tillë. Ai person që dëshiron të bëhet deputet duhet pa tjetër të betohet para ligjit. Betimi për të respektuar atë ligj që i jep të drejtë njerëzve për të vendosur ligje.

Komisionit të përhershëm i është drejtuar kjo pyetje : Disa muslimanë betohen në Allahun se do ti respektojnë ligjet e vendosura nga njerëzit, ligje të cilat bien në kundërshtim me Islamin. A është kjo vepër haram në Islam duke ditur se ky betim bëhet kur dikush zgjidhet si deputet në kuvend?

Përgjigje : “Nuk lejohet respektimi i tyre pa betim e jo më duke u betuar. Nuk ka dyshim që gjynahu është më i rëndë”. [Abdul Aziz Ibn Baz, Abdu Er-Raz-zak El Afifi, Abdullah Ibn Gudejan, Abdullah Ibn Ku’ud] ¹⁴¹.

Albanit i është drejtuar kjo pyetje : Unë e mora vesh përgjigjen tuaj në lidhje me hyrjen në kuvend por kam një pyetje specifike. Në vendin tonë ka “ahbash” ¹⁴² dhe ata hyjnë në kuvend dhe ndryshojnë shumë gjëra në dëm të muslimanëve dhe për këtë arsye u detyruan muslimanët që të hyjnë në kuvend që të shfrytëzojnë hapësirat ligjore për të fituar muslimanët të drejtat e tyre. Nuk është qëllimi për të ngritur shtet Islam siç thonë disa. Çfarë mendimi keni për këtë veprim?

Përgjigja e Albanit : “O vëlla ne nuk e përkrahim hyrjen në kuvend absolutisht sepse dëmi ka për të qënë më i madh se dobia. Ajo që the ka lidhje të fortë me një rregull që nuk është rregull Islam por është rregull cionist i cili thotë : **“Qëllimi e justifikon rrugën (e keqe) që të çon për tek ai qëllim”**. Ne i pamë ata të cilët hynë në këto kuvende. Përfundimi i tyre ishte shumë i keq. **Mund të kurohen disa gjëra në disa aspekte por në aspekte të tjera ky veprim është shkatërrim i fesë**. Ne vazhdojmë të këmbëngulim në qëndrimin që e treguam më parë. Kurimi nuk bëhet me anë të këtyre rrugëve të shtrembëra sepse ky rregull që treguam nuk është rregull Islam ¹⁴³. A të kundërshtoj Islamin për të ndihmuar një musliman?! Shumë herë jam pyetur madje edhe dje u pyeta : A i lejohet muslimanit ta rruajë mjekrën nga frika se mos ketë ndonjë pasojë ose dëm? Kjo hyn tek ky rregull : **“Qëllimi e justifikon rrugën (e keqe) që të çon për tek ai qëllim”**. Ky nuk është besim Islam. Besimi Islam thotë :

¹⁴¹ Fetava El-lexhneti Ed-daimeh el mexhmuatu el Ula, nr fetvas 7802 1/790-791.

¹⁴² Ahbashët janë një sekt që pretendojnë se janë muslimanë. Në besimin e tyre kanë përfshirë shumicën e pislloqeve që ndodhen tek sektet.

¹⁴³ Kjo dmth që qëllimi i mirë nuk e justifikon mënyrën e keqe për ta arritur atë qëllim. Kështu që ne nuk jemi si çifutët që thonë : **“Qëllimi i mirë e justifikon mënyrën e keqe që përdoret për të arritur tek ai qëllim”**. Ne besojmë se për të arritur një qëllim të mirë duhet pa tjetër një rrugë dhe mënyrë e mirë.

“Kush i frikësohet Allahut i bën Allahu rrugëdalje dhe e furnizon andej nga nuk ia pret mendja”. Nëse ahabashët e shohin të lejuar të hyjnë në një kuvend mosbesimtar si ai ku jeni ju në Liban që të dëmtojnë muslimanët, a ta kurojmë ne problemin sipas medhhebit të Ebu Nesu-uasit që thotë : **“Më kuro me atë që ishte shkaku i sëmundjes”.** Nëse këta ahabashët nuk kanë frikë Allahun dhe e bëjnë fenë dëshira pa u interesuar çfarë është hallall dhe çfarë është haram sepse **“qëllimi e justifikon mënyrën”** tek ata dhe hyjnë në kuvend që të dëmtojnë Ehli Sun-netin a ti marrim ata shembull ne dhe të veprojmë si ata të hyjmë në këtë kuvend mosbesimtar. **Atje ka për detyrë ai që hyn, të betohet me një betim jolislam. Për këtë asrye ne e konsiderojmë haram hyrjen atje”** ¹⁴⁴.

▪ **Dëmet që ka hyrja në këto vende :**

Ata që e lejojnë hyrjen në këto vende treguan dobisë që ka ky veprim por nuk treguan dëmet që ka. Duke hequr në një anë kundërshtimin e argumenteve që treguam më sipër, pjesmarrja në këto vende ka dëme të cilat janë më të mëdha se dobisë që i përfytyrojnë ata. Prej tyre kemi sa vijon :

1. Mos largimi nga taguti.

E kemi treguar me sipër se ai që pretendon për veten e tij se ka të drejtë të vendosë ligje e ka ngritur veten në gradën e Allahut dhe është shndërruar në tagut. Atëherë pyetja që del këtu është : Kush është detyra e muslimanëve kundrejt tagutit? A duhet ta përkrahin për hir të dobive që mund të arrijnë prej tij dhe për tu ruajtur nga dëmi i tij? Apo duhet të largohen nga ai, të distancohen dhe ta tregojnë në formë të qartë që kjo është rruga e humbjes dhe xhehenemit?

Përgjigjen na e jep Allahu në një ajet të qartë si dielli në të cilin tregon kush është rruga e profetëve në këtë çështje. Ka thënë Allahu u Madhëruar : **“Ne kemi dërguar në çdo popull të dërguar (që tu thonë) adhuroni Allahun dhe largohuni nga taguti”** [En-nahl 36]. Si bëhet largimi nga taguti? A bëhet duke hyrë në kuvend apo duke u larguar prej tij?! A bëhet duke treguar të metat e tagutit apo duke e mbështetur atë për hir të disa dobive...?!

2. Dobësia e edukimit të njerëzve me anë të besimit të vërtetë fetar ose neglizhimi i tij.

Kjo ndodh sepse ndryshimi në këtë lloj rruge vjen nga sipër dhe jo nga themeli sepse i gjithë interesi është i përqendruar tek puna politike dhe lakmia për të marrë sa më shumë vende në kuvend pa i dhënë rëndësi formimit të njerëzve dhe edukimit të tyre në akiden e tyre që më pas të kenë mundësi të përballojnë vështirësitë. I gjithë interesi do përqëndrohet tek lufta politike me qëllim për të arritur në pushtet me anë

¹⁴⁴ Kaseta nr 737_02. Marrë nga faqja www.alalbany.net

të këtyre kuvendëve duke ditur se natyra e tyre është se duhet pa tjetër të sakrifikosh pjesë të fesë dhe të bësh lëshime dhe marrveshje me rryma të tjera pa asnjë lloj kufizimi Islam. Kjo gjë pa dyshim do të çojë në neglizhimin e punës së daves. Kështu do kthehet xhemati – i cili ishte xhemati që merrej me dave – në një xhemat që merret me politikë. Gjë që do të çojë në shfaqjen e drejtuesve që përfaqësojnë shembullin e gjymtuar të akides dhe mendimit.

Duke mos harruar se këtyre njerëzve nuk do tu interesojë mësimi i akides sepse ata kanë nevojë për sa më shumë njerëz që tu japin votën. Por nëse këta do flasin për akiden patjetër që do cekin grupe të ndryshme të cilat nuk do jenë të kënaqur dhe si rezultat nuk ka se si të votojnë pro këtyre. Rezultati është i qartë. Ata do interesohen me **“artin e grumbullimit”** dhe jo me pastrimin e akides sepse atyre u interesojnë sa më shumë vota dhe nuk duhet të largojnë askënd. Prandaj duhet të heshtin prej shumë çështjeve fetare qofshin ato edhe çështje akideje për hir të interesave **“të përbashkëta”**. Siç thonë një grup njerëzish : **“E ndihmojmë njëri tjetrin për ato gjëra që biem dakord dhe e justifikojmë njëri tjetrin për ato gjëra që nuk biem dakord”** edhe po qenë këto çështje madhore të akides...!!

Gjithashtu nën petkun e këtij edukimi jo të saktë do gesh se thirrja e këtyre njerëzve në shumicën e rasteve do jetë për çështje dynjaje si ngritja e nivelit të jetesës, barazia, infrastruktura etj, që të tërheqin një grup deputetësh rreth vetes e jo në bazë të akides, por sa shihet në horizont ndonjë shenjë sprove, gjithë këto grupe të mëdha avullojnë. Nuk ngelet vetëm se ai që është edukuar në formën e saktë. Atëherë gjithë ai mund i shpenzuar dhe ekzagjerimi i bisedimeve për të drejtat e njeriut dhe problemeve të tyre bëhen në llogari të punës për daven. Gjë e cila është humbje kohe që dobia e saj është shumë e pakët. Po sikur ftuesit ta shfrytëzonin këtë kohë për të edukuar njerëzit në formën e duhur, duke i edukuar për të marrë të gjithë Islamin dhe jo vetëm një prej pjesëve të tij, siç ka vepruar profeti sal-l Allahu alejhi ue selem mbase do ishim afruar pranë përfundimit të ndërtimit të një brezi më të mirë. Një brezi të fuqishëm që është i gatshëm të përballojë vështirësitë që hasin ata që ndjekin rrugën e profetëve me lejen e Allahut të Madhëruar.

3. Ndryshimi i akides me kalimin e kohës.

Kush të siguron, mbase me kalimin e kohës njerëzit do ta pëlqejnë këtë rrugë me zemër dhe nuk e kundërshtojnë fare atë. Atëherë çështja nuk do jetë më vetëm përputhje e jashtme por do jetë përputhje me zemër me të kotën. Kryerja e vazhdueshme e një pune e bën atë akide tek njerëzit. E po të shohësh në përgjithësi të këqijat kur fillojnë janë të vogla më pas zmadhohen me kalimin e kohës. Kur’ani na ka treguar një gjë të tillë në historinë e popullit të Nuhut alejhi selam ku thotë : **“Ata thanë : Mos i lini idhujt tuaj, mos e lini Ued-den, Sua’an, Jeguthën, Jeukën dhe Nesrën”** [Nuh 23]. Transmeton Buhariu nga Ibn Ab-basi radiAllahu anhumu se ka thënë në lidhje me këto emra : Ato ishin emrat e disa njerëzve të mirë prej popullit të

Nuhut. Kur ata vdiqën u inspiroi shejtani popullit të tyre që të vendosin disa statuja tek vendet ku rrinin ata dhe ti emërtonin ato me të njëjtit emra. E kështu vepruan me të vërtetë. Por nuk u adhuruan. Deri sa kur vdiqën këta (që i ngritën këto statuja) u harrua dija dhe u adhuruan ¹⁴⁵.

Transmeton Ibn Xheriri nga Muhamed Ibn Kajs se ka thënë (për këto emra) : Ata ishin njerëz të mirë dhe kishin nxënës që mësonin prej tyre. Kur vdiqën thanë ata që mësonin prej tyre : Përse të mos u bëjmë disa statuja në format e tyre?! Kjo do na nxisë më shumë për adhurim sa herë që ne i kujtojmë ata. Ashtu vepruan por kur vdiqën erdhën të tjerë të cilëve u erdhi Iblisi dhe u tha : Të parët tuaj i adhuronin këto dhe me anë të tyre sillnin shiun e kështu i adhuruan ¹⁴⁶.

Muslimanët sot edhe pse e lejojnë hyrjen në këto kuvende ata e pranojnë se populli nuk ka të drejtë të vendosë ligje. Por duke shikuar që këto fjalë janë fjalë teorike ndërsa realiteti është në të kundërt. Me kalimin e ditëve dhe vazhdimësinë e kësaj veprë ndërmjet njerëzve, mund të vijë një ditë që njerëzit ta besojnë të kotën për të vërtetë. Siç e shohim sot tek grupe njerëzish të cilët nuk e njohin të vërtetën.

4. Tolerimi në çështje thelbësore të fesë :

Këto sisteme njerëzore ushtrojnë presion kundrejt atyre që hyjnë në këto kuvende duke i akuzuar se ata po ndjekin këtë rrugë për të mbërritur tek qëllimet e tyre. E për ta mohuar këtë akuzë, këta muslimanë e shprehin qartë dhe e përforcojnë se ata e besojnë thellësisht filozofinë demokratike dhe se ajo është zgjidhja e tyre strategjike dhe se nuk ka se si të veprojnë ndryshe. Për këtë arsye (për të hequr akuzën nga vetja) përpjekjet e tyre përqendrohen tek kërkimi i zbatimit të demokracisë me të gjitha rregullat e veta pa asnjë përjashtim. E sa herë që pushteti bën presion ata bëjnë lëshime pas lëshimesh. Si e si vetëm për të vëtetuar se thirrja e tyre buron nga besimi i tyre i vërtetë në vlerat perëndimore!!

5. Përçarja e muslimanëve, dobësimi i tyre dhe mbjellja e mosmarrveshjeve mes tyre.

Është e njohur se asnjë grup që punon për Islamin nuk mund të pretendojë se ai përfaqëson të gjithë muslimanët. Lejimi i hyrjes në këto vende do çojë që këto grupe të bëjnë gara me njëri-tjetrin kush e kush të mbërrijë në këtë vend. Këtu shfaqet problemi i krijimit të disa partive Islame. Gjë e cila i përçan muslimanët e dobësonë bashkësinë e tyre dhe mbjell ndërmjet tyre urrejtje sepse çdo grup përpaket që të bëjë për vete shumicën e muslimanëve. Kjo gjë do çojë që muslimanët ti shpërndajnë votat e tyre ndër këto parti dhe mbase asnjëri nuk fiton gjë edhe pse ata që votuan ishin të shumtë.

¹⁴⁵ Transmeton Buhariu nr 4920.

¹⁴⁶ Tefsiri I Ibn Xherir Et-taberiu 23/639.

6. Përzjerja e atyre që pretendojnë se janë besimtarë ose atyre që kanë besim të dobët me ata që janë të sinqertë :

Duhet pasur parasysh se ata që e lejojnë ndjekjen e kësaj rruge nuk mund ta kufizojnë me një grup të veçantë ose person të veçantë. Duke pasur parasysh se kjo rrugë është e paqme dhe me përfundim të njohur dhe të sigurt mund të hyjnë në të shumë njerëz. Gjë që i hap portën edhe atyre që e pretendojnë të vërtetën (por nuk janë në të), të hyjnë në këtë rrugë të cilët kanë për ta prishur me fjalët dhe veprat tyre dhe me mendimet e veçanta të dijetarëve me anë të të cilave ëndërrojnë të arrijnë disa fitore. Ndërsa rruga e daves në Islam me të gjitha fushat e veta është rrugë e vështirë. Rrugë që nuk e ndjek në shumicën e rasteve vetëm se ata që janë të sinqertë, ata të cilët janë të gatshëm të përballojnë pasojat që vijnë nga puna në rrugën e daves. Kështu që rruga e vërtetë bën pastrimin e atyre që nuk janë të sinqertë ose kanë besim të dobët të cilët prishin më shumë se rregullojnë. Kemi shembull për këtë gjendjen e daves në Mekë. Pranimi i Islamit në atë periudhë kishte vështirësi të mëdha. Prandaj nuk u futën në të vetëm se besimtarët e sinqertë. Ata ishin shtyllat e shtetit Islam dhe mbi ta u ngrit, ndërsa në Medine kur u ngrit shteti Islam dhe pranimi i daves Islame përmbante dobi të kësaj jete hynë në të ata që ishin të sinqertë dhe ata që nuk ishin të sinqertë. Prandaj Allahu i sprovoi besimtarët edhe në Medine që të dallohet kush është i sinqertë dhe kush nuk është i tillë. Allahu i Madhëruar ka thënë pas luftës së Uhudit në të cilën u sprovuan muslimanët dhe doli në pah hipokrizia e qartë : **“Allahu nuk mund ti linte besimtarët në gjendjen në të cilën ishit (dmth besimtarë dhe munafikë bashkë) por do ta ndante të ndyrën nga e mira”** [Ali Imran 179]. Kështu që ata që pretendojnë me gojë ose ata që kanë besim të dobët mund të përdoren nga armiqtë e Islamit për ti prishur ato synime që kanë ata që hyjnë në këto kuvende.

Shikimi i përfundimit :

Duhet që në lidhje me dobitë nuk duhen shikuar vetëm ato dobi të momentit por duhet shikuar më larg. Prandaj nëse një dobi e momentit të çon edhe pse pas një farë kohe në dëm ajo nuk duhet përdorur sepse përfundimi i saj është i keq. Lejimi i hyrjes në këto kuvende edhe pse mund të ketë disa dobi momentale, përfundimi të çon në dëme reale të cilat janë më të mëdha se këto dobitë. Kjo gjë do çojë që njerëzit në të ardhmen ta harrojnë gjykimin Islam dhe se kujt i takon kjo e drejtë etj. Mund ta shohësh këtë realitet sot tek grupe njerëzish që e njohin Islamin në formë të cekët.

Gjithashtu edhe dëmi nuk duhet shikuar në moment por duhet shikuar çfarë dobishë ka në përfundim. Për këtë arsye duhet bërë durim edhe pse ka disa dëme, për të arritur dobi më të mëdha, siç ndodhi në marrveshjen e Hudejbijes. Për këtë arsye nuk duhet shikuar ai dëm që përfytyrohet për momentin nëse nuk hyjnë muslimanët në këto kuvende sepse kjo gjë do u ruajë muslimanëve akiden e tyre. Kështu ajo akide nuk do përzihet me atë lloj gabimi që përfytyrohet me kalimin e kohës. Sikurse kjo gjë

do ti shtyjë ata që duan të punojnë për këtë fe që të ndjekin rrugën e saktë për të arritur atë që shpresojmë por pa u përzier me të kotën. Por edhe sikur ta përfytyrojmë se ne pasi ta kemi ndjekur këtë rrugë të saktë pa bërë lëshime dhe as tolerime në çështjet bazë të fesë nuk arrijmë atë që dëshirojmë, kjo gjë nuk na dëmton sepse çështja është siç ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Nuk e ke ti për detyrë ti udhëzosh ata por Allahu udhëzon kë të dojë”** [EL Bekareh 272]. Allahu nuk na ka bërë detyrë ne që të arrijmë fitoren por na ka bërë detyrë të japim atë që kemi mundësi. Kështu që nëse ne ecim në rrugën e drejtë duke u bazuar në Kur’an dhe Sun-net dhe japim përpjekjet tona që mundemi e kemi kryer detyrën tonë. Ndërsa fitorja është dhuratë prej Allahut ia jep Allahu kujt të dojë prej robërve të Tij. Ditën e Gjykimit do vijnë profetë të cilët kanë shumë pak njerëz që i kanë besuar e do vijnë profetë që nuk i ka besuar askush. Por ata nuk kanë gjynah për këtë. Po ta shohim çështjen në këtë aspekt nuk kemi nevojë për të bërë lëshime. Ta konsiderosh marrjen e pushtetit qëllimin e parë në dave domethënë të bësh shumë lëshime në fe dhe shkëmbime për të arritur atje, ndërkohë që pushteti nuk vjen nga kjo rrugë.

Pyetje : Mund të thonë ata që e lejojnë hyrjen në këto kuvende : Ju u justifikuat se përfundimi është në dorë të Allahut dhe ju nuk mbani përgjegjësi nëse nuk arrini rezultate. Të njëjtën gjë themi dhe ne. Ne hyjmë në këto kuvende me qëllim të mirë ndërsa rezultatet i ka në dorë vetëm Allahu.

Përgjigje : Dallimi është si nata me ditën sepse në rrugën që ndoqëm ne nuk pranuan të bëjmë tolerime, as të bëjmë haramë, as të heshtim ndaj të kotës ose ta pranojmë atë qoftë edhe vetëm me gojë dhe as ta fshehim të vërtetën. Por ecëm ashtu siç ka ecur profeti sal-Allahu alejhi ue selem me shokët e tij. Ndërsa ju thatë se do hyni në këto kuvende për hir të këtyre dobive që pretenduat. Për këtë arsye pranuat të bëni shumë tolerime në fe dhe shumë haramë. Më pas nuk arritët gjë. Kështu që ju as fenë tuaj nuk e ruajtët dhe as dobitë që pretenduat nuk i arritët, ato “dobi” për shkak të të cilave ia lejuat veteve tuaja tolerimet në fe. Për këtë ne kërkojmë llogari. Pse gjithë këto tolerime kundrejt asgjëje. Po qe se ju nuk do bënit tolerime në fe dhe do punonit në përhapjen e Islamit dhe nuk do kishit rezultate askush nuk do guxonte të fliste kundër jush sepse rezultatet nuk janë në dorën e njerëzve.

❖ **Temë : Fjalët e dijetarëve në lidhje me hyrjen në këto kuvende :**

Nuk kam dëshirë të zgjerohem shumë në tregimin e fjalëve të dijetarëve edhe pse e di që ka shumë dijetarë që kanë folur për këtë çështje sepse e vërteta është ajo që tregohet në Kur’an dhe Sun-net edhe po e kundërshtoi atë shumica e njerëzve. Ajo që dua të tregoj këtu me anë të këtyre fjalëve të dijetarëve është se ndalesa e hyrjes në kuvend nuk është gjë e re në fe dhe as nuk kam kundërshtuar ixhmaun e dijetarëve.

U pyet Shejh Mukbil Ibn Hadij El Uadi'i këtë pyetje ¹⁴⁷: Ata që i lejojnë votimet argumentohen me fjalën e Albanit, Ibn Bazit dhe Ibn Uthejminit, çfarë mendimi keni për këtë :

Përgjigje : “Falenderimi i takon vetëm Allahut paqja dhe salavatet janë për profetin tonë, familjen, shokët e tij dhe çdokënd që e përkrah atë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij. Unë e kam marrë në telefon Albanin dhe e pyeta për këtë fetva. I thashë : Si i bëre hallall votimet ? Tha : “Unë nuk i bëra hallall, por për shkak të kryerjes së asaj gjëje që ka më pak dëme...” ¹⁴⁸. Këtë përgjigje dha. Le ti shohim, a ndodhi në Algjeri dëmi më i vogël apo dëmi më i madh ¹⁴⁹ ?! Lexoni biografinë e Ebu Hanifes. Do gjeni në të se dijetarët e kanë ndaluar nxjerrjen e gjykimeve fetare me mendim. Ata e shohin këtë si portë që të çon në rrugën e Mu'tezileve dhe Xhehmijeve. Ndërsa Ibn Uthejmini, është e çuditshme që ai të ndalojë formimin e partive dhe grupacioneve dhe të lejojë atë që është më e rrezikshme si rasti në fjalë. Ne besojmë se është haram të imitosh

¹⁴⁷ Tuhfetu El Muxhib f 314-318.

¹⁴⁸ Gjatë kërimit të gjatë tek fetvatë e Albanit më rezultoi se ai ka dy mendime të ndryshme në lidhje me hyrjen në kuvend dhe votimin. Ai e ndalon në mënyrë të prerë hyrjen në kuvend dhe nuk e lejon atë e për këtë kam gjetur shumë fetva të tij por kam nxjerrë dhe përkthyer **14 fetva** që e vërtetojnë mendimin e tij për këtë çështje. Fetva të cilat ndodhen të shpërndara në këtë libër. Ajo që ka lejuar Albani – Allahu e mëshiroftë – është **votimi** (jo hyrja në kuvend) për ata kandidatë muslimanë që hyjnë në kuvend duke e justifikuar këtë gjë se zgjedhja e tyre është më pak dëme. Por ai nuk e lejon hyrjen e tyre në këto vende. Shiko me vëmendje : Ai e ka lejuar këtë vetëm në vendet Islame ku shumica absolute e atyre që votojnë janë muslimanë dhe kur kandidati është musliman. Kështu që përdorimi i kësaj fetave në vendin tonë për të treguar se lejohet të votosh është gabim i qartë sepse Albani siç e thashë e ka lejuar për vendet Islame dhe kur kandidati është musliman. Ndërsa kur kandidati nuk është musliman për këtë nuk ka folur Albani dhe as nuk di të ketë fetva që e lejon këtë. E megjithatë ne nuk jemi dakord me mendimin e tij sepse përderisa ai e ndalon hyrjen në atë vend, atëherë votimi i këtyre njerëzve që hyjnë është ndihmë për ta dhe ndihmesa në gjynahe nuk lejohet. Kurse argumenti që tregon se ndërmjet dy të këqijave ne zgjedhim atë më të voglën, ky nuk është në të vërtetë argument në këtë rast dhe ne do ta shpjegojmë këtë gjë në një kapitull të veçantë sepse ky është argumenti i vërtetë i të gjithë atyre që e lejojnë hyrjen në këto vende ose votimin. Gjithashtu të njëjtin argument e përdorin edhe ata që e lejojnë hyrjen në kuvend. Thonë : Ndër dy të këqijat ne zgjedhim atë më të voglën. Pse Shejhu Allahu e mëshiroftë nuk e mori në konsideratë këtë argument kur foli për hyrjen në kuvend por e hodhi poshtë atë duke e thënë në mënyrë të prerë se kjo nuk është rruga profetike e rregullimit ndërsa këtu e mori në konsideratë ndërkohë që çështja është pothuajse e njëjtë nga shumë aspekte të cilat e kanë shtyrë Albanin ta konsiderojë të ndaluar hyrjen atje. Gjithashtu edhe ne themi kjo nuk është rruga profetike e rregullimit. E ne do flasim për këtë gjë në një kapitull që vjen më poshtë për të treguar në formë të qartë se çfarë gjykimi ka në Islam votimi. Allahu e lehtësoftë.

¹⁴⁹ Realiteti ka treguar se atje dëmi që ndodhi ishte shumë herë më i madh për shkak të këtyre votimeve. Ndërhynë shtetet perëndimore ushtarakisht për të marrë pushtetin pasi u frikësuan se po u ikte nga duart. Pasi fituan muslimanët afro 86 % të votimeve. Gjë e cila ishte sfidë e madhe për perëndimin sepse kjo do çonte në ndryshimin e ligjeve. Atëherë e humbi demokracia vlerën e vet. Ajo u bë e keqe përderisa ata që do përfitonin prej saj ishin muslimanët. Për këtë arsye ndërhyne ushtarakisht dhe përdorën forcën deri sa i kthyen gjërat në gjendjen “normale”. Atëherë ku qenka dobia e votimit për ata që pretendojnë se ndërmejt të këqijave ne zgjedhim atë që ka më pak të këqia?!

¹⁵⁰. Ne nuk na lejohet të imitojmë Albanin as Ibn Bazin dhe as Ibn Utthejminin. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Ndiqni atë që është zbritur nga Zoti juaj dhe mos ndiqni veç Tij askënd”** [El E’raf 3] Ehli Sun-neti nuk imitojnë ¹⁵¹. U themi gjithashtu këtyre dijetarëve : **Kjo fetva që keni dhënë ju është shumë e rrezikshme sepse bota perëndimore kërkon ti kthejë shtetet Islame të gjitha në shtete demokratike!!** Prandaj duhet që këta dijetarë të largohen nga kjo fetva. Unë ju bëj juve dëshimtar se bëj teube për çdo gabim që kam bërë në librat apo kasetat e mia. E them këtë me shpirt të qetë. **Gjithashtu edhe shujhët, nuk ka për ta problem nëse kthehen sepse ata nuk e dinë se çfarë ndodh këtu dhe as se çfarë ndodh në këto kuvende. As nuk e dinë se çfarë dëmsh vijnë prej këtyre votimeve. Ka raste që kanë ndodhur vrasje vetëm për shkak të votimeve, etj dëme... Çfarë dobie sollën ato (për ne)?! Është detyrë për shujhët që të ndryshojnë mendim. Ne do tu shkruajmë atyre in shallah.**

¹⁵⁰ Domethënë të ndjekësh mendimin e dikujt pa ditur argumentet e tij. Ose më keq se kaq, ti dish që argumentet janë në kundërshtim me mendimin e disa dijetarëve dhe të ecësh me mendimin e tyre duke mos u shqetësuar se po kundërshton argumentet e qarta.

¹⁵¹ Dikur kur kemi qënë të vegjël e fillestarë në fe na urdhëronin të mos ndjekim mendimin e Ebu Hanifes dhe as të Malikut apo Shafiut apo Ahmedit sepse muslimani i mirë ecën me argumente. E desh Allahu i madhëruar të na e hapi zemrën për ta pranuar këtë të vërtetë. E kështu vepruam, e lamë mendimin e Ebu Hanifes dhe ecëm me argumentet e qarta fetare. Ndërsa sot që ne nuk jemi fillestarë dhe as të vegjël, por shumica jonë janë prindër e të pjekur na thuhet : Argument është mendimi i filanit, qoftë edhe dijetar. A vallë argumentet duhen djekur vetëm kur bien ndesh me mendimin e Ebu Hanifes?! Apo dijetarët e sotëm janë më të ditur se Ebu Hanifja apo Maliku apo Shafiu apo Ahmedit?! Apo detyra jonë është të ndjekim argumentin vetëm tek mënyra e faljes ndërsa për çdo çështje tjetër fetare na lejohet të marrim argument fjalën e një dijetari e të mos i lodhim trutë duke kërkuar të vërtetën?! Apo atëherë që ishim të vegjël dhe ishim fillestarë në fe i kuptonim më mirë argumentet fetare ndërsa sot jo?! Apo atëherë ata që e drejtonin fenë ishin të tjerë dhe fjalën tonë nuk e dëgjonte njeri për këtë arsye ishim të detyruar të mbështeteshim tek një gjë e qartë për të folur para njerëzve që të ishim sa më bindës në atë që thoshim ndërsa sot jemi ne ata që drejtojmë prandaj askush nuk ka të drejtë të na kundërshtojë, as të kërkojë argument dhe as të na kërkojë llogari kur ne largohemi nga argumentet e qarta të fesë duke pretenduar se kemi ndjekur një fetva?! Kur ka qënë në fenë e Allahut fjala e një dijetari apo e dhjetë dijetarëve apo më shumë argument në fe?! Fjala e tyre është argument vetëm atëherë kur ka rënie dakord në formë unanime nga ana e të gjithë dijetarëve të umetit Islam pa përjashtim. E them me plotë binde që rinia Islame në fillimet e Islamit në Shqipëri para 15 vjetësh ka qënë shumë herë më e interesuar për kërkimin e argumentit fetar në çdo çështje se sot. Gjithashtu e them me bindje të plotë dhe me keqardhje që periudha në të cilën ne jetojmë sot në Shqipëri është periudha e fetvave dhe jo e ndjekjes së argumentit. Ne nuk jemi kundra fetvave të dijetarëve por jemi kundra konsiderimit të tyre argumente në fe. Teorikisht të gjithë e pranojnë këtë ndërsa praktikisht shumë njerëz justifikohen për veprimet që bëjnë me fetvatë e njërit dijetar ose tjetrit. A kështu ndiqen argumentet?! Po qe se dikush mund të thotë që ne nuk jemi dijetarë kështu që do ndjekim fetvatë e dijetarëve. U themi : Po para 15 vjetësh që ne ishim fillestarë a mos vallë ishim dijetarë?! Pastaj ai që ecën me një fetva të një ose më shumë se një dijetari, në rastin më të mirë ai e ka të lejuar, por nuk i lejohet atij ti detyrojë njerëzit të ecin me atë mendim dhe as ti konsiderojë ata të humbur dhe mëkatarë pse nuk ndjekin atë mendim?! Këtu qëndron problemi. Sot shohim se argument për njerëzit janë fetvatë dhe shohim se ata nxjerrin gjykim për të tjerët me humbje në bazë të këtyre fetvave?! Ku shkuan gjithë ato përpjekje të mëdha para 15 vjetësh për të ndjekur argumentin?! Realiteti tregon se ato kanë avulluar. Ajo kohë ishte një periudhë e begatshme që iku dhe vështirë se kthehet më, vetëm po të dojë Allahu i Madhëruar.

Nëse ata nuk kthehen ne e bëjmë Allahun Dëshimtar se ne jemi larg fetvasë së tyre sepse ajo bie në kundërshtim me Kur'anin dhe Sun-netin”¹⁵².

Megjithatë Ibn Bazi Allahu e mëshiroftë ka një fetva të përbashkët me komisionin e përhershëm që është në kundërshtim me atë që tregohet prej tij. **Ai në këtë fetva e ndalon hyrjen në këto vende dhe votimin gjithashtu.** Më sipër treguam edhe një fetva tjetër të komisionit po për këtë çështje që është në përputhje me këtë që po themi. E po e sjellim edhe një herë këtu për rikujtim.

Komisionit të përhershëm i është drejtuar kjo pyetje : A lejohet të votojmë dhe të kandidojmë në zgjedhje, duke ditur se vendi ynë nuk gjykon me ligje Islame?

Përgjigje : “Nuk i lejohet muslimanit të kandidojë që të hyjë në një pushtet që nuk gjykon me ligjet e Allahut dhe vepron me ligje jo Islame. Nuk i lejohet gjithashtu muslimanëve që të votojnë për të ose për dikë tjetër që punon në këtë lloj pushteti. Vetëm nëse ai që kandidon dhe ata që votojnë kanë shpresë që ta kthejnë atë pushtet në pushtet që gjykon me ligjin Islam por me kusht që ai person që kandidon të punojë vetëm në ato poste që nuk bien në kundërshtim me ligjin Islam”. [Abdul Aziz Ibn Baz , Abdu Rrazak El Afifi , Abdullah Ibn Gudejan dhe Abdullah Ibn Kuud]¹⁵³.

Shiko me vëmendje se çfarë kushtesh ka vendosur komisioni që të jetë e lejuar kjo punë pasi treguan fillimish që kjo punë është e ndaluar në fe. **1.** Që të kesh shpresë ta ndryshosh pushtetin, në pushtet që gjykon me ligjin e Allahut. Gjë që nuk e ka arritur deri më sot askush prej atyre që kanë hyrë në këto ujëra që prej 70 vjetësh. **2.** Që të mos punosh në vende që ka haramë. Me këto dy kushte besoj se të gjithë janë dakord që ky veprim lejohet. Askush nuk kundërshton.

Pyetja që del këtu është : A ka mundësi njeri ti realizojë këto dy kushte? Madje vetëm kushtin e dytë? Realiteti 70 vjeçar ka treguar që jo. Gjithashtu vet natyra e vendit të tregon qartë që në këto vende nuk mund të shpëtojë njeri prej gjynaheve dhe fitneve¹⁵⁴.

Shiko se çfarë thotë profeti sal-l Allahu alejhi ue selem për fitnet : Transmeton Buhariu nga Ebu Hurejreh radi Allahu anhu se profeti sal-l allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Do vijnë fitne. Ai që është ulur është më i mirë se ai që është në këmbë. Ai që është në këmbë është më i mirë se ai që ecën për tek ato dhe ai që ecën është**

¹⁵² Këtu mbaroi fjala e Mukbilit Allahu e mëshiroftë.

¹⁵³ Fetava el-lexhneti ed-daimah , el mexhmuatu el ula 23/406 nr i fetvas 4029.

¹⁵⁴ Fitne quhet çdo sprovë që e fut njeriun në gjynah. Ajo në pamjen e jashte mund të duket shumë e mirë dhe e dobishme për shumë njerëz të cilët nuk kanë dije por ajo merr përpara kë të dali dhe nuk mund ta kuptojë njeriu që ka rënë në të, vetëm nëse dëshiron Allahu ta mëshirojë. E ky është problemi kryesor i fitneve, shumica e njerëzve nuk i njohin ato dhe bien kollaj në to e disa i njohin por nuk kanë atë devotshmëri që i ndalon të bien në to. Prandaj në këto raste ka nevojë njeriu të ketë dije por jo vetëm dije duhet edhe devotshmëri e cila e pengon nga gjynahet. Allahu na ruajt nga fitnet.

më i mirë se ai që rend për tek ato. Kush i del përpara (fitneve) ato e tërheq (dhe e shkatërrojnë). Kush gjen vend strehim ose mbrojtje (prej tyre) le të mbrohet” ¹⁵⁵.

Kanë thënë dijetarët në shpejgimin e këtij hadithi : “Ai që është ulur domethënë që nuk përzihet me fitnen është më i mirë se ai që është në këmbë sepse ai që është në këmbë sheh dhe dëgjon atë që nuk e sheh dhe nuk e dëgjon ai që është ulur. Kështu që ai që është në këmbë është më afër fitnes. Ai që është në këmbë është më i mirë se ai që ecën domethënë shkon për të hyrë në fitne. Ai që ecën për tek fitneja është më i mirë se ai që rend për tek ajo” ¹⁵⁶.

E nga fitnet më të mëdha janë të hyjë njeriu tek prijësat sepse nëse hyn tek ata do ti besojë për gënjeshttrat e tyre dhe do ti ndihmojë për padrejtësitë e tyre. E argumentet për këtë i përmendëm më sipër.

I ka thënë profeti sal-IAllahu alejhi ue selem Ka’b Ibn Uxhres : **“Allahu të ruajt o Ka’b Ibn Uxhreh prej drejtimit të mendjelehtëve”**. Tha : Ç’është drejtimi i mendjelehtëve ? Tha : **“Priësa që do jenë pas meje, nuk ecin në rrugën time dhe nuk e marrin sunnetin tim. Kush i beson ata në gënjeshttrat që thonë dhe i ndihmon në padrejtësitë që bëjnë nuk ka lidhje me mua edhe unë nuk kam lidhje me të dhe as nuk kanë për ardhur tek haudi im”** ¹⁵⁷, Ndërsa kush nuk i beson ata në gënjeshttrat e tyre dhe nuk i ndihmon ata në padrejtësitë e tyre ai është njeriu im dhe unë jam i tij i dhe ka për të ardhur tek haudi im” ¹⁵⁸. Po kur ata nuk janë fare muslimanë!!

E si të mos bjerë në kundërshtim me ligjin Islam ai që hyn në këto poste kur detyra e parë është siç e sheh në pyetjen që vijon :

Komisionit të përhershëm i është drejtuar kjo pyetje : Disa muslimanë betohen në Allahun se do ti respektojnë ligjet e vendosura nga njerëzit, ligje të cilat bien në kundërshtim me Islamin. A është kjo vepër haram në Islam duke ditur se ky betim bëhet kur dikush zgjidhet si deputet në kuvend?

Përgjigje : “Nuk lejohet respektimi i tyre pa betim e jo më duke u betuar. Nuk ka dyshim që gjynahu është më i rëndë”. [Abdul Aziz Ibn Baz, Abdu Er-Raz-zak El Afifi, Abdullah Ibn Gudejan, Abdullah Ibn Ku’ud] ¹⁵⁹.

¹⁵⁵ Transmeton Buhariu nr 3601.

¹⁵⁶ Et-tejsir bi sherh El Xhami’ Es-sagir 2/112.

¹⁵⁷ Pellgu që i ka premtuar Allahu profetit të Tij sal-IAllahu alejhi ue selem uji it ë cilit është më i bardhë se qumështi dhe shija e të cilit është më e ëmbël se mjalti kush pi prej tij nuk etet më kurrë. E kush e humbet atë me të vërtetë është fatkeq.

¹⁵⁸ Transmeton Tirmidhiu nr 617 dhe nr 2425 , En-nesai nr 4207 dhe nr 4208. Saktësoi Albani. Shih sahih et-tirmidhi dhe sahih en-nesai me të njëjtët numra.

¹⁵⁹ Fetava El-lexhneti Ed-daimeh el mexhmuatu el Ula 1/790-791, nr fetvas 7802.

Pas kësaj a mund të thotë njeri se këta dijetarë e lejojnë hyrjen në kuvend apo i lejojnë votimet?!

Në vijim po tregojmë një këshillë që ia drejton Albani njërit prej kokave të selefijve në një prej vendeve arabe të cilët u morën me politikë pas një rruge të gjatë në daven e drejtë sipas Sun-netit të profetit sal-I Allahu alejhi ue selem.

Ka thënë Albani : “Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk ka qënë i interesuar që të afrohej tek mushrikët e Mekës dhe as nuk ka ecur me ta për hir të daves së tij sepse Allahu i Madhëruar e edukoi atë në formën më të mirë dhe e paralajmëroi që të mos anojë nga ata sadopak qoftë, siç ka thënë Allahu i Madhëruar : **“E sikur mos të të kishim forcuar do kishe anuar nga ata pak”**. [El Isra 73-75]. Allahu i Madhëruar e edukoi atë në formën më të mirë e gjithashtu profeti sal-I Allahu alejhi ue selem i edukoi shokët e tij deri sa u krijua ai grup muslimanësh me anë të të cilëve pati mundësi profeti sal-I Allahu alejhi ue selem që të mbrohej nga sulmet e mosbesimtarëve në Medine. Ndërsa ju që hyni në kuvend dhe ata që e lejojnë si ju këtë gjë përfundimi juaj është dështim i qartë sepse do ta humbni daven për të cilën kujdeseshit, me anë të së cilës keni edukuar kë keni dashur në këtë rrugë. Më në fund po preokupoheni me politikë dhe me kuvende më pas mund të bëheni ministra. E këta ministra do gjykojnë jo me ligjet e Allahut. A ky është daveti për ta njësuar Allahun në gjykim, ndërkohë që ju do ta mbështesni gjykimin me ligje të tjera veç ligjit të Allahut me pretendimin se do rregulloni ligjin?! Dikur para shumë kohësh kam pas dëgjuar prej Ihuanëve se thoshin që rregullimi i shoqërisë bëhet me anë të rregullimit të individit dhe kjo është e vërteta që ne e besojmë në mënyrë të sigurt. Kjo është davja e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem siç e dëshmon këtë gjë jeta e tij e ndritshme. Nuk e di pasha Allahun se çfarë ju shtyu që të kundërshtoni rrugën e profetit tuaj sal-I Allahu alejhi ue selem duke hyrë ne këto kuvende të cilat janë të ngritura mbi gjykimin me ligje të tjera veç ligjit të Allahut”¹⁶⁰.

Kapitull i tretë

❖ Temë : A lejohet të votosh nëse kandidati është besimtar ose jobesimtar?

E treguam në kapitujt e mëparshëm që hyrja në këto kuvende domethënë që njeriu ti japi të drejtë vetes që i takon vetem Allahut e kjo është shirk i madh dhe është nga gjynahet më të mëdha.

Shiko se çfarë thuhet në librin : **“Enciklopedia e feve dhe sekteve bashkëkohore”** : “Nuk ka dyshim se sistemi demokratik është një nga llojet e reja të **shirkut në bindje ose në të drejtën e vendosjes së ligjeve, në të cilin anulohet e drejta absolute e Krijuesit të Madhëruar për të vendosur ligje dhe kjo e drejtë kalon në dorë të**

¹⁶⁰ Kasete nr 700_02. Marrë nga faqja www.alalbany.net

krijesave. Allahu i Madhëruar ka thënë : “Ju nuk adhuron veç Tij vetëm se emra të cilat i keni vendosur ju dhe baballarët tuaj. Nuk ju ka zbritur Allahu argument për to. Gjykimi i takon vetëm Allahut. Ai ka urdhëruar të mos adhuron kënd tjetër veç Tij. Kjo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë” [Jusuf 40]. Gjithashtu ka thënë : “Gjykimi i takon vetëm Allahut” [El En’am 57]”¹⁶¹.

A është kjo çështje e diskutueshme në Islam? Shih se çfarë thotë Albani për të : “Kuvendet janë të ngritura në parimin se gjykimi i takon popullit. Kurse në Islam gjykimi i takon Allahut. **E kjo është një çështje që nuk ka kontradiktë ndërmjet muslimanëve për të edhe pse ata kanë kontadikta në shumë çështje të tjera e falenderimi për këtë i takon Allahut.** Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Gjykimi i takon vetëm Allahut. Ka urdhëruar të mos adhuron askënd tjetër veç Tij”.** [Jusuf 40]. **Kjo është një e vërtetë që nuk pranon diskutim. Atëherë si mund të thuhet që gjykimi i takon popullit?!”**... Më pas tha : Nuk bëhet ndryshimi duke ecur me njerëzit në humbjen tyre por duhet të jetë siç ka thënë Sejid Kutub Allahu e Mëshiroftë i cili përdorte këtë shprehje : **“Duhet pa tjerët të bëhet ndarje (e të vërtetës nga e kota)”**. Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem në daven e tij dhe në luftën kundër tagutit nuk anoi nga mushrikët. Allahu i ka thënë : **“E sikur mos të të kishim forcuar do kishe anuar nga ata pak.”**. [El Isra 73-75] Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk e bënte këtë gjë por Allahu ia tha atij që të jetë mësim për ne që të mos anojmë nga mosbesimtarët dhe mushrikët”¹⁶².

Treguam gjithashtu në një nga kapitujt e kaluar se ai që pretendon për veten se ka të drejtë të vendosë ligje ai është **tagut** dhe ka rënë në shirkun e madh. Treguam për këtë argumente të mjaftueshme për atë që dëshiron të njohë të vërtetën.

Votimi domethënë : Që personi që voton i jep të drejtën kandidatit për ta përfaqësuar atë në kuvend. Po ta deshifrojmë këtë shprehje sipas Islamit mund ta shprehim kështu : Ti japësh kandidatit të drejtën për tu bërë zot dhe të drejtën që të të përfaqësojë ty në këtë cilësi. Del pyetja: Kush musliman është i kënaqur që ta përfaqësojë atë dikush për të qënë zot për të, veç Allahut të Madhëruar?! A mund të lejohet kjo në fenë Islame për hir të dobive që mund të ketë?! Cilat dobi janë më të mëdha se dobia e ruajtjes së Akides?! Çfarë do lloj dobie që mund tregohet ajo ngelet më e vogël se dobia e ruajtjes së akides dhe besimit nga ndytja me këtë gjynah.

Po qe se e ke kuptuar çështjen e shirkut në këtë temë mund ta kuptosh kollaj këtë që po të them, përndryshe, nëse nuk e ke kuptuar qaje veten tënde se zemra jota ka marrë fund. Po nuk arriti muslimani të njohë ç’është shirku dhe llojet e tij, si mund të

¹⁶¹ Enciklopedia e feve dhe sekteve bashkëkohore 2/1066-1067. Ky është nga librat më të njohur në botën Islame i cili ka folur për fetë dhe sektet bashkëkohore.

¹⁶² Kasete nr 358_03. Marrë nga faqja www.alalbany.net

ruhet prej tij?! Në një kohë që njohja e shirkut është më e rëndësishme se shumica e çështjeve të tjera fetare!!

Ne do tregojmë disa shembuj nga çështjet Islame të cilat të ndihmojnë të kuptosh se çfarë gjykimi ka votimi.

Shembulli i parë : Alkooli, dihet që alkooli është gjynah i rëndë në Islam dhe profeti sal-I Allahu alejhi ue selem e ka mallkuar atë që pi alkool. A mendon se ai që pi alkool është i mallkuar ndërsa ai që e vendos veten e vet në vend të Allahut është i bekuar?! Kush është gjynah më i rëndë : Pirja e alkoolit apo ta ngrejë njeriu vetën në gradën e Zotit?! Besoj se nuk ka nevojë për përgjigje. Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk ka mallkuar vetëm atë që pi alkool por ka mallkuar me të edhe nëntë veta të tjerë.

Transmetohet nga Enes Ibn Malik radi Allahu anhu se Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ka mallkuar tek alkooli dhjetë veta : **“Atë që e shtrydh, atë që e kërkon ti shtrydhet, atë që e pi, atë që e mbart, atë që e kërkon ti mbartet, atë që ua jep për të pirë (u mbush gotat), atë që e shet, atë që ha pasurinë e fituar nga alkooli, atë që e blen dhe atë kërkon ti blihet”** ¹⁶³.

Siç e sheh gjithë këta janë mallkuar tek çështja e alkoolit edhe pse nuk e kanë pirë atë. E gjithë kjo për ti mbyllur çdo portë alkoolit. Patjetër që këta njerëz kanë dobi prej alkoolit, dikush duke fituar para në prodhim, dikush duke i shërbyer atyre që e pijnë e me radhë. E megjithatë Islami i ka hedhur poshtë të gjitha këto dobi. Madje edhe sikur të vijë dikush e të thotë unë i dua këto para që të ndërtoj xhami apo i dua ti përdor në punë të mira apo për të ndihmuar të varfërit. I themi këto para janë të pista dhe nuk lejohet të përdoren. **Kështu që çdo lloj dobie që vjen prej këtij harami është dobi e pistë dhe nuk ka në të mirësi.**

A mendon se Allahu i Cili i ka mallkuar gjithë këta njerëz dhe ua ka ndaluar të përfitojnë në të gjitha format prej alkoolit, të na e lejojë ne të ndihmojmë një person që të bëhet zot sepse kemi dobi prej kësaj ndihme?! Besoj se nuk ka nevojë për përgjigje. Kush është gjynah më i rëndë, pirja e alkoolit apo të pretendojë njeri se ka atë të drejtë që i takon vetëm Zotit?!

Marrim një shembull tjetër : Kamata, dihet se kamata është nga gjynahet më të mëdha për të cilat ka mallkim. A mendon ti se ai që ha kamatën është i mallkuar ndërsa ai që pretendon se ka të drejta që i takojnë vetëm Zotit është i bekuar?! Kush prej këtyre të dyjave është gjynah më i madh?! Nuk ka ka dyshim se i shirku është gjynah shumë herë më i madh se kamata. **Thelbi i Islamit është të njësoh Allahun në çdo gjë që i takon vetëm Atij**, prandaj çdo vepër që bie ndesh me këtë është më e

¹⁶³ Transmeton Tirmidhiu nr 1295 dhe Ibn Maxheh nr 3381. Hadithin e saktësoi Albani. Ka për qëllim me fjalën : “shtrydh” prodhimin e tij.

rëndë se gjynahet që nuk kanë lidhje me këtë. Por Allahu nuk ka mallkuar tek kamata vetëm ata që hanë kamatë por ka mallkuar edhe të tjerë të cilët ndihmojnë në të.

Transmetohet nga Abdullah Ibn Mes'udi se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Ka mallkuar Allahu atë që ha kamatë, atë që i jep për të ngrënë kamatë (të tjerëve) dëshmitarin dhe atë që e shkruan (aktin e marrveshjes për të fituar kamatë)”** ¹⁶⁴. Në këtë hadith janë mallkuar gjithë këta siç e sheh vetëm sepse kanë ndihmuar në këtë gjynah edhe pse mund të pretendojë ndonjëri prej tyre se ato para do ti përdorë për punë të mira apo për të ndihmuar të varfërit etj...

Harami nuk kthehet në hallall për shkak të atyre dobive që përfytyrojnë njerëzit me mendjet e tyre. E sikur të ndodhte kështu nuk do ngelej haram në tokë sepse për çdo haram do gjesh njerëz që pretendojnë se ka dobi në të. Eh, nuk ka dyshim që edhe haramet kanë dobi, por dobitë e tyre janë shumë herë më të vogla se dëmet e tyre dhe Islami i ka hedhur poshtë ato dobi deri ditën e Gjykimit. Kështu që nuk mund të vijë njeri e të pretendojë se këto gjëra janë hallall për shkak të dobive që kanë. A mendon ti se Allahu – I Cili i ka mallkuar këta njerëz që ndihmojnë në ngrënien e kamatës – e lejon të ndihmosh dikë për të marrë ato të drejta që i takojnë vetëm Zotit?! Përgjigjen do të ta le ty.

Marrim një shembull tjetër, hadithin që e përmendëm më sipër. Ky hadith e tregon qartë që ndihmesa në gjynahe nuk lejohet : I ka thënë profeti sal-IAllahu alejhi ue selem Ka'b Ibn Uxhres : **“Allahu të ruajt o Ka'b Ibn Uxhreh prej drejtimit të mendjelehtëve”**. Tha : Ç'është drejtimi i mendjelehtëve ? Tha : **“Prijësa që do jenë pas meje, nuk ecin në rrugën time dhe nuk e marrin sun-netin tim. Kush i beson ata në gënjeshtat që thonë dhe i ndihmon në padrejtësitë që bëjnë nuk ka lidhje me mua edhe unë nuk kam lidhje me të dhe as nuk kanë për ardhur tek haudi im”** ¹⁶⁵, **Ndërsa kush nuk i beson ata në gënjeshtat e tyre dhe nuk i ndihmon ata në padrejtësitë e tyre ai është njeriu im dhe unë jam i tij i dhe ka për të ardhur tek haudi im”** ¹⁶⁶.

Kush i ndihmon në padrejtësitë e tyre ka këtë gjykim, po ai që i ndihmon të bëhen zotra?! A mendon ti se e ka të lejuar ti ndihmojë ata?!

¹⁶⁴ Transmeton Muslimi nr 4176 dhe 4177, Ebu Daudi nr 3335 dhe Ibn Maxheh nr 2277. Kanë thënë dijetarët në shpejgimin e hadithit : Është i mallkuar edhe nëse vetëm e merr kamatën dhe nuk e ha atë. Të gjithë këta janë të mallkuar sepse janë ortakë në këtë gjynah.

¹⁶⁵ Pellgu që i ka premtuar Allahu profetit të Tij sal-IAllahu alejhi ue selem uji it ë cilit është më i bardhë se qumështi dhe shija e të cilit është më e ëmbël se mjalti kush pi prej tij nuk etet më kurrë. E kush e humbet atë ai me të vërtetë ëhstë fatkeq.

¹⁶⁶ Transmeton Tirmidhiu nr 617 dhe nr 2425 , En-nesai nr 4207 dhe nr 4208. Saktësoi Albani. Shih sahih et-tirmidhi dhe sahih en-nesai me të njëjtët numra.

Ka thënë Ibn Tejmija : “Kanë thënë disa prej selefëve : Ndhmuesit e mizorëve janë ata që i ndihmojnë qoftë edhe duke u dhënë kutinë e bojës ose duke u mprehur lapsat. Disa kanë thënë : Ai që u lan rrobat është prej ndihmuesve të tyre” ¹⁶⁷.

Ka thënë Sufjan Eth-theuri për ata që ndihmojnë prijësat mizorë : **“Kush u jep atyre bojën ose u mpreh lapsat (me të cilin shkruajnë) ai është ortak me ta në çdo gjak që kanë derdhur në lindje apo perëndim”** ¹⁶⁸.

Po ai që i ndihmon për gjëra më të mëdha se boja dhe mprehja e lapsit. Mendo pak, çdo gjynah që bëjnë ata, ky njeri që i ndihmon ata është ortak me ta në to. Për çdo imoralitet që bëjnë ata, ai që i ndihmon është ortak, për çdo vjedhje gjithashtu, për çdo mashtrim, për çdo vrasje etj etj gjynahe të shumta. A mendon ti se këta që ndihmojnë prijësin musliman që është mizor janë mëkatarë, ndërsa ai që ndihmon mosbesimtarin nuk është mëkatar?! Pasha Allahun që kjo është e çuditshme. Duke ditur se mosbesimtarët nuk e kanë frikë Allahun dhe mund të zhyten në të gjitha llojet e gjynaheve që nga llojet më të ndyra të shirkut e deri tek gjynahet e rëndomta të cilat i bën çdokush jo vetëm ai që është në pushtet. A mund të më thuash kush janë këto dobi që e bëjnë të lejuar në fe që ti ndihmosh këta njerëz për të bërë gjithë këto gjynahe?!

Një herë takoi Sufjani Sherikun pasi ky i fundit ishte bërë gjykatës, i tha (Sufjani) : O Sherik, pas gjithë kësaj të mire që të ka dhënë Allahu në udhëzim dhe dije, ti bëhesh gjykatës?! Ia ktheu Sheriku: O Sufjan, por njerëzit kanë nevojë patjetër për gjykatës. I tha Sufjani: O Sherik, njerëzit gjithashtu kanë nevojë edhe për polic ¹⁶⁹!

Gjithashtu edhe hadithet e tjera që e ndalojnë hyrjen në këto poste të cilat i përmendëm më sipër, janë të bazuara në këtë rregull që ka treguar Allahu i Madhëruar ku thotë : **“Ndhmoheni njëri-tjetrin në bamirësi dhe devotshmëri dhe mos e ndihmoni njëri-tjetrin në gjynahe dhe armiqësi”** [El Maideh 2] Ky ajet i ka përfshirë të gjitha llojet e gjynaheve. Nuk ka lënë gjë ¹⁷⁰.

¹⁶⁷ “Mexhmu’ El Fetaua” i Ibn Tejmijes 7/64.

¹⁶⁸ El Uera’ Ahmed Ibn Hanbel f 93.

¹⁶⁹ Ka për qëllim Sufjani me fjalën e tij: “Njerëzit gjithashtu kanë nevojë edhe për polic”, ti kujtojë Sherikut hadithin që profeti sal-Allahu Alejhi ue selem ka ndaluar të punosh polic kur i pari i shtetit është njeri i keq edhe pse mund të jetë musliman . Transmeton Ebu Hurejreh dhe Ebu Seid El Hudriu nga profeti sal-Allahu alejhi ue selem se ka thënë: **“Do t’ju vij në disa prijësa të cilët afrojnë njerëzit e këqinj dhe vonojnë namazin nga koha e vet. Kush i arrin këta, të mos bëhet i parë tek ata, as polic, as taksa mbledhës dhe as arkëtar”**. Transmeton Ibn Hibani e të tjerë . Saktësoi Albani. Es-silsiletu Es-sahihah nr 360. Hadithi tregon idenë që kur prijësat janë mizorë nuk lejohet ndihma e tyre. Për këtë arsye e qortoi Sufjani Sherikun që ishte bërë gjykatës edhe pse gjykonte me ligjin Islam. Po të ishte Sufjani gjallë dhe të shihte gjendjen tonë sot, çfarë mendon se do thoshte...!!

¹⁷⁰ Ka thënë Imam Shatibiu : Kanë rënë dakord dijetarët që nuk lejohet ndihmesa në gjynahe dhe armiqësi. “El Mu’uafakat” 5/185.

Shembull tjetër : Transmeton Seid Ibn Musejib se Umeri radi Allahu anhu vrau shtatë veta prej banorëve të San'as të cilët vranë një person dhe tha : **“Sikur të bashkohen të gjithë banorët e San'as (qytetit) për të vrarë një person do ti vras të gjithë”** ¹⁷¹.

E nxorri këtë gjykim Umeri radi Allahu anhu në bazë të gjykimit që ka bashkëpunimi në të këqia dhe gjynahe sepse dihet në formë të sigurt se sikur të mblidhen 10 veta tek një person nuk e vrasin dot të gjithë njëherësh por do veprojnë dikush më shumë e dikush më pak. Dikush e mban e dikush e godet e kështu me radhë. Por gjykimi për ta është i njëjtë edhe pse vrasjen e drejtpërdretj e kryen vetëm njëri prej tyre sepse ata e kanë ndihmuar njëri-tjetrin në këtë gjynah.

Shembull tjetër : Transmetohet nga Ebu Tufejl se ka thënë : E pyetën Aliun radi Allahu anhu : A ju la profeti sal-I Allahu alejhi ue selem diçka të veçantë që nuk ia la askujt tjetër? Tha : Nuk la profeti sal-I Allahu alejhi ue selem asgjë të veçantë për ne përveç të tjerëve. Vetëm se na la këtë që ndodhet në millin e shpatës dhe nxorri prej saj një letër në të cilën ishte shkruar : **“E ka mallkuar Allahu atë që ther për dikë tjetër përveç Allahut. E ka mallkuar Allahu atë që ndryshon kufijtë e tokës. E ka mallkuar Allahu atë që mallkon prindërit e tij. E ka mallkuar Allahu atë që strehon atë që ka kryer krim** ^{172, 173}.

Ka thënë Ibn Tejmije : “Kush strehon një kriminel ose hajdut e të tjerë si këta – të cilët duhen ndëshkuar për të shkuar e drejta e Allahut ose e njerëzve në vendin e vet – dhe e mbron atë që të mos marrë ai njeri të drejtën e tij, ai është ortak me të në gjynah. Madje Allahu edhe i dërguari i Tij sal-I Allahu alejhi ue selem e ka mallkuar atë që bën krim ose që strehon një kriminel ... Nëse dikush e di vendin e pasurisë (së marrë padrejtësisht) ose të personit të kërkuar para drejtësisë e ka detyrë që të tregojë dhe nuk i lejohej ta fshehtë sepse kjo është ndihmesë në bamirësi dhe devotshëmi e kjo është vaxhib. Ndërsa nëse pasuria ose personi kërkohet padrejtësisht nuk duhet treguar sepse tregimi (në këtë rast) konsiderohet ndihmesë në gjynahe dhe armiqësi. Përkundrazi është detyrë të mbrohet sepse mbrojtja e atij që i është bërë padrejtësi është vaxhib. Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Enes Ibn Malik radia Allahu anhu se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Ndhimjoje vëllain tënd nëse i bën dikujt padrejtësi ose nëse i bëhet padrejtësi. I thashë : O i dërguari i Allahut : E ndihmoj kur i është bërë padrejtësi ndërsa kur ai bën padrejtësi si ta ndihmoj? Tha : Duke e penguar prej padrejtësisë. Kjo është ndihma jote për të”** ¹⁷⁴.

¹⁷¹ Transmeton Maliku në “El Muueta”. Etherin e ka saktësuar Albani në “Irua El Galil” nr 2201.

¹⁷² Fjala të cilën ne e kemi përkthyer krim në arabisht është “muhdith” që dmth : ai që bën diçka të keqe të tokën e Allahut. Këtu hyn edhe ai që shpik diçka të re në fenë Islame.

¹⁷³ Transmeton Buhariu në shumë kapituj të librit të tij dhe Muslimi gjithashtu.

¹⁷⁴ Es-sijasetu Esh-sher’ijeh f 113.

Shembull tjetër : Është pyetur Ibn Tejmija Allahu e Mëshiroftë për ata muslimanë të cilët përgatisin ushqim feste për festat e krishterëve ose bëjnë veprimet e tyre si pagëzimi ose festa e ditëlindjes (së Isës alejhi selam) e të tjera festa si këto. Ose u shesin atyre ato gjëra që i përdorin ata (krishterët) në festat e tyre. A u lejohet muslimanëve të bëjnë ndonjë nga këto veprime apo jo?

Përgjigje: “Falenderimi i takon vetëm Allahut. Nuk i lejohet muslimanëve të përngjasohen me ta në asnjë gjë prej atyre festave që janë për ta. As në ushqime, as në veshje, as në larje (pagëzim), as në ndezje zjarresh e të tjera si këto. Nuk lejohet përgatitja e gostive dhe as dhurimi apo shitja e atyre gjërave që i përdorin ata në festat e tyre. Nuk duhet të lejohen as fëmijët që të luajnë ato lojra të veçanta për festat e tyre dhe as të zbukurohen me ndonjë zbukurim të veçantë. Festat e tyre tek muslimanët duhet të jenë si ditët e tjera duke mos i veçuar me asgjë. Veçimi e këtyre ditëve ¹⁷⁵ (të festave krishtere) për muslimanët me qëllim është i ndaluar. Për këtë nuk ka kontradiktë ndërmjet dijetarëve. Madje disa dijetarë janë të mendimit se ai që i vepron këto vepra ka bërë kufër sepse në to ka madhërim për shenjat e kufrit. Kanë thënë disa dijetarë : Ai që ther atë ditë bagëtinë që ka ngordhur është njësoj sikur ka therur një derr ¹⁷⁶. Ka thënë Amr Ibn El As radia Allahu anhu : **“Kush merr shembull vendet e huaja dhe feston festat e tyre dhe përngjasohet me ta deri sa të vdesë, do të ringjallet me ta ditën e Gjykimit”**. Transmetohet në Sun-netin e Ebu Daudit nga Thabit Ibn Ed-dah-hak se ka thënë : Një person bëri nedhr (u zotua) se do therte deve në Beuaneh (emër vendi). Erdhi tek profeti sal-I Allahu alejhi ue selem dhe i tha : Unë kam bërë nedhr që të therr deve në Beuaneh. I tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“A ka pasur në të ndonjë idhull që adhurohej veç Allahut në kohën e injorancës”**? I tha: jo. I tha: **“A kanë pas festuar në të ndonjë nga festat e tyre”**? I tha : jo. I tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“Kryeje nedhrin tënd. Nuk duhet kryer ai nedhr që përmban mëkat dhe as ai që nuk e ka në dorë biri i Ademit”**. Nuk i dha leje profeti sal-I Allahu alejhi ue selem që ta kryejë nedhrin edhe pse kryerja e tij është vaxhib deri sa i tregoi që atje nuk janë kryer festat e mosbesimtarëve. Më pas i tha : **“Nuk kryhet nedhri që përmban mëkat”**. Kur therja (që është adhurim për Allahun) në një vend që ata kanë pas kryer në të festa është e ndaluar, po të marrësh pjesë në festat e tyre ¹⁷⁷?! Umeri radi Allahu anhu, sahabet dhe dijetarët e tjerë i kanë vënë kusht atyre që të mos i shfaqin festat e tyre në vendet e muslimanëve por ti bëjnë ato fshehurazi në vendbanimet e tyre. Po kur ata që i shfaqin ato festa (festat e krishterëve) janë vet muslimanët?! Umeri radi Allahu anhu ka thënë : **“Mos e mësoni**

¹⁷⁵ Veçimi i tyre duke bërë gosti ose pushim ose duke veshur veshje të veçanta si veshjet e festave etj.

¹⁷⁶ Krahasoje këtë therje me votimin. Mos harro që dijetarët e kanë konsideruar këtë therje të ndaluar vetëm pse u përngjason atyre. Po kur ky veprim i shërben atyre?! Po votimet a nuk janë një prej veçorive të tyre?! Islami nuk i njeh ato, kështu që pjesmarrja në to është përngjasim me ta.

¹⁷⁷ Ndryshoja vetëm emrin dhe thuaj : Po të marrësh pjesë në votimet e tyre!!

gjuhën e të huajve dhe mos hyni tek mushrikët në kishat e tyre ditën e festave ¹⁷⁸
sepse zemërimi zbret mbi ta ¹⁷⁹. Kur ai që hyn vetëm për të shikuar e ka të ndaluar
sepse zemërimi i Allahut zbret mbi ta, po ai që vepron veprat e tyre të cilat janë shkak
i zbritjes së zemërimit. Kanë thënë disa prej selefëve në shpjegimin e fjalës së Allahut
: “... edhe ata që nuk marrin pjesë në shpifje” d.m.th në festat e mosbesimtarëve.
Kur ky është gjykimi për pjesëmarrjen pa vepruar asgjë, po ai që vepron diçka që
është prej veçorive të tyre?! Është transmetuar nga profeti sal-I Allahu alejhi ue
selem në librat e suneneve dhe në musned se ka thënë : “Kush i përngjan një populli
ai është prej tyre” ndërsa në një transmetim : “Nuk është prej nesh ai që
përngjasohet me të tjerët”. Ky është hadith i saktë. Kur ky është gjykimi i
përngjasimit me ta në zakonet e tyre e çfarë mund të jetë përngjasimi me ta në ato
gjëra që janë edhe më të mëdha. Shumica e dijetarëve e kanë konsideruar të pa
pëlqyer – ose haram ose mekruh – ngrënien e mishit që kanë therur në festat e tyre
duke e futur këtë gjë tek ajo që është therur për dikë tjetër veç Allahut. Gjithashtu e
kanë ndaluar ndihmesën e tyre në festat e tyre me dhurata ose shitje ¹⁸⁰. Kanë thënë
: Nuk i lejohet muslimanëve ti shesin krishterëve ato gjëra që janë në dobi të festave
të tyre as mish, as gjak, as rroba. As nuk u japin hua kafshë dhe as nuk ndihmohen
në fenë e tyre për asgjë sepse kjo konsiderohet madhërim i shirkut të tyre dhe
ndihmesë në kufrin e tyre ¹⁸¹. Duhet që prijësi ti ndalojë muslimanët nga këto gjëra
sepse Allahu i Madhëruar ka thënë: “Ndhimohuni në bamirësi dhe devotshmëri dhe
mos u ndihmoni në gjynahe dhe armiqësi”. Muslimanit nuk i lejohet ti ndihmojë ata
për të pirë alkool duke ua prodhuar atë ose në forma të tjera e ç’mund të thuhet
për ndihmesën në atë që është kufër?! Nëse nuk lejohet ti ndihmojë ç’mund të
thuhet kur ai i vepron vet ato veprime. Allahu e di më mirë” ¹⁸². (Këtu mbaroi fetvaja
e Ibn Tejmijes).

Shembull tjetër : Është pyetur Ibn Tejmije për marrdhëniet e tregëtisë me Tetarët
(Mongolët) a janë të lejuara ?

Përgjigje : “Lejohet në marrdhëniet e tregëtisë me Tetarët ajo që lejohet me të tjerët
si ata dhe është e ndaluar ajo që është e ndaluar me të tjerët si ata. Kështu që lejohet
që të blejë njeriu prej bagëtive ose kuajve të tyre e të tjera si këto, siç mund të blihen

¹⁷⁸ Hyrja në kishat e tyre është e ndaluar jo vetëm ditët e festave por çdo ditë të vitit për shkak të
pikturave dhe statujave që ndodhen atje. Ka thënë Umeri radi Allahu anhu : “**Ne nuk hyjmë në kishat
tuaja për shkak të figurave që ndodhen në to**”. Transmeton Bejhakui me zinxhir transmetimi të saktë
shih librin : “**Rregullat e martesës**” të Albanit f 92. Kur ky është gjykimi vetëm i hyrjes po ndihmesa e
tyre apo kryerja e veprimeve të tyre!!

¹⁷⁹ Po kur njerëzit votojnë për të zgjedhur zotin e tyre që do gjykojë për ta, a mendon se këtyre u zbret gjë
tjetër veç zemërimit?!!

¹⁸⁰ Kur qënka e ndaluar ti ndihmohet ata në festat e tyre a mendon se lejohet të ndihmohet dikë që ta ngrëjë
veten e vet në gradën e Zotit dhe të bëjë të gjitha llojet e gjynaheve pa përjashtim sepse nuk i kërkon kush
llogari me justifikimin se ka në këtë dobi!!

¹⁸¹ Ndërsa votimi na qënka i lejuar sepse paska dobi!! Allahu na ruajt.

¹⁸² “El Fetava El Kubra” i Ibn Tejmijes 2/487-489. Peyetja nr 359 – 29.

prej turqëve, fshatarëve ose kurdëve. Lejohet që tu shesë atyre ushqim ose rroba siç mund t'ia shesë të tjerëve që janë si ata. Kurse nëse u shet atyre ose të tjerëve ato gjëra që i ndihmojnë ata për të bërë haramë si kuaj ose armë të cilat përdoren për të luftuar në formë të ndaluar, kjo nuk lejohet. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Ndihmohuni në bamirësi dhe devotshmëri dhe mos u ndihmoni në gjynahe dhe armiqësi”**. Gjithashtu transmetohet në librat e suneneve se profetit sal-I Allahu alejhi ue selem ka mallkuar tek alkooli dhjetë veta : **“Atë që e shtrydh atë që e kërkon ti shtrydhet, atë që e pi, atë që e mbart, atë që e kërkon ti mbartet, atë që ua jep për të pirë (duke e hedhur në gotë), atë që e shet, atë që ha pasurinë e fituar nga alkooli atë që e blen dhe atë kërkon ti blihet”**. Ka mallkuar atë që e shtrydh kur dihet që ai shtrydh rrushin dhe e bën lëng dhe ky lëng është hallall dhe mund të përdoret në forma të lejuara ¹⁸³.

Shembull tjetër : Është pyetur Ibn Tejmija për një grua të ve e cila posedon disa bizhuteri dhe i jep ato me qera dhe prej kësaj pasurie ushqehet. A është hallall ky veprim apo jo?

Përgjigje : “Falenderimi i takon Zotit të Botëve. Ky veprim është i lejuar tek Ebu Hanifja, Shafiu dhe të tjerë dijetarë. Por e ka konsideruar jo të pëlqyeshme Maliku, Ahmedi, dijetarët e medhhebit Maliki dhe shumë prej dijetarë të medhhebit Hanbeli. Ky mos pëlqim domethënë mekruh jo haram. E gjithë kjo nëse është paraja që fiton në të njëjtin lloj të bizhuterive ¹⁸⁴. Ndërsa nëse paratë e fituara nuk janë prej llojit të bizhuterive kjo është e lejuar. Kështu që kjo grua nëse i jep këto me qera dhe ushqehet me këtë fitim për shkak të nevojës që ka nuk e ka të ndaluar. Por e ka për detyrë të japë zekatin e bizhuterive në mendimin e shumicës së dijetarëve si Ebu Hanifja apo Maliku apo Ahmedi. Ky gjykim (që thamë) është nëse ajo i jep me qera për atë grua që zbukurohet para burrit të saj ose për të marrë pjesë në ato takime që janë të lejuara si psh në dasëm që lejohet të marrësh pjesë në të. Ndërsa nëse ua jep me qera atyre grave që zbukurohen për burrat e huaj kjo nuk lejohet. E nëse i jep me qera për ato që zbukurohen për të bërë imoralitet gjykimi është aq i rëndë (dhe i qartë) sa nuk ka nevojë të pyesë. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Ndihmohuni në bamirësi dhe devotshmëri dhe mos u ndihmoni në gjynahe dhe armiqësi”**. [El Maideh 2]. **Nuk lejohet që të ndihmohet askush për të bërë imoralitet dhe asnjë gjynah tjetër as duke i dhënë bizhuteri apo rroba apo banesë apo kafshë e të tjera as në formë qeraje dhe as në ndonjë formë tjetër”** ¹⁸⁵.

¹⁸³ Mexhmu' El Fetaua 29/275.

¹⁸⁴ Dmth : nëse bizhuteritë janë prej ari atëherë marrja e fitimit të qerasë së tyre në ar është mekruh. Gjithashtu nëse bizhuteritë janë argjend marrja e fitimit të tyre në argjend është mekruh. Ndërsa nëse fitimi që nxjerr nga qeraja e bizhuterive të arit është argjend ose e bizhuterive të argjendit ar kjo nuk është mekruh por e lejuar.

¹⁸⁵ Mexhu' El Fetaua 30/194-195.

Shembujt janë të shumtë. Mund të bëhet një libër i tërë vetëm me shembuj të tillë të cilët tregojnë në mënyrë të prerë që ndihmesa në haram nuk lejohet. Sidomos në ato haram që nuk mund të bëhen hallall kurrë as edhe në rastet e domosdoshmërisë si shirku apo padrejtësia e të tjerëve apo imoraliteti.

Po nëse kandidati është musliman a lejohet të votosh për të? Fakti që kandidati është musliman nuk ndryshon ndonjë gjë nga realiteti. Ne nuk dyshojmë tek nijeti i muslimanëve. Besojmë se ata e duan të mirën për umetin Islam por kjo nuk është rruga e duhur për të arritur të mirën. Ato dëme që përmendëm më sipër në hyrjen e muslimanëve në këto vende shpresoj ti kujtosh në këtë moment. Hyrja e muslimanit atje domethënë pranim me vepra i shirkut edhe pse me zemër thotë që unë nuk e pranoj. Nëse e di se çfarë gjykimi ka në Islam ai vend në vetvete. Mos pranimi vetëm me zemër nuk mjafton. E jo më që ai me gojë thotë të kundërtën e asaj që ka në zemër kur betohet para ligjit. Detyra e muslimanit është të largohet nga shirku, ta mohojë atë me gojë, me zemër dhe me vepra. Nuk i mjafton atij vetëm të falet dhe të agjërojë, nëse nuk e bën këtë. Allahu ka thënë në Kur'an : **"Kush e mohon tagutin dhe beson Allahun ai është kapur për hallkën më të fortë"** [El Bekareh 256].

Ka thënë Ibn Xherir Et-taberi : "Mendimi më i saktë në kuptimin e fjalës **"tagut"** është se tagut quhet çdokush që e tepron para Allahut **duke i detyruar njerëzit që ta adhurojnë ose ti binden atij**. Kështu që kuptimi i fjalës është : Kush e mohon adhurimin e çdo të adhuruari veç Allahut dhe beson në Allahun dhe e thotë me sinqeritet që Allahu është i Adhuruari dhe Zot, ai është kapur për gjënë më të fortë që mund të kapet ai që dëshiron të shpëtojë veten nga dënimi i Allahut"¹⁸⁶.

Ka thënë Muhamed Ibn Abdul Ueh-hab : Dije se njeriu nuk bëhet besimtar në Allahun deri sa të mohojë tagutin. Argument është fjala e Allahut : **"Kush e mohon tagutin dhe beson Allahun ai është kapur për hallkën më të fortë"** [El Bekareh 256]¹⁸⁷.

Gjithashtu ka thënë Muhamed Ibn Abdul Ueh-hab : Dije se detyra e parë që i ka bërë Allahu birit të Ademit është mohimi i tagutit dhe besimi në Allahun dhe argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar : **"Ne kemi dërguar në çdo umet të dërguar (që tu thonë popujve të tyre) : Adhuroni Allahun dhe largohuni nga taguti"** [En-nahl 36]¹⁸⁸.

Domethënë që davja e profetëve ka qënë e përqendruar në këto dy pika. Besimi në Allahun dhe largimi nga taguti. A është betimi për të respektuar shirkun dhe tagutin apo votimi i tij largim nga taguti?! Besoj se nuk ka nevojë për përgjigje.

¹⁸⁶ Tefsir Et-taberi 5/419.

¹⁸⁷ Ed-durer es-senijeh fil exhuibeti en-nexhdijeh 1/163.

¹⁸⁸ Mexhmuatu Et-teuhid f 160.

Normalisht që muslimani që hyn në këto vende nuk hyn me qëllim të keq. Por a nuk betohet ai kur hyn atje që do e respektojë këtë shirk dhe tagut mbi të cilin është ndërtuar ky sistem?! Këtë gjë e treguam më sipër. Treguam më sipër edhe fetvanë e komisionit të përhershëm në lidhje me këtë betim. Po ai që e voton tagutin a e ka mohuar në të vërtetë në këtë formë?! A ky është mohimi i tagutit që ka urdhëruar Allahu në Kur'an. Apo ta ndryshojmë Kur'anin për hir të dëmeve dhe dobive?!

Gjithashtu kur të hyjë në atë vend a do tu flasë pjesëtarëve për teuhidin e për shirkun që ata bëjnë përditë. Mendoj se përgjigja është : Jo. Përkundrazi nëse do flasë, ka të drejtë të flasë për temën e radhës. Atëherë çfarë do lloj dobie që vjen prej kësaj rruge çfarë vlere ka kur njeriu rri mes tyre kur ata bëjnë shirk dhe nuk u thotë gjysëm fjale për të?! A është teuhidi çështja kryesore në Islam dhe thelbi i thirjes së gjithë profetëve?!

Hyrja në kuvend a është qëllim në vetevete apo shkak me anë të të cilit mendojnë disa muslimanë se mund të arrijnë disa dobi?! Atëherë pyetja që del është : **A lejohet të heshtësh ndaj qëllimit kryesor të fesë për të ruajtur një shkak** që pretendohet se prej tij ka dobi por që në të vërtetë nuk është ashtu. Por edhe sikur të ketë dobi, kush janë ato dobi më të mëdha se teuhidi?!

❖ **Çështje : A lejohet të qëndrosh në një mexhlis ku bëhet shirk ose gjynahe pa i kundërshtuar ato dhe pa u larguar prej tyre?**

- Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“(Allahu) ju ka zbritur juve në libër (urdhër) nëse dëgjoni që njerëzit mohojnë dhe tallen me ajetet e Allahut mos qëndroni me ta deri sa të ndryshojnë bisedë sepse përndryshe ju jeni si ata”** [En-nisa 140]

Ka thënë Ibn Tejmija : “Nuk i lejohet askujt që të marrë pjesë në mexhlistet ku bëhen gjynahe me dëshirë dhe pa domosdoshmëri¹⁸⁹. Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Kush beson Allahun dhe ditën e Fundit të mos rrijë në një tavolinë ku pihet alkool”**¹⁹⁰. Çuan tek Umer Ibn Abdul Azizi disa njerëz që kishin pirë alkool. Urdhëroi që të ndëshkoheshin të gjithë. I thanë : Ndër ta është një person që (nuk ka pirë sepse) po agjëron. Tha : Me të filloni. A nuk e keni dëgjuar se çfarë thotë Allahu në Kur'an : **“(Allahu) ju ka zbritur juve në libër (urdhër) nëse dëgjoni që njerëzit mohojnë dhe tallen me ajetet e Allahut mos qëndroni me ta deri sa të ndryshojnë bisedë sepse përndryshe ju jeni si ata”** [En-nisa 140]. Kështu e sqaroi Umer Ibn Abdul Azizi se ai që merr pjesë në gjynah është njësoj si ai që e ka vepruar atë. Prandaj kanë thënë dijetarët : Nëse dikush ftohet në një darkë në të cilën ka gjynahe si alkooli ose

¹⁸⁹ Do ta shpjegojmë më poshtë in shallah se çfarë d.m.th “dosmodoshmëri” dhe kush janë kushtet e saj. Për arsye se shumë njerëz janë argumentuar me këtë gjë dhe kanë bërë haramin hallall pa u kufizuar me kushtet që ka domosdoshmëria.

¹⁹⁰ Transmeton Tirmidhiu nr 2801 dhe të tjerë. Hadithi është i saktë.

muzika nuk lejohet të marrë pjesë sepse Allahu na ka urdhëruar ta kundërshtojmë të keqen në bazë të mundësisë. Kështu që ai që merr pjesë në këtë të keqe me dëshirë dhe nuk e kundërshton atë ka thyer urdhërin e Allahut dhe të dërguarit të Tij sepse ka lënë pa zbatuar urdhërin që i ka dhënë (Allahu). Kështu që ai që merr pjesë në mexhlisin e akloolit me dëshirë dhe pa domosdoshmëri dhe as nuk e kundërshton atë (mëkat) siç ka urdhëruar Allahu, ai është ortak me ata fasikë në mëkatin e tyre prandaj u bashkangjitet atyre (në gjykim)”¹⁹¹.

Ka thënë Sulejman Ibn Abdullah Ibn Muhamed Ibn Abdul Ueh-hab¹⁹² pasi ka treguar ajetin : **“(Allahu) ju ka zbritur juve në libër (urdhër) nëse dëgjoni që (njerëzit) mohojnë dhe tallen me ajetet e Allahut mos qëndroni me ta deri sa të ndryshojnë bisedë sepse përndryshe ju jeni si ata”** [En-nisa 140] : “Kush ulet me ata që mohojnë ajetet e Allahut dhe tallen me to në atë moment që ata e veprojnë këtë gjë ai është si ata. Nuk ka dallim këtu ndërmjet atij që ka frikë prej tyre apo dikujt tjetër vetëm nëse është i imponuar”¹⁹³.

Gjithashtu ka thënë Sulejman Ibn Abdullah Ibn Muhamed Ibn Abdul Ueh-hab : “Kuptimi i ajetit është siç duket në pamjen e jashme. Ai person që dëgjon njerëzit duke mohuar ajetet e Allahut e duke u tallur me to dhe rri me ta duke mos qënë i detyruar, nuk i kundërshton dhe as nuk largohet prej tyre deri sa të ndërrojnë bisedë, ai është si ata edhe pse nuk ka vepruar veprimin e tyre. Me këtë ajet janë argumentuar dijetarët se ai që kënaqet me gjynahun ai është njësoj si ai që e ka vepruar atë. Nëse ai pretendon se ai e urren këtë veprim me zemër nuk i pranohet sepse gjyrimi lidhet me pamjen e jashme”¹⁹⁴.

- Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Kur të shohësh ata që merren me ajetet Tona largohu prej tyre deri sa të ndryshojnë bisedë. E nëse shejtani të bën të harrosh atëherë mos rri pasi të kujtohesh me njerëzit mizorë”** [El En’am 68].

Ka thënë Et-taberi në shpjegimin e këtij ajeti : “I thotë Allahu i Madhëruar profetit të Tij sal-l Allahu alejhi ue selem : Nëse i sheh mushrikët të merren me ajetet Tona që ti kemi zbritur dhe ti kemi shpallur – duke u tallur, duke i përgënjeshtuar ato dhe cënuar Allahun që i ka zbritur e që i ka folur ato – largohu prej tyre, ngrihu nga ai vend dhe mos rri me ta deri sa të ndryshojnë bisedë. E nëse të bën shejtani që të harrosh që Ne të kemi ndaluar të rrih në këto vende kur të kujtohesh ngrihu dhe

¹⁹¹ El Fetaua El Kubra 4/478.

¹⁹² Sulejman Ibn Abdullah Ibn Muhamed Ibn Abdul Ueh-hab është një prej dijetarëve të Nexhdit (Një prej krahinave të Arabisë Saudite sot) dhe nipi i Muhamed Ibn Abdul Ueh-habit. Ka thënë Ez-zerkeli për të : Ka qënë një nga dijetarët e Nexhdit. Ka qënë i veçantë në tefsir hadith dhe fikh. Ka shkruar disa libra. Ka vdekur në vitin 1233 të hixhrit. Shih librin “El Ea’lam” i Ez-zerkelit 3/129.

¹⁹³ Ed-durer Es-senijeh 8/121.

¹⁹⁴ Ed-durer Es-senijeh 8/163.

mos rri me njerëzit mizorë. E mizoria e tyre këtu është sepse ata u futën në ato gjëra që nuk u takon”¹⁹⁵.

Ka thënë Abdul Aziz Ibn Baz : “Kundërshtimi i të keqes me zemër është farz për të gjithë sepse të gjithë kanë mundësi ta bëjnë, që d.m.th ta urrejnë të keqen me zemër dhe të largohen nga vendi ku bëhet ky mëkat nëse nuk kanë mundësi ta kundërshtojnë me dorë ose me gojë sepse Allahu i Madhëruar ka thënë : **“Kur të shohësh ata që merren me ajetet Tona largohu prej tyre deri sa të ndryshojnë bisedë. E nëse shejtani të bën të harrosh atëherë mos rri pasi të kujtohesh me njerëzit mizorë”** [El En’am 68]”¹⁹⁶.

Siç e sheh pas këtyre argumenteve që treguam a mendon se i lejohet njeriu të qëndrojë në vende të tilla të cilat janë ndërtuar për të bërë shirk? Detyra e muslimanit në këto vende është që : Të kundërshtojë thelbin e ndërtimit të tyre së pari. Por si mund ta kundërshtojë atë kur ai është betuar që në momentet e para që do ta respektojë atë?! E nëse nuk mundet, le të largohet prej tyre. Nëse ai nuk e vepron as këtë e as këtë ai është në rrezik shumë të madh. Kur ai që rri në një mexhlis të tillë dhe hesht ka këtë gjykim. Po ai që e mbështet gjynahun ose shirkun duke votuar a mendon se shpëton pa gjynah?!

Gjithashtu nuk u lejohet edhe muslimanëve që ta ndihmojnë atë të hyjë në këtë vend në të cilin ai zhytet në gjynahe sepse kjo ndihmesë është ndihmesë në të këqia dhe jo në të mira. Prandaj votimi i tij është i ndaluar edhe pse ai i thotë vetes musliman për arsyet që treguam edhe për një arsye tjetër që do ta tregojmë tani.

Dihet se mosbesimtarët votojnë me besimin e plotë që t’ia japin të drejtën e vendosjes së ligjeve dhe përfaqësimit të tyre në kuvend njërit prej kandidatëve. E kjo gjë është ndihmesë e qartë për tu bërë ky kandidat zot. Ti si musliman kur të hysh në këto vende do ti shohësh këta njerëz duke e kryer këtë gjynah dhe jo vetëm që nuk do ti këshillosh që të largohen prej tij por do veprosh si ata. Kështu që ti je ortak me ta në këtë gjynah në më shumë se një aspekt sepse ti e di atë që ata nuk e dinë e megjithatë ti hesht, madje vepron si ata. Atëherë kur do tua tregosh njerëzve ti shirkun dhe llojet e tij dhe mënyrën si të largohen prej tij kur ti me veprat tua tregon të kundërtën?!

❖ Çështje : Mbyllja e rrugëve të shirkut.

Allahu i Madhëruar kur e ndalon diçka, ndalon edhe rrugët që të çojnë tek ajo gjë. Prandaj po të shohësh ndalesat në Islam nuk janë të gjitha të një niveli. Ka prej tyre që janë ndaluar në vetvete dhe ka prej tyre që janë ndaluar për shkak të ruajtjes së një ndalese më të madhe. Shembujt për këtë janë të shumta. Ne përmendëm disa

¹⁹⁵ Tefsir Et-taberi 11/436.

¹⁹⁶ Ed-durer es-senijeh 16/143.

më sipër, shembujt e atyre që ndihmojnë në kryerjen e një gjynahu. Ibnul Kajim ka treguar në librin e tij “I’lam El Muuekiine” 99 shembujt të kësaj natyre.

Shih psh gjynahun e imoralitetit, Islami e ka ndaluar imoralitetin dhe e ka konsideruar atë një nga gjynahet më të mëdha. Por nuk ka ndaluar vetëm atë. Ka ndaluar gjithashtu çdo rrugë që të çon atje, për ta ruajtur muslimanin sa më larg prej këtij harami. Për këtë arsye është ndaluar që muslimani të prekë me dorë një grua të huaj. Është ndaluar që ta shohë atë. Është ndaluar të veçohet me të. Është urdhëruar gruaja që të mbulohet dhe të ulë shikimin gjithashtu edhe burri është urdhëruar të ulë shikimin. Është ndaluar përzjerja e burrave me gratë. Por është lejuar prej kësaj përzjerje në rastet e domosdoshme siç janë rrugët apo tregjet. E shumë e shumë ligje të tjera të kësaj natyre të cilat tregojnë qartë se Allahu i Madhëruar ka dashur ti largojë muslimanët nga ky gjynah sa më larg. Argumentet për këto ndalesa janë të qarta prandaj nuk besoj se ka nevojë të tregohen këtu.

Dihet që shirku është gjynahu më i rëndë në Islam prandaj edhe rrugët që të çojnë tek shirku janë mbyllur në mënyrë edhe më të fortë. Ne do tregojmë disa rrugë të shirkut të cilat i ka mbyllur Islami për të dalë më pas në temën tonë.

Ka thënë Salih Ali sh-shejh : Profeti sal-l Allahu alejhi ue selem e ka ruajtur teuhidin dhe kufijtë e tij. Gjithashtu i ka mbyllur rrugët e shirkut. Në sun-netin e profetit sal-l Allahu alejhi ue selem ka shumë shembuj që tregojnë se profeti sal-l Allah alejhi ue selem i ka mbyllur rrugët (që të çojnë tek gjynahet). E rrugët më të këqia që duhen mbyllur janë rrugët që të çojnë tek shirku. Ruajtja e kufijve të teuhidit dhe mbyllja e rrugëve të shirkut nga ana e profetit sal-l Allahu alejhi ue selem ka qënë në fushën e besimit, fjalëve dhe veprave. Po të vëzhgohesh sun-netin e tij do shohësh që profeti sal-l Allahu alejhi ue selem i ka mbyllur portat e shirkut në besim, në fjalë dhe në vepra”¹⁹⁷. Do përmendim disa shembuj me lejen e Allahut për çdo njërën prej këtyre.

Po të shohësh librin “**Kitab Et-teuhid**” të Muhamed Ibn Abdul Uehabit do vesh re shumë tema të kësaj natyre. Prej këtyre temave kemi psh :

1. Tema : “**Shkaku që i çoi në kufër dhe në lënien e fesë bijtë e Ademit ishte madhërimi i tepruar i njerëzve të mirë**”. Ka treguar në këtë temë hadithin e Ibn Abbasit në të cilin tregon shkaku pse ranë në shirk populli i Nuhut Alejhi selam. Hadith të cilin e përmendëm më sipër dhe ka treguar argumente të tjera që do vinjë më poshtë in shallah. Më pas ka treguar disa dobi që nxirren prej këtyre argumenteve e një prej këtyre dobive është se : **Shkaku që i çoi ata në shirk ishte përzjerja e të kotës me të vërtetën. Siç e sheh, ata në fillim nuk i adhuruan por vetëm i madhëruan**. Më pas pasardhësit e tyre ishin ata që i adhuruan. Kush të siguron që brezat që do vijnë pas nesh do ta ruajnë teuhidin nëse ne do tu mësojmë atyre që

¹⁹⁷ Et-teuhid Sherh Kitab Et-teuhid.

votimi i këtyre njerëzve ka dobi për ne. Mbase në të ardhmen kjo e drejtë që i takon vetëm Allahut do bëhet e drejtë e padiskutueshme e njerëzve. Siç ndodhi me popullin e Nuhut. Kështu fillojnë humbjet. Në fillim pak, më pas zgjerohen deri sa në fund ndryshojnë drejtim plotësisht nga rruga e vërtetë. Kjo temë është shembull për mbylljen e rrugëve të shirkut në besim.

2. Tema : **“Shefati”** (Ndërmejtësimi). Ka përmendur në këtë temë argumente nga Kur’ani dhe sun-neti se shefati është në dorën e Allahut të Madhëruar edhe pse profeti sal-I Allahu alejhi ue selem do ndërmejtësojë ditën e Gjykimit. Por dihet që ky ndërmejtësim do bëhet vetëm me lejen e Allahut. Këtu janë përmendur të gjitha këto argumente vetëm që të mos mendojë njeri se krijesat mund të ndërmejtësojnë tek Allahu pa lejen e Tij apo se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem e ka në dorë ndërmejtësimin edhe pse ai do ndërmejtësojë ditën e Gjykimit dhe këtë e ka treguar në disa hadithe. **E gjithë kjo vetëm për të ruajtur besimin e pastër në Allahun dhe për të mbyllur çdo rrugë që të çon në besimin se krijesat kanë atë të drejtë që i takon vetëm Allahu të Madhëruar.**

Kur do ta mësojnë muslimanët që e drejta për të vendosur ligje i takon vetëm Allahut nëse ne thërrasim mbi mimberet e xhamive : Votoni për këtë apo për atë?! Në vend që ne ti tregojmë muslimanëve që ky është një prej llojeve të shirkut dhe ne duhet të jemi sa më larg tij, ne i thërrasim ata për ta mbështetur këtë shirk me justifikimin se ne kemi dobi në të. A ka dobi më të madhe se teuhidi dhe dëm më të madh se shirku. Apo ka diçka tjetër...?! Kjo temë ka të bëjë gjithashtu me mbylljen e rrugëve të shirkut në besim.

Marrim disa shembuj të tjerë të mbylljes së rrugëve të shirkut në vepra dhe fjalë : Ka thënë Muhamed Ibn Abdul Ueh-habi :

1. Temë : **“Kritikimi i rëndë që ka ardhur për ata që e adhurojnë Allahun tek varri i një njeriu të mirë. E çfarë mund të thuhet për atë që i adhuron (varret)”**. Ka treguar në këtë temë disa hadithe prej tyre është ky hadith :

Nga Aishja dhe Ibn Ab-basi transmetohet se kur i erdhi profetit sal-I Allahu alejhi ue selem vdekja mori një copë dhe e vendoste atë në fytyrë. Kur ndiente nxehtësi e hiqte dhe thoshte : **“Allahu i mallkoftë çifutët dhe krishterët i bënë varret e profetëve të tyre vend falje.”** E tha këtë si paralajmërim (që të mos bëhej e njëjta gjë me varrin e tij) ¹⁹⁸.

Ka thënë Salih Alish-shejh : “Kjo temë tregon një prej rrugëve që të çojnë tek shirku rrugë e cila duhet mbyllur. Kjo temë d.m.th që një person të shkojë tek varri i një njeriu të mirë qoftë profet apo dikush tjetër për të adhuruar Allahun të vetëm pa i

¹⁹⁸ Transmeton Buhariu nr 425 dhe në vende të tjera dhe Muslimi nr 531.

bërë shok në atë vend, duke shpresuar se ka më shumë begati në këtë vend”¹⁹⁹. Ky gjykim pra, ka të bëjë me atë që adhuron Allahun në drejtim të varrit.

Ajo që kuptohet nga hadithi është se adhurimi i Allahut të vetëm ndalohej tek varret sepse mund të mendohet që ky person që po e kryen këtë adhurim po adhuron varret në të vërtetë, jo Allahun sepse vepra e tij nuk ka dallim nga vepra e atij që adhuron varrin. Dallimi ndërmjet tyre është vetëm në nijet. Kështu edhe deputeti musliman i ka dhënë vetes të drejtë për të vendosur ligje si të tjerët. Ai thotë unë nuk e kam këtë nijet. Ne e besojmë, por vepra e tij nuk ka asnjë dallim nga vepra e atyre që besojnë për vetet e tyre këtë të drejtë. Atëherë a lejohet ta ndihmosh këtë musliman që të hyjë në këtë vend?! Gjithashtu nuk ka asnjë dallim ndërmjet atij muslimani që voton me “nijet të mirë” dhe mosbesimtarit që voton për të zgjedhur zotin e vet vetëm se tek nijeti. Në pamjen e jashtme ata duken njësoj. A mund të themi se adhurimi i Allahut në vendet ku adhurohen idhujt është i ndaluar dhe votimi me nijetin e mirë në atë vend ku ngrihen idhujt është i lejuar?!

Nga Umu Selemeh dhe Umu Habibeh transmetohet se ato kanë parë kur ishin në Habeshë një kishë që kishte piktura. Tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“Këta njerëz kur vdiste një njeri i mirë e bënë varrin e tij vend falje dhe pikturonin ato piktura. Ata janë krijesat më të këqia tek Allahu ditën e Gjykimit”**²⁰⁰.

Siç e sheh nuk thuhet në hadith që i adhurojnë por thuhet i bënë varret e tyre vend falje. E ka treguar profeti sal-I Allahu alejhi ue selem se këta janë krijesat më të këqia tek Allahu. Kur ky është gjykimi për atë që kryen një adhurim për Allahun në këto vende, çfarë mund të thuhet për ata që adhurojnë dikë tjetër veç Allahut, po për atë që pretendon se është zot?! Siç e sheh, ky gjykim i rëndë ka ardhur vetëm për ti mbyllur rrugët atyre që adhurojnë krijesat.

Komisionit të përhershëm i është drejtuar kjo pyetje : A lejohet namazi në një xhami që ka varr? Ju lutemi sqaroheni këtë gjë me imtësi sepse disa marrin si argument varrin e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem në xhaminë e tij. Nëse nuk lejohet të falemi në të, çfarë të veprojmë ? A ta nxjerrim të vdekurin (nga xhamia edhe eshtrat e tij)?

Përgjigje : “Nuk lejohet namazi në ato xhami që ka varre. Është transmetuar në hadithe të sakta nga Xhundub Ibn Abdilah radi Allahu anhu se ka thënë : Kam dëgjuar profetin sal-I Allahu alejhi ue selem pesë ditë para se të vdiste se ka thënë : **“Ata që ishin para jush i bënë varret e profetëve të tyre vende falje, mos i bëni varret vende falje. Unë ju ndaloj nga kjo”**²⁰¹. Gjithashtu Aishja radi Allahu anha transmeton nga profeti sal-I Allahu alejhi ue selem se ka thënë : **“Allahu i mallkoftë çifutët dhe**

¹⁹⁹ Et-temhid Sherh Kitab Et-teuhid.

²⁰⁰ Transmeton Buhariu nr 417, Muslimi nr 528, En-nesai nr 704 etj.

²⁰¹ Transmeton Muslimi dhe En-nesai.

krishterët i bënë varret e profetëve të tyre vend falje". Është detyrë që i pari i vendit ti prishë ato xhami që janë ndërtuar në varre sepse ato nuk janë ndërtuar mbi themelin e devotshmërisë dhe të nxirren ata të vdekur që janë varrosur në xhami pas ndërtimit të xhamisë qoftë edhe vetëm eshtrat e tij sepse kjo varrosje në xhami është padrejtësi. Të kalohen eshtrat e tij në varrezat e përgjithshme. Më pas nuk ka problem të falesh në atë xhami". [Abdul Aziz Ibn Baz , Abdu Rrazak El Afifi , Abdullah Ibn Gudejan dhe Abdullah Ibn Kuud]²⁰².

Pse gjithë këto veprime dhe ndalesa kur njeriu nuk po adhuron varrin? Shkaku është se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ka dashur ti mbyllë të gjitha rrugët që të çojnë tek shirku.

Problemi i shumicës së njerëzve është se ata kujtojnë që shirku është vetëm të adhurosh idhujt siç vepronin mushrikët e Mekës. Por ne e treguam më sipër se shirku është shumë lloje e një prej tyre është edhe shirku në bindje ose që njeriu të besojë se dikush veç Allahut ka të drejtë të vendosë ligje²⁰³. Kështu që çdo rrugë që të çon tek ky besim i gabuar duhet mbyllur.

Shembull tjetër për mbylljen e rrugëve të shirkut. Përmendëm më sipër një fetva të Ibn Tejmijes ku ndër të tjera ka thënë : "Transmetohet në Sunetin e Ebu Daudit nga Thabit Ibn Ed-dah-hak se ka thënë : Një person bëri nedhr (u zotua) se do therte deve në Beuaneh (emër vendi). Erdhi tek profeti sal-I Allahu alejhi ue selem dhe i tha : Unë kam bërë nedhr që të thër deve në Beuaneh. I tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **"A ka pasur në të ndonjë idhull që adhurohej veç Allahut në kohën e injorancës"**? I tha: jo. I tha: **"A kanë pas festuar në të ndonjë nga festat e tyre"**? I tha : jo. I tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **"Kryeje nedhrin tënd. Nuk duhet kryer ai nedhr që përmban mëkat dhe as ai që nuk e ka në dorë biri i Ademit"**. Nuk i dha leje profeti sal-I Allahu alejhi ue selem që ta kryejë nedhrin edhe pse kryerja e tij është vaxhib deri sa i tregoi që atje nuk janë kryer festat e mosbesimtarëve. Më pas i tha : **"Nuk kryhet nedhri që përmban mëkat"**. Kur therja (që është adhurim për Allahun) në një vend që ata kanë pas kryer në të festa është e ndaluar, po të marrësh pjesë në festat e tyre"²⁰⁴?!²⁰⁵

Gjithashtu në hadith e pyet profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **"A ka pasur në të ndonjë idhull që adhurohej veç Allahut në kohën e injorancës"**? dhe nuk e lejoi deri sa ai i tha : Jo, nuk ka pasur. Prej kësaj pyetje kuptohet se Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem do ta ndalonte këtë veprim po të kishte pasur idhuj atje. E gjithë kjo për ti mbyllur rrugët shirkut.

²⁰² Fetaua el-lexhneti ed-daimeh, el mexhuatu el Ula. 6/256

²⁰³ Shih librin "Mexhmu' El Fetaua" të Ibn Tejmijes 7/70.

²⁰⁴ Ndryshoja vetëm emrin dhe thuaj : Po të marrësh pjesë në votimet e tyre!!

²⁰⁵ "El Fetaua El Kubra" i Ibn Tejmijes 2/487-489. Peyetja nr 359 – 29.

Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ka ndaluar edhe gjëra të tjera në këtë fushë shih psh hadithin e Muadhit radi Allahu anhu. Transmeton Abdullah Ibn Ebi Eufa se Muadhi radi Allahu anhu kur erdhi nga Shami i bëri sexhde profetit sal-I Allahu alejhi ue selem. I tha : **“Çfarë bën kështu o Muadh”?** I tha : Unë kur shkova në Sham pashë që ata i bënë sexhde të parëve të tyre dhe dëshirova të ta bëjmë ty këtë gjë. Tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“Mos e bëni. Po sikur të urdhëroja dikë ti bënte sexhde dikujt tjetër veç Allahut do urdhëroja gruan ti bënte sexhde burrit të vet”**²⁰⁶.

Kjo sexhde që i bëri Muadhi profetit sal-I Allahu alejhi ue selem nuk ishte sexhde adhurimi por sexhde respekti dhe përshëndetjeje²⁰⁷. E megjithatë profeti sal-I Allahu alejhi ue selem e ndaloi vetëm që të ruante kufijtë e teuhidit edhe pse ajo sexhde në vetvete nuk ishte shirk.

Ka thënë Ibn Tejmija : “Është ndaluar edhe ti falesh dikujt prej krijesave në formë respekti dhe nderimi. Për këtë arsye e ndaloi profeti sal-I Allahu alejhi ue selem Muadhin që ti bënte sexhde. Gjithashtu e ka ndaluar ti përkulesh dikujt për përshëndetje siç i kishte ndaluar që të qëndronin në këmbë mbrapa tij në namaz kur ai ishte ulur.”²⁰⁸. Edhe pse në formë respekti kjo nuk lejohet. E gjithë kjo për ti mbyllur rrugët shirkut.

Transmeton Xhabir radi Allahu anhu se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ishte i sëmure. U fal ulur ndërsa ne u falëm mbrapa tij. Ebu Bekri përsëriste tekbinin që ta dëgjnin njerëzit. Ai (profeti sal-I Allahu alejhi ue selem) u kthye nga ne dhe na pa në këmbë. Na e bëri me shenjë që të ulemi dhe u ulëm e u falëm ulur. Kur dha selam tha : **“Ishit gati duke vepruar siç veprojnë persët dhe romakët. Qëndrojnë në këmbë tek mbretërit e tyre ndërsa ata ulur. Mos e bëni këtë gjë. Ndiqni imamin tuaj. Nëse falet në këmbë faluni në këmbë e nëse falet ulur faluni ulur”**²⁰⁹.

Ka thënë Ibnu Rexhebi : “E ka konsideruar profeti sal-I Allahu alejhi ue selem qëndrimin në këmbë pas imamit që falet ulur të ngjashëm me atë që bëjnë persët dhe romakët me parinë e tyre të cilët u qëndrojnë atyre në këmbë ndërsa vet paria rrijnë ulur. Sheriati jonë ka ardhur në kundërshtim me këtë (që veprojnë ata). Ka thënë profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“Kush dëshiron ti ngrihen njerëzit në këmbë le të përgatisë vendin e tij në zjarr”**²¹⁰. Ka thënë Umer Ibn Abdul Azizi : **“Nëse ngriheni do ngrihemi me ju. Nëse uleni do ulemi me ju sepse njerëzit i**

²⁰⁶ Transmeton Ibn Maxheh nr 1853 edhe të tjerë. Hadithin e saktësoi Albani.

²⁰⁷ Shih librin “El Udhr Bil Xhehl tahte el mixhher esh-sher’i” f 241-242.

²⁰⁸ “Mexhmu’ El Fetaua” 1/75.

²⁰⁹ Transmeton Muslimi nr 955 , En-nesai nr 1200, Ibn Maxheh 1240 e të tjerë.

²¹⁰ Transmeton Ebu Daudi nr 5231 edhe të tjerë. Hadithin e saktësoi Albani shih “Sahih el xhami’ es-sagir” nr 10901.

ngrihen vetëm Zotit të botërave” ²¹¹. Shkaku pse është ndaluar është sepse madhërimi i njerëzve duke u qëndruar atyre në këmbë është një prej rrugëve që të çon për tek shirku edhe pse qëndrimi në këmbë në vetvete nuk është i ndaluar.

Ka ndaluar profeti sal-I Allahu alejhi ue selem edhe disa lloj shprehjesh që përmbajnë shirk në fjalë edhe pse njeriu nuk ka për qëllim që ti bëjë shok Allahut të Madhëruar.

Transmeton Ibn Ab-basi se një person i tha profetit sal-I Allahu alejhi ue selem : Çfarë të dojë Allahu dhe ti. I tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : **“A më bëre mua shok të Allahut! Thuaj : Çfarë dëshiron Allahu i Vetëm”** ²¹².

Gjithashtu e ka ndaluar të betohet njeriu në dikë tjetër veç Allahut edhe pse besimtari mund të thotë që unë nuk kam qëllim me këtë betim që ti ngre krijesat në gradën e Allahut të Madhëruar.

Gjithashtu ka ndaluar pikturimin e frymorëve dhe mbajtjen e figurave të frymorëve në shtëpi. Madje profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk hynte në ato ambjente në të cilat kishte figura frymorësh. Gjithashtu ka treguar se melaiket nuk hyjnë në shtëpitë që ka figura frymorësh. Hadithet për këtë temë janë të shumta dhe kanë nevojë për një libër të veçantë. Sidomos në kohën e sotme në të cilën janë sprovuar shumica dërrmuese e muslimanëve me to. Gjithë këto ndalesa vetëm për ti mbyllur rrugët shirkut.

Ka thënë Ibnul Kajim : “Shumica e shirkut në të cilin kanë rënë popujt e ka origjinën nga figurat dhe varret” ²¹³.

Mbjatja e hajmalive për shërim. Komisionit të përhershëm i është drejtuar kjo pyetje : A bën kufër njeriu nëse mban hajmali qoftë me Kur’an apo jo?

Përgjigje : “Hajmalitë që mbajnë njerëzit janë dy lloje : 1. Ato që përmbajnë vetëm Kur’an. 2. Ato që nuk kanë Kur’an. Nëse ato përmbajnë vetëm Kur’an, për mbajtjen e tyre ka dy mendime tek selefët. 1. Nuk lejohet të mbahen. Me këtë mendim është Ibn Mes’udi dhe Ibn Ab-basi. Kjo gjë kuptohet edhe prej fjalëve të Hudhejfes, Ukbeh Ibn Amir dhe Abdullah Ibn Ukejm radi Allahu anhum. Ky gjithashtu është edhe mendimi i një grupi prej tabi’inëve prej tyre nxënësit e Ibn Mes’udit. Këtë mendim e ka shprehur edhe Imam Ahmedi në një transmetim të cilin e kanë zgjedhur ndjekësit e tij. Këtë mendim gjithashtu e kanë zgjedhur edhe dijetarët që kanë ardhur më pas. Ky mendim është i mbështetur në atë që ka transmetuar Ahmedi, Ebu Daudi dhe të tjerë nga Ibn Mes’udi radi Allahu anhu se ka dëgjuar profetin sal-I Allahu alejhi ue selem të thotë : **“Rukjet (e pakuptueshme) hajmalitë dhe et-tiueleh (magjia e**

²¹¹ Fet’hu El Bari i Ibn Rexhebit 4/156.

²¹² Transmeton Ahmedi Ibn Maxheh etj. Hadithi është i saktë shih es-silsiletu es-sahihah nr 139.

²¹³ Zad El Mead 3/458.

afrimit) **janë shirk**”. Ka thënë Abdurrahman Ibn Hasen Ali Esh-shejh në librin [Fet’h El Mexhid] : **Ky është mendimi i saktë, për tre arsye që i ve re ai që i mediton** : 1. Sepse ndalesa ka ardhur e përgjithshme prandaj nuk ka kush e përjashton (lejimin e hajmalive me Kur’an). 2. **Për ti mbyllur rrugën që të çon në mbajtjen e atyre hajmalive që nuk janë me Kur’an (sepse ato janë shirk)**. 3. Ai që e mban hajmalinë patjetër që ai e poshtëron atë sepse e mban me vete kur hyn në banjo për të kryer nevojën personale. Mendimi i dytë është se mbajtja e hajmalive me Kur’an lejohet. Ky mendim është mendimi i Amr Ibn El As radi Allahu anhu dhe kjo kuptohet edhe prej fjalëve të Aishes radi Allahu anha. Me këtë mendim është edhe Ebu Xha’fer El Bakir dhe ky është një transmetim nga Ahmedi. Ndërsa hadithin këta e shpjeguan duke thënë se në hadith ndalohen ato hajmali të cilat kanë shirk. **Kurse nëse hajmalitë nuk përmbajnë Kur’an dhe as emrat ose cilësitë e Allahut ato janë shirk** sepse i përfshin hadithi i mësipërm në të cilin tregohet se ato janë shirk”. [Abdu Er-razak El Afifi, Abdullah Ibn Gudejan, Abdullah Ibn Meni’] ²¹⁴.

Shiko, edhe pse hajmalitë përmbajnë vetëm Kur’an këta dijetarë i kanë ndaluar ato nga frika se ato mund ti çojnë njerëzit në një të ardhme të mbajnë ato hajmali që janë shirk. Kështu që për ti mbyllur portën shirkut ata kanë thënë që ato janë haram. E ç’mund të thuash për atë që ndihmon dhe mbështet një person që pretendon për veten e tij se ai ka të drejtë atë gjë që i takon vetëm Allahut?! A mund të jetë kjo e lejuar?! A nuk mund të çojë në një të ardhme edhe kjo që të besojnë njerëzit se kjo e drejtë i takon atyre. Pa thënë se shumica e muslimanëve sot nuk e dinë se kujt i takon ajo e drejtë sepse të rrallë janë ata që kanë folur për të.

Gjithë këto ndalesa që treguam edhe pse shumica e tyre në vetvete nuk janë shirk kanë ardhur të tilla vetëm për të mbyllur çdo rrugë të shirkut. Ky ishte qëllimi që i tregova këto shembuj.

Pas gjithë këtyre shembujve a nuk na takon të themi se është detyrë për ne ti mbyllim të gjitha rrugët e shirkut. A nuk e kemi ne për detyrë të largohemi prej tij dhe të mos ndihmojmë askënd që dëshiron ta veprojë atë qoftë është me qëllim të mirë!! Siç i sheh hadithet e mësipërme tregojnë që nijeti nuk vlen për ta justifikuar personin që të veprojë haramin. A i takon muslimanit të ndihmojë atë njeri që pretendon se ka të drejtën që i takon vetëm Allahut që ai të arrijë në këtë gradë me justifikimin se ka dobi prej tij?!

❖ **Temë : A lejohen votimet me pretendimin se në to ka dobi dhe lënia e tyre ka dëm dhe ne jemi të urdhëruar të marrim dobitë dhe të largohemi nga dëmet?**

²¹⁴ Fetaua El-lexhneti Ed-daimeh el mexhuatu El ula 1/331.

Përgjigje : Allahu i Madhëruar i zbriti librat dhe i dërgoi profetët për tu treguar njerëzve dhe për tu sjellë atyre gjërat e dobishme. Gjithashtu për tu treguar atyre gjërat e dëmshme që të ruhen prej tyre dhe për ti larguar ato në maksimum.

Ka thënë Ibn Tejmije : “Allahu ka urdhëruar për të gjërat e dobishme dhe ka ndaluar nga gjërat e dëmshme. Gjithashtu i ka dërguar profetët e Tij që të sjellin (tek njerëzit) gjërat e dobishme dhe ti plotësojnë ato e për të larguar gjërat e dëmshme dhe për ti pakësuar ato” ²¹⁵.

Allahu i Madhëruar ka thënë : **“Nuk të kemi dërguar ty vetëm se mëshirë për botërat”**. [El Enbija 107]. Mëshira përfshin sjelljen e dobive që ka nevojë njerëzia dhe largimin e dëmeve që i dëmtojnë ata në të dy botët.

Profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Çdo gjë që ju afron për në xhenet ju ka kam urdhëruar ta veproni. E çdo gjë ju afron për në zjarr jua kam ndaluar. Shpirti i Shenjtë më inspiroi në shpirtin tim se : askush nuk ka për të vdekur deri sa të plotësojë rrizkun e vet prandaj kini frikë Allahun dhe zgjidhni rrugën e duhur në kërkim. Të mos ju shtyjë vonesa e rrizkut që ta kërkoni atë duke kundërshtuar Allahun sepse çka janë tek Allahu nuk arrihen duke e kundërshtuar Atë.”** ²¹⁶.

Ka thënë Ibn Tejmija : “Sheriati nuk ka neglizhuar asnjë dobi kurrë. Përkundrazi Allahu e ka plotësuar për ne fenë dhe mirësinë e Tij. Çdo gjë që na afron për në xhenet na e ka treguar profeti sal-I Allahu alejhi ue selem. Na ka lënë një rrugë të bardhë nata në të është si dita (në bardhësi) nuk humbet prej saj vetëm se ai që është i shkatërruar” ²¹⁷.

Atëherë detyra jonë është vetëm të ndjekim atë që na ka ardhur prej Allahut të Madhëruar dhe të dërguarit të Tij sal-I Allahu alejhi ue selem sepse Allahu i Madhëruar nuk ka lënë asgjë të dobishme pa na e treguar. Kështu që nuk kemi nevojë të përdorim logjikën tonë për njohjen e dëmeve dhe dobive.

Teorikisht të gjithë bien dakord me këtë që po themi ndërsa realisht jo. Argument është vet fjala e atyre që e lejojnë hyrjen në kuvend ose votimin dhe ndihmesën e ngritjes së shirkut me pretendimin se në të ka dobi.

E çuditshme është me këta njerëz, flasin për dëmet dhe dobitë që i përcaktojnë ata me mendjet e tyre edhe pse ato bien në kundërshtim të qartë me Kur'anin dhe Sun-netin e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem kur dihet që zbatimi i çdo urdhëri që ka

²¹⁵ Ikametu Ed-delil ala Ibtal et-tahlil 4/332.

²¹⁶ Transmeton Ebu Bekr Ibn El Had-dad dhe Ibn Merdeuejhi. Hadithin e saktësoi Albani sih es-silsileti es-sahihah nr 2866.

²¹⁷ Mexhmu' El Fetaua 11/344.

sjellë Allahu është më i dobishëm se mos zbatimi i tij dhe kryerja e çdo harami që ka ndaluar Allahu është më i dëmshëm se lënia e tij.

E nëse nuk është kështu, atëherë d.m.th që : **Mund të ketë gjëra që na ka urdhëruar Allahu dhe zbatimi i tyre është i më i dëmshëm për ne se mos zbatimi ose gjëra që na i ka ndaluar Allahu dhe largimi prej tyre është më i dëmshëm për ne se mos largimi. Sikurse në të kundërt i bie që mos zbatimi i urdhërave të Allahut është më i dobishëm për ne dhe hyrja në haramë është më e dobishme për ne.** Fatkeqësisht e them, që këtë gjë e tregon gjendja e tyre edhe pse nuk e shprehin me gojë.

Allahu na ruajt prej kësaj ideje që në përfundim të çon në zhveshjen prej fesë. Kjo që po tregoj nuk është imagjinatë. Përkundrazi është realitet sepse shumë muslimanë sot kur i pyet pse ke rënë në këtë haram të përgjigjet duke thënë : Kam parë dëmet dhe dobitë. E kanë ngritur këtë çështje sipër Kur'anit dhe Sun-netit.

Siç mund të përgjigjet një musliman i mirë kur pyetet ku e ke argumentin për çështjen në fjalë, ai të tregon fjalën e Allahut dhe të dërguarit të Tij sal-I Allahu alejhi eu selem ndërsa këta të tregojnë dëmet dhe dobitë që i hamendëson mendja e tyre edhe pse ato dobi mund të bien në kundërshtim me urdhrat e Allahut të Madhëruar. Sikur Allahu nuk i ka caktuar kush janë dëmet dhe kush janë dobitë por ia ka lënë në dorë njezërve ti përcaktojnë ato. Allahu na ruajt.

Ka thënë Ibn Tejmija : “Atë gjë të cilën e imagjinon mendja si të dobishme nëse nuk është treguar në Sheriat (në formë të qartë), ajo ka një nga këto dy mundësitë të cilat janë të domosdoshme për të : 1. Sheriati e ka treguar që kjo gjë është e dobishme por ky njeri nuk e ka ditur atë, ose 2. Ajo gjë nuk është fare e dobishme edhe pse ai e mendon të tillë. Shumë herë njerëzit e imagjinojnë diçka si të dobishme në fe ose jetë por ajo dobi është shumë e vogël (në krahasim me dëmet). Allahu i Madhëruar ka thënë për alkoolin dhe bixhozin : **“thua në to ka dëm të madh dhe dobi për njerëzit por dëmi i tyre është më i madh se dobia”**. Shumë besime dhe punë që i kanë **shpikur** njerëzit – qofshin ato bidatet e atyre që ndjekin filozofinë, apo të sufistëve dhe atyre që ndjekin mendimin e tyre, apo të atyre që kanë pushtet – i imagjinuan si të dobishme, të vërteta dhe të sakta por nuk ishin ashtu” ²¹⁸.

Ibn Tejmija këtu flet për ato gjëra që i mendonin njerëzit të dobishme për të cilat nuk ka ndonjë argument të veçantë që i ndalon ato. E megjithatë shikoje se çfarë tregon për to. I quan shpikje (bidate). Po kur flitet për raste që njeriut i duket e mirë ajo që e ka bërë Allahu të keqe dhe i kundërshton argumentet e sakta të Islamit me justifikimin se po ndjek atë që është më e dobishme si rasti jonë për të cilin kemi treguar shumë argumente në kapitujt e mëparshëm?! Madje edhe shumë prej atyre

²¹⁸ Mexhmu’ El Fetaua 11/344-345.

që e lejojnë hyrjen në kuvend e pranojnë ²¹⁹ që në të ka shumë dëme dhe se në origjinë ajo është e ndaluar, por për hir të arritjes së dobive dhe largimit të dëmeve ...!!

Po të jetë kështu, atëherë nuk ka nevojë për Kur'an dhe as për Sun-net. Nuk kishte nevojë që Allahu të dërgonte profetë sepse ne sot jetojmë në kohën kur njerëzit i përcaktojnë vet dëmet dhe dobitë edhe pse bien ndesh në formë të qartë me Kur'anin dhe Sun-netin!!

Ky drejtim ngjan me besimin e grupeve të humbura si Mu'tezilet, Esh'arijet e të tjerë të cilët e shprehin me gojë që : **“Nëse bie në kontradiktë Kur'ani dhe Sun-neti me logjikën ne i japim përparësi logjikës”**. Ndërsa sot kjo nuk shprehet me gojë por me vepra. Nëse Islami e ndalon diçka ata e veprojnë duke u justifikuar se në të ka dobi!!

- **Mund të thotë dikush : Ne nuk kemi për qëllim me fjalën “Shikimi i dëmeve dhe dobive” këtë që thua ti, por ne kemi për qëllim që “Ndër dy të këqia ne zgjedhim atë që është më e vogël”.** E ky është një rregull Islam i njohur.

Përgjigje : Po është e vërtetë që ekziston një rregull i tillë dhe ai është rregull i saktë. Nuk ju kundërshtoj në këtë rregull nga ana teorike por nga ana praktike. Gjithashtu u themi që ky rregull që ju e përdorni këtu tek tema e hyrjes në kuvend ose votime d.m.th që ato të dyja qenkan haram në origjinë por ju duke shikuar se dëmi i kryerjes së tyre është më i vogël e lejuat. E nëse është kështu pranojeni para të gjithëve këtë gjë që ta mësojnë muslimanët këtë gjykim me argumentet fetare të qarta pastaj diskutojmë se a hyn në këtë çështje apo jo.

Për ta sqaruar këtë çështje po tregojmë se kushti i përdorimit të këtij rregulli është që njeriu të gjendet ndërmjet dy të këqijave dhe nuk ka asnjë rrugë tjetër. Duhet të kryejë njërën prej tyre patjetër. Si psh : Dikush është duke vdekur nga uria dhe ka përpara mish derri. Po nuk hëngri do vdesë. Në këtë rast lejohet të hajë aq sa të largojë urinë vdekjeprurëse. Kështu që ky njeri ishte ndërmjet dy të këqijave : Ose të hante mish derri dhe kjo është haram ose ta linte veten të vdiste prej urisë, kur para tij kishte diçka për të ngrënë. Në këtë rast mund të themi se dëmi i vdekjes është më

²¹⁹ Këtë gjë e pranojnë shumë prej tyre në librat e tyre si Umer El Eshkar – e të tjerë që kanë shkruar në këtë fushë – i cili ka shkruar një libër me titull : **“Sheriati Hyjnor jo ligjet njerëzore”** ku tregon në të se e drejta e vendosjes së ligjeve i takon vetëm Allahut dhe se ata që vendosin ligje kanë rënë në shirk dhe janë bërë taguta. E ka treguar disa argumente prej atyre që kemi treguar në këtë libër madje edhe argumente të tjera që nuk i kemi treguar. Ka treguar edhe fjalët e dijetarëve për këtë. Por gjithashtu ka shkruar edhe një libër tjetër që e lejon hyrjen në këto vende ku bëhet shirk dhe justifikohet me disa prej dyshimeve që treguam më sipër dhe ndër më kryesoret është argumenti i dobive që ka hyrja në këtë vend. Madje edhe në vendin tonë ka prej tyre që i kanë ndaluar votimet dhe kur i kanë kundërshtuar disa njerëz që janë në parti duke u treguar dobitë që ka në votime u kanë thënë që lejohet. Disa të tjerë janë pyetur për votimet e kanë thënë që janë haram, dhe më pas për inerci ... kanë thënë që lejohen!!

i madh se dëmi i ngrënies së mishit të derrit për të shpëtuar. Për këtë arsye e ka bërë detyrë Islami në këtë rast shpëtimin e jetës.

Shembull tjetër : Një njeriu i del përpara një kusar dhe i thotë ose më jep paratë ose të vrava. Në këtë rast i lejohej këtij njeriu që ti japë paratë për të shpëtuar jetën. Por nuk e ka për detyrë ti japë pasurinë këtij njeriu. Këtij i lejohej që të mos ia japë pasurinë dhe ta luftojë atë për të mbrojtur pasurinë e tij deri në vdekje.

Shembull tjetër : Një njeriu i del përpara një keqbërës dhe dëshiron ti përdhunojë gruan dhe i thotë : Ose më lejo ose të vrava. Në këtë rast nuk i lejohej këtij njeriu që të dorzohet por e ka vaxhib të luftojë deri sa të vdesë.

Pse ndryshoi çështja : Sepse nderi është haram të jepet ndërsa pasuria mund të dhurohet edhe pa pasur nevojë për të rënë në vështirësi të tilla. Ndërsa nderi nuk dhurohet.

Haramet ndahen në Islam në dy lloje. Shih se çfarë thotë Ibn Tejmija për këtë : “Haramet janë dy lloje : Njëri lloj është ai që mund të themi në formë të sigurtë që ai nuk bëhet hallall kurrë as në raste domosdoshmërie e as në ndonjë rast tjetër si : shirku, imoraliteti, të thuash për Allahun atë që nuk e di dhe padrejtësia e qartë. Këto të katërta janë përmendur në fjalën e Allahut : **“Thuaj ka ndaluar Zoti im imoralitetin e dukshëm dhe të fshehtë, padrejtësinë ndaj vetes dhe të tjerëve, ti bëni shok Allahut duke mos pasur fakte dhe të flisni për Allahun atë që nuk e dini”**. [El Ea’raf 33]. Këto të katërta kanë qenë të ndaluara në të gjitha sheriatet e profetëve të mëparshëm dhe nuk kanë qenë të lejuara kurrë në asnjë lloj gjendjeje”²²⁰.

Atëherë ndër dy të këqijat për të cilat flitet e keqja më e madhe është një nga këto të katërta. Kështu që shirku nuk bëhet hallall kurrë dhe nuk ka në të asnjë dobi. E ai është dëmi më i madh për njerëzinë. Ne e treguam që ato kuvende janë ngritur mbi parimin e shirkut. Atëherë kush është dëm më i madh, shirku apo çdo gjynah tjetër?! Gjithashtu në këto kuvende, a nuk kanë vendosur ligje që lejojnë imoralitetin dhe homoseksualizmin dhe ligje që konsiderohen padrejtësi e qartë për njerëzit?! Patjetër që po. Atëherë cilat qenkan ato dëme më të mëdha se këto harame të cilat janë gjynahet më të mëdha mbi faqen e dheut, po ashtu është edhe ndihmesa në këto gjynahe. Ndhimesa në to është më e rëndë se ndihmesa në çdo gjynah të tjetër. Kështu edhe ky rregull nuk është argument për ata që i lejojnë votimet dhe hyrjen në kuvend por argument kundër tyre.

Por ne u themi edhe një përgjigje tjetër : Ne nuk biem dakord fare që këtu ne jemi para dy dëmeve pa rrugëdalje dhe u dashka patjetër të bëjmë njërin prej tyre. A mund të na thoni : A ka vdekur njeri pse nuk hyri në kuvend apo pse nuk votoi?! A

²²⁰ Mexhmu’ El fetaua 14/470.

është vrarë njeri pse nuk hyri në kuvend ose pse nuk votoi?! Përkundrazi e kundërta ka ndodhur. Njerëzit janë vënë në rrezik kur kanë hyrë në këto vende. Madje janë rrahur dhe vrarë në shumë vende të botës sepse “karrigia” i përmban këto rregulla loje. Kështu që pretendimi që ne jemi para dy dëmeve dhe nuk kemi rrugë dalje është i kotë. Shembulli i këtij njeriu që i lejon vetes kryerjen e haramit me këtë justifikim është si një person që është ftuar në një darkë dhe i nxjerrin përpara mish derri dhe birrë dhe i thonë ose pi këtë ose ha këtë. E ky zgjedh atë që ka më pak dëme duke u nisur nga ky rregull ... !!

▪ **A konsiderohet votimi ose hyrja në kuvend rast i domosdoshëm duke ditur se në raste të domosdoshme harami bëhet hallall?**

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje duhet të tregojmë si fillim përkufizimin e domosdoshmërisë. Kanë thënë dijetarët në përkufizimin e domosdoshmërisë : **“Ajo është nevojë shumë e madhe e cila e detyron njeriun të kryejë atë që është e ndaluar në Sheriat”** ²²¹.

Dihet që e domosdoshmja për të cilën po flasim në këtë përkufizim e bën të lejuar haramin për njeriun që bie në këtë vështirësi, por dijetarët kanë vendosur për të 5 kushte. Kështu, që të quhet i saktë përdorimi i domosdoshmërisë duhet të plotësohen këto 5 kushte të cilat janë nxjerrë nga argumentet e Kur’anit dhe Sunetit. Ne nuk mund ti tregojmë të gjitha detajet këtu sepse nuk është qëllimi për të sqaruar këtë çështje por qëllimi është për të treguar që a konsiderohet hyrja në kuvend apo votimi i domosdoshëm me këtë kuptim që treguam.

“Kushtet janë si vijon : **1.** Të ekzistojë një dëm i madh ose të jetë i sigurt njeriu ose shumë afër sigurisë se do ndodhi një dëm i tillë. Shembull për këtë është kur njeriu ndodhet në një vend në të cilin nuk gjen për të ngrënë vetëm se mish të ngordhur bagëtie. **2.** Të jetë e pamundur gjetja e shkaqeve të lejuara të cilat e largojnë këtë nevojë kaq të rëndë ose më thjesht të mos gjesht asnjë rrugëzgjidhje të lejuar. Shembull për këtë është shembulli që treguam më sipër, nëse nuk ke asgjë për të ngrënë prej atyre që i ka lejuar Allahu madje as bar atëherë të lejohet. **3.** Të përcaktohet kjo nevojë me kohën e vet. Kështu që koha e lejimit të ngrënies së bagëtisë së ngordhur mbaron në momentin kur njeriu nuk ka më nevojë të detyrueshme për atë ushqim. **4.** Të kufizohet përdorimi i këtij harami me atë sasi që e largon këtë nevojë të detyrueshme dhe mos zgjerohet më shumë se kaq. **5.** Duhet që të mos çojë kryerja e këtij harami për rastin e nevojës në një haram më të rëndë ose sa ai i pari” ²²².

²²¹ Shih librin “Ed-daruratu Esh-sher’ijeh ue tetbikatuha el Muasirah” f 25.

²²² Ed-daruratu Esh-sher’ijeh ue tetbikatuha el Muasirah f 66-101.

Treguam më sipër se haramet janë dy lloje. Lloji i parë janë ato haramet të cilat nuk lejohen në asnjë rast si shirku, padrejtësia, imoraliteti dhe të thuash për Allahun atë që nuk e di.

Ka thënë Sujuti : “Nëse dikush detyrohet (prej dikujt duke e kërcënuar me vrasje) që të bëjë imoralitet ose të vrasë një njeri nuk i lejohet ta bëjë atë sepse dëmi i këtyre gjynaheve është i barabartë me dëmin të cilin dëshiron ta largojë njeriu ose më i madh se ai” ²²³.

Kështu që siç e sheh jo të gjitha haramet lejohen në rast domosdoshmërie. Ka prej tyre që nuk lejohen as në rast domosdoshmërie. Këto janë ato haramet që mund ti quajmë vizat e kuqe të cilat nuk lejohet ti kalojë njeriu në asnjë lloj rasti apo gjendeje.

Pas këtij sqarimi del pyetja : A konsiderohet hyrja në kuvend ose votimi i domosdoshëm me këtë kuptim që treguam këtu dhe a i plotëson kushtet e domosdoshmërisë? Përgjigje : Askush nuk pretendon dot se mos hyrja në kuvend ose në votime ka ndonjë dëm real konkret. Madje as nuk pretendon dot që dëmi është i sigurt ose afër sigurisë që do të ndodhë. Për një arsye shumë të thjeshtë, e cila është se ata nuk e përcaktojnë dot se çfarë është ky dëm. Prandaj kur flasin për votimin flasin në përgjithësi dhe thonë që duhet të zgjedhim ndër dy dëmet atë më të voglin. Ne u themi : Na i tregoni kush janë këto dëme reale dhe konkrete. Ka ndodhur në shumë raste që është votuar dikush që muslimanët kanë menduar se është më pak i dëmshëm për ta dhe në fund ka dalë që ai ishte më i keq se i pari ²²⁴. Por mos harro se lejimi i haramit nuk pranon këto hamendësira dhe iluzione. Po kur bëhet fjalë për shkeljen e vijave të kuqe të cilat nuk lejohen të shkelen në asnjë rast?!

A është e pamundur që muslimanët të gjejnë rrugë të tjera për zgjidhjen e problemeve të tyre?! Patjetër që ka shumë rrugë por kjo gjë ka nevojë për

²²³ El Eshbah ue En-nedhair f 84.

²²⁴ Para pak kohësh kam lexuar në një libër të shkruar para afro 9 vjetësh në kohën kur në një nga vendet më demokratike të botës u zhvilluan votimet presidenciale. Thotë shkrimtari : Muslimanët vepruan shumë mirë që votuan për “filanin” sepse ai është më i mirë se kandidati tjetër!! Por pas kaq vitesh më duket fjala e këtij shkrimtari qesharake dhe shumë e cekët, jo vetëm mua por çdo kujt që e lexon sepse na rezultoi se nuk paska qënë ashtu. Vet historia e atij vendi ka dëshmuar që nuk ka pasur president më të keq dhe dëmprurës se ky që zgjodhën muslimanët duke menduar se është më i mirë se kandidati tjetër!! Kështu që në votime nuk ka mundësi njeri të përcaktojë kush është dëmi, sasinë e tij, madhësinë e tij, madje as llojin e tij sepse kjo është gajb. Kështu që këta flasin për dëme që nuk kanë ndodhur dhe as nuk e dine, a do të ndodhin apo jo, që ndryshe mund ti quajmë : iluzione. Atëherë del pyetja : A mund të bëhet harami hallall për shkak të iluzioneve. Po nëse ky person që zgjidhet del në të vërtetë më i dëmshëm se tjetri, kush e mban gjynahun e zgjedhjes së tij dhe ndihmesës së tij në të gjitha gjynahet që do veprojë ai gjatë pushtetit të tij?! Atëherë do thonë këta që e zgjodhën : Ne kishim qëllim të mirë... Po kështu thoshin edhe munafikët në kohën e profetit sal-I Allahu eljhi ue selem kur u binte ndonjë fatkeqësi për shkak të gjynaheve që bënin. Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Kur u thuhet atyre : ejani tek ajo që ka zbritur Allahu dhe tek i dërguari, do ti shohësh munafikët duke kthyer shpinën. E si do jetë gjendja e tyre kur tu bjerë atyre ndonjë fatkeqësi për shkak të asaj që kanë punuar me duart e tyre. Më pas do vijnë tek ti e do betohen në Allahun se ne deshëm vetëm mirësi dhe bashkim”** [En-nisa 61-62].

bashkëpunim të mirë ndërmjet muslimanëve për të arritur rezultate sa më të mira për zgjidhjen e problemeve të tyre në format më të pastra larg haramëve. E gjithë kjo është nëse ne themi që këto probleme u erdhën muslimanëve sepse nuk u futën në kuvend ose sepse nuk votuan, gjë që nuk është fare e vërtetë. Është e vërtetë që muslimanët kanë problemet e tyre por shkak për to në shumë raste është mosndjekja e të vërtetës dhe mosbashkëpunimi ndërmjet tyre. Kemi për qëllim mosbashkëpunimin në baza të pastra Islame jo në bazat e dëshirave të njerëzve.

Sikurse duhet theksuar se rastet e nevojës së domosdoshme nuk i lejojnë muslimanit të kryejë çdo lloj harami për të larguar nevojën e tij sepse siç e treguam tek kushtet kjo nuk lejohet. Prandaj duke u bazuar tek kushtet që treguam dhe lidhja e tyre me realitetin rezultojmë se hyrja në kuvend ose votimi nuk konsiderohet domosdoshmëri sepse nuk plotëson asnjë nga kushtet e saj.

▪ **A janë të imponuar muslimanët të votojnë ose të kandidojnë?**

Për të marrë përgjigjen e kësaj pyetje kemi nevojë të tregojmë se çfarë është detyrimi. Imponimin (Ikrahun) dijetarët e kanë ndarë në dy lloje. 1. Imponim në të cilin njeriu ka të drejtë të zgjedhë ndërmjet dy ose më shumë gjërave. 2. Imponim në të cilin njeriu nuk ka të drejtë të zgjedhë fare. Shembulli i llojit të dytë është si një person të cilin e hedhin disa njerëz nga taraca e një pallati dhe bie mbi një njeri tjetër dhe vdesin të dy. Në këtë rast ai që ra nuk kishte zgjidhje tjetër sepse e hodhën. Ai në këtë rast është si gjethja që e hedh era nga të dëshirojë. Ky njeri nuk ka gjynah në Islam për këtë vepër sepse nuk është me dëshirën tij dhe është jashtë mundësive të tij në mënyrë të plotë.

Ndërsa shembull për llojin e parë është rasti kur një person i vendos pistoletën në kokë dikujt dhe i thotë pije këtë gotë me alkool. Në këtë rast njeriut i është dhënë të zgjedhë ndërmjet jetës dhe pirjes së gotës me alkool. Por dijetarët kanë vendosur 4 kushte për konsiderimin e imponimit justifikim për të kryer një gjynah përveç kushtit që treguam më sipër kur thamë që jo të gjitha llojet e haramëve lejohen në rast domosdoshmërie ose imponimi.

Ka thënë Ibn Haxher El Askalani : “Kushtet janë si vijon : **1.** Që të kërcënohet njeriu prej dikujt duke qënë i sigurt ose afër sigurisë se kërcënuesi ka mundësi ta kryejë atë që e thotë dhe i kërcënuari nuk ka mundësi të mbrohet ose të shpëtojë në asnjë formë. **2.** Të jetë i sigurt ose afër sigurisë që po nuk e kreu atë që i kërkohet, kërcënuesi do zbatojë atë që tha. **3.** Të jetë kërcënimi me diçka që ka lidhje me momentin. Prandaj nëse i thotë : “Po nuk e bërë do të të vras nesër” nuk quhet i imponuar. Përfundohet këtu koha e shkurtër në të cilën mendohet se kërcënuesi

zakonisht mund ta kryejë kërcënimin. **4.** Mos duket se i kërcënuari e dëshiron ta kryejë veprimin për të cilin po imponohet” ²²⁵.

Atëherë në bazë të këtyre që treguam mund të themi se hyrja në kuvend dhe votimet nuk konsiderohen imponim sepse nuk plotësojnë asnjë nga kushtet e sipërpërmendura.

▪ **Le ta shohim çështjen në një aspekt tjetër.**

Davja në veçanti dhe Islami në përgjithësi nuk kanë lindur sot dhe muslimanët e sotëm nuk janë të parët muslimanë në histori. Gjithashtu edhe nevojat që kanë muslimanët sot dhe vështirësitë që hasin nuk janë të reja. Madje vështirësitë që kemi ne sot (flas për vendin tonë) nuk përbëjnë as 10% të vështirësive që kanë hasur sahabet dhe para tyre profeti sal-l Allahu alejhi ue selem.

Çdo vështirësi dhe sprovë që mund të pretendojnë sot muslimanët, brezi i parë e ka kaluar. E megjithatë nuk ka pranuar profeti sal-l Allahu alejhi ue selem dhe as sahabet të bëjnë tolerime në fe për hir të dobive dhe për të larguar dëmet. Edhe pse profeti sal-l Allahu alejhi ue selem ka vuajtur vet dhe i shikonte sahabet duke u torturuar e u thoshte : Bëni durim... U thoshte : Bëni durim o familja e Jasirit se vendi juaj është Xhen-neti... U thoshte : Ju jeni popull që nguteni ... U thoshte : Allahu ka për ta ngritur këtë fe deri sa të shkojë gruaja nga filan vend e deri në filan vend pa pasur frikë askënd veç Allahut... U tregonte atyre historitë e durimit që kanë bërë besimtarët e mëparshëm etj etj... Ndërsa sot e kundërta. Sot njerëzit përpiqen ku e ku të gjejnë sa më shumë tolerime në fe sepse nuk duan sprova. Mendojnë se sprovat janë shënues i keq për njeriun dhe fenë e tij.

“Një prej fatkeqësive dhe turpësive që u kanë rënë sot muslimanëve është që ata mendojnë se sprovat që i ndodhin njeriut në dave tregojnë që ai është në rrugë të gabuar. Për këtë arsye ata përpiqen të shpëtojnë prej tyre në çdo formë. E disa prej tyre marrin edhe guximin për të bërë harame vetëm se i duket që në të ka “dobi”. Ata menduan se mos sprovimi është dobi që duhet të kujdesen për të, me të gjitha format. Por marrja në konsideratë të kësaj “dobie” ka pasur shumë ndikim negativ sepse i penguan njerëzit që të kërkojnë rrugët që janë larg haramit. I penguan ata prej ndjekjes së rrugës që u duket se në të ka sprova. Kjo gjë i privoi ata prej punës së pastër të cilën nuk e ndot asgjë për shkak të vështirësive. Kështu që sot u bë e pamundur (për këta) të punosh për Islamin pa rënë në gjynahe” ²²⁶.

Mushrikët i paraqitën profetit sal-l Allahu alejhi ue selem të njëjtat oferta pas të cilave rendin sot muslimanët dhe ai nuk i pranoi. E si mund ti pranonte kur ata i

²²⁵ Këto kushte janë marrë nga libri : “Fet’hu El Bari” i Ibn Haxher El Askalanit 12/311-312.

²²⁶ El Musharakeh fil Barلمان uel Uizareh f 138.

kërkonin që të heshte nga e vërteta. Ndërsa sot muslimanët, jo vetëm heshtjen por edhe lëshimet në fe janë duke i dhuruar për të arritur “pak pushtet”.

Është transmetuar nga Xhabir radi Allahu anhu se Utbeh Ibn Rabian e dërgoi paria e Kurejshëve tek profeti sal-I Allahu alejhi ue selem. I tha : Na përçave, shave fenë tonë, shave baballarët tanë, shave idhujt tanë. Na turpërove para arabëve. A më dëgjon të të paraqes disa gjëra mbase pranon ndonjërin prej tyre? I tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : Fol o Ebu Uelid. I tha : Nëse dëshiron pasuri, ne të mbledhim pasurinë tonë deri sa të jesh nga më të pasurit ndër ne. Nëse dëshiron post të lartë, ne të bëjmë të parin tonë deri sa të mos bëjmë asgjë pa marrë mendimin tënd. Nëse dëshiron pushtet ne të bëjmë mbretin tonë. E nëse kjo që thua është një mendim që të vjen e ti nuk e largon dot, do të kërkojmë një mjek dhe do ti japim atij pasurinë tonë që të shërohesh. Kur mbaroi Utbeh i tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : A mbarove o Utbeh? I tha : Po. I tha profeti sal-I Allahu alejhi ue selem : Tani dëgjo prej meje dhe i këndoi atij ajetet e para nga surja Fusilet²²⁷.

Ky ishte i dërguari i Allahut sal-I Allahu alejhi ue selem. I hodhi poshtë të gjitha ato dobitë që njerëzit sot i pretendojnë të tilla në dave. Nuk pranoi asnjërin prej tyre edhe pse sahabet torturoheshin, vuanin dhe nevoja e tyre për ato dobi ishte shumë herë më e madhe se nevoja jonë për to sot. Kjo është rruga e tij e qartë. Kujt i dhimbset vetja le ta ndjekë atë se vetëm kjo është rruga e shpëtimit.

Ka thënë Ibn Tejmiya : **“Çdo çështje e cila ka ekzistuar në kohën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem dhe nevoja për ta kryer atë në kohën e tij ka ekzistuar e megjithatë profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk e ka kryer, kjo tregon se ai veprim nuk është i dobishëm”. Më pas tha : “...ndërsa çështjet që nevoja për tu kryer (në kohën e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem) ka ekzistuar e megjithatë ai nuk i ka kryer ato, tregojnë se kryerja e tyre është ndryshim i fesë së Allahut. Këto gjëra i kanë futur në fe mbretërit ose dijetarët ose adhuresit të cilët janë cilësuar si bidatçinj ose ata dijetarë të cilët rrëshkitën duke gabuar në to”²²⁸.**

Në këtë rast është pushteti ose marrveshja me të. Nevoja për një marrveshje paqeje mes profetit sal-I Allahu alejhi ue selem dhe mushrikëve të Mekës ka qënë e madhe e megjithatë profeti sal-I Allahu alejhi ue selem nuk e ka vepruar sepse ata kërkonin të heshte prej të vërtetës dhe të mos fliste keq për shirkun e tyre. Kjo tregon se po të ishte kjo gjë pjesë e fesë apo e lejuar në fe do ta kryente profeti sal-I Allahu alejhi ue selem. Ndërsa sot muslimanët jo vetëm që po heshtin prej shirkut por po kërkojnë ta mbështesin shirkun me pretendimin se në të ka dobi!!

²²⁷ Transmetoi Ibn Is'hak në librin “El Megazi” e të tjerë. Hadithin e saktësoi Albani “fihku Es-sirah” f 106.

²²⁸ Iktidhau Es-sirat El Mustekim f 279.

- **Le të bëjmë një krahasim imagjinar. “Përfytyro sikur mushrikët e Mekës të shkonin dhe ti kërkonin profetit sal-l Allahu alejhi ue selem këtë kërkesë që vijon :**

Ne paria e Mekës jemi ndarë në tre parti dhe kemi vendosur t’ia lemë në dorë popullit të zgjedhë kush do ta drejtojë Mekën dhe kush do ti vendosë ligjet në të. E kemi parë që edhe ju muslimanët keni vuajtur për vite me rradhë. Ndërsa që tani e tutje nuk ka më diktaturë por mund të zgjidhni ju vetë një nga këto tre parti për të drejtuar : **1.** Partia e idhullit “El Uz-za”, **2.** Partia e idhullit “El-lat” dhe **3.** Partia e idhullit “Menat”.

Çdo parti ka ligjet, parimet dhe besimet e veta për jetën dhe do vendosë ato ligje që mendon ajo si parti (ligje të inspiruara nga idhulli i vet) për sa kohë është në fuqi. Por të gjithë janë dakord që ligjet i vendosin vet njerëzit ²²⁹. Prandaj të treja partitë kanë rënë dakord për disa pika : Adhuro kë idhull të dëshirosh madje edhe Allahun po deshe mund ta adhurosh. Nuk të pengon njeri, vetëm mos fol keq për këto tre partitë dhe as për idhujt që përfaqësojnë. Ne i kemi caktuar Allahut pjesën e vet në shoqëri. Allahu ka të drejtë të vendosë ligje vetëm në xhami dhe brenda shtëpive tuaja ndërsa përjashta jo ²³⁰. Kurse idhujt tanë kanë të drejtë absolute për të vendosur ligje kudo madje edhe të ndërhyjnë tek pjesa e Allahut që ia kemi caktuar ne ²³¹, ndërsa Allahut nuk i takon të ndërhyjë tek pjesa e idhujve tanë. Për bagëtitë vendosim ne se kush janë hallall dhe kush janë haram ²³². Të ngordhurën ne e kemi bërë hallall ²³³. Ngrënia

²²⁹ Ka thënë Allahu i Madhëruar [El En’am 137] (Surja el En’am ka zbritur në Mekë) : **“Gjithashtu shumë prej mushrikëve ua kanë zbuluar vrasjen e fëmijve të tyre, idhujt e tyre që ti shkatërrojnë ata dhe tua ngatërrojnë fenë e tyre. Po të dëshironte Allahu nuk do ta bënin, prandaj leri ata dhe shpifjet e tyre”**.

²³⁰ Kujto pak ngjarjen e Ebu Bekrit me Ibn Ed-degineh që e përmendëm më sipër ku ndër të tjera i thanë Mushrikët : Thuaji Ebu Bekrit le të falet në shtëpinë e tij dhe mos e shfaqë adhurimin e tij se kemi frikë se i bën fitne grave dhe fëmijëve tanë.

²³¹ Ka thënë Allahu i Madhëruar në suren [El En’am 136] **“Ata i bënë Allahut pjesë (pronë) prej drithrave dhe bagëtive që Ai i ka krijuar dhe thanë : kjo është për Allahun me pretendimin e tyre ndërsa kjo është për idhujt tanë. Ajo (pjesë drithi ose bagëtie) që ishte e idhujve nuk shkonte tek Allahu (e të bëhej pronë e pjesës së Tij) ndërsa ajo pjesë që ishte e Allahut mund të shkonte tek idhujt (e mund të bëhej pronë e pjesës së tyre). Ah sa keq që kanë gjykuar”**. Ka treguar Ibn Ab-basi radi Allahu anhu se mushrikët kur mblidhnin drithin e ndanin atë në dy grumbuj. Njëra për Allahun dhe tjera për idhujt. Nëse frynte era dhe e merrte drithin që ishte për Allahun dhe e çonte tek drithi që ishte për idhujt ata nuk e kthenin mbrapsht. Ndërsa nëse frynte era dhe merrte drithin e idhujve dhe e çonte tek pjesa e Allahut sipas pretendimit të tyre ata e kthenin atë mbrapsht sepse ai ishte i idhujve. [Tefsiri i Taberiut 12 131]. Për këtë u ka thënë Allahu : **“Sa keq që kanë gjykuar”**.

²³² Ka thënë Allahu i Madhëruar [El En’am 138] : **“Ata sipas pretendimit të tyre thonë se këto bagëti e ato drithëra janë të ndaluara dhe askush nuk duhet t’i hajë, përveç atyre që i lejojmë ne. E ka disa kafshë që ndalohen të përdoren për ngarkesë (apo për punë tjetër), si edhe bagëti për të cilat nuk duhet të përmendet Emri i Allahut (në përdorimin ose therjen e tyre), duke shpifur ndaj Tij . Ai do t’i shpërblejë ata për çfarë shpifën”**.

²³³ Ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Shejtanët u inspirojnë miqjve të tyre që të djalogojnë me ju e nëse ju i bindeni atyre atëherë me të vërtetë jeni mushrikë”**. [El En’am 121] Transmeton Abdullah Ibn Ab-basi radi-Allahu anhu se disa njerëz shkuan tek profeti sal-l Allahu alejhi ue selem dhe i thanë : A të hamë

e gjakut është e lejuar, bixhozi është formë e drejtë fitimi, shtirja e fallit është formë e drejtë për njohjen e të ardhmes, Nuk ka botë tjetër. Imoraliteti (bashkëjetesa) është çështje personale, nuk ka të drejtë të ndërhyjë njeri në të. Ne kështu i kemi gjetur baballarët tanë, madje edhe Allahu na ka urdhëruar për të bërë imoralitet²³⁴. Vrasja e vajzave është çështje personale²³⁵ që i përket babait të vajzës²³⁶.

Zgjidh një nga këto tre parti. Mos harro se ajo që fiton merr pushtetin dhe në bazë të kësaj varen të drejtat tuaja si muslimanë. Duam të të kujtojmë gjithashtu se “Menati” është partia e djathtë, ata janë tolerantë ndaj jush. Ndërsa partia e “Uz-zës” është partia e majtë të cilën e drejton Ebu Xhehli. Partia e tij është shumë e ashpër dhe mund tju bëjnë shumë dëme juve si muslimanë. Ndërsa parti El-latit nuk ka ndonjë qëndrim të qartë ndaj jush por po ta mbështesni ka mundësi që edhe tu ndihmojë për ndonjë nevojë që keni. Edhe një herë po e përsërisim kujdes në zgjedhjen, se këtu varet e ardhmja juaj. Mund t’ju vijë çdo parti t’ju paraqesë ofertat e veta si parti, që ju ta mbështesni për të marrë pushtetin. Vetëm se nuk besojmë se partia e Ebu Xhehilit ka për të ardhur për t’ju kërkuar ndihmë për shkak të urrejtjes së madhe që kanë ndaj jush”.

Si mendoni o muslimanë, a do zgjidhte profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ndonjë parti nga këto të treja, për hir të dobive që mund të vinin prej tyre ...?! Mendoj se pyetja nuk ka nevojë për përgjigje.

Mos harro se ne e treguam më sipër argumentin që tregon se mushrikët i kërkuan profetit sal-I Allahu alejhi ue selem diçka shumë herë më të mirë dhe më të dobishme se kjo që imagjinuam ne. I thanë : Të bëjmë mbret etj etj e megjithëkëtë ai nuk

atë që e vrasim vetë dhe të mos hamë atë që e vrau Allahu (dmth të ngordhurën?! Atëherë zbritën këto ajete. Ka thënë Ibn Kethiri në tefsirin e tij : Fjala e Allahut “**e nëse ju i bindeni atyre atëherë me të vërtetë jeni mushrikë**” dmth nëse largoheni nga urdhëri i Allahut dhe ligji i Tij dhe merrni fjalën e dikujt tjetër dhe i jepni përparësi atëherë keni rënë në shirk.

²³⁴ Ka thënë Allahu në suren [El Ea’raf 28] e cila është sure që ka zbritur në Mekë : “**E nëse ata bëjnë imoralitet thonë : Ne i kemi gjetur baballarët, tanë kështu vepronin dhe Allahu na ka urdhëruar për këtë. Thuaj Allahu nuk urdhëron për imoralitet a po thoni për Allahun atë që nuk e dini**”.

Ka treguar Aishja radi Allahu anha se në kohën e injorancës kanë ekzistuar katër lloje martesash. Një prej tyre është që burri ta çojë gruan e tij tek një burrë trim disa netë që ti lindi një djalë trim si ai. E një lloj tjetër është që gruaja vendos një flamur tek dera e shtëpisë dhe kush ka dëshirë hyn dhe bën mardhënie me të deri në dhjetë veta. Kur gruaja lind i mbledh burrat që kanë bërë mardhënie me të dhe e cakton ajo se kush është babai i fëmijës ... Transmeton Buhariu nga Aishja radi Allahu anha. E kemi treguar të shkurtuar sepse hadithi është i gjatë.

²³⁵ Ka thënë Allahu i Madhëruar [El En’am 140] : “**Janë shkatërruar ata që kanë vrarë fëmijët e tyre me mendjelehtësi e padije dhe kanë bërë haram atë që ua ka furnizuar Allahu duke shpifur ndaj Allahut. Kanë humbur dhe nuk janë të udhëzuar**”.

²³⁶ Këto janë disa prej ligjeve të tyre. Sikur ti tregonim të gjitha do duhej një libër i tërë. Ka shkruar Muhamed Ibn Abdul Ueh-habi një libër për këtë çështje me titull “**Çështjet në të cilat i ka kundërshtuar profeti sal-I Allahu alejhi e selem mushrikët**”. Është me të vërtetë libër i bukur. Ka treguar në të rreth 100 çështje si ato që përmendëm më sipër, në të cilat ai i ka kundërshtuar mushrikët, të argumentuara me argumente nga Kur’ani dhe Suneti.

pranoi. E si mund të pranonte këto lloj ofertash, kur Allahu e dërgoi që ti kundërshtonte dhe ti ndryshonte ato zakone të këqia në formë të qartë?! Për këtë i treguam edhe ajetet që ndodhen në fusnota. E këto ajete janë vetëm një pjesë e ajeteve që flasin për ligjet që kishin vendosur mushrikët e Mekës dhe se çfarë përgjigje u ka dhënë Allahu atyre për këto ligje. Prandaj shumë ajete që tregojnë se vetëm Allahut i takon gjykimi dhe se nuk ka shok në të kanë zbritur në Mekë, si ajeti 62 i sures El En'am ose ajeti 40 i sures Jusuf ose ajeti 67 po në suren Jusuf ajeti 26 i sures El Kehf etj ajete. (Të gjitha këto sure që përmendëm kanë zbritur në Mekë).

Ka thënë Muhamed Ibn Abdul Ueh-hab : “Kur profeti sal-l Allahu alejhi ue selem u ngrit për ti paralajmëruar (mushrikët) për dëmin që ka shirku dhe për ti urdhëruar për teuhidin, ata nuk e urryen atë që tha. Përkundrazi u pëlqeu e disa menduan edhe të hyjnë në këtë fe, derisa u tregoi profeti sal-l Allahu alejhi ue selem haptazi mangësinë e fesë së tyre dhe të metat e dijetarëve të tyre. Atëherë iu përveshën atij dhe shokëve të tij në armiqësi dhe thanë : Na i bëri budallenj njerëzit e mençur, na cënoi fenë tonë, na ofendoi idhujt tanë. Mirëpo siç dihet, profeti sal-l Allahu alejhi ue selem nuk ka ofenduar Isën alejhi selam, as nënën e tij, as melaiket dhe as njerëzit e mire, por kur u tha atyre se nuk duhet t'u luten këtyre sepse këta nuk bëjnë dëm dhe as dobi e konsideruan mushrikët këtë gjë ofendim dhe cënim. Po e kuptove këtë, ke për ta marrë vesh se njeriut nuk i konsiderohet i drejtë islami i tij edhe pse e njehson Allahun dhe largohet nga shirku derisa ta urrejtë dhe armiqësojë të keqen dhe ta shfaqë atë. Siç ka thënë Allahu i Madhëruar : **“Nuk gjën një popull që beson Allahun dhe ditën e Fundit të duan ata që luftojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij”**. [El Muxhadeleh 22]. Po e kuptove këtë ke për të marrë vesh se shumë prej atyre që pretendojnë se kanë fe nuk e njohin atë sepse çfarë i shtynte muslimanët që të mbartnin gjithë atë durim, vuatje, tortura, burgim hixhret në Habeshe duke qënë se profeti sal-l Allahu alejhi ue selem ishte njeriu më i mëshirshëm. Po të gjente mundësi për lehtësim do tu jepte lehtësim atyre. E jo më që Allahu ka zbritur ajetin që thotë : **“Ka prej atyre njerëzve që thonë besuam Allahun dhe kur sprovohen për Allahun ata e konsiderojnë sprovën e njerëzve si ndëshkimin e Allahut”**. Kur ky ajet flet për ata që pajtohen (me mushrikët) vetëm me gojë (jo me zemër) po të tjerët (që bënë më shumë)”²³⁷?!“

Ka thënë Muhamed Ibn Abdul Ueh-hab gjithashtu : “Kuptimi i mohimit të tagutit domethënë që të largohesh prej çdo kujt që besohet veç Allahut qoftë njeri apo xhind apo pemë apo gur etj. Të dëshmosh për të që ka rënë në mohim dhe në humbje dhe ta urresh kushdo qoftë ai. Ndërsa ai që thotë : Unë nuk adhuroj askënd tjetër veç Allahut por unë nuk flas për idhujt apo varret e të tjera si këto, ai është gënjeshtar në

²³⁷ Mexhmuatu Et-teuhid f 140.

fjalën që thotë se “nuk adhuron tjetër veç Allahut”, nuk e ka besuar akoma Allahun dhe nuk e ka mohuar tagutin” ²³⁸.

E para se ta mbyllim këtë çështje po ju kujtoj të rishikoni dëmet që treguam në kapitujt e mëparshëm që ka hyrja e muslimanëve në këto kuvende. Të njëjtat dëme ekzistojnë edhe këtu. Besoj se nuk ka nevojë ti përsërisim edhe një herë. Kështu që edhe duke e shikuar çështjen nga i njëjti këndvështrim që thonë edhe ata që i lejojnë ne themi se dëmi i votimeve për muslimanët është shumë herë më i madh se dobia e tyre. Këtë gjë e treguam më sipër. Gjithashtu do flasim për të edhe më mbrapa kur të flasim për bidatin dhe të tregojmë se a hyn kjo çështje tek bidatet në fe apo jo?

❖ **Temë : A është çështja e hyrjes në këto kuvende ose siç quhet ndryshe kandidimi dhe votimi prej bidateve në fe?**

Së pari duhet të tregojmë se ç’është bidati. Fjala **bidat** në kuptimin gjuhësor të gjuhës arabe domethënë : shpikja e një gjëje të re që nuk ka shembull të mëparshëm. Siç ka thënë Allahu i Madhëruar : “**Thuaj unë nuk jam i ri (bidat) ndër profetët**” [El Ahkaf 9]. Domethënë nuk jam i pari profet që ka dërguar Allahu tek krijesat e Tij ²³⁹.

Përkufizimi i bidatit si term që përdoret në Islam është : “**Çdo gjë që shpiket në fenë e Allahut dhe nuk ka bazë në argumentet fetare**” ²⁴⁰.

Kështu që bidati përbëhet nga tre shtylla : **1.** Shpikja, që domethënë të sjellësh diçka të re që nuk ka qënë e njohur më parë. **2.** Kjo shpikje ti bashkangjitet fesë, që domethënë të thuhet se kjo gjë i përket fesë. **3.** Të mos ketë kjo shpikje në fe argument mbi të cilin mbështetet.

Ka thënë Ibn Rexhebi : “**Çdo gjë që shpiket e i mvishet fesë dhe nuk ka argument që e mbështet atë, konsiderohet humbje dhe feja është larg saj**” ²⁴¹.

Ka thënë Ibn Rexhebi gjithashtu : “Bidat është : ajo gjë që shpiket dhe nuk ka bazë në fe që e mbështet atë. Ndërsa ato gjëra që kanë bazë në fe që e mbështetin nuk quhen bidat në fe edhe pse mund të quhen bidat në kuptimin gjuhësor” ²⁴².

▪ **Çështje : Disa çështje që mendojnë njerëzit se janë kusht që një shpikje të quhet bidat por që në të vërtetë nuk është ashtu** ²⁴³.

²³⁸ Ed-durer Es-senijeh 2/121-122

²³⁹ Tefsir Et-taberi 22/97.

²⁴⁰ Ka edhe përkufizime të tjera për bidatin që janë shumë të njohura, si përkufizimi që ka dhënë Shatibiu por ky më duket se është më i thjeshtë dhe më afër të vërtetës. Këtë përkufizim e ka treguar Ibn Rexhebi fjalën e të cilit e kemi treguar në tekst. Këtë përkufizim e mora nga libri : “Rregullat e njohjes së bidatit”.

²⁴¹ Xhami’ El Ulum ue El Hikem f 266.

²⁴² Xhami’ El Ulum ue El Hikem f 266.

1. Nuk është kusht që bidati mos ketë asnjë dobi. Përkundrazi ka bidate që kanë disa dobi sepse bidatet nuk hyjnë tek e kota që është e kotë në çdo aspekt që nuk përmban asgjë të vërtetë. Por këto dobi që ekzistojë tek bidatet nuk i bëjnë ato të mira sepse dëmet e tyre janë më të mëdha ndërsa dobitë e tyre janë të pakta.

Ka thënë Ibn Tejmija : “Madje edhe çifutët edhe krishterët gjejnë dobi në adhurimet e tyre sepse ato adhurime patjetër që përmbajnë diçka që në origjinë është e ligjëruar sikurse edhe fjalët e tyre patjetër përmbajnë një lloj sinqeriteti që është transmetuar nga profetët (e mëparshëm). E megjithë këtë ne nuk kemi pse i bëjmë adhurimet e tyre” ²⁴⁴.

2. Nuk është kusht që bidati të bëhet gjithmonë ose në formë të rregullt. Përkundrazi një gjë mund të bëhet qoftë edhe vetëm një herë e konsiderohet bidat.
3. Nuk është kusht në bidat që të bëhet me qëllim për tu afruar tek Allahu dhe as me qëllim adhurimi. Përkundrazi bidati mund të jetë i tillë edhe pa këtë qëllim. Siç ndodh psh me bidatin e përngjasimit me mosbesimtarët ose me rrugët që të çojnë tek bidatet. Vetëm se shumica e bidateve sidomos në adhurim duhet të shoqërohen patjetër me qëllimin e adhurimit që të quhen të tilla.
4. Nuk është kusht që të thuhet për atë që bën një bidat se ai ka qëllim të keq. Përkundrazi ai që bën një bidat mund të ketë qëllim të mirë e megjithë këtë veprimi i tij quhet bidat dhe humbje. Siç është transmetuar në ether nga Ibn Mes’udi radi Allahu anhu se ka thënë : **“Sa e sa njerëz që e duan të mirën nuk e qëllojnë atë”** ²⁴⁵.
5. Nuk është kusht që bidati të mos ketë asnjë argument qoftë është të përgjithshëm. Përkundrazi argumentet e përgjithshme mund të tregojnë se kjo vepër në përgjithësi është e ligjëruar por jo duke e kufizuar me disa kufij të veçantë. Si psh Allahu ka thënë në Kur’an : **“O ju që keni besuar përkujtojeni Allahun shumë”**. [El Ahzab 41]. Por kjo nuk d.m.th që lejohet të thërresësh ezan për namazin e Bajramit. Gjithashtu kjo nuk d.m.th që lejohet ta përkujtosh Allahun vetëm me emrin Allah, Allah, Allah ose hu, hu, hu, (që dmth Ai, Ai, Ai) siç veprojnë sufistët.

²⁴³ Marrë nga libri “Rregullat e njohjes së bidatit f 38-39. Të cilin e ka shkruar Muhamed Ibn Husejn El Xhizani porfesor në Universitetin Islam të Medines.

²⁴⁴ Iktidau Es-sirat El mustekim f 290.

²⁴⁵ Transmeton Ed-daremi. Këtë ether e ka saktësuar Albani në es-silsiletu es-sahihah nr 2005.

“U bë e njohur nga përkufizimi i bidatit se kuptimi i përgjithshëm i tij është : shpikja në fe. Fjala fe përfshin dy aspekte : **1. Të afrohesh tek Allahu me atë që e ka ligjëruar Ai. 2. Ti nënshtrohesh fesë së Allahut me përlje**” ²⁴⁶.

Kështu që bidati në fe bëhet me një nga dy rregullat e mëposhtëm ²⁴⁷:

- 1. Të afrohesh tek Allahu me diçka që nuk e ka ligjëruar Ai** sepse rregulli i përgjithshëm është se afrimi tek Allahu bëhet vetëm me anë të asaj që ka ligjëruar Ai dhe profeti i Tij sal-I Allahu alejhi ue selem. Kështu që kush e adhuron Allahu me diçka tjetër që nuk e ka ligjëruar Allahu ai ka bërë bidat.
- 2. Të dalësh nga sistemi i fesë** sepse rregulli i përgjithshëm në këtë fe është se: **Është detyrë që ne të bazohemi në fenë Islame dhe ti nënshtrohemi ligjeve të saj me përlje. Kështu që kush i jep të drejtë diku veç Islamit për t’iu bindur dhe nënshtrohet ka bërë bidat.**

Këto dy rregulla i përfshijnë të gjitha bidatet. Por u bashkangjitet këtyre dy rregullave edhe një rregull i tretë që thotë :

- 3. Rruga që të çon për tek bidati i bashkangjitet atij.** Sepse bidati në fe mund të vijë në mënyrë të drejtpërdrejtë duke shpikur diçka ose mund të vijë duke bërë disa veprime që janë të lejuara në vetvete por që në përfundim të çojnë në bidat. Për këtë arsye rruga që të çon tek bidati ka marrë gjykimin e tij.

Nën këto tre rregulla hyjnë 23 pika ose rregulla të veçanta që i sqarojnë këto rregulla të përgjithshme në lidhje me bidatin ²⁴⁸. Normalisht ne nuk do ti tregojmë të gjitha ato sepse kjo ka nevojë për të shkruar një libër në veçanti. Por do tregojmë ato rregulla që i përkasin temës tonë në fjalë për të shikuar se çfarë qëndrimi mban Islami kundrejt veprimeve të tilla.

- **Përpara se të tregojmë disa rregulla që kanë lidhje me çështjen në fjalë kam dëshirë të flas për një çështje që ka lidhje me votimet dhe ka lidhje të ngushtë edhe me temën tonë.**

Është bërë zakon që afro një muaj para votimeve kandidatët për pushtet të bëjnë fushata elektorale për të tërhequr masën e gjerë me qëllim që të fitojnë sa më shumë vota ditën që do votohet. Nuk çuditëm për këtë. Ajo që më çudit është se shumë muslimanë dhe imamë xhamish i kanë kthyer xhamitë e tyre në qendra reklamimi për kandidatët ose partitë politike. Për këtë arsye unë desha ti kujtoj

²⁴⁶ Shih librin : “Rregullat e njohjes së bidatit” f 43.

²⁴⁷ Këto rregulla janë marrë nga libri : “Rregullat e njohjes së bidatit” f 44-45.

²⁴⁸ Shikoj këto rregulla tek libri : “**Rregullat e njohjes së bidatit**” f 66-178.

këtyre vëllezërve një hadith të profetit sal-I Allahu alejhi ue selem në të cilin na tregon një rregull dhe edukatë të cilën duhet ta kemi kur jemi në xhami.

Transmeton Ebu Hurejre radi Allahu anhu se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush dëgjon një njeri duke thirrur: “Kush e ka gjetuar atë që më ka humbur”²⁴⁹, Thuajini : Allahu mos ta ktheftë atë që të ka humbur sepse xhamitë nuk janë ndërtuar për këtë punë”²⁵⁰.**

Ndërsa Tirmidhiu e ka transmetuar këtë hadith nga Ebu Hurejre radi Allahu anhu nga profeti sal-I Allahu alejhi ue selem me këtë tekst që vijon : **“Nëse shikoni dikë duke shitur ose blerë në xhami thuajini : “Mos të dhëntë Allahu fitim prej tregësitë tënde” dhe nëse shikoni dikë duke thërritur : Kush e ka gjetur atë që më ka humbur thuajini : “Allahu mos ta ktheftë atë që të ka humbur””²⁵¹.**

Komisionit të përhershëm i është drejtuar kjo pyetje : A lejohet shitja e librave ose e mishit në xhami? **Përgjigje** : “Nuk lejohet shitja dhe as blerja në xhami sepse ka transmetuar Tirmidhiu nga Ebu Hurejreh ... (treguan këtë hadith)”. [Abdul Aziz Ibn Baz, Abdu Er-razak El Afifi]²⁵².

Shih një pyetje tjetër që i ka ardhur komisionit të përhershëm në lidhje me këtë çështje : **Pyetje** : Unë jam imam xhamie. Kur isha ulur në mimber dhe po prisja të mbaronte ezani para hytbes më dha një prej punonjësve të bashkisë disa dokumenta të dërguara nga drejtoria e tij. Kur mbarova hytben dhe namazin dhe dola nga xhamia i lexova ato. Në të ishte një shkresë dhe me të ishin dy lajmërime që kërkonin banesë me qera për interes të bashkisë. Në të bëhej e qartë gjithashtu numri i dhomave që kërkoreshin dhe madhësia e tyre, gjithashtu numri i banjove dhe të tjera të dhëna. Kërkohej prej meje që ta lexoj këtë para xhematit pas namazit të xhumasë. Por unë mendova që shenjtëria e xhamisë nuk e lejon që të kthehet në vend për të lexuar reklamat. Për shkak të haditheve të cilat ju i dini dhe fjalëve të dijetarëve. Prandaj unë i tregova atij që i kishte dërguar këto letra por ai kishte mendim tjetër dhe i nisi edhe një herë ato letra edhe pse shumë njerëz e kanë marrë vesh atë lajm, ai këmbënguli me forcë që ato të lexohen pas namazit të xhumasë. Për këtë arsye po ua paraqes këtë çështje juve që ta ndani këtë çështje duke dhënë gjykimin e Islamit për të, që unë te eci me të në të ardhmen. Allahu ua shpërbleftë me të mira.

²⁴⁹ Fjala që e ne e kemi përkthyer “ka humbur” në arabisht është “dal-leh”. Në origjinë kjo fjalë përdoret për bagëtitë ose devetë që kanë humbur por këtu në hadith ajo përfshin çdo gjë që ka humbur qoftë ajo bagëti apo send. Kështu e ka shpjeguar El Mubarekfuri këtë fjalë në librin : “Tuhfetu El Ahuedhi” 4/458.

²⁵⁰ Transmeton Muslimi nr 1288.

²⁵¹ Transmeton Tirmidhiu nr 1321. Hadithin e saktësoi Albani.

²⁵² Fetaua El-lexhneti Ed-daimeh, el mexhmuatu EL Ula 6/284 pyetja 11 e fetvasë nr 12087.

Përgjigje : “Ajo që ke vepruar ti domethënë : mos leximi i atyre lajmërimeve është e sakta. Allahu ta shpërbleftë me të mira. Xhamitë nuk janë ndërtuar për këtë gjë e për gjëra të ngjashme si këto. Por janë ndërtuar për adhurimin e Allahut. Për të bërë dhikër ose mësim ose këshilla. Argumentet kanë treguar se xhamia duhet të pastrohet prej këtyre veprimeve si rasti që të kërkoj punonjësi i bashkisë. Ka trasnmetuar Imam Muslimi Allahu e Mëshiroftë nga Ebu Hurejreh se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Kush dëgjon një njeri duke thirrur: “Kush e ka gjetuar atë që më ka humbur”, Thuajini : Allahu mos ta ktheftë atë që të ka humbur sepse xhamitë nuk janë ndërtuar për këtë punë”**. Gjithashtu transmeton En-nesai dhe Tirmidhiu se profeti sal-I Allahu alejhi ue selem ka thënë : **“Nëse shikoni dikë duke shitur ose blerë në xhami thuajini : “Mos të dhëntë Allahu fitim prej tregësitë tënde”**”. [Abdul Aziz Ibn Baz , Abdu Rrazak El Afifi , Abdullah Ibn Gudejan dhe Abdullah Ibn Kuud]

Dihet që shitblerja ose kërkimi i një gjëje që të ka humbur nuk është haram në vetvete por është e lejuar, ndërsa në xhami ndryshon gjykimi sepse xhamitë janë ndërtuar për adhurim dhe jo për këto gjëra. Po kur dikush thërret në xhami për të kryer diçka e cila që në origjinë është haram?! Normalisht që kjo është edhe më e rëndë se e para. Unë e di që ata që thërrasin në xhami mbi mimbere : Votoni për këtë apo për atë parti, nuk besojnë se votimi është i ndaluar në vetvete sepse po ta besonin këtë nuk do ta bënin këtë thirrje.

Le të ecim momentalisht me besimin e tyre që kanë për votimet. U themi që ju besoni se votimet janë hallall? Nëse thonë po. Atëherë ne u themi : Edhe tregëtia hallall është madje nuk ka kontradikta ndërmjet dijetarëve për këtë e megjithatë profeti sal-I Allahu alejhi ue selem e ka ndaluar tregëtinë në xhami. I themi : Të kërkoksh atë që të ka humbur është hallall e për këtë nuk ka kontradiktë ndërmjet dijetarëve e megjithatë e ka ndaluar këtë veprim profeti sal-I Allahu alejhi ue selem. Atëherë pse u lejoka të thërrasësh duke thënë : Votoni për këtë apo atë parti dhe nuk lejohet të thërrasësh duke thënë : “O njerëz më ka humbur diçka kush prej jush e ka gjetur” kur nuk paska dallim ndërmjet atyre që ka ndaluar profeti sal-I Allahu alejhi ue selem dhe votimit të cilin ju e quani të lejuar.

Është pyetur Albani : Çfarë gjykimi ka hyrja në kuvend?

Përgjigje : “Ne besojmë se kjo nuk është e lejuar. Këto veprime e çojnë mundin dëm në ato gjëra që nuk kanë dobi sepse këto kuvende gjykojnë jo me ligjin e Allahut. Disa prej atyre që hyjnë mund të hyjnë me nijet të mirë duke menduar se mund të ndryshojnë ndonjë gjë prej atyre ligjeve. Por ata e harrojnë një fakt të hidhur e ky është se ata që hyjnë në kuvend nuk kanë në dorë gjë por ata janë në dorë të dikujt tjetër. E përderisa është kështu atëherë ata nuk kanë mundësi të bëjnë gjë. Përkundrazi ata do detyrohen të ecin me disa rregulla edhe pse mund të jetë në kundërshtim me Islamin... **Nuk rregullohet gjendja në këtë formë bidati (të shpikur)**

e cila që në origjinë është bidat sepse kuvendi ngrihet me anë të votimeve dhe ato përfshijnë burrin dhe gruan. Që këtu fillon gabimi i këtij sistemi. Ai përfshin gjithashtu njeriun e mirë dhe njeriun e keq. Nuk ka dallim ndërmjet tyre. I miri dhe i keqi ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet. Gjithashtu ndër këta nuk ka dallim ndërmjet dijetarit dhe injorantit. Ndërsa Islami e zgjedh mexhlisin e konsultit prej njerëzve më të zgjedhur të muslimanëve në dije dhe në sjelle” ²⁵³.

Mbase nuk ishte shumë e nevojshme të nxirrnim në rezultat a është ky veprim bidat në vetvete apo jo, pas gjithë atyre argumenteve që treguam gjatë librit por më duket me rëndësi të tregoj se kush janë pasojat nga ana fetare e marrjes në konsideratë të këtyre çështjeve dhe ku të çojnë ato sidomos kur ato mbështeten mbi mimberet e xhamive. Normalisht që muslimanët nuk i kanë njohur këto çështje për 14 shekuj me radhë.

Shih se çfarë thotë Albani : “Ne e dimë se kuvendet sot nuk janë Islame, E ky është një realitet që nuk pranon diskutim në formë të prerë. Sepse Islami ka 14 shekuj dhe nuk i ka njohur kuvendet vetëm se kur u sulmuan nga mosbesimtarët në shtëpitë e tyre të cilët ua detyruan muslimanëve ligjet e tyre, ideologjinë e tyre dhe mënyrën e tyre të jetesës” ²⁵⁴.

Ky fakt në vetvete do mjaftonte që muslimanët ti vendosin gishtin kokës dhe të mendohen : A kështu do ngrihet feja, duke vepruar ato gjëra që nuk i kanë vepruar muslimanët gjatë gjithë këtyre shekujve madje duke vepruar ato gjëra që i ka ndaluar Allahu i Madhëruar dhe profeti sal-I Allahu alejhi ue selem në hadithet e sakta të cilat i përmendëm më sipër?!

Përmendëm tek rregulli i tretë në lidhje me bidatet se **“Rruga që të çon për tek bidati i bashkangjitet atij”** sepse bidati në fe mund të vijë në mënyrë të drejtpërdrejtë duke shpikur diçka ose mund të vijë duke bërë disa veprime që janë të lejuara në vetvete por që në përfundim të çojnë në bidat. Për këtë arsye rruga që të çon tek bidati ka marrë gjykimin e tij.

Një prej rregullave të veçanta që hyjnë tek ky rregull i përgjithshëm është si vijon : **“Nëse një veprim që është i urdhëruar në Islam kryhet në atë formë që i çon njerëzit të mendojnë se ai ka gjykim tjetër në Islam ai i bashkangjitet bidatit”** ²⁵⁵.

Shembull për këtë është që imami i xhamisë të këndojë çdo ditë xhumaje për sabah suren Sexhdeh dhe Insan pa e lënë asnjë herë. Kjo gjë do çojë që të mendojnë njerëzit se leximi i këtyre dy sureve është vaxhib ²⁵⁶.

²⁵³ Kaseta nr 440_03. Marrë nga faqja www.alalbany.net

²⁵⁴ Kaseta nr 358_03. Marrë nga faqja www.alalbany.net

²⁵⁵ Kauaidu Ma’rifeti El Bida’ f 165.

Shembull tjetër : Është që disa imamë e këndonin suren Sexhdeh gjithmonë në namazin e sabahut të ditës së xhuma. Dihet që surja Sexhde ka sexhde dhe imami bën sexhde kur mbërrin në atë ajet. Nga kryerja e vazhdueshme e këtij veprimi njerëzit e thjeshtë arritën në besimin se namazi i sabahut ditën e xhuma ka tre rekate ²⁵⁷.

Gjithashtu edhe ky rregull që vijon është i ngjashëm me të parin : **“Të kryhet një veprim që është i lejuar por jo i urdhëruar në atë formë që mund të mendojnë njerëzit se ai është i urdhëruar nga ana fetare”**. Shembull për këtë është zbukurimi i xhamive. Shumica e njerëzve besojnë se zbukurimi i tyre hyn tek respekti ndaj shtëpisë së Allahut. Gjithashtu varja e abazhurëve të mëdhenj e të shtrenjtë në xhami. Njerëzit mendojnë se këto hyjnë tek shpenzimi në rrugë të Allahut ²⁵⁸.

Kur kryerja e këtyre adhurimeve që i do Allahu, në këtë formë, i çoi njerëzit në këtë mendim që në të vërtetë është një lloj ndryshimi i fesë dhe tregon rrezik. Po të kryesh diçka që nuk është adhurim në vetevetë në atë formë sa t’u duket njerëzve si adhurim?! Patjetër që rreziku është edhe më i madh. A i kanë lënë ndonjëherë muslimanët votimet ose u është thënë që këtë herë nuk duhet të votojmë vetëm që të mos mendojnë njerëzit se votimi është vaxhib?!

Por nëse ata thonë : Nuk ke pse lodhesh kaq shumë, ne e themi që votimi është vaxhib ²⁵⁹. U themi : **“Sillni argumentin tuaj nëse jeni të vërtetë”**. Pasha Allahun që ky është guxim shumë i madh në fenë e Allahut!! Të bëhen gjërat vaxhib sepse kështu i pëlqen njërit apo tjetrit pa argumente të qarta nga Kur’ani dhe Sun-neti?! E ku ta gjejnë argumentin ata pas gjithë atyre ajeteve dhe haditheve që e ndalojnë të anojmë dhe të ndihmojmë mizorët. Gjithashtu argumentet e tyre i kemi treguar më sipër dhe i kemi vlerësuar, kështu nuk ka nevojë për përsëritje. Ju me këtë guxim të madh që keni treguar në nxjerrjen e gjykimeve në fenë Islame të pa bazuara, i keni hapur portën çdo kujt të nxjerrë çfarë gjykimi të dojë edhe pse nuk ka argumente fetare duke ju marrë juve si shembull të keq. **“Mos thonë duke shpifur me gojët tuaja kjo është hallall e kjo është haram duke shpifur ndaj Allahut. Ata që shpifin ndaj Allahut nuk shpëtojnë”** [En-nahl 116]. Nijeti i mirë nuk e ruan njeriun nga gabimi dhe as nuk e justifikon atë që të bjerë në gjynahe.

Një rregull tjetër në këtë prizëm është ky që vijon : **“Kur e kryejnë gjynahun dijetarët që janë shembull për njerëzit në formë të hapur deri sa atë person që i kundërshton**

²⁵⁶ Shih librin El baith ala Inkar El Bida’ i Ebu Shameh f 54.

²⁵⁷ Shih librin El I’tisam të Shatibiut 2/27.

²⁵⁸ Kauaidu Ma’rifeti El Bida’ f 168.

²⁵⁹ E çuditshme me ju deri dje thoshit që votimi është haram. Kaq kollaj u bë harami dhe mbështetja e shirkut vaxhib!!

këta dijetarë nuk e dëgjon njeri dhe deri sa të besojnë njerëzit e thjeshtë se kjo është prej fesë atëherë ky veprim i bashkangjitet bidateve”²⁶⁰.

Ka thënë Imam Shatibiu : “Disa besojnë se filan dijetar nuk e vepron këtë veprim vetëm sepse ai ka argumente. **Origjina (e problemit) është heshtja e dijetarëve dhe kryerja e këtyre veprimeve me hutesë.** Për këtë arsye kanë thënë që tre gjëra e shkatërrojnë fenë : **“Rrëshkitja e dijetarit, dialogu i munafikut në Kur’an dhe imamët e humbur”²⁶¹.**

Kemi edhe një rregull të ngjashëm me të parin që thotë : **“Kur e kryejnë një gjynah njerëzit e thjeshtë dhe përhapet ndër ta. Dijetarët që janë shembull nuk e kundërshtojnë atë edhe pse kanë mundësi derisa të besojnë njerëzit që ky veprim nuk është i ndaluar kjo hyn tek bidatet”²⁶².**

Shembull për këtë rregull janë të gjitha gjynahet që i sheh muslimani tek njerëzit dhe nuk i kundërshton ato. Kjo i bën njerëzit të besojnë se ato nuk janë të ndaluara si muzika sidomos në xhami me heshtjen e imamet të xhamisë ose duhani ose gjynahe të tjera të cilat njeriu me dije, i sheh tek njerëzit dhe nuk i kundërshton ato. Po kur hoxha i urdhëron vet njerëzit që ti kryejnë ato harame. Normalisht që njerëzit do të mendojnë se ato nuk janë harame. Realisht kjo është ajo që ka ndodhur. Për votimet kanë folur disa njerëz në mexhlise dhe kanë thënë që nuk lejohen e më pas kur i kanë kundërshtuar disa njerëz të paditur u kanë thënë lejohen e më në fund kanë thënë që janë vaxhib²⁶³. Kjo është fatkeqësi... Gjithashtu një tjetër është pyetur për votimet dhe ka thënë që nuk lejohen e më pas për inerci ... ka thënë që janë të lejuara. Mjafton vetëm thirrja e hoxhallarëve mbi mimbere për të votuar që ta kuptosh se rreziku i ndryshimit të fesë është shumë i madh.

Ka thënë Ibn Tejmija : **“Çdo çështje e cila ka ekzistuar në kohën e profetit sal-l Allahu alejhi ue selem dhe nevoja për ta kryer atë në kohën e tij ka ekzistuar e megjithatë profeti sal-l Allahu alejhi ue selem nuk e ka kryer, kjo tregon se ai veprim nuk është i dobishëm”. Më pas tha : “...ndërsa çështjet që nevoja për tu kryer (në kohën e profetit sal-l Allahu alejhi ue selem) ka ekzistuar e megjithatë ai nuk i ka kryer ato, tregojnë se kryerja e tyre është ndryshim i fesë së Allahut. Këto gjëra i kanë futur në fe mbretërit ose dijetarët ose adhuresit të cilët janë cilësuar si bidatçinj ose ata dijetarë të cilët rrëshkitën duke gabuar në to”²⁶⁴.**

²⁶⁰ Kauaid Ma’rifeti El Bida’ f 170.

²⁶¹ El I’tisam 2/101.

²⁶² Kauaid Ma’rifeti El Bida’ f 172.

²⁶³ Më pas kur dalin rezultatet e turpshme të këtyre votimeve si rasti konkret i ligjit të martesës së homoseksualëve të thonë ne nuk e dimë gajbin, ne kishim njëjtë të mirë etj. A tani e pranoni që nuk e dini gajbin?! A këto qënkan ato dobitë që kishit parashkuar ?!! Nijeti i mirë kurrë nuk ka për të qënë justifikim për veprat e këqia të cilat i ka ndaluar Allahu dhe i dërguari i Tij sal-l Allahu alejhi ue selem.

²⁶⁴ Iktidhau Es-sirat El Mustekim f 279.

Kur do ta mësojnë njerëzit këtë lloj shirku për të cilin kemi treguar kaq shumë argumente, nëse hoxhallarët i ftojnë njerëzit për të votuar mbi mimbere. Njerëzit normalisht, jo vetëm që nuk kanë për ta mësuar këtë kurrë, por do besojnë se demokracia është pjesë e fesë Isalme dhe në Islam lejohet të vendosë ligje çdokush. Do besojnë se ndihmesa në të këqia nuk është haram sa do të mëdha të jenë ato haramet. Do besojnë se kjo formë është një nga rrugët më të mira të daves. Kur do ta mësojnë njerëzit se çfarë është animi nga mosbesimtarët, kur për këta nuk ekziston fare në realitet kjo gjë. Për çdo veprim që bëjnë, ata gjejnë justifikim dhe nuk e quajnë anim.

Kjo gjë më kujton një rast që një vëlla musliman në dialogun me shiat u ka bërë një pyetje të cilës nuk kanë ditur ti përgjigjen. U ka thënë : A besoni ju se shirku është i ndaluar. I kanë thënë po. U ka thënë : Mirë, ma jepni përkufizimin e shirkut. Nuk i janë përgjigjur sepse ata janë deri në fyt të zhytur në shirk, atëherë çfarë përkufizimi mund t'i japin shirkut. Kështu edhe këta i lexojnë ajetet e Kur'anit për shirkun dhe animin nga mosbesimtarët por nuk i kuptojnë ato. Si përfundim njerëzit do ta lexojnë Kur'anin dhe hadithet e profetit sal-I Allahu alejhi ue selem vetëm për "beteqet" dhe jo për të punuar me to sepse vetë hoxhallarët i kanë mësuar si të gjejnë "rrugëdalje" prej atyre urdhërave dhe ndalesave që ndodhen në Kur'an dhe Sun-net.

Kështu që do vijë një brez (për të mos thënë që ka ardhur) që i lexon argumentet fetare dhe beson se ato u përkasin vetëm brezave që kanë kaluar. Argumentet e shirkut i përkasin kohës së profetit sal-I Allahu alejhi ue selem. Argumentet e animit nga mosbesimtarët u përkasin kohës së sahabëve. Argumentet që na ndalojnë të ndihmojmë mizorët i takojnë kohës së imam Ahmedit dhe Sufjan Eth-theurit e kështu me rradhë. Ndërsa sot nuk u përket atyre asgjë nga këto. Mashallah, sot ne jetojmë në kohën më ideale të shoqërisë?!

❖ **Mbyllje : Thelbi i gjithë këtyre fjalëve që thashë në libër.**

Demokracia është një ideologji që fytyra e saj politike quhet sekularizëm (ndarja e fesë nga shteti). Fytyra e saj ekonomike është kapitalizmi i cili nuk ecën pa korrupsion siç e kanë thënë vetë ata që janë paria e kësaj ideologjie : **"Korrupsioni për shoqërinë është si lubrifikanti për motorrin"**. Fytyra e saj morale është : **"E drejta e njeriut për të vepruar çdo gjë, jashtë çdo kufiri moral"**. Nuk është gabim nëse e quajmë këtë ideologji : Fe të re e cila është pjellë njerëzore. Kjo fe ka vite që po përpiqet të pushtojë botën madje ka pushtuar shumë pjesë të saj. Ajo ka hyrë fuqishëm edhe tek muslimanët në shtëpitë e dhe në vendet e tyre. Ajo është si një rrymë lumi e tërbuar që merr çdo gjë që i del përpara. E gjithë frika është që muslimanët të rrëmbehen nga kjo rrymë. Të ecin me të dhe më pas të mos e shohin aspak problematike atë gjë. Sot kjo ideologji është rreziku më i madh që i kanoset Islamit.

Për këtë arsye ka thënë Shejh Mukbili – Allahu e mëshiroftë – që fetvatë e dijetarëve që e lejojnë hyrjen në kuvend dhe votimet janë shumë të rrezikshme (siç e treguam më sipër). Prandaj detyra e muslimanëve është të qëndrojnë të pa tundur në parimet e tyre fetare para kësaj rryme. Në të vërtetë çdo ideologji që ngrihet, ajo ngrihet duhe hedhur poshtë një ideologji tjetër.

Por “Islami është feja e Allahut dhe nuk mposhtet kurrë në një betejë ideologjike të ndershme. Islami nuk e ka frikë përplasjen me të kotën kushdo qoftë ajo sepse rreziku që i kanoset shoqërisë Islame nuk vjen nga përplasje. Përplasje ndërmjet të vërtetës dhe të kotës është një prej ligjeve hyjnore që e ka vendosur Allahu I Ditur i Urti. Ai e godet të kotën me anë të të vërtetës dhe “Shkumba shkon kot ndërsa ajo që u bën dobi njerëzve ngelet në tokë” [Er-rad 17]. Kështu që kjo përplasje nuk është burim rreziku. Përkundrazi ajo ndjell në vete shpresën e mirë dhe qetësinë (në premtimin e Allahut). Burimi dhe shenja e rrezikut vijnë nëse zhduket kjo përplasje. Atëherë njerëzit kanë për ta humbur ndjesinë e dallimit ndërmjet asaj që është Islame dhe asaj që është perëndimore. Humbja e kësaj ndjesie është shënuesi i vërtetë i rrezikut sepse ai do të thotë humbja e ndjesisë së identitetit. Shoqëritë njerëzore arrijnë ta ruajnë identitetin e tyre nëpërmjet dy rrugëve : 1. Nëpërmjet parimeve dhe vlerave morale që kanë dhe 2. Nëpërmjet kundërshtimit dhe dallimit nga të tjerët. Kështu që rreziku që i kanoset kësaj bashkësie i vjen nga shembja e këtyre dy shtyllave që thamë. Prandaj humbja e ndjesisë së dallimit dhe ndryshimit (nga të tjerët) është shembje e njërës prej shtyllave mbi të cilat qëndron identiteti i një populli që mbart në vete një ideologji. E kjo është ajo që po ndodh sot në të vërtetë!!”²⁶⁵. Madje me shembjen e saj shembet edhe shtylla e parë. Lus Allahun e Madhëruar të na udhëzojë në rrugën e drejtë dhe e lus Atë që të na forcojë në këtë rrugë deri në vdekje. Ai është Dëgjuesi dhe Ai që i përgjigjet lutjeve tona. Amin

²⁶⁵ Marrë nga libri : “Audetu El Hixhab” f 8-9.

Pasqyra e lëndës.

Parathënie

Çështja e parë : Realiteti i ndjekjes se Kur'anit dhe Sun-netit.

Çështja e dytë : Një prej rregullave bazë në temën e argumentimit.

Çështja e tretë : Studimet e mëparshme që janë bërë në këtë temë.

Kapitulli i parë

Kujt i takon e drejta e vendosjes së ligjeve në sistemin demokratik.

Kujt i takon e drejta për të vendosur ligje në fenë Islame.

Krahasim ndërmjet sistemit demokratik dhe sistemit Islam në këtë çështje.

Kapitulli i dytë

Tema e parë : Argumentet e atyre që e lejojnë hyrjen në kuvend dhe përgjigja ndaj tyre.

- Argumentet nga Kur'ani :
- Argumentimi me historinë e Jusufit alejhi selam:
- Argumentet e sun-netit të profetit salallahu alejhi ue selem :
- Argumentimi me historinë e Nexhashit Allahu e mëshiroftë ²⁶⁶.
- Argumenti i dobive :

Tema e dytë : Argumentet e atyre që e ndalojnë hyrjen në kuvend.

- A është çështja e hyrjes në kuvende çështje ixhtihadi.
- Argumentet e Kur'anit :
- Argumentet nga sun-neti i profetit sal-IAllahu Alejhi ue selem :
- Është e ndaluar për muslimanët që të punojnë nën pushtetin e atyre që kundërshtojnë Islamin.
- Argumenti i rrugës së sahabeve radi Allahu anhum.

²⁶⁶ Marrë nga libri “El Musharekeh fil barlaman uel uizareh” f 224-250 me disa shkurtime.

- Betimi para ligjit.
- Dëmet që ka hyrja në këto vende :

Temë : Fjalët e dijetarëve në lidhje me hyrjen në këto kuvende :

Kapitull i tretë

Temë : A lejohet të votosh nëse kandidati është besimtar ose jobesimtar?

- ❖ Çështje : A lejohet të qëndrosh në një mexhlis ku bëhet shirk ose gjynahe pa i kundërshtuar ato dhe pa u larguar prej tyre?
- ❖ Çështje : Mbyllja e rrugëve të shirkut.

Temë : A lejohen votimet me pretendimin se në to ka dobi dhe lënia e tyre ka dëm dhe ne jemi të urdhëruar të marrim dobitë dhe të largohemi nga dëmet?

- ❖ Çështje : “Ndër dy të këqia ne zgjedhim atë që është më e vogël”.
- ❖ Çështje : A konsiderohet votimi ose hyrja në kuvend rast i domosdoshëm duke ditur se në raste të domosdoshme harami bëhet hallall?
- ❖ Çështje : A janë të imponuar muslimanët të votojnë ose të kandidojnë?
- ❖ Çështje : Krahasim i dobive bashkëkohore me periudhën e Mekës.
- ❖ Çështje : Karaheqim i imagjinuar ndërmjet realitetit dhe periudhës së Mekës.

Temë : A është çështja e hyrjes në këto kuvende ose siç quhet ndryshe kandidimi dhe votimi prej bidateve në fe?

- Çështje : Disa çështje që mendojnë njerëzit se janë kusht që një shpikje të quhet bidat por që në të vërtetë nuk është ashtu.
- Çështje : Ftesa për të votuar mbi mimberet e xhamive.

Mbyllje : Thelbi i gjithë këtyre fjalëve që thashë në libër.